

INSTITUTI ALB-SHKENCA
TAKIMET VJETORE NDËRKOMBËTARE

ALB-SHKENCA INSTITUTE
INTERNATIONAL ANNUAL MEETINGS

**Libri i përmbledhjeve
Takimi i 16-të Ndërkombëtar Vjetor
i Institutit Alb-Shkenca
Shkup, 1-3 tetor 2021**

**Book of Proceedings
The Sixteenth International Annual
Meeting of Alb-Shkenca Institute
Shkup, 1-3 October 2021**



Tiranë - Prishtinë - Shkup

Abstracts

Book of Proceedings


The Sixteenth International Annual Meeting of Alb-Science Institute
Shkup, 01 - 03 October 2021

Të gjitha përmbledhjet e këtij dokumenti janë regjistruar në sistemin **ALPA**[®] nga vetë autorët e tyre. Rrjedhimisht, ndonjë gabim i mundshëm drejtshkrimor apo tjetër në përmbledhje dhe informacionin përkatës është i autorit apo autores përkatëse.

Të drejten për kopjimin dhe shumëfishimin e përmbledhjeve në këtë dokument e ruan ekskluzivisht Instituti Alb-Shkenca (IASH): www.alb-shkenca.org

Gjeneruar më 10 Tetor 2021.

Ky dokument është gjeneruar në mënyrë automatike nga sistemi **ALPA**[®].



ALPA - *Albanian Papers*
mali Information Technologies
<http://alpa.mali-it.eu>

CIP – Katalogizimi në publikim
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare "Shën Kliment Ohridski"
Shkup

304(062)

TAKIMI NDËRKOMBËTAR vjetor i Institutit Alb-Shkenca
(16 ; 2021 ; Shkup)

Libri i përmbledhjeve takimi i 16-të Ndërkombëtar vjetor
i Institutit Alb-Shkenca Shkup, 1-3 tetor 2021 =
Book of proceedings the sixteenth International annual meeting
of Alb-Shkenca Institute Shkup, 1-3 October 2021. – Shkup :
Instituti alb-shkenca ; Skopje :
Alb-Shkenca Institute, 2021. – 271 стр. : ilustr ; 23 см

Teksti në shqip dhe anglisht

ISBN 978-608-4980-00-1

a) Politika sociale – Takime

COBISS.MK-ID 55282437

Content - List of abstracts

Conference of Philology, History and Culture Sciences section

.....	9
<i>Dibra në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878-1881</i> [Dibra in the period of the Albanian League of Prizren 1878-1881]: Zile Kryeziu	
.....	10
<i>Artet pamore shqiptare pas rrëzimit të diktaturës komuniste</i> [Albanian Visual Arts after the fall of the communist dictatorship]: Edmond Muço	
.....	12
<i>Sfidat për gjithëpërfshirje në edukim në sistemin e arsimit para universitar në Kosovë</i> [Challenges for inclusive education in the pre-university education system in Kosovo]: Muhabere Maliqi	
.....	14
<i>"Orkestrat Frymore, djepi i edukimit muzikor shqipëtar"</i> ["Wind Orchestras, the origin of Albanian music education"]: Sokol Saraci	
.....	16
<i>Edukimi gjithëpërfshirës në Kosovë nga perspektiva e fëmijëve me aftësi të kufizuara kundrejt fëmijëve pa aftësi të kufizuara</i> [Inclusive Education in Kosovo from the perspective of Children with disabilities Vs Children without disabilities]: Vjollca Belegu-Caka	
.....	18
<i>"Njeriu i netëve të vjeshtës" ose Robinson Kruzoja i qytetit - hije</i> ["The Man of the Autumn Nights" or the Robinson Crusoe of the shadow city]: Teuta Dhima	
.....	21
<i>Perikopea Evangjelike dhe himni "Krishti u ngjall"</i> [Evangelical Pericope and anthem "Christ is risen"]: Edmond Buharaja	
.....	23
<i>Imazhi i labirintit në veprën "Pallati i Ëndrrave"</i> [The Image of the Labyrinth in the Novel "The Palace of Dreams"]: Neli Naço	
.....	25
<i>Identiteti si mishërim i modeleve ligjërimore</i> [Identity as the Embodiment of Discursive Patterns]: Lirim Sulko	
.....	27
<i>Edukimi dhe arsimimi përballë sfidës globale të digjitalizimit</i> [Education in the face of the global challenge of digitalization]: Rudina Alimerko	
.....	30

<i>Vështrim mbi problemet e letërsisë së sotme për fëmijë dhe të rinj</i> [An overview of the problems of today's literature for children and young people]: Elmira Mucopataj	33
<i>Lasgush Poradeci si folklorist: Koncepte, rezultate, kritere</i> [Lasgush Poradeci as a folklorist: Concepts, results, criteria]: Kristaq Jorgo	35
<i>Elementet fantastike në letërsinë e Ernest Koliqit</i> [Fantastic elements in the literature of Ernest Koliqi]: Eris Rusi	37
<i>Komunikimi publik në veprat "Historia e Skënderbeut" dhe "Rrethimi i Shkodrës" të Marin Barletit dhe komunikimet politike sot: Një qasje krahasuese në funksion të së ardhmes</i> [Public communication in "Skanderbeg's History" and "The Siege of Shkodra" by Marin Barleti and the political communications today: A comparative approach for the future]: Edlira Birko	39
<i>Mbi figurat poetike në poezinë shqipe</i> [Overview on poetic figures in Albanian poetry]: Riza Braholli	42
<i>Gjuha e simboleve në piktograma</i> [Language of symbols in pictogram]: Luljeta Dano	44
<i>Raporti histori - fiksion në prozën e Mehmet Krajes</i> [The history-fiction relationship in prose of Mehmet Kraja]: Hekuran Hasanaj	46
<i>Muzika faktor i rëndësishëm edukativ dhe terapeutike për fëmijët me aftësi ndryshe</i> [Music, as important therapeutic and educational factor for children with different skills]: Eliona Lici	48
<i>Prerjet tematike në prozën e autorit Veli Stafa</i> [Thematic views in the prose of the author Veli Stafa]: Loreta Loli	51
<i>Masnavia dhe rubaia persiane në poetët minorë shqiptarë</i> [The Masnavi and persian rubaiyat in Albanian minor poets]: Blerina Harizaj	53
<i>Balada e Lalë Bajramit</i> [The ballad of Lala Bajram]: Zeqirja Neziri	55
<i>Digjitalizimi i bazës dialektore të shqipes</i> [Digitalization of the Albanian dialectal basis]: Mustafa Ibrahim	57
<i>Gazetaria shqiptare në Maqedoni në vitet e para të pasluftës (1945)</i> [Albanian journalism in Macedonia during first years after the WW2 (1945)]: Sevdail Demiri	59
<i>Huazimet në gjuhën shqipe në aspekt sinkronik dhe diakronik</i> [Borrowings in albanian language in synchronic and diachronic aspect]: Ismail Kamberi	61

<i>Sistemi tatimor i fshatarsisë dhe efekti që pati në ekonomi në regjimin komunist</i> [The tax system of the peasantry and the effect it had on the economy under the communist regime]: Elona Gjellaj	63
<i>Vizita parë e një Sekretari të Përgjithshëm të OKB-së, në Tiranë dhe çështja e Kosovo- vës</i> [First visit of a UN Secretary in Tirana, and Kosovo issue]: Blertha Derhemi	65
<i>Tregimi “ Njerka” - Faik Ballanca</i> ["The Stepmother" story by Faik Ballanca]: Bleta Berisha	67
<i>Leksiku i veprës së Azem Shkreli</i> [Azem Shkreli's Works Vocabulary]: Ali Caka	69
<i>Pastërtia e gjuhës problem gjithnjë i mprehtë për gjuhën shqipe (Me rastin e 60- vjetorit të ndarjes nga jeta të prof. Aleksandër Xhuvanit 1961-2021)</i> [The language purity remains a sensible issue for the Albanian (On the 60th an- niversary of Prof. Aleksandër Xhuvani's death, 1961-2021)]: Emil Lafa	72
<i>Applied Computer Science Conference (IASH- ACSC)</i>	75
<i>Përdorimi i teknologjive blockchain për të përmirësuar votimin me kusht</i> [Using blockchain technologies to improve conditional voting]: Vehbi Neziri, Blerim Rexha, Ramadan Dervishi, Isak Shabani	76
<i>Aplikimi i teknologjisë blockchain në Open Banking / PSD2, siguria e të dhëna- ve dhe privatësia</i> [Application of Blockchain technology in Open Banking / PSD2, data security and privacy]: Ramadan Dervishi, Blerim Rexha, Vehbi Ne- ziri, Kadri Sylejmani	79
<i>Zbatimi i një modeli për identifikimin e autorësisë bazuar në machine-learning për gjuhën shqipe</i> [Application of authorship identification model based on machine-learning for Albanian language]: Miranda Harizaj, Arli Minga, Vil- ma Tomço, Alfons Harizaj	82
<i>Integrimi i Industrisë 4.0 në sistemet e kontrollit Ethernet të makinave me kontroll numerik</i> [Integration of Industry 4.0 in CNC Ethernet control systems]: Mi- randa Harizaj, Igli Bisha	84
<i>Efekti i dizajnit të arkitekturës si komponentë jo -dixhitale në zhvillimin e industrisë dixhitale - rast studimi Prishtinë, Kosovë</i> [The effect of architecture design as the non-digital component to the digital industry development - case study Prishtina, Kosovo]: Arta Basha - Jakupi, Gresa Kuleta, Vlora Navakazi	86

<i>Arsimi i lartë në epokën e digjitalizimit shikuar nga këndvështrimi i teknologjisë blockchain [Higher education in the age of digitalization viewed from the perspective of blockchain technology]:</i> Ali Caka, Vehbi Neziri	88
--	----

Conference of Law Sciences section

<i>Paditja e mundshme e Serbisë nga Kosova para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë: Potenciali i një rasti bazuar në Konventën kundër Gjenocidit [The possible lawsuit by Kosovo against Serbia before the International Court of Justice: The potential for such a case based the Convention Against Genocide]:</i> Gentian Zyberi	91
<i>Transformimet e së Drejtës së Pronësisë gjatë Shekullit XX në Shqipëri [The Transformation of Property Law during the XX Century in Albania]:</i> Ervin Pupe	93
<i>Shpëtimi në Det, nga një "Detyrim i Angazhimit" në "E Drejta për Zbarkim" analizë e të Drejtës Ndërkombëtare të Njeriut [Rescue at Sea, from an ‘Obligation of Conduct’ to ‘Right to Disembark’ in light of International Human Rights Law]:</i> Enkelejda Koka, Isli Addiu	95
<i>Partneriteti Publik-Privat në ofrimin e të mirave/shërbimeve publike. Rasti i Shqipërisë dhe vështrim krahasues kryesisht me vendet e rajonit dhe vendet e BE-së. [Partnership Public-Private in providing public goods/services. The case of Albania and comparative view mainly with the countries in the region and EU countries.]:</i> Renata Kau, Sofjana Veliu	97

Conference of Agriculture Sciences section

<i>“Përdorimi i energjisë diellore për furnizimin me energji të fabrikës së përpunimit të frutave “Kop. Frut”. Krahasim i përfitimit Energjetik dhe Ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe Gjermanisë” [“Using solar energy to power the fruit processing plant “Kop. Frut”. Comparison of Energy and Economic benefit between Albania and Germany”]:</i> Kristjana Sulejmani, Aleksander Peqini, Etleva Jojiç	101
<i>Vleresimi i ekosistemit pyje - kullota dhe impakti ne mjedis, Komuna Antigone, Gjirokastr. [The environmental assessment of the forest and pasture ecosystem in Antigone administrative unit, Gjirokastr.]:</i> Klevis Dajlani, Liri Miho, Ardian Maci	104

Conference of Environmental Sciences section

.....	106
<i>MASKAT - NDIKIMI I TYRE NË MJEDIS</i> [MASKS - THEIR IMPACT ON THE ENVIRONMENT]: Florije Tahiri	
.....	107

Conference of Economical Sciences section

.....	110
<i>Meta - Analizë: Pronësia e Aksioneve të Punonjësve dhe Kostoja e Kapitalit</i> [A Meta - Analysis: Employee Stock Ownership and the Cost of Capital]: Fisnik Morina	
.....	111

Conference of Natural Sciences section

.....	113
<i>Vlerësimi i elementeve metalike në Primula veris L., Primulaceae në Kosovë</i> [Evaluation of metallic elements in Primula veris L., Primulaceae in Kosovo]: Arjana Ylli, Laura Binxhia	
.....	114
<i>Vlerësimi i absorbimit të dritës nga karboni i zi në ajër për grimcat PM2.5 të mbledhura në rrethinat urbane të Tiranës</i> [Enhanced Light Absorption of Black Carbon Aerosols in PM2.5 collected in Tirana urban outskirts]: Lotar Kurti, Fotion Mitrush, Fatos Ylli	
.....	116
<i>Ndryshimet fiziko-kimike të vajit të farës së kungullit gjatë pjekjes së farës dhe ndikimi në stabilitetin e lipideve të vajit të farës së kungullit të pjekur</i> [Physico-chemical changes of pumpkin seed oil during seed roasting and impact in lipid stability of roasted pumpkin seed oil]: Fatos Rexhepi, Aziz Behrami	
.....	119

Conference of Medical Sciences section

.....	121
<i>Impakti psikoemocional që shkaktoi pandemia e Covid-19 tek studentët e infermierisë</i> [The psycho-emotional impact that caused the Covid-19 pandemic on nursing students]: Valbona Alliu, Alketa Qosja (Hoxha), Rudina Pirushi	
.....	122

<i>TE DHENA EPIDEMIOLOGJIKE TE INTERVENTEVE KIRURGJIKALE PLASTIKE NE REGJIONIN E KOKE-QAFES [EPIDEMIOLOGICAL DATA OF PLASTIC SURGERY INTERVENTIONS IN THE HEAD-NECK REGION]:</i> Besnik Faskaj	125
<i>Zakonet e të ushqyerit dhe stili i të jetuarit tek adoleshentët në qytetin e Prishtinës [Dietary Habits and Lifestyle among Adolescents in the Pristina City]:</i> Laura Binxhija Qeska	128
Conference of Engineering and Information Technology Sciences section	130
<i>Modelimi matematikorë i afatit të shfrytëzimit të litarëve të çelikut në minierën “Trepça” Stan Tërg [Mathematical modeling of using time - period for the steel ropes at the “Trepça” mine Stan Terg]:</i> Ujmir Uka, Irfan Voca, Egzon Fetahu	131
<i>Ndikimi i zgjyrës së granular në përmirësimin i vetive të asfalt betoneve të derdhura [The influence of granulated slag on the improvement of properties of poured concrete asphalt]:</i> Izet Ibrahim, Nurten Beligradi-Deva, Musa Rizaj	134
<i>Rëndësia e kombinimit të imazheve të sentinel 1 dhe 2 për minierën e bitumit në Selenice, Shqipëri [Importance of combining sentinel 1 and 2 images of Selenica bitumen mine in Albania]:</i> Pietro Belba	137
<i>Vlerësimi i efikasitetit të paneleve fotovoltaike të instaluar në godinën e agromekanikës, Universiteti Bujqësor i Tiranës [Evaluation of the efficiency of photovoltaic panels installed in the building of agromechanics, Agricultural University of Tirana]:</i> Etleva Jojiç, Edmond Demollari, Aleksander Peqini, Olsid Mema, Ndoc Vata	139
<i>Ndikimi ekonomik dhe mjedisor i shfrytëzimit të lymit anodik të bakrit sekondar [Economic and environmental impact of secondary copper anodic slim utilization]:</i> Nurten Beligradi-Deva, Izet Ibrahim, Muharrem Zabeli	142
<i>Rindërtimi 3D CAD i modeleve të serisë NPL të karnave të shpejta dislokuese më fund të rrumbullakosur [3D CAD reconstruction of models of the NPL systematic series of fast displacement round bilge hull forms.]:</i> Blenard Xhaferaj	145
<i>Hulumtimi i metaleve të rënda në frutat e mollëve të kultivuara në fshatrat e rajonit të Mitrovicës [Research of heavy metals in apple cultivated fruits in the villages of Mitrovica region]:</i> Milaim Sadiku, Sadija Kadriu, Yllka Mehana, Burim Hoxhaxhiku	147

<i>Cilësia e ujit të pijshëm të puseve në fshatrat Novolan e Brusnik të Vushtrrisë- Kosovë</i> [The quality of drinking water of wells in Novolan and Brusnik villages of Vushtrria- Kosovo]: Sadija Kadriu, Milaim Sadiku, Arbër Hyseni	150
<i>Përcaktimi i dozës optimale të koagulantit në procesin e kthjellimit të ujit</i> [Determination of the optimal coagulant dose in the water cleaning process]: Mehush Aliu, Mensur Kelmendi	153
<i>Hulumtimi i efikasitetit të reaktorit të mbyllur ciklik dhe atij me llum aktiv në zvogëlimin e azotit dhe fosforit gjatë trajtimit të ujërave të zeza</i> [Research of efficiency of sequencing batch reactor and activated sludge tank in reduction of phosphorus and nitrogen]: Mensur Kelmendi, Mehush Aliu, Endrit Kelmendi	155
<i>Rëndësia e zbatimit të konventës së Kryebashkiakëve për Bashkinë e Tiranës</i> [The importance of the implementation of the Covenant of Mayors in the Municipality of Tirana]: Aida Spahiu, Loreta Nakuçi, Lindita Dhamo	158
<i>Ndikimi i lopatave në trupin e furrave rrotulluese, në uzinën e ferronikelit në Drenas</i> [Impact of shovels on the body of rotary kiln, in the ferronikel plant in Drenas]: Zarife Bajraktari-Gashi	161
<i>Arkitektura dhe dimensionimi digjital në rikrijimin e marrëdhënieve shoqërore dhe hapësinore</i> [Architecture and the Digital Dimension: Recreating Social and Spatial Relations]: Dasara Pula	163
<i>Mbi rëndësinë dhe llogaritjen e treguesit të ri, EsCJ, për vlerësimin mjedisor të mbulesës së banesave</i> [On the importance and calculation of the new indicator, EeLC, for environmental assessment of the dwelling roofs]: Shpresa Caslli, Dervish Elezi, Elfrida Shehu	166
<i>Organizimi dhe funksionimi i sigurisë ushqimore në Kosovë</i> [Organization and functioning of food safety in Kosovo]: Valdet Gjinovci, Ismet Mulliqi, Festim Rexhepi	169
<i>Rreziku i tërmeteve në disa nga pikat më të rëndësishme bregdetare në Shqipëri. Përcaktimi i rrezikut më anë të simulimeve me programet kompjuterike</i> [Earthquake risk in some of the most important coastal points in Albania. Risk determination through simulations with computer programs]: Adisa Daberdini, Novrus Metaj	171
<i>Fusha makrosizmike rajonale për tërmetin e gjirit të Lalzit, 2018 (m 5.1)</i> [Regional macrosismic field for Lalzi bay earthquake, 2018 (m 5.1)]: Novrus Metaj, Adisa Daberdini, Rrapo Ormeni	173

Korniza e qëndrueshmërisë Flogen dhe roli primar i shkencës dhe teknologjisë [Flo-
gen sustainability framework and the primary role of science and technology]:
Musa Rizaj, Justina Pula, Florian Kongoli 176

Vlerësimi i zonës së sigurisë së rrezatimit RF, metodat dhe instrumentet matëse [RF
radiation safety zone assessment, methods and measuring instruments]: **Besnik
Dobi, Sonila Dobi, Ermal Dobi** 179

Conference of Social and Political Sciences section

. 182

Ndikimi i besimeve fetare në sistemin e vlerave të shoqërisë shqiptare [The influence
of religious beliefs in the value system of the Albanian society]: **Ada Kocani** 183

*Efikasiteti i kornizës së kurrikulës në promovimin e vlerave sociale në arsimin para
universitar në Republikën e Kosovës* [The efficiency of curriculum framework
on promotion of social values on the pre-university education in the Republic
of Kosovo]: **Muhabere Maliqi** 185

Lista e autorëve - Author list 187

Abstracts

Conference of Philology, History and Culture Sciences section

The Sixteenth International Annual Meeting of Alb-Science Institute
Shkup, 01 - 03 October 2021

Të gjitha përmbledhjet e këtij dokumenti janë regjistruar në sistemin **ALPA**® nga vetë autorët e tyre. Rrjedhimisht, ndonjë gabim i mundshëm drejtshkrimor apo tjetër në përmbledhje dhe informacionin përkatës është i autorit apo autores përkatëse.

Të drejten për kopjimin dhe shumëfishimin e përmbledhjeve në këtë dokument e ruan ekskluzivisht Instituti Alb-Shkenca (IASH): www.alb-shkenca.org

Gjeneruar më 10 Tetor 2021.

Ky dokument është gjeneruar në mënyrë automatike nga sistemi **ALPA**®.



ALPA - *Albanian Papers*
mali Information Technologies
<http://alpa.mali-it.eu>

Dibra në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878-1881

Dibra in the period of the Albanian League of Prizren 1878-1881

ZILE KRYEZIU
Arsim
Tiranë, ALBANIA
zileta@hotmail.com

Fjalë çelës: Dibra, Kongresi i Berlinit, Iljaz Pashe Dibra.

Keywords: Dibra, Congress of Berlin, Iljaz Pashe Dibra.

Përmbledhja:

Kriza Lindore solli dobësimin e Perandorisë Osmane, por njëkohësisht edhe rrezikun e madh që u shfaqej trevave Shqiptare nga copëtimi i shteteve fqinje. Traktati i Shën Stefanit alarmoi Fuqitë e Mëdha perëndimore, pasi sipas tij realizohej ëndrra e vjetër Ruse e pansllavizmit dhe zotërimi nga ana e saj e detit Mesdhe. Sipas këtij traktati zgjeroheshin shumë kufijtë e shteteve të Ballkanit në dëm të tokave Shqiptare. Krahu e Dibrës sipas këtij traktati duhej t'i aneksohej Bullgarisë. Dibra sapo mori vesh këtë lajm reagoi menjëherë nëpërmjet një telegrami drejtuar ambasadës angleze në Stamboll: "Lajmërohem se Dibra hyn midis viseve që iu dhanë Bullgarisë në Shën Stefan. Populli i Dibrës është egërsuar tepër nga ky lajm. Dibra s'ka të bëjë fare me vendin që quhet Bullgari. Dibra është një vend krejt shqiptar dhe ka mbi 220.000 myslimanë e 10.000 të krishterë të cilët, të gjithë janë prej gjakut shqiptar. Më mirë shuhemi deri në ma të fundit se sa të hyjmë nën sundimin e Bullgarisë, kundër dëshirës sonë, e kundër të drejtave të kombësisë sonë". Anglia dhe Gjermania thirrën me nxitim Kongresin e Berlinit më 13 qershor 1878 për të studiuar dhe rishikuar kushtet e Traktatit të Shën Stefanit. Perandoria Osmane e frikësuar nga shpërbërja e menjëhershme i mirëpriti shqiptarët madje i nixiti të organizonin komitetet e "vetëmbrotjes" me shpresën e shmangies së mëtejshme të shpërbërjes së Perandorisë. Ata i lutën shqiptarëve myslimanë ta shpallnin veten besnikë të saj. Patriotët shqiptarë nuk mund të pranonin asnjë nga dy alternativat: as nënshtrimin ndaj sllavëve dhe as vazhdimin e nënshtrimit nga osmanët. Për këto arsye ata filluan të organizoheshin, ku organizimi më i madh është thirrja e Kuvendit të Prizrenit tre ditë para hapjes së Kongresit të Berlinit. Kuvendi i Prizrenit është ngjarja më e madhe historike në Historinë e Popullit Shqiptar pasi aty u lidh besa ndërmjet shqiptarëve për të mbrojtur trojet nga copëtimi. Shqiptarët në prag të Lidhjes së Prizrenit ishin në një situatë shumë të vështirë pasi ata nuk kishin mbështetje nga asnjë faktor i jashtëm dhe ndërkohë udhëheqësit e politikës Shqiptare bënë përpjekje të fuqishme pranë Portës së Lartë që të lejonte formimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, por ajo nuk i mori parasysh kërkesat e tyre. Porta e Lartë u shqetësua nga lëvizjet e vazhdueshme popullore në Shqipëri, për këtë arsye në fund të majit 1878 thirri në Stamboll shumë nga personalitetet shqiptare të dy vilajeteve të Shqipërisë: Kosovës dhe Janinës. Ndër to mund të përmenden: Ali bej Guçia, Iljaz pashë Dibra, Sheh Mustafa Tetova, Zija Prishtina e të tjerë. Qëllimi i kësaj mbledhjeje nga Porta e Lartë ishte që nëpërmjet presionit t'i detyronte këta patriotë që t'i jepnin besëlidhjes që do të formonin karakterin e një organizate ballkanike islamike. Madje ajo u përpoq që të vonote takimin dhe t'i mbante sa më gjatë në Stamboll me synimin që të mos përfaqësoheshin në kuvendin që po përgatitej të mbledhej në Prizren. Patriotët shqiptarë e kuptuan këtë qëllim të Portës së Lartë dhe nuk pritën, por në mëngjesin e 8 qershorit u nisën drejt Prizrenit. Nismën për thirrjen e Kuvendit të përgjithshëm e mori Komiteti i Stambollit, i cili u formua në Stamboll nga një grup patriotësh, bërthamën e të cilit e përbënin rilindasit e njohur Pashko Vasa, Jani Vreto, Zija Prishtina, Abdyl Frashëri e të tjerë, të cilët ishin të mendimit se

tërësia e tokave shqiptare mund të mbrohej vetëm nëse lufta për të mbështetej në parimin e kombësisë dhe të ngrihej deri në sigurimin e autonomisë.

Abstract:

The Eastern Crisis brought the weakening of the Ottoman Empire, but at the same time the great danger that appeared to the Albanian territories from the fragmentation of the neighboring states. its the Mediterranean Sea. According to this treaty, many borders of the Balkan states were expanded to the detriment of Albanian lands. According to this treaty, the province of Dibra was to be annexed to Bulgaria. As soon as Dibra heard this news, he immediately responded via a telegram to the British Embassy in Istanbul: "We are informed that Dibra is among the territories given to Bulgaria in St. Stephen. The people of Dibra are very angry with this news. Dibra has nothing to do with the place called Bulgaria. Dibra is an all-Albanian country and has over 220,000 Muslims and 10,000 Christians who are all of Albanian blood, of our nationality ". England and Germany hastily convened the Congress of Berlin on 13 June 1878 to study and revise the terms of the Treaty of St. Stephen. Fearing immediate dissolution, the Ottoman Empire welcomed the Albanians and even encouraged them to organize "self-defense" committees in the hope of further avoiding the dissolution of the Empire. They prayed to Muslim Albanians to declare themselves loyal to it. Albanian patriots could not accept either of the two alternatives: neither submission to the Slavs nor continued subjugation by the Ottomans. For these reasons they began to organize, where the largest organization is the convening of the Assembly of Prizren three days before the opening of the Berlin Congress. The Assembly of Prizren is the largest historical event in history of the Albanians on the eve of the League of Prizren were in a very difficult situation as they had no support from any external factor and meanwhile the leaders of Albanian politics made strong efforts near the High Gate to allow the formation of the Albanian League of Prizren, but it did not consider their request. The Assembly of Prizren is the largest historical event in the History of the Albanian People as it was a pledge between Albanians to protect the lands from fragmentation. The Albanians on the eve of the League of Prizren were in a very difficult situation as they had no support from any external factor and meanwhile the leaders of Albanian politics made strong efforts near the High Gate to allow the formation of the Albanian League of Prizren, but it did not consider their request. The High Gate was disturbed by the constant popular movements in Albania, for this reason at the end of the year 1878 many of the Albanian personalities of the two vilayets of Albania were invited to Istanbul: Kosovo and Ioannina. Among them can be mentioned; Ali bej Guxia, Iljaz pasha Dibra, Sheh Mustafa Tetova Zija Prishtina etc. The purpose of this was gathered from the High Gate to pressure these patriots to give the covenant that would form the character of a Balkan Islamic organization, and she even tried to delay the meeting and keep it as long as possible in Stamoll with the intention that not to be represented in the assembly that was preparing to convene in Prizren. The Albanian patriots understood this purpose of the High Gate and did not wait, but on the morning of June 8 they left for Prizren. The initiative to convene the General Assembly was taken by the Istanbul Committee, which was formed in Istanbul by a group of patriots, whose core consisted of the well-known renaissance Pashko Vasa, Jani Vreto, Zija Prishtina, Abdyl Frashëri and others, who were the opinion that the entirety of Albanian lands could be protected only if the struggle for it was based on the principle of nationality and raised to the point of securing autonomy.

Artet pamore shqiptare pas rrëzimit të diktaturës komuniste Albanian Visual Arts after the fall of the communist dictatorship.

EDMOND MUÇO

Akademia e Studimeve Albanologjike

Tiranë, ALBANIA

edmondmuco3@gmail.com

Fjalë çelës: Artet pamore, realizmi socialist, diktatura komuniste, ekspozita.

Keywords: Visual arts, socialist realism, communist dictatorship, exhibition.

Përmbledhja:

Qëllimi i këtij punimi është t'i evidentojë artet pamore në Shqipëri, ato të periudhës së Realizmit Socialist dhe ato të periudhës pas rrëzimit të diktaturës komuniste. Çështjet që do të trajtohen janë: (1) periudha e Realizmit Socialist; dhe periudha e transformimit të arteve pamore në vitet e fundit të shekullit të kaluar dhe të fillimshekullit XXI. Kështu, së pari do të pasqyrojmë periudhën e Realizmit Socialist. Kjo veprimtari artistike u zhvillua në një periudhë, ku, më tepër se kurrë ngjizja e artit me ideologjinë u ofrua si formati i vetëm artistik. Realizmi Socialist vendos përjetoi ndryshime stilistike "tronditëse", gjithnjë për të njëjtën arsye. Shtetit, porositi i vetëm i veprave të artit i interesonte një art militant, materializues i denjë i ideologjisë shtetërore, ku mesazhi nuk duhej cënuar në emër të qëllimit parësor; Së dyti do të trajtohen më gjerësisht zhvillimet e arteve pamore pas viteve të '90 - ta. Për artistët shqiptarë, fillimvitet '90 ishin përtej të gjitha përkufizimeve të lirisë krijuese. Ndërkaq secili tashmë ishte në kërkim të një stili estetik personal për një publik të ri, që për më tepër nuk mbyllej më në kufinj të vendit, por mund të propozohej dhe në galeri perëndimore, duke u peshuar në parametra dhe rregulla loje tërësisht të tjerë. U dalluan grupime artistësh të rinj e më pak të rinj, të cilët duke ekspozuar, shpesh në shumë ekspozita të përbashkëta ndihmonte secilin prej tyre në gjetjen e zërit personal. Njëri prej këtyre grupimeve, ndërtuar si i tillë (në heshtje) që në vitet '80 ishte ai i përbërë nga piktorët Edi Hila, Bashkim Ahmeti, Gazmend Leka e Ilir Pojani. Secili prej tyre edhe pse vinte nga një ndërtim akademik i njëjtë, ishte në kërkim të një identiteti estetik bazuar në eksperiencën personale e jetësore tejet të ndryshme, siç ishte rasti i piktorit Edi Hila, i cili që në fundvitet '70, kishte punuar fshehtëzi subjektet dhe personazhet e habitatit socialist, me nota të ethshme groteske e të një trajtimi stilistik të huazuar nga ekspresionizmi gjerman. Së fundi, të çliruar përfundimisht nga censura e komisioneve u krijuan shoqata, u hapën galeri private, u ekspozuan vepra artistike në shumë vende perëndimore, sa brenda, ashtu edhe jashtë kontinentit. U krijua shoqata e piktorëve dhe e skulptorëve të pavarur shqiptarë, e cila kishte për qëllim "krijimin e një klime artistike shpirtërore të përshtatshme për të nxitur e stimuluar forcat krijuese e talentet e reja", si dhe ndarjen nga e kaluara, sidomos me lidhjen e shkrimtarëve dhe të artistëve. Viti 1993 do të shënonte dhe hapjen e galerisë Te & Gi, e para galeri private. Në aspektin metodologjik studimi mbështetet në vëzhgimin në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë, në disa galeri të rretheve, si dhe bashkëbisedime me artistë pamorë të periudhës së Realizmit Socialist dhe atë të ditëve të sotme. Rezultatet japin një tablo të zhvillimeve artistike gjatë periudhës së Realizmit Socialist dhe zhvillimet pas përmbysjes së diktaturës komuniste, ku arti u çlirua nga censura dhe komisionet. Studimi, kështu do të përpiqet të përcaktojë rrugët e transformimit dhe të orientimit që do të marrin artet pamore në fillimshekullin XXI. Ky studim është i dobishëm për studiuesit dhe

studentët e artit.

Abstract:

The purpose of this paper is to highlight the visual arts in Albania, those of the period of Socialist Realism and those of the period after the fall of the communist dictatorship. The issues to be addressed are: (1) the period of Socialist Realism and the period of transformation of the visual arts in the last years of the last century and the beginning of the XXI century. Thus, we will first reflect on the period of Socialist Realism. This artistic activity took place in a period when, more than ever, the conception of art with ideology was offered as the only artistic format. Domestic Socialist realism experienced "shocking" stylistic changes, always for the same reason. The state, the sole commissioner of works of art, was interested in a militant art, a worthy materializer of state ideology, where the message should not be violated in the name of the primary purpose; Second, the developments in the visual arts after the 1990s will be discussed in more detail. For Albanian artists, the early 1990s were beyond all definitions of creative freedom. Meanwhile, everyone was already looking for a personal aesthetic style for a new public, which moreover was no longer confined to the borders of the country, but could be proposed in the western gallery, being weighed in completely different parameters and rules of the game. Groups of young and lesser-known artists were distinguished, who by exhibiting, often in many joint exhibitions, helped each of them to find their personal voice. One of these groups, built as such (silently) since the '80s was the one composed of painters Edi Hila, Bashkim Ahmeti, Gazmend Leka and Ilir Pojani. Each of them, although coming from the same academic structure, was looking for an aesthetic identity based on very different personal and life experience, as was the case of the painter Edi Hila, who since the late '70s, had secretly worked on the subjects and characters of socialist habitat, with feverish grotesque notes and of a stylistic treatment borrowed from German expressionism. Finally, finally freed from the censorship of the commissions, associations were created, private galleries were opened, works of art were exhibited in many western countries, both inside and outside the continent. The Association of Independent Albanian Painters and Sculptors was established, which aimed to "create a suitable spiritual artistic climate to stimulate and stimulate creative forces and new talents", as well as separation from the past, especially with the connection of writers and artists. The year 1993 would also mark the opening of the Te & Gi gallery, the first private gallery. In terms of methodology, the study is based on observations at the National Gallery of Arts in Tirana, in several district galleries, as well as conversations with visual artists of the period of Socialist Realism and that of today. The results give an overview of artistic developments during the period of Socialist Realism and developments after the overthrow of the communist dictatorship, where art was liberated from censorship and commissions. The study will thus try to determine the paths of transformation and orientation that the visual arts will take in the early 21st century. This study is useful for art researchers and students.

Sfidat për gjithëpërfshirje në edukim në sistemin e arsimit para universitar në Kosovë

Challenges for inclusive education in the pre-university education system in Kosovo

MUHABERE MALIQI

Universiteti i Prishtinës

Prishtinë, KOSOVA

muhabere.r.maliqi@gmail.com

Fjalë çelës: Edukimi, gjithëpërfshirja, reforma, integrimi, kurrikula

Keywords: Education, inclusion, reform, integration, curriculum

Përmbledhja:

Abstrakt Gjithëpërfshirja është një qasje që pjesëmarrja në arsimit të jetë një e drejtë për të gjithë, pa varësisht dallimeve apo aftësive të nxënësve, me qëllimin për të ruajtur barazinë në shoqëri. Përmes arsimit gjithëpërfshirës kërkohet që të adresohen nevojat mësimore për të gjithë fëmijët, me një fokus specifik tek ata që janë më të rrezikuar nga marginalizimi dhe përjashtimi. Shpesh, termi arsim gjithëpërfshirës bëhet sinonim i arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Mirëpo arsimi i suksesshëm gjithëpërfshirës nënkupton kur të gjithë fëmijët pa dallime si përkatësia etnike, gjuha, gjinia, aftësitë dhe statusi socio-ekonomik, përfshihen brenda sistemit arsimor. Arsimit është e drejta themelore e çdo fëmije, andaj qëllimi është të sigurohet që të gjithë të kenë qasje në arsim në mënyrë që të fitojnë njohuri dhe aftësi që do t'i përgatisë ata për të ardhmen e tyre si dhe të kontribuojnë për komunitetin në përgjithësi. Gjithashtu, fëmijët me nevoja të veçanta duhet të përfshihen në sistemin arsimor të përgjithshëm pa ndonjë dallim dhe diskriminim. Sipas autorëve për gjithëpërfshirje në sistemin arsimor, fëmijët me nevoja të veçanta nuk duhet të vendosen brenda shkollave speciale, por mund të merren masa për përfshirjen e tyre në sistemin e arsimit të përgjithshëm, ku mund të kenë mundësi të mësojnë me nxënës të tjerë. Sidoqoftë, për arritjen e suksesit në arsimin gjithëpërfshirës qëndrojnë disa pengesa dhe sfida. Shumë probleme të tilla si, mungesa e mësuesve të arsimuar mirë, kurrikula jo adekuate, burime të pamjaftueshme, mungesë të pajisjeve infrastrukturore, mungesa e vetëdijesimit, mungesa e politikave dhe veprimeve adekuate krijojnë pengesa për shtrirjen e konceptit të arsimit gjithëpërfshirës. Qëllimi i studimit është të shqyrtoj disa probleme që krijojnë pengesa në zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës. Suksesi i arsimit gjithëpërfshirës pengohet nga faktorë të ndryshëm organizativ dhe ndërinstitucional të cilët mbajnë edhe përgjegjësinë kryesore për promovimin e arsimit gjithëpërfshirës, zbatimin e politikave dhe udhëzimeve ekzistuese. Ndër pengesat e përmendura, është edhe përgatitja e një mësuesi të mirë, efektiv dhe kompetent, i cili mund të drejtojë dhe praktikojë në mënyrë adekuate konceptin e arsimit gjithëpërfshirës. Për më tepër, duhet të bëhet akoma më shumë për të siguruar që të arrihet më e mira nga objektivat e arsimit gjithëpërfshirës. Çelësi i suksesit për arsimin gjithëpërfshirës është se nevojitet një qasje transformuese. Transformimi i sistemit të shkollave të rregullta është i nevojshëm në mënyrë që të ofrohen kapacitete shtesë për të arritur që të gjithë nxënësit në një mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme të bëhen pjesë e sistemit arsimor. Rëndësia e këtij studimi konsiston në mundësinë për të identifikuar sfidat të cilat ndikojnë në zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë. Arsimit gjithëpërfshirës është një nga parimet kryesore të paraqitura edhe Kornizën në Kurrikulën të Kosovës. Rekomandimet nga ky punim mund të ndihmojnë politikëbërësit për të adresuar disa nga

faktorët që ndikojnë në arsimin gjithëpërfshirës. Gjithashtu mund të theksohen disa nga pengesat në zbatimin e gjithëpërfshirjes nga shkollat si institucione me përgjegjësi të lartë në këtë proces. Metodat e përdorura janë analiza e përmbajtjes ku janë identifikuar aspekti ligjor dhe organizativ për arsimin gjithëpërfshirës, metoda historike për analizimin e trendeve respektivisht suksesit në zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës si dhe intervistat si metodë për identifikim më të detajuar të sfidave në realizimin e arsimit gjithëpërfshirës.

Abstract:

Abstract Inclusive education is an approach that participation in education is a right for all, regardless of students' differences or abilities, with the aim of maintaining equality in society. Inclusive education seeks to address the learning needs of all children, with a specific focus on those most at risk of marginalization and exclusion. Often, the term inclusive education becomes synonymous with education for children with disabilities. However, successful inclusive education means when all children, regardless of ethnicity, language, tender, abilities and socio-economic status, are included within the education system. Education is a fundamental right of every child, therefore the goal is to ensure that everyone has access to education in order to gain knowledge and skills that will prepare them for their future as well as contribute to the community. In addition, children with special needs should be included in the general education system without any distinction or discrimination. According to the authors for inclusion in the education system, children with special needs should not be placed within special schools, but measures can be taken for their inclusion in the general education system, where they can have the opportunity to learn with other students. However, there are some obstacles and challenges to achieving success in inclusive education. Many problems such as lack of well-educated teachers, inadequate curricula, insufficient resources, lack of infrastructure equipment, lack of awareness, lack of adequate policies and actions create obstacles to the extension of the concept of inclusive education. The purpose of the study is to examine some problems that create obstacles in the implementation of inclusive education. The success of inclusive education is hindered by various organizational and inter-institutional factors, which also bear the primary responsibility for promoting inclusive education, implementing existing policies and guidelines. Among the obstacles mentioned is the preparation of a good, effective and competent teacher, who can adequately guide and practice the concept of inclusive education. In addition, more needs to be done to ensure that the outmost of the inclusive education objectives are achieved. The key to success for inclusive education is in need for a transformational approach. The transformation of the regular schooling system is necessary, in order to provide additional capacities, so that all students become part of the education system in a continuous and sustainable way. The importance of this study consists of the possibility to identify the challenges that affect the implementation of inclusive education in Kosovo. Inclusive education is one of the main principles presented in the Kosovo Curriculum Framework. Recommendations from this paper can help policymakers address some of the factors influencing inclusive education. In addition, it will be highlighted some of the obstacles, in the implementation of inclusion by schools as institutions with high responsibility in this process. The methods used are content analysis, where the legal and organizational aspects of inclusive education are identified, historical methods for analyzing trends and success in the implementation of inclusive education and interviews as a method for more detailed identification of challenges in the realization of inclusive education.

"Orkestrat Frymore, djepi i edukimit muzikor shqipëtar" "Wind Orchestras, the origin of Albanian music education"

SOKOL SARACI
Universiteti i Arteve
Tiranë, ALBANIA
saracisokol@yahoo.com

Fjalë çelës: teori, edukim, muzike, histori, shkrimi
Keywords: theory, education, music, history, writing

Përmbledhja:

Në artikullin "Orkestrat Frymore, djepi i edukimit muzikor shqiptar" trajtohet kryesisht problematika dhe zhvillimi i muzikës si shkencë në Shqipëri. Trajtimi historik dhe kulturor i kohës kur u krijuan këto banda muzikore është shumë i rëndësishëm. Figurat që kontribuan në krijimin e tyre dhe muzikantët që i drejtuan këto banda muzikore janë të një rëndësie të veçantë jo vetëm në muzikën tonë, por edhe në historinë tonë në tërësi. Nëpërmjet mësimit të interpretimit në instrumentet frymore, ata hodhën bazat për pedagogjinë e këtyre instrumenteve. Deri në këtë moment teoria e muzikës, shkrimi, apo edhe leximi i notave muzikore nuk ekzistonte. Kësisoj, mungonin muzikantët profesionistë, si në fushën e teorisë, ashtu edhe në atë të interpretimit. Krijimi i këtyre orkestrave frymore fillimisht nisi në qytetin e Shkodrës me kontributin e klerit katolik të kohës, i cili kishte një mbrojtje nga ish perandoria Austro-Hungareze dhe Vatikani. Kontaktet e shumta me Perëndimin dhe misionarët e shumtë që vinin në Shqipëri sillnin me vete frymën e kulturës së arteve, letërsisë, pikturës dhe muzikës nga këto vende. Edhe Korça, si një qytet që kishte lidhje të forta me komunitetin e shqiptarëve të Bukureshtit apo emigrantët e shumtë të Amerikës, solli kontribute të shquara në fushën e arsimit shqip. U bë një ndër qytetet e para në Shqipëri që krijoi dhe ngriti orkestrën e parë frymore në këtë periudhë. Kjo pasuroi dhe zhvilloi jetën artistike, por edhe bëri të mundur mësimin e instrumenteve muzikore dhe të notave muzikore. Kthimi i këtyre formacioneve muzikore në shkolla për mësimin e instrumenteve dhe luajtja e muzikës së kompozitorëve të famshëm përbën një risi e zhvillim të madh për kohën. Në kuptimin e lavrimit të kësaj teme me karakter historik, ka patur përpjekje të herë pas hershme, sidomos pas viteve 1990, të trajtohet sadopak. Por si efekt i regjimit komunist, ku u fshi kontributi i klerit katolik apo figurave që patën vlera të mëdha në histori, informacioni ka qenë pothuajse i papërfillshëm. Kështu, është me rëndësi që gjithashtu të lidhet konteksti historik me atë muzikor; Si ai i viteve 1878 - kur u krijua banda e parë muzikore në Shkodër, vit i cili përkon me lëvizjen patriotike për shkëputje nga Perandoria Osmane dhe themelimin e Lidhjes së Prizrenit. Trajtimi i kësaj teme në kontekstin muzikor, nxjerr në pah rëndësinë e këtyre lëvizjeve, si dhe shfaq rrjedhojat e rëndësishme të kulturës në formimin e një vendi. Pa kontributin e këtyre muzikantëve dhe patriotëve, sot do të kishim një pjesë të munguar të historisë muzikore shqiptare. Krijimi me shumë mund dhe pasion i kësaj tradite të shkrimit të muzikës dhe mësimit të saj, solli një lulëzim në shumë drejtime të edukimit muzikor në vendin tonë. Rëndësia e shkrimit të muzikës në vendin tonë, qysh në krijimin e bandave muzikore, solli njohjen me kompozitorë të famshëm të kohës. Njohja e notave muzikore solli gjithashtu një sërë përpunimesh të këngëve popullore dhe patriotike shqiptare. Muzika folklorike u bë e mundur të mbetet e të shkruhet si pjesë e historisë tonë. Gjithashtu Shqipëria pati mundësinë të jetë pjesë e një familjeje të madhe botërore të

komunikimit në një gjuhë universale: muzikës.

Abstract:

The article "Wind Orchestras, the cradle of Albanian music education" explores mainly the problems and the development of music as a science in Albania. The historical and cultural analysis of the time when these music bands were created is very important. The figures who contributed to their creation and the musicians who led these bands are of particular importance not only in our music, but also in our history as a whole. Through teaching of the interpretation on wind instruments, they laid the foundations for the pedagogy of these instruments. Up to this point, music theory, writing, or even reading of music sheets was non-existent. Thus, professional musicians were lacking, both in the field of theory and in the field of interpretation. The creation of these wind orchestras initially began in the city of Shkodra with the contribution of the Catholic clergy of the time, who had a protection from the former Austro-Hungarian Empire and the Vatican. Numerous contacts with the west and the many missionaries who came to Albania brought with them the spirit of culture of arts, literature, painting and music from these countries. Even Korca, as a city that had strong ties with the Albanian community of Bucharest or the many immigrants of America, brought outstanding contributions in the field of Albanian education. It became one of the first cities in Albania to create and set up the first wind orchestra in this period. This enriched and developed the artistic life, but also made possible the learning of musical instruments and musical notes. The transformation of these musical formations into schools for learning instruments and playing the music of famous composers is a great innovation and development for the time. This enriched and developed the artistic life, but also made possible the learning of musical instruments and musical notes. The return of these musical formations to schools for teaching instruments and playing the music of famous composers of the time constitutes a great innovation and development for the time. In terms of exploring this topic in a historical character, there have been occasional attempts, especially after the 1990s, to address it somewhat. But as a result of the communist regime, where the contribution of Catholic clergy or figures who had great value in history was hidden, the information has been almost negligible. Thus it is important to also connect the historical context with the musical one; Like the one of 1878 - when the first music band was created in Shkodra, a year which coincides with the patriotic movement for secession from the Ottoman Empire and the establishment of the "Lidhja e Prizrenit". The treatment of this topic in the musical context, highlights the importance of these movements, as well as reveals the important consequences of culture in the formation of a country. Without the contribution of these musicians and patriots, today we would have a missing part of the Albanian music history. The creation with great effort and passion of this tradition of writing music and teaching it, brought a flourishing of music education in many directions in our country. The importance of writing music in our country, since the creation of music bands, brought the acquaintance with famous composers of the time. Recognition of musical notes also brought a series of arrangements of Albanian folk and patriotic songs. Folk music became possible to remain and be written as part of our history. Albania also had the opportunity to be part of a large global family of communication in a universal language: music.

Edukimi gjithëpërfshirës në Kosovë nga perspektiva e fëmijëve me aftësi të kufizuara kundrejt fëmijëve pa aftësi të kufizuara

Inclusive Education in Kosovo from the perspective of Children with disabilities Vs Children without disabilities

VJOLLCA BELEGU-CAKA
SEEU - Tetove
Tetovë, NORTH MACEDONIA
vjollca.caka1@gmail.com

Fjalë çelës: Edukimi, gjithëpërfshirja, fëmijët me aftësi të kufizuara

Keywords: Education, Inclusiveness, children with disabilities

Përmbledhja:

Në dekadat e fundit vërehet një vëmendje e shtuar në mbarë botën drejt krijimit të shoqërive gjithëpërfshirëse dhe të diversitetit kulturor. Megjithatë, personat me aftësi të kufizuara, në veçanti fëmijët me aftësi të kufizuara, shpesh anashkalohen në këtë proces, pasi mbeten të padukshëm dhe përballen me shumë diskriminime, sfida dhe pengesa në jetën e tyre të përditshme. Në përpjekjen për të mbështetur këtë proces, edukimi gjithëpërfshirës është konsideruar si një nga hapat më të rëndësishëm drejt ofrimit të mundësive të barabarta për qasjen në arsimin adekuat për të gjithë, duke respektuar të drejtat themelore të njeriut, si në aspektin social, kulturor e po ashtu duke konsideruar edhe diversitetet e ndryshme shoqërore. Bazuar në Organizatën Botërore të Shëndetësisë, të paktën 15% e popullsisë evropiane jeton me një ose më shumë aftësi të kufizuar, nga të cilët 2-4% përjetojnë vështirësi të rëndësishme në funksionim. Ata shpesh janë të padukshëm për të tjerët dhe mund të jenë në rrezik për t'u përballur me diskriminime dhe sfida të rëndësishme në jetën e tyre të përditshme. Fëmijët me aftësi të kufizuara shpesh neglizhohen në politikë bërjen, duke kufizuar mundësinë e arsimimit të tyre dhe mundësinë për të marrë pjesë në jetën sociale, ekonomike dhe politike. Në mbarë botën, ka shumë të ngjarë që këta fëmijë të mos jenë në shkollë. Ata përballen me pengesa të vazhdueshme në arsim që rrjedhin nga diskriminimi, stigmatizimi dhe dështimi në përfshirjen e tyre në vendimmarrje për përfshirjen e 'aftësisë së kufizuar' në shërbimet shkollore. Vlerësohet se në fillim të vitit shkollor, rreth 50% e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk janë në shkollë, krahasuar me vetëm 13% të moshatarëve të tyre pa aftësi të kufizuara. Me këtë nivel të ulët të angazhimit të tyre, fëmijëve me aftësi të kufizuara u mohohet shpesh mundësia për të marrë pjesë në komunitetet e tyre, në forcën punëtore dhe në vendimet që ndikojnë më shumë tek ata. Gjithëpërfshirja është "një koncept kompleks dhe i kontestuar, dhe shfaqjet e saj në praktikë janë të shumta dhe të larmishme" (Lindsay, 2003, p.3). Kosova ka zhvilluar një kuadër të fortë politikash rreth mos diskriminimit dhe krijimit të një shoqërie gjithëpërfshirëse, megjithatë fëmijët nga grupet e cenuara dhe të marginalizuara vazhdojnë të përballen me sfida të rëndësishme në zhvillim, arsim, mbrojtje të të drejtave të tyre dhe pjesëmarrje në këto zhvillime. Parimi i arsimit gjithëpërfshirës është përfshirë në të gjitha ligjet, strategjitë dhe kurrikulat përkatëse të Kosovës që qeverisin në funksionimin e institucioneve dhe qendrave të ndryshme arsimore që kanë për qëllim nxitjen dhe sigurimin e kushteve të barabarta të arsimit për të gjithë, duke përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Ndonëse, një numër i madh i fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë është rritur me kalimin e kohës, megjithatë shumica e tyre nuk e gëzojnë këtë të drejtë dhe mbesin jashtë sistemi arsimor. Kështu, fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilëve u mohohet e drejta për arsim, ka të ngjarë të

mbeten të përjashtuar nga mundësitë më të mira të punës në të ardhmen, nga jeta e shëndetshme, si dhe nga siguria sociale dhe ekonomike. Bazuar në vlerësimet globale për përqindjen e popullsisë me aftësi të kufizuara, rreth 2.1% e fëmijëve me aftësi të kufizuara llogariten të vijnë shkollën, nga gjithsejtë 15% të identifikuar. Sipas MASHT-it, numri i përgjithshëm i nxënësve me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollën është 5.300. Llojet e aftësive të kufizuara të identifikuar në sistemin shkollor përfshijnë ato intelektuale, fizike, komunikuese, emocionale, autizmin, Sindromen Down, dëgjimin dhe dëmtimin e të folurit. Kjo jep një ide të përafërt për masën në të cilën ata janë përjashtuar. Kjo sfidë mund të shumëfishohet në qoftë se ata vijnë nga familje të varfra që jetojnë veçanërisht në një zonë të largët apo pakica etnike joserbe. Ky punim diskuton rreth vështirësive dhe sfidave me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuara gjatë procesit të edukimit gjithëpërfshirës nga perspektiva e vetë fëmijëve me aftësi të kufizuara krahasuar me moshatarët e tyre pa aftësi të kufizuara që ndjekin klasat gjithëpërfshirëse si pjesë e procesit të edukimit gjithëpërfshirës në Kosovë. Hulumtimi bazohet në një analizë kualitative, përmes diskutimeve të fokus-grupeve të organizuar në dy grupe të ndara veç e veç për të krahasuar të dy perspektivat në kontekst. Gjetjet nga ky kërkim tregojnë se procesi i përgjithshëm përfshirës i arsimit është shumë kompleks, dhe ka dallime të mëdha në stilin e jetës së përditshme, gjendjen dhe nevojat e tyre shëndetësore, edukimin dhe mundësitë e përfshirjes sociale ndërmjet dy grupeve të synuara. Ka ende shumë pengesa dhe sfida për t'u kapërcyer për të përmirësuar qasjen e barabartë dhe mundësitë për fëmijët me aftësi të kufizuara në procesin e edukimit gjithëpërfshirës në Kosovë.

Abstract:

In the recent decades there is a world-wide increasing attention towards creating inclusive societies and cultural diversity. However, persons with disabilities and in particular children with disabilities are often overlooked in this process as they remain invisible and face many discriminations, challenges, and barriers in their everyday life. In the effort of supporting this process, inclusive education has been considered amongst most important steps towards providing equal opportunities in accessing adequate education for all, by respecting basic human rights, social justice and different cultures and diversities. An inclusive society is a society that over-rides differences of race, gender, class, generation, and geography, and ensures inclusion, equality of opportunity as well as capability of all members of the society to determine an agreed set of social institutions that govern social interaction Based on the World Health Organisation, at least 15% of the European population live with one or more disabilities, of whom 2-4% experience significant difficulties in functioning. They are often invisible to the others and may be in risk of facing important discriminations and challenges in everyday life. When it comes to children, an estimated 93 million of children worldwide live with disabilities and they are “among the most likely to be left behind and at least likely to be heard” (UN High Commissioner for Human Rights)(Michelle Bachelet, 2019). Yet, children with disabilities are often overlooked in policymaking, limiting their access to education and their ability to participate in social, economic, and political life. Worldwide, these children are most likely to be out of school. They face persistent barriers to education stemming from discrimination, stigma, and the routine failure of decision makers to incorporate disability in school services. Further, it is estimated that nearly 50 per cent of children with disabilities are not in school, compared to only 13 per cent of their peers without disabilities. With this low level of their engagement, children with disabilities are often denied the chance to take part in their communities, workforce, and in the decisions that most affect them. Inclusion is “a complex and contested concept, and its manifestations in practice are many and varied” (Lindsay, 2003, p.3). Kosovo has developed a strong policy framework about non-discrimination and the creation of an inclusive society, however children from vulnerable and marginalized groups continue to face significant challenges in development, education, protection, and participation. The principle of inclusive education is incorporated in all of the relevant Kosovo laws, strategies and curricula governing the functioning of institutions and

different educational centres aimed at promoting and ensuring equal education conditions for all, including children with disabilities. However, although the enrolment of children with disabilities in all levels of education in Kosovo has increased over time, yet most of them do not enjoy this right and remain excluded from education system. Those children with disabilities whose right to education is denied are likely to remain excluded from better future job opportunities, healthy life, social and economic security. Children with disabilities are estimated to be roughly 2.1 per cent of students in school but are estimated to be around 15 per cent of the population based on global estimates for the prevalence of disability. An estimated, 43,000 children with disabilities across Kosovo should be in school when schools open on 1st of September, while according to recent statistics published by MEST, the total number of students with a certified disability attending school is 5,300, of which 41 per cent are female and 59 per cent male. The types of disability identified in the school system include intellectual, physical, communicative, autism, emotional, Down syndrome, hearing and speech impairment. This gives a rough idea of the extent to which they are excluded. This challenge may be multiplied if they come from poor households particularly living in a remote area or non-Serbian ethnic minorities. This paper discusses about the difficulties and challenges faced during the inclusive education process from the perspective of children with disabilities compared to their peers without disabilities that attend inclusive classes as part of the inclusive education process in Kosovo. The research is based on a qualitative analysis, through the focus group discussions organized in two separated groups, one with children with disabilities and the other one with children without disabilities to compare both perspectives in the context. Findings from this research show that the overall inclusive education process is very complex, and there are big differences in the daily life style, health condition, education and social inclusion opportunities between both target groups. There are still many barriers and challenges to overcome to improve equal access and opportunities for children with disabilities in the inclusive education process in Kosovo

“Njeriu i netëve të vjeshtës” ose Robinson Kruzoja i qytetit - hije “The Man of the Autumn Nights” or the Robinson Crusoe of the shadow city

TEUTA DHIMA
Biblioteka Publike Durrës
Durrës, ALBANIA
teutadhima@yahoo.com

Fjalë çelës: qytet i braktisur, vetmi, ëndërr, trill, njëmendësi.

Keywords: abandoned city, loneliness, dreams, fiction, reality.

Përmbledhja:

Romani “Njeriu i netëve të vjeshtës” nga Gjergj Vlashi, ka në qendër të tij një njeri që thjesht për të mos iu bindur verbërisë arbitrare të një urdhri të dhënë, vendos të rrijë i vetëm në qytetin e braktisur nga njerëzit. Asnjëherë nuk ka një arsye të vetme që na shtyn të marrim një vendim, ndaj në punim do t’u jepet përgjigje pyetjeve: • Pse u veçua Mariani dhe preferoi të mbetet i vetëm në qytetin - hije? • Si do ta përballojë ai këtë vetmi? Roli që do të luajnë ëndrrat, kujtimet, njerëzit e dashur që nuk janë më, elementët natyrorë: shiu, mbrëmja në vetminë e Marianit. Marrëdhëniet që do të vendosë ai me njerëzit që tani janë larguar, me vendin më intim të tyre, shtëpinë, të cilën e kanë braktisur si rezultat i bombardimit. Në këto vizita uni i tij mbetet diku larg. Ai merr nga pak prej secilit banor të tyre dhe shndërrohet në dikë tjetër. Vetmia e afron personazhin tonë me Robinson Kruzonë, por ndërsa ky i fundit bridhte pjesët e panjohura të ishullit të tij dhe nuk dinte me kë do të përballej, Mariani futet në shtëpitë e braktisura nga fqinjët, për të prekur nga afër gjërat e tyre më intime si: ditarin, albumin fotografik, dhomën e gjumit, kuzhinën. Largimi nga disiplina e tepruar që duket se i kishte tharë lëngun e jetës Marianit, a do të mjaftojë për ta përmbushur atë plotësisht? Transformimet që duket se përjeton, shndërrimet në momentet kur ndodhet brenda shtëpive të braktisura, a do të mbushin hone të zbrazura në marrëdhëniet e tij, së pari me veten e më pas me të tjerët? Bashkë me veçimin e Marianit, vetminë e tij, do të analizohen edhe disa personazhe të tjerë të romanit me vetminë e të cilëve do të njihemi nëpërmjet ditarit, rrëfimit epistolar dhe fotografive. Po a ishte me të vërtetë i vetëm Mariani në qytet? Takimi me Nasin dhe Aneloren, a ndodhën me të vërtetë, apo ishin veç një dyzim që dëshmonte gjendjen e pazakontë të tij nën trysinë e vetmisë? Në lëvizjet e tij mbrëmjesore të krijohet përshtypja se ai ecën në një skenë rrotulluese teatri që ndërron mjediset e saj sipas situatave. Monologët e Marianit përshkohen nga një satirë therrëse që aludon për probleme thelbësore të shoqërisë. Duke njohur nga afër fqinjët e tij, edhe pse në asencë, ai zbulon një sërë problemesh që në të vërtetë nuk janë vetëm të tyre, por të gjithë shoqërisë ku ata jetojnë dhe i përkasin. Mendimet e Marianit si personazh, evoluojnë nën peshën e vetmisë. Nëse fillimisht vdekja e shoqëronte si një hije e dytë, pasi kishte shkelur urdhërin duke ndenjur në qytet, më në fund ai e mposhti atë. Daljet e tij tanimë nuk ishin vetëm natën, por edhe ditën dhe ai shihte me sytë e tij se si frika nga vdekja, jepte shpirt në hapat e tij që bëheshin edhe më të rënda në rrugicën ku ai jetonte. Vendimi që mori Mariani për të qëndruar i vetëm në qytetin-hije, braktisur prej luftës dhe bombardimit, ishte sfida e parë që i bëri vdekjes. Ai jetoj në kufirin e paqartë mes trillit dhe njëmendësisë, në vetminë e tij që zgjati sa një stinë.

Abstract:

Right at the center of the novel “The Man of Autumn Nights” by Gjergj Vlashi is a man who, in order

not to obey the arbitrary blindness of a given order, decides to stay alone in his city abandoned by people. There is never just one single reason that pushes us to make a decision, so in this work the following questions will be answered: • Why did Marian stand out and prefer to be alone in the shadow city? • How will he cope with this loneliness? The role that dreams, memories, loved ones that passed away, the natural elements will play: the rain, the evening in Marian's solitude. The relationship he will establish with the people who have now left, with their most intimate place, the house, which they have abandoned as a result of the bombing. In these visits his own self remains somewhere far away. He takes a little from each of their inhabitants and transforms them into someone else. Loneliness brings our character closer to Robinson Crusoe, but while Crusoe was wandering the unknown parts of his island and did not know who he would face, Marian enters the houses vacated by the neighbors, to touch their most intimate things like diaries, photo albums, bedrooms, kitchens. Getting away from the excessive discipline that seemed to be sucking the life out of him, will this be enough to help him feel more fulfilled? The changes he seems to be experiencing, the transformations in the moments when he is inside empty houses, will they fill the gaps in his relationships: firstly, the one he has with himself and secondly, with others? Was Marian, really living alone in the city? Did the meeting with Nasi and Aneloren, really occur, or was just a mental freak, which testified his unusual mental state, under the pressure of loneliness? His twilight movements created the impression of walking around on a revolving theatrical stage, that shifts its settings as per situations. Marian's monologues are being permeated by a poignant criticism, alluding to the critical problems of the society. By getting to know closely his neighbors, although in their absence, he unfolded a number of problematic issues, which did not belong only to them, but to the society as a whole. Marian's thoughts as a character evolve under the weight of the loneliness. If, initially, death accompanied him as a second shadow, after breaking the order to stay in the city, at the end, he conquered it. Now, his walks did not happen during the night time, but throughout the day, too; and he was witnessing with own eyes, how fear and death died on his steps, the later ones becoming heavier on the alleys, he lived in. Along with Marian's isolation, his loneliness, several other characters of the novel will be analyzed, we will get to know their solitude through the diary, the epistolary narrative and the photographs. Marian's decision to be alone in the shadow city, abandoned because of war and bombing, was the first step to challenging death. He lived on the blurred line between fiction and reality, in the depths of a solitude that lasted as long as a season.

Perikopea Evangjelike dhe himni "Krishti u ngjall" Evangelical Pericope and anthem "Christ is risen"

EDMOND BUHARAJA
Universiteti i Arteve Tirane
Durrës, ALBANIA
e.buharaja@libero.it

Fjalë çelës: Perikope, evangjelike, Krishti, himn, Ungjilli, Matteo.

Keywords: Pericope, Evangelical, Christ, hymn, Gospel Matthew.

Përmbledhja:

Deri në këtë çast dokumentet më të hershme të përdorimit të shqipes në liturgjinë ortodokse duket se mbeten Perikopea Evangjelike dhe $\rho\iota\sigma\tau^{\prime}\nu^{\prime}\sigma\tau\iota$ (Krishti u ngjall) të cilët, sipas studiuesve të ndryshëm mund t'i përkasin madje shek. XIV. Teksti në shqip me alfabet grek përmban vargjet 62-66 të 'Kapitullit XXVII' të Ungjillit sipas Matteut, si dhe të himnit muzikor të Pashkës. Praktika e përkthimit të pjesëve biblike lidhet me nevojat e besimtarëve të cilët, duke mos ditur greqishten ose latinishten, e kishin të pamundur të kuptonin realisht përmbajtjen e Shkrimeve të Shenjta. Prania e dokumenteve të kësajsojta na bën të besojmë në gjallimin e një tradite të hershme, e cila e pranonte përdorimin e përkthimeve në gjuhët lokale të Shkrimeve të Shenjta, edhe brenda riteve të kodifikuara. Është shfaqur kështu në etni të ndryshme, në varësi të botës së tyre shpirtërore dhe kulturore, si dhe të mjedisit historik të jetesës një formë liturgjike sui iuris, ku riti nuk është më një element konstitutiv i institucionit të besimit. Është pikërisht në këtë mënyrë që arbërit, arbëreshët dhe arbërorët kanë mbajtur gjallë e kanë zhvilluar një besim vetiak ku, bashkë me liturgjikën, është mplekur edhe paraliturgjika dhe shekullarja, e kjo rezultoi madje prurja më e rëndësishme e tyre në ritin kristian në përgjithësi, e në atë ortodokse në veçanti. Nuk do të ishte i tepruar, pra vlerësimi i misionit të alfabetizimit të etnisë së tyre përmes shpalljes në shqip të doktrinës kristiane, si i të njëjtës tipologji me atë që realizoi përkthimi i Biblës për protestantët. Është e pranuar teza që i një alfabetit fonetik një rol transformues të liturgjisë në teatrin, domethënë në një hapësirë të të shikuarit. Ka një investim psikologjik krejt të ndryshëm që alfabeti fonetik ushtron ndaj njeriut që tenton kalimin nga hapësira akustike — pra, liturgjia — tek ajo pamore — domethënë, teatri — e nuk është rastësi që një fenomenen i tillë lindi me Humanizmin dhe u kurorëzua me Rilindjen. Nuk është çudi që katekizmi në mesin e mijëvjeçarit të dytë të erës kristiane të ishte për arbërit, arbërorët dhe arbëreshët një tekst jo për t'u lexuar, por për t'u mësuar përmendësh përmes dëgjimit, e kjo do të fuqizonte edhe më tepër potencialin e përhapjes së gjuhës përmes këndimit. Kjo na bën të besojmë që, edhe gjatë riteve fetare, drejtuesit e tyre ta kenë përfshirë përdorimin e latinishtes apo të greqishtes në mënyrë esenciale, duke u përqendruar në gjuhën shqipe si nevojë për të komunikuar me besimtarët. E parë kështu, përkthimi i teksteve biblike do të kufizonte ndikimin e të ashtuquajturave 'gjuhë liturgjike' — domethënë: të greqishtes, latinishtes, si dhe të sllavishtes antike. Duket se besohet në këtë mënyrë gjallimi i një tradite më të hershme që lejonte përdorimin e përkthimeve në gjuhët lokale të Shkrimeve të Shenjta brenda riteve të kodifikuara e të pranuar universalisht, e kjo madje edhe për aktivitetin e përditshëm. E kësaj linje duhet vlerësuar Perikopeja Ungjillore e 'Meshës së Pashkës', si edhe himni përkatës, dokumentuar tek 'Fleta 63' e Kodikut B 112, hallka munguese ose rikthime këto të një procesi që nuk ka rreshtur së praktikuarit në hapësirën e Ballkanit Perëndimor, e këtu qëndron

edhe «përrjashimi nga rregulli» për të cilën flet Borgia.

Abstract:

Deri në këtë çast dokumentet më të hershme të përdorimit të shqipes në liturgjinë ortodokse duket se mbeten Perikopea Evangjelike dhe $\rho\iota\sigma\tau\` \nu\sigma\tau\iota$ (Krishti u ngjall) të cilët, sipas studiuesve të ndryshëm mund t'i përkasin madje shek. XIV. Teksti në shqip me alfabet grek përmban vargjet 62-66 të 'Kapitullit XXVII' të Ungjillit sipas Matteo-s, si dhe të himnit muzikor të Pashkës. Praktika e përkthimit të pjesëve biblike lidhej me nevojat e besimtarëve të cilët, duke mos ditur greqishten ose latinishten, e kishin të pamundur të kuptonin realisht përmbajtjen e Shkrimeve të Shenjta. Prania e dokumenteve të kësajsojta na bën të besojmë në gjallimin e një tradite të hershme e cila e pranonte përdorimin e përkthimeve në gjuhët lokale të Shkrimeve të Shenjta edhe brenda riteve të kodifikuara. Është shfaqur kështu në etninë të ndryshme, në varësi të botës së tyre shpirtërore dhe kulturore, si dhe të mjedisit historik të jetesës, një formë liturgjike sui iuris, ku riti nuk është më një element konstitutiv i institucionit të besimit. Është pikërisht në këtë mënyrë që arbërit, arbëreshët dhe arbërorët kanë mbajtur gjallë e kanë zhvilluar një besim vetiak ku, bashkë me liturgjiken, është mplekur edhe paraliturgjika dhe shekullarja, e kjo rezultoi madje prurja më e rëndësishme e tyre në ritin kristian në përgjithësi, e në atë ortodokse në veçanti. Nuk do të ishte i tepruar, pra, vlerësimi i misionin të alfabetizimit të etnisë së tyre përmes shpalljes në shqip të doktrinës kristiane si i të njëjtës tipologji me atë që realizoi përkthimi i Biblës për protestantët. Është e pranuar teza që i njeh alfabetit fonetik një rol transformues të liturgjisë në teatrin, domethënë në një hapësirë e të shikuarit. Ka një investim psikologjik krejt të ndryshëm që alfabeti fonetik ushtron ndaj njeriut që tenton kalimin nga hapësira akustike — pra liturgjia — tek ajo pamore — domethënë, teatri — e nuk është rastësi që një fenomenen i tillë lindi me Humanizmin dhe u kurorëzuan me Rilindjen. Nuk është çudi që katekizmi në mesin e mijëvjeçarit të dytë të erës kristiane të ishte për arbërit, arbërorët dhe arbëreshët një tekst jo për t'u lexuar, por për t'u mësuar përmendësh përmes dëgjimit, e kjo do të fuqizonte edhe më tepër potencialin e përhapjes së gjuhës përmes këndimit. Kjo na bën të besojmë që, edhe gjatë riteve fetare, drejtuesit e tyre ta kenë përfshirë përdorimin e latinishtes apo të greqishtes në më esenciale, duke u përqëndruar në gjuhën shqipe si nevojë për të komunikuar me besimtarët. E parë kështu, përkthimi i teksteve biblike do të kufizonte ndikimin e të ashtuquajturave 'gjuhë liturgjike' — domethënë: të greqishtes, latinishtes, si dhe të sllavishtes antike. Duket se besohet në këtë mënyrë gjallimi i një tradite më të hershme që lejonte përdorimin e përkthimeve në gjuhët lokale të Shkrimeve të Shenjta brenda riteve të kodifikuara e të pranuar universalisht, e kjo madje edhe për aktivitetin e përditshëm. E kësaj linje duhet vlerësuar Perikopeja Ungjillore e 'Meshës së Pashkës', si edhe himni përkatës, dokumentuar tek 'Fleta 63' e Kodikut B 112, hallka munguese ose rikthime këto të një procesi që nuk ka rreshtur së praktikuarit në hapësirën e Ballkanit Perëndimor, e këtu qëndron edhe «përrjashimi nga rregulli» për të cilën flet Borgia.

Imazhi i labirintit në veprën “Pallati i Ëndrrave” The Image of the Labyrinth in the Novel “The Palace of Dreams”

NELI NAÇO

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

Korçë, ALBANIA

nelinaco@hotmail.com

Fjalë çelës: Labirint, imazh, pallat, pushtet, ëndërr.

Keywords: Labyrinth, image, palace, power, dream.

Përmbledhja:

Imazhi i labirintit është një imazh shumë i përhapur në letërsinë botërore. Fillesat e tij ne i gjejmë që nga mitologjia dhe që janë përhapur prej saj në veprat e Homerit, Ovidit, Virgjilit, Dante-s, Chauser-it, Spenser-it, Milton-it, Blake-ut e të tjera; ndërsa “letërsia moderne na jep në manifestime të hapura njeriun që fanitet labirinteve në vepra të Jitsit, Xhojsit, Kafkas dhe Kalvinos”. Ndër të tjera imazhi i labirintit kthehet në një imazh të preferuar edhe për shkrimtarët amerikolinë, siç janë Borhesi ose Markesi. Imazhi i labirintit është imazh me rëndësi të veçantë për letërsinë bashkëkohore, sepse na lejon letërsia të ketë tek labirinti një metaforë për shumësinë të pasuruar me domethënie të tjera si frika, ankthi, pafuqia, vetmia, izolimi. “Pallati i ëndrrave” gjakon shpeshherë të jetë labirintik në disa përmasa, duke treguar raportin e individit me pushtetin, raportin e individit të izoluar, fillimisht kafkian, përballë ngrehinës së madhe që shpreh dominancën e pushtetit dhe fuqisë. Artistët, shkrimtarët dhe filozofët kanë përdorur imazhin e labirintit për të simbolizuar betejën e njeriut, konfliktin e pandërprerë midis mendjes dhe shpirtit, frikërat dhe shpresat tona, dhe po ashtu paradoksin e pashpjegueshëm të fatit të njerëzimit. Labirintet janë një vend i rritjes spirituale, kërkimeve magjike dhe paraqitje të luftës humane ku e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja janë shkrirë brenda një njësie të vetme, një arketipi për botën e brendshme. Pallati i ëndrrave del në sytë e Ebu Qerimit si një imazh labirinti të vërtetë. Në asnjë alternativë personazhi nuk arrin ta zotërojë menjëherë hapësirën e tij. Marrëdhënia e tij me godinën është padyshim si marrëdhënia e njeriut me labirintin e vërtetë. Korridore të gjata të zymta që nuk kanë fund. Hapësira që edhe pse autori gjallon prej disa kohësh aty nuk e di që ekzistojnë ose i zotëron me vështirësi. Hapësira të mëdha që duken sikur nuk ka frymë njeriu dhe papritmas korridore të mbushura plot ku është zor të takosh për të dytën herë të njëjtin njeri. Imazhi i labirintit është i pranishëm pa hyrë në godinë kanatet e rënda të ndërtesës që janë të gjitha variante hyrjeje. Në të janë katër, nga pikëpamja e dizajnit janë të gjitha njëlloj, me dorezat e rënda prej bronzi. Kjo gjë do të thotë që nga pikëpamja psikike zgjedhja e personazhit është e vështirë. Karakteristika kryesore e labirintit është iluziviteti dhe kur shpreson që zgjedhja është e vështirë ajo bëhet më lehtë seç e mendon dhe anashjelltas. Në situatën që vjen më pas dyert shfaqen nga të gjitha anët dhe Ebu Qerimi i shtyn të gjitha me radhë derisa arrin të hapë një, e cila e nxjerr në një korridor tjetër. Në konceptin arkitekturor godina institucionale është e mirëorganizuar, me një lehtësi në projektimin konceptual të saj, me lehtësi të tjera dytësore, për shembull dyer me numra dhe hapësira të kontrollueshme prej individëve që punojnë aty ose prej vizitorëve. Raporti i individit të zvogëluar në nëpunës ndaj godinës të zmadhuar në pallat është labirintik, sepse shpeshherë dominanca e fuqisë së labirintit ndaj individit nuk qëndron vetëm në përmasat reale të tij, por qëndron në madhësinë e shfaqur virtualisht mbi individin, ai ka një fuqi mbi

psikikën që e bën të zotërojë fuqitë e individit.

Abstract:

The image of the labyrinth is a very popular image in the world literature. Its origins date back since mythology and they are spread since then in Homer, Ovid, Virgil, Dante, Chaucer, Spenser, Milton, Blake's works as well as others' works. Modern literature on the other hand, provides us through open manifestations with the man who haunts inside labyrinths in Yeats, Joyce, Kafka and Calvino's works". Among others, the image of the labyrinth becomes a favourite image for Latin-American writers as well, writers, such as Borges or Marques. The image of the labyrinth is of special importance to the contemporary literature since we are allowed a metaphor by literature as regards variety enriched with other connotations, such as fear, anxiety, powerlessness, loneliness, isolation. This paper is focused on the novel "The Palace of Dreams". Oftentimes "The Palace of Dreams" tends to become labyrinthic in some dimensions, presenting the relation between the individual and the autocratic power, the relation between the originally Kafka-like-character-isolated individual and the large building which expresses the dominance of reign and power. The artists, the writers, and the philosophers have used the image of the labyrinth to symbolize man's struggle, the unceasing conflict between mind and soul, our fears and hopes as well as the inexplicable paradox of mankind's destiny. Labyrinths are a place of spiritual growth, magical research, and presentations of human struggle where the past, the present, and the future are united within a single unit, an archetype of the inner world. The Palace of Dreams appears in the sight of Ebu Qerim as a real labyrinth image. No alternative provided, the character is not able to dominate his space all at once. His relationship to the building is certainly like the relationship between man and the real labyrinth. There are long, sombre, unending corridors. There are spaces which the character either knows nothing about or he can hardly dominate, despite the fact that the character has been living in for some time. There are vast spaces which seem void of people and all of a sudden there can be seen flooded corridors, where you can hardly meet the same person a second time. The image of the labyrinth is present as yet outside the building. The heavy shutters of the buildings, which are all entrance options - there are four of them - they are all the same as regards designing, with heavy bronze handles. This means that psychically speaking the character's choice is difficult. The main characteristic of the labyrinth is illusion. While hoping that the choice is difficult, it becomes easier than someone thinks and vice-versa. In the following setting, doors are shown on all sides and Ebu Qerim pushes all of them one by one until he finally makes it to open one door leading to another corridor. Architecturally speaking, the institutional building is well organized, facilitating as regards its conceptual projecting, providing other secondary facilities, for example, doors with numbers on them, and controllable spaces by the individuals working there or by the visitors. The relation between the diminished individual to an employee and the building magnified to a palace is labyrinthic, since oftentimes dominance of the power of labyrinth towards the individual does not only rest in his real dimensions, but also on the virtually outspoken magnitude upon the individual. He exercises power on the psyche, which makes it own the individual's powers.

Identiteti si mishërim i modeleve ligjërimore

Identity as the Embodiment of Discursive Patterns

LIRIM SULKO

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

Durrës, ALBANIA

lirimsulko@yahoo.com

Fjalë çelës: Ligjërim, identitet, praktik shoqërore, model.

Keywords: Discourse, identity, social practices, discursive patterns.

Përmbledhja:

Ligjërimi është aktualizim i gjuhës në përputhje me praktikën shoqërore të identitetit, i cili është shprehje e vetëdijes njerëzore në kontekstet në të cilat ai përfshihet. Kjo vetëdije nënkupton prirjen e natyrshme të individit për transhendum të pragmatikës së qënies njerëzore, e cila është pjesë e memories individuale të përditshmërisë në kuadër të ligjërimin të përditshëm. Pra jemi duke homologuar me konceptimin poststrukturalist të marrëdhënies mes gjuhës dhe mendimit, që, përkundër bindjes paraprake të gjithpranuar se mendimi paraprin ligjërimin, konfirmoi se s'ka të menduar përtej ligjërimin: ligjërimi përmban mendjen, e cila i jep formë realitetit. Pragmatika individuale e qënies njerëzore realizohet përmes ligjërimin të përditshëm, ku marrëdhënia arbitrare midis fjalës dhe gjësëndit bën referencë tek imazhi njollë, i depozituar në kujtesë, në formën e një memorie individuale të përditshmërisë. Komunikimi, si mundësi permanente njerëzore, realizohet përmes Kodit që është produkt i përzgjedhjes së shenjave nga niveli fizik i gjuhës (tërësia fjalëve dhe e rregullave) që synon të orientojë/të drejtojë dëshirat, emocionet, disponimet. Pra në kushtet e ligjërimin të përditshëm individit mbetet i zhytur në imanencën e tij ende të pamodeluar, në një realitet të jashtëm të paformë, i cili i prezantohet individit përmes ngjarjeve akute (pa model), duke e shtrënguar atë ose të induktojë, ose të ritualizojë, ose të konvencionalizojë. Secila prej tri praktikave të mësipërme mundësojnë transhendumin e individit qoftë si vullnet për të vërtetën, qoftë si vullnet për pushtet (jemi duke perifrastuar M. Fukonë): në rastin e parë përmes sistemit të ligjërimin të dijës dhe në të dytin si shprehje të ligjërimin të pushtetit; në rastin e parë është identiteti që e zgjedh dijen e në të dytin dija zgjedh identitetin. Tri praktikat e mësipërme të transhendumin, secila në mënyrën e vet, në kuadër të ligjërimin përkatëse (tani për tani po i konsiderojmë si ligjërimi induktiv, ligjërim ritual dhe ligjërimi konvencional) përcaktojnë modelin për identitetin: të sjelljes, të ndërveprim-konceptimit, të performimit. Ligjërimi induktiv modelon sjelljen e identitetit përmes përshkrimit të rrethanave me të cilat ai kontakton. Marrëdhënia e tillë midis përshkrimit dhe rrethanës bën referencë tek mendimi, prej nga buron informacioni i nevojshëm, tashmë si pjesë e memories shoqërore, me qëllim modelimin e sjelljes së identitetit shoqëror. Diskurset përshkruese (në ligjërimin induktiv) duke e pajisur identitetin me informacionin e radhës kërkojnë prej tij minimumin: përshatjen me qëllim mbijetesën. Ligjërimi ritual lidhet me praktikën e ritualit, që ashtu siç e përcakton Huizinga në "Homo ludens", ai (rituali) është një akt përmes të cilit qeniet njerëzore kapërcejnë mundësitë e tyre dhe përfshihen në pragmatikën e përgjithshme të universit. Ligjërimin të tilla janë në formën e rrëfimeve të cilat shenjojnë ngjarje profetike, prej nga buron gjenialiteti dhe harmonia paraprake e gjërave dhe botës, referenca e të cilave është kuptimi si modelim i dinjitetit dhe fisnikërisë së identitetit, si shprehje e dobisë së tij për të tjerët. Natyra e tillë e rrëfimit mbetet e njëjtë edhe kur shenjon një ngjarje të çfardoshme (jo çdo gjë që ndodh mund ta quajmë ngjarje) referenca e së cilës është gjithmonë kuptimi si model i pranuar i mënyrës se si funksionon marrëdhënia midis identitetit

dhe species/njerëzimit (tanimë si analogji midis kuptimit dhe ngjarjes: - ngjarja si e vetmja mundësi e aftësisë njohëse të njeriut për të bërë të mundshëm kuptimin, se ndryshimi i botës është kuptimi i saj). Po kështu edhe rrëfimet filozofike në formën e diskurseve universale (si jeta e ideve), dialogjike, argumentuese realizojnë kultivimin e koncept-imazheve si njohje e çështjeve të përhershme, si ndër-gjegjësim i identitetit për origjinën dhe arsyen e ekzistencës së botës dhe mënyrës së saj të funksionimit. Identiteti, zotëruesi i ndër-gjegjes, i jep asaj statusin e dijes absolute, e cila modelon marrëdhënien e identitetit, jo më në kontakt me rrethanën e ndërprerë në kohë dhe hapësirë, por me të gjithë botën, si zgjedhje e ndërveprimit të disponimit të identitetit në ofrimin e qëndrueshmërisë së botës, si kontribut lokal në mjedisin shoqëror, ku ai ndodhet. Transhendenca të tilla mbeten gjithmonë të hapura për kaprëcime të reja. Ligjërimi shkencor përmes zbulimit të simetrive të fshehura është shprehje e rritjes së kontrollit dhe fuqisë së njerëzimit: transhëndimi i identitetit nuk është më një model harmonie me njerëzimin, as zbulim i origjinës së botës, por është një imanencë e re. Ligjërimi artistik-letrar, po ashtu modelon identitetin përmes transhëndencës akute si dalje nga bota, si kontakt me format pa përmbajtje, duke përfunduar kështu në një imanencë të mbyllur, individuale. Si të tillë, ligjërimi shkencor dhe ai poetik-letrar, sa kohë nuk kanë përpunuar një sistem konceptual paraprak ushqejnë imanencën individuale tashmë si një hiperrealitet: identitetit i mjafton vetvetja dhe zhbën modelet. Por me synimin për t' u afirmuar identiteti duhet të performojë ose brenda sistemit, ose brenda kuptimit, tanimë përmes konvencioneve në kuadër të lojërave ligjërimore.

Abstract:

Discourse is the actualization of language in accordance with the social practices of identity, which is the expression of human consciousness in the contexts in which it is involved. This awareness implies the natural tendency of the individual to transcend the pragmatics of the human being, which is part of the individual memory of everyday life within the framework of Daily Lecture. So we are homologating with the poststructuralist conception of the relationship between language and thought, which, despite the universally accepted belief that thought precedes discourse, confirmed that there is no thought beyond discourse: discourse contains the mind, which shapes the reality. The individual pragmatism of the human being is realized through everyday discourse, where the arbitrary relationship between word and thing makes reference to the blurred image, stored in memory, in the form of an individual memory of everyday life. Communication, as a permanent human possibility, is realized through the Code which is a product of the selection of signs from the physical level of the language (the set of words and rules) that aims to orient/direct the desires, emotions, possessions. So in terms of everyday discourse the individual remains immersed in his still unmodulated immanence, in an amorphous external reality, which is presented to the individual through acute events (without pattern), forcing him either to induce, or to ritualize, or conventionalize. Each of the above three practices enables the transcendence of the individual either as a will to truth or as a will to power (we are paraphrasing M. Foucault): in the first case through the system of discourses of knowledge and in the second as an expression of the discourses of power; in the first case it is identity that chooses knowledge and in the second knowledge chooses identity. The above three transcendental practices, each in its own way, within the respective discourses (we are currently considering them as inductive discourse, ritual discourse, and conventional discourse) define patterns of identity: behavior, interaction-conception, performance. Inductive discourse models identity behavior through the description of the circumstances with which it contacts. Such a relationship between description and circumstance makes reference to thought, from which the necessary information comes, already as part of social memory, in order to model the behavior of social identity. Descriptive discourses (in inductive discourse) equipping identity with the following information require from it the minimum: adaptation for the purpose of survival. Ritual discourse relates to the practice of ritual, which as Huizinga defines in "Homo ludens", it (ritual)

is an act through which human beings transcend their possibilities and become involved in the general pragmatics of the universe. Such discourses are in the form of narratives which mark prophetic events, from whence originates the geniality and primal harmony of things and the world, the reference of which is the meaning as a model of the dignity and nobility of identity, and being useful to others. Such a nature of narrative remains the same even when it marks an event (not everything that happens can be called an event) whose reference is always the meaning as an accepted model of how the relationship between identity and species/mankind. (already as an analogy between meaning and event: -event as the only possibility of man's cognitive ability to make meaning possible, that the change of the world is its meaning). Likewise, philosophical narratives in the form of universal discourses (like the life of ideas), dialogical, argumentative realize cultivate concept-images as knowledge of permanent topics, as awareness of identity for the genesis and reason of the existence of the world and its way of functioning. Identity, the possessor of consciousness, gives it the status of absolute knowledge, which shapes the relationship of identity, no longer in contact with the circumstance interrupted in time and space, but with the whole world, as interaction of possession of identity with offer of a sustainability of the world, as its local contribution to the social environment in which it is located. Such transcendences always remain open to new overcomes. Scientific discourse through the discovery of hidden symmetries is an expression of the growing control and power of mankind: the transcendence of identity is no longer a model of harmony with mankind, nor a revelation of the origin of the world, but a new immanence. Artistic-literary discourse also models identity through acute transcendence as a way of leaving the reality, as contact with forms without content, thus ending in a closed, individual immanence. As such, scientific and poetic-literary discourse, as long as they have not elaborated a preliminary conceptual system which it gives life to individual immanence already as a hyper reality: Identity suffices itself and undoes patterns. But in order to affirm identity it must perform either within the system, or within the meaning, already through conventions within discourse games.

Edukimi dhe arsimimi përballë sfidës globale të digjitalizimit

Education in the face of the global challenge of digitalization

RUDINA ALIMERKO
Universiteti i Vlorës
Vlorë, ALBANIA
rudi_alimerko@yahoo.it

Fjalë çelës: digjitalizim, sfidë, edukim, zhvillim, mendim kritik

Keywords: digitalization, challenge, education, development, critical thinking

Përmbledhja:

Udhëtimi drejt dijes është pjesë e pandashme e botës njerëzore dhe zhvillimit të shoqërisë. Mësimi përgjatë jetës është një proces i pafund i kërkimit, hulumtimit, i rrënjësor në rrafshin mendor se, dija nuk ka fund. Transformimi global e ka përshtatur njerëzimin global në kushte të reja, përse i përket avancimit të zhvillimit të teknologjisë, informacionit, sfidave në fushat e edukimit dhe arsimimit. Ndaj, ky punim vjen i strukturuar dhe i pasqyruar rreth refleksionit, raportit të pakushtëzuar të njeriut me teknologjinë, i udhëtimit të bashkëveprimit shoqëror se edukimi dhe arsimimi duhet të mundësojë dhe të sigurojë baza të sigurta për hulumtimin, të mësuarit dhe të nxënimit pa fund, gjatë gjithë jetës. Pikërisht, ky hulumtim aktual paraqet një panoramë specifike në trajtimin e saj, pasi ajo është projektuar në tri drejtime kryesore: mësuesi, nxënësi, letërsia si edukim artistik, edukativ, estetik. Duke patur parasysh këtë objektiv, do të mundohemi që ky punim të pasqyrojë sa më natyrshëm, në konceptin e globalizimit ndryshimet që ka pësuar shoqëria jonë. Nëpërmjet metodës së analizës teorike, krahasuese, vëzhguese, do të jetë ura lidhëse në trajtimin delikat përse i përket edukimit bashkëkohor, aktual, problematikave që shfaqen ndaj arsimit tashmë të digjitalizuar. Trajtimi i këtij punimi pasqyron edhe një panoramë gjithëpërfshirëse që po pëson edhe letërsia, si një fuqi dhe recetë magjike në pasurimin shpirtëror e refleksionin artistik e estetik. Mësuesi dhe shkrimtari me misionin e përhapjes së dijes, janë gjithmonë në kërkim të temave, çështjeve aktuale bashkëkohore që evoluojnë brezat dhe shoqërinë. Nuk kemi më një letërsi didaktike, moralizuese. Transformimi global po e shndërron letërsinë në intermediale, mediatike. Qëllimi është që shkrimtarët me krijimet e tyre, nëpërmjet këndvështrimeve, rrethaneve dhe situatave që kërkon koha, epokën digjitale që po ndryshon me shpejtësi, të pasqyrojnë tematika dhe problematika edukative për një arsimim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Për njohësit e psikologjisë së fëmijëve dhe për ata që ndjekin strategjitë më të mira didaktike në edukimin e tyre, kanë vënë re se magjia e një libri i shkruar për fëmijë buron nga magjia e fjalës dhe e rrëfimit, magjia e jetës. Ndaj, një shkrimtar i mirë duhet të njohë botën e fëmijëve, formimin e tyre, që krijimet të mos jenë vetëm argëtim për atë që shkruan e lexon, por edhe një edukim e burim dijesh. Shfletimi apo leximi i librave u mundëson fëmijëve të mësojnë gjëra të reja, të paeksploruara, të gjenden në vende të tjera dhe të pasurojnë fjalorin me fjalë të reja. Në ndërgjegjen tonë, mendojmë se duhet të kemi shumë kujdes në edukimin dhe arsimimin ndaj brezave të sotëm, kjo në raport me teknologjinë, mësimin digjital, vëmendjen vetëm ndaj mësimdhënies digjitale, përzgjedhjen e pjesëve letrare të përshtatura sipas grupmohave në tekstet e gjuhës shqipe. Duhet një reflektim se çfarë pune është bërë gjatë periudhës së pandemisë e në vazhdim; çfarë pune është bërë me nxënësit e klasës së parë, të pestë, e në vijim, në lidhje me të mësuarit, të lexuarit, të kuptuarit, të nxënimit; për të kuptuar dhe për t'u përgatitur përballë sfidave që mund të na shfaqen. Duhet strategji të menjëhershme në lidhje me mësimdhënien, reagime dhe reflektime të mësuesve, metodistëve, studiuesve dhe shkrimtarëve në edukimin e fëmijëve dhe të rinjve me shije të shëndoshë në formimin e kulturës

estetike, morale duke nxitur të menduar kritik, krijues dhe shkencor. Duke patur parasysh situatën të cilën po përjetojmë, rëndësinë dhe sfidat në përballjen tashmë globale rekomandojmë: – Vëmendje në edukimin dhe arsimimin e brezave, pasi arsimimi ka fuqinë të transformojë dhe të gjenerojë shtresa të dijes njerëzore drejt qytetërimit të njerëzve; – Reflektime dhe bashkëpunime; domosdoshmëria ku mësuesit dhe nxënësit të marrin informacione, të trajnohen në drejtim të përparimit të teknologjisë. Për të patur një mësimdhënie të suksesshme në raport me kërkesat e epokës digjitale, nevojitet që institucionet arsimore të ndjekin në çdo hap trajnimin e mësimdhënësve; – Përgjegjësi; nxitja drejt përdorimit të teknologjisë u mundëson mësuesve të kenë përgjegjësi, të përvetësojnë teknologjitë shpjeguese interaktive në përmirësimin cilësor të të nxënit; – Kreativitet; kërkesë e kohës, për të reflektuar mbi zhvillimin e shoqërisë, brezave të ardhshëm, duke nxitur jo vetëm në aftësitë e të menduarit kritik e krijues, jo vetëm të pyeturit dhe hulumtimit, por duhet të theksojmë përpjekje për edukim estetik, nxitje të përfytyrimit, imagjinatës, fantazisë, levrimit e copëzave diturake, enciklopedike. Nëpërmjet karaktereve, personazheve, modeleve, mësuesit dhe shkrimtarët duhet të tregojnë kujdes për të vlerësuar ndërjegjësimin ndërkulturor, zhvillimin e karakterit, sepse vetëm fuqia e arsimit e pasuron, edukon brezat drejt dijes dhe të ardhmes së sigurt.

Abstract:

The journey to knowledge is an inseparable part of human world and the development of society. Lifetime learning is an endless process of research and investigation stuck into the mental plane that the knowledge never ends. Global transformation has adapted global humans to new conditions regarding advancement of technology development, information and challenges in education area. Thus, this study comes structured and presented around reflection, unconditional report of humans with technology, of the journey of social cooperation that education should enable and provide safe bases for research, learning and endless education through lifetime. Exactly, this current research presents a specific overview in its treatment, as it is designed in three main directions: teacher, student, literature as artistic education, educational, aesthetic. Given this objective, we will try to make this paper reflect as naturally as possible in the concept of globalization, the changes that our society has undergone. Through the method of theoretical analysis, comparative, observational, will be the connecting bridge in the delicate treatment in terms of contemporary education, current, problems that appear to the already digitalized education. The treatment of this work reflects a comprehensive panorama that literature is also experiencing, as a magical power and recipe in spiritual enrichment and artistic and aesthetic reflection. The teacher and writer with the mission of spreading knowledge, are always in search of topics, current contemporary issues that evolve generations and society. We no longer have a didactic, moralizing literature. Global transformation is turning literature into intermediate, media. The aim is for writers with their creations, through the perspectives, circumstances and situations that time requires, the rapidly changing digital age, to reflect educational themes and issues for a sustainable education and development. For those who know the psychology of children and for those who follow the best didactic strategies in their education, they have noticed that the magic of a book written for children stems from the magic of speech and storytelling, the magic of life. Therefore, a good writer must know the world of children, their formation, so that creations are not only fun for what he writes and reads, but also an education and source of knowledge. Browsing or reading books enables children to learn new, unexplored things, find themselves in other places, and enrich their vocabulary with new words. In our consciousness, we think that we should be very careful in educating and educating today's generations, in relation to technology, digital learning, attention only to digital teaching, the selection of literary pieces adapted according to age groups in Albanian language texts. A reflection is needed on what work has been done during the pandemic period and beyond; what work has been done with first, fifth, and subsequent students in relation to learning, reading, understanding, learning; to understand

and prepare for the challenges that may arise. Immediate strategies related to teaching are needed, reactions and reflections of teachers, methodologists, researchers and writers in educating children and young people with sound taste in the formation of aesthetic, moral culture by encouraging critical, creative and scientific thinking. Given the situation we are experiencing, the importance and challenges in the already global confrontation, we recommend: – Attention in education of generations, as education has the power to transform and generate categories of human knowledge to human civilization; – Reflection and cooperation; the necessity of teachers and pupils to get information, to be trained in technology. There should be a successful teaching in relation to the request of digital era, and the education institutions should follow in every step the training of teachers; – Responsibility: promotion on the use of technology enables teachers to be responsible, to know the explanatory and interactive technology in quality improvement of learning; – Creativity; contemporary requirements to reflect on the development of society of future generations, to promote not only skills of creative and critical thinking, not only questioning and research, but we should emphasize efforts for aesthetic education, encouragement of imagination, vision, fantasy, investigation of knowledge and encyclopaedic parts of education. Through characters and models teachers and writers should be careful in evaluating intercultural awareness, development of personality, as only the power of education enriches and educates generations toward knowledge and safe future.

Vështrim mbi problemet e letërsisë së sotme për fëmijë dhe të rinj

An overview of the problems of today's literature for children and young people

ELMIRA MUCOPATAJ
BNiblioteka Publike Durrës
Durrës, ALBANIA
niketdardani@libero.it

Fjalë çelës: Fëmijë, shkrimtarë, letërsi, libra, gjuhë, televizion, internet

Keywords: Children, writers, literature, books, language, television, internet

Përmbledhja:

Ndryshimet politiko-shoqërore të viteve 90 shkaktuan një sërë problemesh në të gjitha fushat e organizimit të jetës tek ne. Familja, shkolla, media, morali, arti morën goditje të mëdha, ndaj është e kuptueshme që këtyre andrrallave nuk mund t'u shpëtonë as letërsia, veçnisht ajo për fëmijë. Edhe pse me një traditë paraardhëse të pasur dhe relativisht të sukseshme, letërsia e sotme për fëmijë, është në ngërç. Përveç peripecive të procesit krijues, të realizimit artistik, estetik të veprës, të procesit të botimit, të shpërndarjes, kritikës etj, ajo vuan ndër të tjera një problem jo pak të rëndësishëm, atë të faktit që edhe pse shkruhet jo pak dhe ka libra të bukur për fëmijë e të rinj, shkrimtarët e sotëm nuk po arrijnë të fitojnë tipare të cilat jo thjesht ti individualizojnë stilistikisht e ti dallojnë nga njëri-tjetri, por që ti përbashkojnë dhe t'u japin fizionominë e një brezi krijuesish, që do të shënjojnë një etapë të re në zhvillimin e letërsisë shqipe, e cila ashtu si edhe gjuha është një dukuri sociale e historike. Nisur nga përhapja dhe cilësia që arriti letërsia për fëmijë, sidomos gjatë viteve 70-90, krisja e traditës së shkrimit për fëmijë bëhet më e dukshme. Nëse librin do ta shohim si djepin ku nanuriten dhe ëndërrojnë lexuesit e vegjël — të cilët nesër do të jenë shkrimtarët e ardhshëm, kritikët, publicistët, intelektualët e të gjitha fushave, apo më gjerë, qytetarët e nesërm — duhet të besojmë se librat dhe letërsia janë “ninullat” pra mesazhet e para të dashurisë, qetësisë, moralit, estetikës e më gjerë. Librat dhe leximi e shtojnë fëmijën përtej të përditshmes, konkretes, drejt një bote të re më të madhe, ku të të panjohurat zbulohen jo thjesht në mënyrë empirike, por përmes fantazisë, imagjinatës, të ngjashmëve me veten, aventurave, dështimeve, fitoreve etj. Ndodh kështu nëse shkrimtarët kujdesen të zgjedhin personazhe me të cilët fëmijët mund të identifikojnë veten, shokët, të afërmit; nëse përshkruajnë peripeci e aventura të ngjashme me çfarë ndodh në fëmijëri. Ndërtimi i heroit apo antiheroit, tematika, përzgjedhja e titujve duhet të marrin në konsideratë formimin psiko-emocional por edhe atë intelektual të fëmijëve. Mendoj se element shumë i ndjeshëm nga fëmijët është edhe gjuha. Ajo duhet të jetë e kuptueshme, por jo e thjeshtëzuar, që të ndikojë në formimin e tij dhe jo në refuzimin e veprës, sepse gjuha dhe stili i autorit bashkuar me imagjinatën e fëmijëve janë mjeti që mundëson transformimin e aktit kreativ, në një botë të personalizuar ndjesore të fëmijëve. E theksoj këtë e fakt, sepse sot librit i duhet të përballet me konkurrentë të fuqishëm dhe shumë joshës si televizioni, interneti, lojërat elektronike, etj dhe ndonëse fëmijët e duan librin, për fat të keq vë re se ata preferojnë më mirë që të njëjtën ngjarje ta shohin si film, ose ta luajnë në videogame sesa ta lexojnë. Ky fenomen që po përhapet, do të shfaqë pasojat nesër. Prandaj duhen bërë përpjekjet maksimale për përdorimin e gjuhës letrare. Në libra gjejmë gabime drejtshkrimore, të pikësimit, formulime sintaksore të cinguar, të pasakta, herë-herë një leksik të thatë,

gjuhë të përditshme në rrëfim, përsëritjen e shpeshtë të fjalëve, mungesën e fjalorit sqarues në fund të faqeve etj. Nje situatë e tillë në vend që ta afroje lexuesin e ri e largon atë. Përmes evidentimit të problemeve, referimi im synon të orientojë shkrimtarët për femijë në përzgjedhjen e tematikave, si dhe në stilizimin artistik. Kjo do të mund të përmirësojë raportin e tyre me lexuesin e ri.

Abstract:

The socio-political changes of the 90s caused a series of problems in all of life organization areas in our country. The family, the school, the media, the morals and the art received great blows, so it is understandable that even literature, especially that for children, could not escape these problems. Although with a rich and relatively successful past tradition, the children's literature is in stagnation. In addition to the vicissitudes of the creative process, of the artistic, aesthetic realization of the work, of the process of publishing, distribution, criticism, etc., it suffers, among other things, a significant problem. Although much is written and there are beautiful books for children and young people, today's writers are failing to acquire features that not only stylistically individualize and distinguish them from each other, but that unite them and give them the physiognomy of a generation of creators, who will mark a new stage in the development of Albanian literature, which like language is a social and historical phenomenon. Given the spread and quality of children's literature, especially during the 70s and 90s, the flaw in the tradition of children's writing becomes more apparent. If we are to see the book as the young readers cradle—who tomorrow will be the future writers, critics, publicists, intellectuals of all fields, or even just the citizens of tomorrow—we must believe that books and literature are the "lullabies", i.e. the first messages of love, peace, morality, aesthetics and beyond. Books and reading push the child beyond the everyday, the concrete, towards a bigger new world, where the unknowns are discovered not just empirically, but through fantasy, imagination, self-similarity, adventures, failures, victories, etc. This is the case if writers take care to choose characters with whom children can identify themselves, friends, relatives; if they describe vicissitudes and adventures similar to what happens in childhood. The construction of the hero or antihero, the theme, the selection of titles should take into account the psycho-emotional but also the intellectual formation of children. A very sensitive element from children is also the language. It must be understandable, but not simplistic, to influence its formation and not the rejection of the work, because the language and style of the author combined with the imagination of children are the means that enable the transformation of the creative act, into a world of personalized sensory children. This fact should be emphasized because today the book has to face strong and very attractive competitors such as television, internet, electronic games, etc. Although children love the book, unfortunately we note that they would rather watch the same event as a movie, or play it on videogames than read it. This phenomenon that is spreading, will show the consequences tomorrow. Therefore, maximum efforts should be made for the use of literary language. In the books we find: spelling, punctuation errors, truncated syntactic formulations, inaccuracies, sometimes a dry lexicon, everyday language in the narrative, frequent repetition of words, lack of explanatory vocabulary at the bottom of the pages, etc. Such a situation, instead of bringing the new reader closer, removes him. Through highlighting the problems, my reference aims to guide children writers in the selection of topics, as well as in artistic stylization. This could improve their relationship with the new reader.

Lasgush Poradeci si folklorist: Koncepte, rezultate, kritere

Lasgush Poradeci as a folklorist: Concepts, results, criteria

KRISTAQ JORGO
Universiteti i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
kristjorgo@yahoo.com

Fjalë çelës: Lasgush Poradeci, folklorist, koncepte, rezultate, kritere

Keywords: Lasgush Poradeci, folklorist, concepts, results, criteria

Përmbledhja:

Kumtesa i kushtohet një aspekti pak dhe aspak të njohur të interesimeve dhe të opusit krijues të Lasgush Poradecit: raportit të tij me poezinë orale shqiptare në veçanti dhe krijimtarinë orale përgjithësisht, e parë kjo në vetvete si dhe në raportet e saj me letërsinë e kultivuar. Në njëfarë mase është bërë objekt studimi pikëprerja e një pjese të lirikës lasgushiane me poezinë popullore: në frymë, në fond dhe në poetikë. Vëmendje e pamjaftueshme i është kushtuar ndërkaq vëzhgimeve që bëjnë objekt studimi krijimtarinë orale, kryesisht poezinë, folklorin shqiptar në kuadrin më të gjerë, dhe të cilat (vëzhgime) dalin në disa trajtesa (artikuj) e në pohime të L. Poradecit fiksuar nga ai vetë, në letërkëmbim e ditarët apo përcjellë nga individë të tjerë, miq të poetit. Nuk ka gjetur vëmendjen e duhur shkencore trajtimi magjistrat i raporteve ‘poezi e kultivuar - poezi orale’ që Lasgush Poradeci bën në disertacionin e tij të doktoratës mbi poetin kombëtar rumun Mihai Eminescu-n. Tërësia e interesimeve të Lasgush Poradecit mbi folklorin zgjerohet së tepërmi e përplotësohet me ndriçimin e një përmase krejt të re, përmes zbulimit të profilit të tij si folklorist ‘stricto sensu’. Jemi vënë në dijeni se prej vitit 1930 e deri në vitin 1946 Lasgush Poradeci mbledh ‘nga goja e popullit’, regjistron e shoqëron me shënime, lëndë folklorike, kryesisht, për të mos thënë ekskluzivisht, këngë popullore. Bëhet fjalë për qindra të tilla. Qendra e kumtimit tonë bën objekt qendror këtë ‘zbulim’, në përpjekje për të ndriçuar natyrën e lëndës folklorike të mbledhur, arealet gjeografikë prej nga ajo vjen, tipologjinë e saj në pikëvështrim të tematikës, të llojeve e nënlojeve, kriteret e regjistrimit/të transkriptimit të përdorur, natyrën e funksionin e aparatit shpjegues si dhe një varg shënimesh e vlerësimesh që L. Poradeci bën aty-këtu dhe që janë të një interesi të posaçëm në më shumë se një aspekt. Me këtë korpus këngësh popullore për të cilat jemi vënë në dijeni nga trashëgimtarët e Poetit dhe që ndodhet tash në pjesën kryesore të tij në proces botimi, Lasgush Poradeci ze vend tejet të rëndësishëm në radhën e mbledhësve e të studiuesve më të shquar të folklorit shqiptar. Lënda si dhe kriteret e regjistrimit të saj e bëjnë, ndër të tjera, këtë ndihmesë madhore, të gëzojë një varg risish apo cilësish unike, të cilat nuk i gjejmë ose i gjejmë në trajta sporadike në të tjera përmbledhje, në të tjerë mbledhës të folklorit shqiptar. Për herë të parë mbidhet tradita gojore e një areali fare të ngushtë dhe prej subjektsh ekskluzivisht femërore. Është rasti, për shembull, i më shumë se 160 këngëve nga fshati Dardhë i Korçës (“Vjersha popullore garishte të hershme . Mbledhur nga goja e popullit”, Vol. I, II, III., Dardhë, gusht-shtator 1931). Po ashtu, një përmbledhje këngësh të qytetit të tij të lindjes, sërish nga subjekte femërore (“Këngë popullore mbledhur në Poradec (vetëm prej goje vashash)”. Interes të posaçëm paraqet identifikimi i lëndës së re folklorike, të cilën nuk i hasim në përmbledhjet e deritashme apo në fondet e pabotuara që ndodhen në institucionet e ruajtjes së trashëgimisë gojore shqiptare. Po ashtu, identifikimi i varianteve të këngëve tashmë të njohura. Rast të veçantë në këtë aspekt shfaq studimi krahasues e lëndës folklorike të Pogradecit e krahinave përreth

me lëndën folklorike të vëllimit “Këngë e brithma nga qyteti i djegur” (1944), të bashkëqytetarit e bashkëpunëtorit të L. Poradecit, Dhimitër Pasko-Mitrush Kuteli. Në mbyllje, shtrohen një varg çështjesh të një botimi të ardhshëm kritik, pajisur me studim hyrës, shënime, vërejtje krahasuese, fjalorth etj. të kësaj trashëgimie të vyer folklorike mbledhur e studiuar nga Poeti.

Abstract:

The paper is dedicated to a little and not at all known aspect of Lasgush Poradec’s interests and creative opus: his relationship with Albanian oral poetry in particular and oral creativity in general, seen in itself as well as in its relations with cultivated literature. To some extent, the object of study is the intersection of a part of Lasgushian lyric poetry with folk poetry: in spirit, in fund and in poetics. Insufficient attention has been paid to the observations that make the object of study oral creativity, mainly poetry, Albanian folklore in the wider context, and which (observations) appear in some treatments (articles) and in statements of L. Poradeci fixed by himself, in correspondence and diaries or forwarded by other individuals, friends of the Poet. Lasgush Poradeci’s masterful treatment of the reports ‘cultivated poetry - oral poetry’ in his doctoral dissertation on the Romanian national poet Mihai Eminescu has not received the proper scientific attention. The totality of Lasgush Poradeci’s interests in folklore is greatly expanded and supplemented with the illumination of a completely new dimension, through the discovery of his profile as a folklorist ‘*stricto sensu*’. We have been informed that from 1930 to 1946 Lasgush Poradeci collects ‘from the mouth of the people’, records and accompanies with notes, folkloric subjects, mainly, not to say exclusively, folk songs. It is about hundreds of such. The center of our communication makes this ‘discovery’ the central object, in an attempt to illuminate the nature of the folkloric material collected, the geographical areas from where it comes, its typology in terms of subjects and topoi, of genres and subgenres, of recording / transcription criteria used, of the nature and function of the explanatory apparatus as well as a series of notes and assessments that L. Poradeci makes here and there and that are of special interest in more than one aspect. With this corpus of folk songs of which we have become aware of the Poet’s heirs and which is now in the process of publication, Lasgush Poradeci occupies a very important place in the ranks of the most prominent collectors and scholars of Albanian folklore. The subject as well as the criteria for its registration, make this major help to enjoy, among others, a series of novelties or unique qualities, which we do not find or find in sporadic forms in other collections of Albanian folk poetry. For the first time, the oral tradition of a very narrow area and exclusively by female subjects is gathered. It is the case, for example, of more than 160 songs from the village of Dardhë in Korça (“Early folk poems. Collected from the mouth of the people”, Vol. I, II, III., Dardhë, August-September 1931). Also, a collection of songs of his hometown, again by female subjects (“Folk songs collected in Poradec (only from girls’ mouths).” Of particular interest is the identification of the new folkloric material, which we do not encounter in the collections to date or in unpublished funds located in the institutions of preservation of the Albanian oral heritage, as well as the identification of variants of already known songs. A special case in this respect is the comparative approach of the folkloric material of Pogradec and the surrounding provinces collected by Lasgush Poradeci with the folkloric material of the volume “Këngë e brithma nga qyteti i djegur” [“Songs and screams from the burnt city”] (1944), by fellow citizen and collaborator of L. Poradeci, Dhimitër Pasko-Mitrush Kuteli. In the and, a series of issues of a future critical edition are posed, equipped with introductory study, notes, comparative remarks, glossary, etc. of this precious folkloric heritage collected and studied by the Poet.

Elementet fantastike në letërsinë e Ernest Koliqit

Fantastic elements in the literature of Ernest Koliqi

ERIS RUSI

Universiteti "Fan S. Noli" Korce

Korçë, ALBANIA

eris.rusi@gmail.com

Fjalë çelës: letërsi fantastike, mit, folklor, imagjinate kolektive, modernitet

Keywords: fantastic literature, myth, folklore, collective imagination, modernity

Përmbledhja:

Ky punim do të ndalet në veprën e shkrimtarit Ernest Koliqi, i cili konsiderohet si një pararendës i prozës moderne shqipe. Në rrafshin e fantastikës, padyshim që dokumentimi i veprës së Koliqit ofron një interes specifik, qoftë për temat e trajtuara (Veçanërisht në librin e parë “Hija e maleve”), qoftë edhe për procedimin e hulumtimit psikologjik, e zbirimit dhe zbërthimit deri në imtësi të botës së brendshme të personazheve, që rezultojnë të jetë një botë paralele me realen, e mbushur me ndjesi, përfytyrime dhe gjallëri që tejkalojnë atë çka mund të shihet apo preket nga realiteti. Mitologjia dhe folklori, zënë një vend të veçantë pasqyrimi artistik në prozën e autorit. Këto burime të letërsisë gojore do ta ushqejnë veprën e tij duke e bërë origjinale dhe mbresëlënëse. Në këtë plan, ne do të analizojmë ndryshimin rrënjësor në trajtimin e mitit dhe folklorit popullor nga ana e kritikës dhe studiuesve bashkëkohorë. Elementi më domethënës i trajtimit dhe analizimit të ri të mitit, qëndron në pranimin e tij njëloj shiç ndodhte në shoqëritë arkaike, pra si një histori e vërtetë e cila mbartte në vetvete vlera të vyera, që kalonin nga e shenjta, tek shembullorja dhe domethënësja për komunitetin. Pra, mitin në vend që ta kemi akoma të filtruar nën dritën e sajësës, trillimit, përrallës, në shekullin e XX e marrim për të skicuar nga e para dritë-hijet shpirtërore moderne dhe bashkëkohore të kombeve. Kjo vlerë e re semantike e mitit gjen vend kryesor në prozën e Ernest Koliqit, sidomos në përmbledhjen me tregime “Hija e Maleve”, ku figurat dhe besëtytnitë që burojnë prej kulturës mitologjike, qeniet mitologjike, zanat dhe orët luajnë rol organizues brenda kontekstit historik e shpirtëror ku ndërthurret natyrshëm fantastikja dhe realja, e përkohshmja dhe e përhershme, e djeshmja dhe e sotmja, tokësorja dhe qiellorja. Ndërmjet miteve dhe gojëdhënave, mund të përkufizohet pasuria artistike që i jep frymë botëkuptimit imagjinar, krijues të kombit. Koliqi e ndjen që sidomos në këtë drejtim, duke asimiluar këtë trashëgimi kulturore të tokës shqiptare, është e mundur të krijohet një letërsi, ku loja e simboleve, kapja e domethënëve të fshehura e nxit lexuesin, e bën kurioz, e prin të kërkojë dhe të “lexojë” domethënie të shumëfishta brenda subjekteve që pasqyrohen të valëzuar tek këto simbole. Në këtë punim, ne do të qëndrojmë në dy aspekte të fantastikes që mund të nënvizohen tek Koliqi: te e mrekullueshmja, mitologjika, te bota e pasur e fantazisë dhe imagjinatës kolektive popullore (Zanat, orët, shtojzovallet), që hyjnë e njëjtësohen me personazhe reale apo historike në vepër. Risia dhe moderniteti i Koliqit, nën këtë dritë përforcohen nga përdorimi i ri i miteve dhe i pasurisë folklorike, të cilët nuk janë elementë të palëvizshëm dhe totalitarë, por përzihen me çaste të çfardoshme të jetës së përditshme, duke ndërhyrë brenda fragmentimit të jetës. Është e natyrshme të hamendësojmë që Koliqi nëpërmjet procesit të shkrimit, rikrijon një botë e cila, më tej ekziston akoma, e nuk mund të lihet më pas dore. Narratori ose protagonist-i-autor, në fund dëshmon pushtetin origjinal të letërsisë (me rikrijimin e miteve nën një optikë të re), e njëkohësisht

është dëshmitar dhe protagonist i po atyre miteve të strukturuar në konturet e fikcionit letrar.

Abstract:

This work will be focused on the literature of the writer Ernest Koliqi who is considered a forerunner of modern Albanian prose. In terms of fantasy, the documentation of Koliqi's work undoubtedly offers a specific interest, both for the topics covered (Especially in the first book "Shadow of the Mountains"), and for the processing of psychological research, digging and decomposing to the smallest detail the inner world of the characters, and creating so a parallel world to the real, filled with sensations, imaginations and liveliness that transcend what can be seen or touched by reality. Mythology and folklore occupy a special place in the artistic reflection in the author's prose. These sources of popular oral literature will nurture his work making it original and impressive. In this plan, we will analyze the radical change in the treatment of popular myth and folklore by contemporary critics and scholars. The most significant element of the new treatment and analysis of the myth, lay in its acceptance as it happened in archaic societies, that is, as a true story which carried in itself valuable values, which passed from the sacred to the exemplary and significant for community. This new semantic value of the myth, finds a central place in the prose of Ernest Koliqi, especially in the collection of stories "Shadow of the Mountains", where Figures and superstitions stemming from mythological culture to mythological beings, play an organizing role within the historical context where the fantastic and the real are naturally intertwined. Between myths and folklore, one can define the artistic richness that inspires the imaginary, creative worldview of the nation. Koliqi feels that by assimilating this cultural heritage of the Albanian land, it is possible to create a literature where the play of symbols and the capture of hidden meanings may lead the reader toward multiple meanings. In this paper, we will dwell on two aspects of fantasy that can be underlined in Koliqi: the wonderful, the mythological, the rich world of fantasy and the collective imagination (fantastic characters), which collaborate with real or historical characters from daily life. The novelty and modernity of Koliqi under this light, is reinforced by the new use of myths and folklore, which are not immovable and totalitarian elements, but are mixed with any moments of daily life, intervening within the fragmentation of life. Koliqi tells with a rare experience, the feeling gained during the journey of life, the lost innocence and the wall that serves as a divider between the magical, the fantastic, the world once left on the brink of childhood, and the present where the longing grief that takes refuge in thoughts. With deep penetration and relief of the soul, the author begins to create a world made of memories and regrets, with a sweetness and fantasy capable of pushing the reader to forget the temporality and suspense of life, and to cling tightly to the supernatural, magic and life that is hidden in the human imagination. It is natural to assume that Koliqi, through the process of writing, recreates a world which, further, still exists, and can not be left behind the narrator or protagonist-author who, in the end, proves the original power of literature (by recreating of myths under a new optics), and at the same time is a witness and protagonist of the same myths structured in the contours of literary fiction.

Komunikimi publik në veprat “Historia e Skënderbeut” dhe “Rrethimi i Shkodrës” të Marin Barletit dhe komunikimet politike sot: Një qasje krahasuese në funksion të së ardhmes

Public communication in "Skanderbeg's History" and "The Siege of Shkodra" by Marin Barleti and the political communications today: A comparative approach for the future

EDLIRA BIRKO

Televizioni Publik Shqiptar Universiteti i Tiranës

Tiranë, ALBANIA

edlirabirko@yahoo.com

Fjalë çelës: Komunikimi politik, tradita shqiptare, Barleti, e ardhmja

Keywords: Public communication, Albanian tradition, Barleti, the future

Përmbledhja:

Objet i kësaj ligjërate është the komunikimi publik, me përqendrim në atë politik, në hapësirën shqiptare sot. Merret në analizë gjendja e tij duke e vendosur krahasueshëm mes dy polesh: Polin e parë e përbën tradita e komunikimit publik të modelit të Humanizmit që na ofrojnë veprat klasike “Historia e Skënderbeut” dhe “Rrethimi i Shkodrës” të Marin Barletit. Poli i dytë ka lidhje me detyrat që mendimtarë të kohës sonë shtrojnë për tiparet që duhet të fitojë e zotërojë komunikimi politik në shekullin XXI. Kjo qasje krahasuese e gjendjes së sotme me këto dy pole a skaje, siç do të shihet në vijim, nuk është e rastësishme. Vërehen shenja të forta të një krize të përgjithshme të komunikimit publik e politik në epokën e sotme, krizë e cila shfaqet shumë e rënduar në hapësirën shqiptare. Në qendër të trajtesës sonë do të jenë jo vetëm analiza e fjalimeve publike të Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, por edhe ato të mbajtura në kampin osman nga autoritetet më të larta, ashtu si dhe komunikimet midis përfaqësuesve të të dy palëve. Vëzhgimi përqendrohet në faktin se si zbatohen parimet etike në të dy kampet kundërshtarë: çmohen e motivohen bashkëpunëtorët, vlerësohet objektivisht armiku, duke i njohur edhe merita si dhe duke shmangur format e rënda denigruese, të cilat sot popullojnë rëndom fjalimet publike të politikanëve shqiptarë, të pozitës e të opozitës pa dallim. Një interesim i veçantë në analizën e veprave të Barletit i kushtohet organizimit të ligjërimit publik në funksion të audiencës: a. audiencë e lartë (përfaqësues të elitës, princërit); b. audiencë masive (masat popullore, ushtarë). Vërehet se si folësit identifikojnë me kujdes të posaçëm karakteristikat kryesore të audiencës sipas dallimeve individuale e grupore, pikërisht duke mbajtur parasysh atë çka theksohet fort sot, pas pesë shekujsh: Se çështjet e etikës dalin në pah sa herë një folës përballet me një folës a një audiencë të gjerë. Dhe se identitetet e individëve ndikohen (për mirë a për keq) nga fjalët me të cilat folësit i etiketojnë ata apo grupin ku bëjnë pjesë. Cilësia e komunikimit publik politik si dhe niveli i emancipimit të entitetit kolektiv në Shqipërinë e dy dekadave të fundit shfaq mangësi të karakterit strukturor që kanë të bëjnë me të kaluarën jo vetëm të afërt por dhe atë të largët e shumë të largët të shoqërisë shqiptare. Në epokën e sotme, në ratsin shqiptar marrë në shqyrtim, audiencë e lartë është kundërshtari politik, i cili ‘ftohet në bashkëpunim’ shpesh përmes qëndrimit zhvlerësues dhe, jo rrallë, përmes fyerjes e denigrimit. Audiencë e masive është ndërkaq publiku, komunikimi me të cilin shfaqet si urdhër e manipulim, jo në formën e bashkëndarjes së mendimeve. E shoqëron pra gjendjen një folës politik i tipit agresiv e manipulues, i cili përdor kryesisht jo argumentin, por etiketimin negativ, magjepsjen dhe sugjestionimin emocional. Kundërshtarit i përcillet

fryma e rrënimt të autoritetit e të prestigjit të tij, në vend të dorës së bashkëpunimit. Masat dëgjuese ushqehen ndërkaq, përmes pezullimit mendor, jo vetëm me pikëpamjet, por dhe me ndjenja e veprime të dëshiruara nga liderët politikë. Ekspertë të mëdhenj të fushës kërkojnë 'të pyllëzohet' gjuha, të rritet cilësia e komunikimit etik në funksion të bashkëpunimit më të mirë mes kampeve politike kundërshtarë, ashtu si dhe në funksion të emancipimit të raporteve mes elitave politike dhe bashkësisë. Veprat e Barletit, pavarësisht hapësirës së madhe kohore që na ndan prej tyre, na japin modele të rralla e tejet të frytshme të një komunikimi publik me tiparet më të mira që i shtrohen si detyrë kumtuesve publikë e posaçërisht atyre politikë të kohës së tashme dhe të epokës që vjen.

Abstract:

The object of this lecture is the public communication, with a focus on the political one, in the Albanian space today. His condition is analyzed by comparing it comparatively between two poles: The first pole is the tradition of public communication of the model of Humanism that the classic works "Skanderbeg's History" and "The Siege of Shkodra" by Marin Barleti offer us. The second pole has to do with the tasks that thinkers of our time pose for the features that political communication should acquire and possess in the 21st century. This comparative approach to the present situation with these two poles or ends, as will be seen below, is not accidental. There are strong signs of a general crisis of public and political communication in today's era, a crisis which appears very aggravated in the Albanian space. At the center of our treatment will be not only the analysis of public speeches of Gjergj Kastriot - Skanderbeg, but also those held in the Ottoman camp by the highest authorities, as well as communications between representatives of both parties. The observation focuses on how the ethical principles are applied in the two opposing camps: the collaborators are valued and motivated, the enemy is objectively evaluated, recognizing the merits as well as avoiding the serious denigrating forms, which today commonly populate the public speeches of Albanian politicians. position and opposition without distinction. A special interest in the analysis of Barletti's works is devoted to the organization of public discourse in function of the audience: a. high audience (representatives of the elite, princes); b. mass audience (popular masses, soldiers). It is observed how speakers identify with special care the main characteristics of the audience according to individual and group differences, exactly keeping in mind what is strongly emphasized today, after five centuries: That ethics issues come to the fore every time a speaker confronts a speaker or a wide audience. And that the identities of individuals are influenced (for better or for worse) by the words with which speakers label them or the group to which they belong. The quality of public political communication as well as the level of emancipation of the collective entity in Albania of the last two decades shows deficiencies of the structural character that have to do not only with the recent but also with the distant and very distant past of the Albanian society. In today's era, in the Albanian case under consideration, the high audience is the political opponent, who is 'invited to cooperate' often through a devaluing attitude and, not infrequently, through insult and denigration. The mass audience is the public, the communication with which appears as an order and manipulation, not in the form of sharing opinions. The situation is accompanied by an aggressive and manipulative political speaker, who uses mainly not the argument, but the negative labeling, fascination and emotional suggestion. The spirit of destroying his authority and prestige is conveyed to the opponent, instead of the hand of cooperation. The listening masses, meanwhile, are nourished, through mental suspension, not only by the views, but also by the feelings and actions desired by political leaders. Leading experts in the field want to 'forestize' the language, to increase the quality of ethical communication in order to better cooperate between opposing political camps, as well as in order to emancipate relations between political elites and the community. Barletti's works, in spite of the great space of time that separates us from them, give us rare and extremely fruitful models of a public communication with the best features that are tasked to the public announcers and especially to

the political ones of the present and the coming era.

Mbi figurat poetike në poezinë shqipe

Overview on poetic figures in Albanian poetry

RIZA BRAHOLLI

Universiteti i Tiranës

Tiranë, ALBANIA

rizabraholli@gmail.com

Fjalë çelës: poezia e sotme shqipe, figura, gjuha poetike

Keywords: poezia e sotme shqipe, figura, gjuha poetike

Përmbledhja:

“Nëse ritmi është zemra dhe fryma e poezisë atëherë, sigurisht, gjuha e figurshme është të mashtruarit e saj, muskulatura dhe lëkura joshëse...”, nënvizon në punimin e tij “The Great Figure: On Figurative Language” studiuesi dhe poeti amerikan D. A. Powell. Nisur nga kjo, format e teknikat e shprehjes artistike, në poezinë shqipe, nuk mund të ecin e të zhvillohen ndryshe nga ligjësia e tërësishme poetike e kësaj bote. Nuk është e re që zhvillimet e reja socio-politike e psikologjike sjellin realitete të reja që natyrisht kërkojnë dhe shprehje të reja stilistike e të figurshme. Odiseu i djeshëm joshej nga sirenat mitike, por Odiseu i sotëm kërkon melodi të tjera, të reja për t’iu dhënë deri në fund mashtresës poetike. E pra, format e kanë të pamundur të ndjekin realitetin me të njëjtin hap dhe janë gjithmonë të vonuara në raport me realitetet e reja psiko-sociale që krijohen. Për këtë shërbejnë, pikërisht, mjetet e shprehjet poetike, figurshmëria e fjalës. Po çfarë vërejmë ne në këtë sendërtim të ri në poezinë shqipe? Si bashkëvepron ligjësia poetike me këto realitete të reja sociale e gjuhësore? Hulumtimi i disa prej poetëve tanë më të mirë, veçanërisht të poezive të spikatura, të vargjeve e fjalëve të figurshme, loja me kontekstin e nëntekstin, do të na tregojë se hapja ndaj kulturave të huaja botërore, marrëdhëniet e ndërëmbimëve të gjithanshme e sidomos kulturore, kanë sjelle konceptime e strukturime të reja të shprehjes poetike, shpesh, me ndërthurje të habitshme që sjellin freski e thellim të kësaj gjuhe tjetërthvënëse të trillit. Duke gjykuar mbi racionalitetin apo iracionalitetin e tyre, mbi marrëdhënien që lind nga lënda e materies me atë abstrakte, në krijimin e lojës alogjike poetike, të futur në shtratin e analizës e të interpretimit, do të shohim prurje ligjërimore e plurale analogjike me poezinë amerikane dhe evropiane, por duke ruajtur e forcuar mëvetësinë strukturore të mëhershme. Kam hasur në një pohim me një spikatje të lavdërueshme nga studiuesi ynë Adem Jakllari, kur flet në një ese të tij, për një koncept historik sipas Eliotit. Kjo sipas tij nuk e pengon “...një gjeneratë poetësh të rinj që të realizojnë edhe në fushën e vetëdijes dhe koncepteve estetike një thyerje të fortë, që në thelb ka të bëjë me çvendosjen e madhe nga estetika e përmbajtjes drejt estetikës së shkrimit”. Nëpërmjet analizave e interpretimeve tona ne do të vërejmë si lëviz magma e nxehtë apo e ftohtë poetiko-estetike në këtë raport këndvështrimi përmbajtësor - shkrimor. Shpesh kjo, për hir të figurës, sjell kërkime e ndërtime të një arkitekture strukturore me hapësira labirinthesh për lexuesin. Dhe ne ngremë pyetjen: a duhet të ndërtohet një figurë vetëm për hir të një thellësie që në fund të fundit, nuk e çon lexuesin askund, duke iu drejtuar një kuptimshmërie të vështirë, vetëm me qëllimin për të krijuar një trop polivalent. . . , me qëllimin që të habitë! Hulumtimi i mjeteve poetike më të spikatura dhe ç’kodifikimi i këtyre figurave, duke u nisur nga harmonia që ndërtojnë me njëra-tjetrën, sendërtimet e zgjedhura për të shkruar drejt një perceptimi poetik, jo vetëm të thellë, por dhe të asimilueshëm e harmonik në aspektin e muzikalitetit, por dhe të mesazhit. Asnjë poezi e madhe nuk ka pasur qëllimin kryesor formën për formë, por ajo është sofistikuar, thelluar apo ndërlikuar, ushtruar nga ndjesi, ide apo mesazhe të mëdha. Gjuha përpunon dhe transfiguron realitetin në një dritë

të tillë, që të krijojë një mënyrë të re dhe mbresëlënëse të lexuari të dëgjuari dhe, sidomos, të shijuari apo të kuptuari. Kështu që është e nevojshme që këto figura t'i kuptosh përmes hulumtimesh të vargut, fjalës, nëntekstit e ngjashmërive sesi ndryshojnë e sesi përshtaten me mendësitë e reja bashkëkohore në të njëjtën gjatësi vale edhe me zhvillimin e gjuhës së folur? Një mënyrë e mirë është ndarja dhe vëzhgimi i tyre në figura retorike dhe deskriptive; dhe si aplikohen këto në figura të veçanta të autorëve të ndryshëm? Ky punim do të ketë si pikësynim një zhvillim të mëvonshëm më të gjerë.

Abstract:

"If rhythm is the heart and soul of poetry then, of course, the figurative language is its deception, musculature and seductive skin ...", underlines in his work "The Great Figure: On Figurative Language" the American researcher and poet DA Powell. Based on that, the forms and techniques of artistic expression, in Albanian poetry, can not lay and develop differently from the entire poetic law of this world. It is not new that new socio-political and psychological developments bring new realities that naturally require new stylistic and figurative expressions. Yesterday's Odyssey was seduced by mythical mermaids, but today's Odyssey seeks other new melodies to end poetic deception. Well, the forms find it impossible to follow reality with the same step and are always delayed in relation to the new psychosocial realities that are created. This is exactly what poetic tools and expressions serve, by the figuration of the word. But what do we notice in this new embodiment in Albanian poetry? How does poetic law interact with these new social and linguistic realities? The research of some of our best poets, especially of outstanding poems, of verses and figurative words, the game with context and subtext, will show us that the openness to foreign world cultures, have brought new conceptions and structuring of poetic expression, often with surprising combinations that bring freshness and depth to this alienating language of fiction. Judging over their rationality or irrationality, by the relationship that arises from the subject of matter with the abstract, in the creation of the illogical poetic game, inserted into the bed of analysis and interpretation, we will see discourse and plural analogies with American and European poetry, but preserving and strengthening the former structural independence. I came across in a statement with a laudable prominence from our scholar Adem Jakllari, when he speaks in one of his essays, about a historical concept according to Eliot. According to him, this does not prevent "... a generation of young poets to realize in the field of consciousness and aesthetic concepts a strong break, which basically has to do with the great shift from the aesthetics of content to the aesthetics of writing" .

Through the analysis of our interpretations we will notice how does move the hot or cold magma of poetic-aesthetic in this content of writing point of view. Oftenly is, for the sake of the figure, it brings research and construction of a structural architecture with labyrinth spaces for the reader. And we raise the question: should a figure be built just for the sake of a depth that, after all, leads the reader nowhere, addressing a difficult understanding, only with the aim of creating a polyvalent trop. . . , with the aim to surprise! The research of the most prominent poetic means and the decoding of these figures, starting from the harmony they build to each other, the embodiments chosen to go towards a poetic perception, not only deep, but also assimilable and harmonious in the aspect of musicality, but also of the message. None of great poems has had the main purpose form to form, but it has been sophisticated, deepened or complicated, used by sensations, ideas or great messages. The Language does process and transform the reality in such a light as to create a new and impressive way of reading, listening and, especially, enjoying or understanding. So is it necessary to understand these figures through research of verse, word, subtext and similarities, how do they change and how do they adapt to new contemporary mentalities at the same wavelength as the development of spoken language? A good way is the separation and observing them into rhetorical and descriptive figures; and how do these apply to particular figures of different authors? This work will aim at a wider subsequent development.

Gjuha e simboleve në piktograma Language of symbols in pictogram

LULJETA DANO
Fondacioni "Tre Mariat"
Tiranë, ALBANIA
luljetadano@gmail.com

Fjalë çelës: Xhubleta shqiptare, gjuha e simboleve, piktograma
Keywords: Albanian Xhubleta, language of symbols, pictogram

Përmbledhja:

Padija ime sa vjen dhe rritet, sa më shumë shtrohen pyetjet që i bëj vetes ndërsa bashkëjetoj prej gjashtëmbëdhjetë vjetësh me “tekstet” magjepsëse të xhubletës Shqiptare. Prejardhjen e kësaj gjuhe, e përcjell më mirë fjala e egjiptianologut John Anthony West: Çdo gjë ishte aty që në fillim. Objektet etnografike që ndodhen në arkivin shtetëror apo në koleksionet private shqiptare, pa folur për rrallësitë, përgjithësisht kanë një vjetërsi fizike 120-250 vjeçare, por tipologjia e tyre, gjuha e simboleve dekoruese në to, unë besoj se, vjen nga parahistoria ende e pamatur me kohë, gjuhë që fatmirësisht na vjen e gjallë, si tekste të shkurtëra, gjurmë apo fragmente, ndër shqiptarët e sotëm, nëpërmjet trashëgimisë së tyre materiale. Sistemin e simboleve në piktograma, Manly Palmer Hall e quan “gjuhë të mistereve të të gjitha natyrave: një simbol mund të zbulojë ose të fshehtë, sepse për të diturit objekti i simbolit është i lexueshëm, kurse për të paditurit simboli mbetet i padepërtueshëm”. Vëzhgimet hulumtuese e studimore nga gjithë mitet kozmogonike të kulturave primitive në botë, dëshmojnë rrënjë të njëjta, gjuhën figurative të simboleve që zotëron edhe attribute kultike e mbrojtëse, si dhe besimin e verbër të bartësve, se zotat e parë do të kthehen. Begatia e piktogrameve në objekte të ndryshme, si në veshje, dru, gur, metal, shkëmbinj, shpella, ikonografi, mblata që shoqërojnë ritet zakonore, në lëkurën njerëzore si tatuazhe me veti të larta kultike, ngado në trevat etnologjike shqiptare, por edhe tek popujt e tjerë, i përkasin një estetike transhendentale të arketipeve, thënë me fjalët e Jungut, i mbart pavetëdija kolektive dhe bëhen një lloj altari për jetën e vetëdijshme, “përbëjnë gjuhën e psikës së lindur”. Fenomeni i dekorimit me këto simbole në kostumin kombëtar khqiptar me xhubletë të grave të Veriut, ka epërsinë të tejkalojë kështu vetveten. Studiuesit shqiptarë dhe të huaj, njëzëri i atribuojnë tipologjisë së xhubletës një moshë parahistorike katërmijëvjeçare a më shumë. Monumentaliteti pamor i skulpturës së xhubletës së zezë, antropologjia e prejardhjes së saj, teknikat e ndërtimit dhe prodhimit, si dhe gjithçka tjetër e mjedisit ku xhubleta jeton, si tipologji e veshjes më të vjetër në botë, ende e gjallë ndër shqiptarë, janë njera anë e medaljes; por ornamentika e qëndisjeve mbi këtë veshje është ana tjetër e cila është kaq e pangjashme me asgjë të llojit të saj, veçse nëse e familjarizojmë me shkrimin piktografik hitit e egjiptian, ose me petroglifet, tatuazhet, hajmalitë, mite botëkrijuese dhe shkrime të tjera nga fise që ende dëshmojnë traditë arkaike të humbur nga tërë kontinentet. Parimi i kompozimit të ornamenteve në këto objekte etnografike është simetria majtas - djathtas ndaj një figure të vetme në qendër. Mund të themi, se milionat e faqeve që mbushin internetin sot me titujt e Dragoit Briartë të Gjenezës; Feniksit; Shqiponjës Dykrenore; Veza Kozmike; Pema Mistike (E Jetës); Lulja Mistike (E Jetës); Kyçi Egjiptian i Jetës; Merimanga, Akrepi dhe Kacabujtë - Brumbujt Mistikë; Teta e Shenjtë, (Infiniti); Fallusi Delfik; Simbolet Zeusiane: Gjethja treshe e Lisit të Shenjtë dhe Dy Gjethet Kryq të Lisit Të Shenjtë; e një shumicë simbolesh të tjera në planetin Tokë që lidhen kryesisht me Kozmogoninë dhe atributet e Krijuesit të Gjithësisë, pranëvënia e këtyre simboleve qëndisur në veshjen tradicionale të malësorës shqiptare,

leximi sipas këtyre rreshtave, më bën të besoj, se interneti nuk është një i ri 31 - vjeçar, por “Është aq i vjetër sa është vetë Universi”!

Abstract:

The more time go by and the more I learn about beautiful style of Albanian Xhubleta. I have been working for 16 years and I am fascinated by the symbols of the Xhubleta. I am trying to figure out the origin of these the symbols. As the Egyptologist John Anthony West said: “Everything was there from the beginning.” Ethnographic objects that are in the state archive or in the Albanian private collections, not to mention these rare objects generally only have a physical age of 120-250 years. But their typology and the language of the decorative symbols in them, I believe, comes from prehistoric times. The language that thankfully comes alive to us, like short texts leave traces or fragments, among today’s Albanians, Manly Palmer Hall calls the system of symbols in pictograms "the language of mysteries of all natures. A symbol can reveal or be hidden. Because for the learned, the object of the symbol is legible, while for the ignorant the symbol remains impenetrable." Research observations from all the cosmogonic myths of primitive cultures in the world, prove that they come from the same roots. The figurative language of symbols possesses both cultural and protective attributes, as well as the blind belief of the bearers that the first gods will return. The richness of pictograms in various objects, such as clothing, wood, stone, metal, rocks, caves, iconography, masks that accompany customary rites, on human skin as tattoos with high cultural properties, everywhere in the Albanian ethnological territories. This also occur in other cultures and belong to a transcendental aesthetic of archetypes. In the words of Jung, carry them to the collective unconscious and become a kind of altar to the conscious life, "constitute the language of the innate psyche." The phenomenon of decoration with these symbols in the Albanian National Costume with the Jubilees of the women of the North, has the advantage of expressing itself in this way. Albanian and foreign scholars unanimously attribute to Xhubleta’s typology a prehistoric age of four thousand years or more. The visual monumentality of the black jubilee sculpture, the anthropology of its origin, the construction and production techniques, as well as everything else of the environment where the jubilee lives, is a typology of the oldest dress in the world. This is still alive among Albanians on one side of the medal. The ornamentation of the embroidery on this dress is the other side which is so unlike anything of its kind. We can only compare it with the Hittite and Egyptian pictographic writing, or with petroglyphs, tattoos, talismans, world-creating myths and writings from other from tribes that still testify to the archaic tradition lost from all continents. The principle of composing ornaments in these ethnographic objects is left-right symmetry to a single figure in the center We can say, that the millions of pages that fill the internet TODAY with the titles of the Brilliant Dragon of Genesis; Phoenix; Double-headed Eagle; Cosmic Egg; Mystical Tree (Of Life); Mystical Flower (Of Life); Egyptian Key to Life; Spiders, Scorpios and Cockroaches - Mystical Beetles; Holy Aunt, (Infinite); Fallusi Delfik; Zeusian Symbols: The Triple Leaf of the Holy Oak and the Two Cross Leaves of the Holy Oak; of many other symbols on our planet that are mainly related to Cosmogony and the attributes of the Creator of the Universe, the placement of these symbols embroidered in the traditional dress of the Albanian highlands, reading according to these lines, makes me believe that the internet is not new 31 year old, but "It is as old as the Universe itself"!

Raporti histori - fiksjon në prozën e Mehmet Krajës

The history-fiction relationship in prose of Mehmet Kraja

HEKURAN HASANAJ
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë
Tiranë, ALBANIA
hhasanaj@yahoo.com

Fjalë çelës: fiksjon, histori, relativizim, këndvështrim, ironi

Keywords: fiction, history, relativism, perspective, irony

Përmbledhja:

Në punimin tonë trajtohet raporti histori - fiksjon në prozën e Krajës. Trualli ku ngrihet vepra është një koordinatë e njohur në arealin dhe botën shqiptare. Një roman historik nuk e tradhton dokumentin dhe vetëm sa e plotëson atë që është e mirënjohur me të dhëna të panjohura mbi ata që e jetësojnë atë. Romani i Krajës është në të vërtetë një relativizim i historisë dhe rruga që ai ka zgjedhur është ajo e stilit të kronikës dhe dokumentimit për të realizuar, në fakt, një fiksjon të përsosur dhe për të prodhuar një roman psikologjik me shtjellime filozofike dhe me përjetimet e përthyerjet e historisë në jetën dhe shpirtin e njeriut në kushtet e dhunës e të mungesës së lirisë. Kjo ngre baza që dërgojnë konceptimin e veprës në thellimet psikologjike dhe në raportet e detyruara e të shpërfytyruara, të cilat bëhen absurde dhe artificiale. Individui i shtypur lufton një luftë së cilës nuk ia di qëllimin dhe përfundon në një labirint ëndërrimesh për të shpëtuar nga realiteti shtypës, i cili shfaros rregullisht çdo gjë të bukur. Edhe pse kronika, dëshmitë, dokumentet, fletoret, letrat e zverdhura me shkrime të padëshifrueshme mbushin prozën romanore të Krajës, do të ishte një lexim i gabuar e sipërfaqësor nëse do të kërkonim ligjërim historik. Historia në vepër shërben për të motivuar gjithë vuajtjet njerëzore dhe pasojat e luftës së përjetshme të njeriut që zënë gjithë kohën e tij pa mëshirë dhe mbyllin shtigjet e frymëmarrjes dhe të ndërtimit të një bote të ëndërruar në breza. Distancimi kohor përbën një domosdoshmëri fiksjonale dhe siguron një këndvështrim që i largohet gjykimit gjaknxehtë. Degradimi i rrethanave, shkatërrimi i përmbajtjes, përqendrimi i të gjitha shqisave jo në atë që ndodh, heqja e çudisë mbi fabulën dhe përqendrimi tek gjuha, ligjërimi dhe rivitalizimi metaforik e simbolik, është sigurisht fiksjon, pesha e të cilit mbartet edhe pas përfundimit të romanit. Ajo çka ndërtohet në reflektimet e lexuesit është romani i vërtetë. Loja fiksjonale e autorit turbullon materialin historik dhe ofron pikëpyetje më tepër se këndvështrime. Ironizimi është një qasje fiksjonale që ndihmon relativizimin absolut dhe shpie në këndvështrime dikotomike. Subjektiviteti metafizik është pikëpamja që autori zgjedh të marrë në vërtetimin e tij fiksjonal duke thurur një modelim të ri të historisë duke lënë jashtë vëmendjes versionin “zyrtar” të saj, atë të njohur botërisht e duke zbuluar rreth tij dritëhije nga kënde të humbura prej vëmendjes. Degradimi i rrethanave, shkatërrimi i përmbajtjes, përqendrimi i të gjitha shqisave jo në atë që ndodh, heqja e çudisë mbi fabulën dhe përqendrimi tek gjuha, ligjërimi dhe rivitalizimi metaforik e simbolik, është sigurisht fiksjon, pesha e të cilit mbartet edhe pas përfundimit të romanit. Ajo çka ndërtohet në reflektimet e lexuesit është romani i vërtetë. Loja fiksjonale e autorit turbullon materialin historik dhe ofron pikëpyetje më tepër se këndvështrime. Ironizimi është një qasje fiksjonale që ndihmon relativizimin absolut dhe shpie në këndvështrime dikotomike. Subjektiviteti metafizik është pikëpamja që autori zgjedh të marrë në vërtetimin e tij fiksjonal duke thurur një modelim të ri të historisë duke lënë jashtë vëmendjes versionin “zyrtar” të saj, atë të njohur botërisht e duke zbuluar rreth tij dritëhije nga kënde të humbura

prej vëmendjes.

Abstract:

Our paper treats the observation on the history-fiction relationship in Kraja's prose. The foundation where the work is erected is a well-known coordinated area in the Albanian world. A historical novel does not betray the document rather it only complements what is well known with unknown facts about those who bring it to life. If truth be told, Kraja's novel is a relativization of history and the path he has chosen is that of the chronicle and documentation style to realize, in fact, a perfect fiction and to produce a psychological novel with philosophical elaborations and experiences, the twists and turns of history in the life and soul of man in the conditions of violence and lack of freedom. This is the point of departure that sends the conception of the work into psychological depths and into forced and distorted relationships, which become absurd and artificial. The oppressed individual fights a war whose purpose is unknown for him ending up in a labyrinth of dreams to escape from the brutal reality, which regularly destroys everything beautiful. Although chronicles, testimonies, documents, notebooks, yellowed letters with undecipherable writings fill Kraja's novel prose, it would be a misleading and superficial reading if we were to seek historical discourse. History in this work serves to motivate all human suffering and the consequences of man's eternal struggle that occupy all his time without mercy and close the paths of breathing and building a world dreamed of for generations. Time distance constitutes a fictional necessity and provides a perspective that shuns hot-blooded judgment. The degradation of circumstances, the destruction of content, the concentration of all the senses not on what is happening, the removal of wonder on the fable and the concentration on language, discourse and metaphorical and symbolic revitalization, is certainly fiction, the weight of which is carried even after the end of the novel. What builds on the reader's reflections is the real novel. The author's fictional play blurs historical material and offers question marks rather than perspectives. Irony is a fictional approach that aids absolute relativism and leads to dichotomous perspectives. Metaphysical subjectivity is the view that the author chooses to take in his fictional observation by weaving a new model of history, leaving out of attention the "official" version of it, the world-famous one, and discovering its shadows from the most hidden angles. The degradation of circumstances, the destruction of content, the concentration of all the senses not on what is happening, the removal of wonder on the fable and the concentration on language, discourse and metaphorical and symbolic revitalization, is certainly fiction, the weight of which is carried even after the end of the novel. What builds on the reader's reflections is the real novel. The author's fictional play blurs historical material and offers question marks rather than perspectives. Irony is a fictional approach that aids absolute relativism and leads to dichotomous perspectives. Metaphysical subjectivity is the view that the author chooses to take in his fictional observation by weaving a new model of history, leaving out of attention the "official" version of it, the world-famous one, and discovering its shadows from the most hidden angles.

Muzika faktor i rëndësishëm edukativ dhe terapeutike për fëmijët me aftësi ndryshe

Music, as important therapeutic and educational factor for children with different skills

ELIONA LICI

University

Vlorë, ALBANIA

elionalici@live.com

Fjalë çelës: Terapia muzikore, shëndeti mendor, edukim

Keywords: Music therapy, mental health, education

Përmbledhja:

Muzika si një faktor i rëndësishëm edukativ, por edhe terapeutik është njohur që në kohët e hershme të njerëzimit, por vetëm pas Luftës II Botërore nisi të njihet termi “muzikoterapi” përkatësisht rreth viteve 1950 dhe baza shkencore për të nisi të krijohet po në këtë periudhë. Muzika si terapi ka gjetur një hapësirë të gjerë përdorimi në shumë sfera të fushës së mjekësisë, po ashtu edhe në pedagogjinë e specializuar dhe në institucionet për mbrojtjen e shëndetit mendor. Muzika dhe rrjedhimisht muzikoterapia, ndikon tek fëmijët me vështirësi në të nxënit dhe aftësi të kufizuara, me probleme të sjelljes, humbje të dëgjimit, çrregullime të spektrit autik etj. Më specifikisht muzika nxit fëmijët të integrohen në edukimin special në një shumësi aspektesh të zhvillimit të tyre, si fusha e perceptimit, lëvizjes, komunikimit, zhvillimit gjuhësor, shoqëror dhe zhvillimi i lidhjeve ndërpersonale. Qëllimi i artikullit qëndron në informimin teoriko-praktik të edukatorëve dhe mësuesve të muzikës në arsimin e përgjithshëm dhe atë special për rolin gjithpërfshirës të muzikës duke sjellë në vëmendje, rëndësinë e veçantë të marrëdhënies që krijohet përmes muzikës dhe lëvizjes si një shprehje e unifikuar e ndjesive shpirtërore, emocioneve mendimeve dhe trupit të njeriut. Metodologjia e përdorur për këtë punim konsiston në kombinim të metodologjive përshkruese, hulumtuese, dhe analitike. Në mënyrë përshkruese trajtohet literatura e huaj dhe koncepti mbi muzikën si terapi, ku më tej analizohen çështje kryesore të efektivitetit të muzikoterapisë në mjedise të ndryshme arsimore ku paraqitet vlera kryesore e përdorimit të muzikës në arsimin special dhe ndikimin pozitiv në integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe. Analiza kryesisht mbështetet në referime apo botime personale të kësaj fushe, si dhe në literaturë të huaj, por gjithashtu evidentohen vëzhgimet prej vlerësimeve formuese të ndërveprimit të dy rasteve nga përvojat personale prej punëve të kryera me fëmijë me nevoja speciale, duke vërtetuar dhe se roli i muzikës nxit integrimin dhe rrit cilësinë e jetës tek individët me aftësi ndryshe. Kryesisht në vëzhgime janë vërejtur dhe krahasuar disa nga reagimet e fëmijëve me nevoja speciale, disleksi, autizëm, sindroma down. Rezultatet dhe diskutimi: duke qenë se në vendin tonë mungojnë strukturat e posaçme për të siguruar një mjedis edukues dhe terapeutik përmes muzikës në institucione shkollore, pesha kryesore i bie mësuesit të muzikës, i cili duhet të jetë i mirëinformuar për rolin edukativ dhe terapeutik të muzikës për të gjithë fëmijët, në përgjithësi dhe për ata me nevoja ndryshe, në veçanti. Muzika në shkolla, por edhe në mjediset jashtë shkollore krahas edukimit me konceptet muzikore dhe argëtimit duhet të sigurojë hapësirën e duhur edhe për fëmijët me nevoja ndryshe për t'i përfshirë të gjithë. Edukimi me muzikë mbetet një faktor me rëndësi për fëmijët me vështirësi në të nxënë dhe neuropsikologët e vlerësojnë mësimin e muzikës si process njohës, pasi përftojnë njohje muzikore, por edhe si zhvillim, pasi

kontribuon në përmirësimin e aftësive, si koordinimi lëvizor, gjuha, përqendrimi dhe kujtesa. Shumësia e hulumtuesve dakortësohen se një individ me vështirësi në të nxënit mund të përfitojë nga muzika dhe nga lëndët e tjera vetëm atëherë kur ndërgjegjësohet dhe njih vështirësinë sa më herët. Një nga vështirësitë që hasë fëmija me disleksi është njohja e partiturës. Simbolet në pentagram i duket sikur “fluturojnë” duke i provokuar stres dhe lodhje fëmijës. Përshembull, shpesh herë ndodh që fëmijët me disleksi të mos dallojnë timbrin e ndryshëm dhe potencën tingëllore. Një linjë e elementeve të muzikës që i lodh fëmijët me disleksi është tempi, ritmi, saktësia ritmike. Gjatë këndimit të këngës apo luajtjes në instrument vërehet një aritmi. Dallimi i lartësisë së tingullit është një tjetër "vështirësi". Në vija të përgjithshme fëmijët disleksikë kanë nevojë për të pasur më tepër kohë që të stabilizojnë ndjesinë e brendshme të lartësisë tingëllore sesa fëmijët e tjerë. Këta fëmijë kanë perceptim pak më të reduktuar të kohës dhe drejtimet, por kanë tendencën të këndojnë mirë.

Abstract:

Music as an important educational but also therapeutic factor has been known since the early times of mankind, but only after World War II the term "Music Therapy" began to be known around the 1950s and the scientific basis for it, began to be created in this period. Music as therapy has found a wide field of use in many areas of the field of medicine, as well as in specialized pedagogy and in institutions for the protection of mental health. Music, and consequently music therapy, affects children with learning difficulties and disabilities, behavioral problems, hearing loss, autism spectrum disorders, etc. More specifically, music encourages children to integrate into special education in a variety of aspects of their development, such as the field of perception, movement, communication, language development, social development and interpersonal connections. The purpose of the article is to provide theoretical and practical information to music educators and teachers in general and special education about the inclusive role of music, bringing to attention the special importance of the relationship created through music and movement as a unified expression of feelings, spirits, emotions thoughts and human body. The methodology used for this paper consists of a combination of descriptive, research, and analytical methodologies. The foreign literature and the concept of music as therapy are treated descriptively, where the main issues of the effectiveness of music therapy in different educational environments are further analyzed, where the main value of the use of music in special education and the positive impact on the integration of children with different abilities are presented. The analysis is mainly based on references or personal publications in this field as well as in foreign literature, but also evidences observations from formative assessments of the interaction of the two cases from personal experiences from work performed with children with special needs proving that the role of music integration and increases the quality of life in individuals with different abilities. Mainly in the observations are observed and compared some of the reactions of children with special needs, dyslexia, autism down syndrome. Results and discussion: As in our country there is a lack of special structures to provide an educational and therapeutic environment through music in school institutions, the main weight falls on the music teacher who should be well informed about the educational and therapeutic role of music for all children in general and for those with different needs in particular. Music in schools, but also in out-of-school settings in addition to education with musical concepts and entertainment should provide the right space for children with different needs to include everyone. Music education remains an important factor for children with learning difficulties, and neuropsychologists value learning music as a cognitive process, as they acquire musical knowledge, but also as a development, as it contributes to improving skills such as motor coordination, language, concentration and memory. Most researchers agree that an individual with learning difficulties can benefit from music and other subjects only when he or she becomes aware of and recognizes the difficulty as early as possible. One of the difficulties that the child with dyslexia faces is the recognition of the score, the symbols on the pentagram, seem

to "fly" provoking stress and fatigue to the child. For example, it often happens that children with dyslexia do not distinguish between different timbre and sound potency. A line of music elements that tires children with dyslexia is tempo, rhythm, rhythmic accuracy, while singing a song or playing an instrument an arrhythmia is noticed. Distinguishing the pitch is another difficulty. "In general, dyslexic children need more time to stabilize their inner sense of pitch than other children. These children have a slightly reduced perception of time and directions, but tend to sing well.

Prerjet tematike në prozën e autorit Veli Stafa

Thematic views in the prose of the author Veli Stafa

LORETA LOLI

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Tiranë, ALBANIA

loreta.loli@gmail.com

Fjalë çelës: Proza, “qyteti modern”, vetmia, Shkodra.

Keywords: Prose, poetry, citizen, “modern town”, loneliness, Shkodra.

Përmbledhja:

Emri i Veli Stafës, i prezantuar ndryshe për lexuesin si Platonicus, pseudonimi fort i dashur dhe kup-timplotë i përzgjedhur nga vetë autori, që e bëri atë të njohur në periodikët shqip më të mirë të shekullit të kaluar, i takon asaj kategorie shkrimtarësh të cilët, edhe pse nuk janë aktorët kryesorë, violinat e para në simfoninë e një sistemi letrar kombëtar, gjithsesi janë të rëndësishëm për studiuesin që të shtrijë shikimin dhe të kuptojë edhe më shumë historinë e letërsisë shqipe të viteve '30 të shekullit XX, periudhë ku vrullima poetike mbetet më e forta për individualitetet krijuese dhe format zhanrore që solli. Ernest Koliqi shprehet se, pasuria letrare e një kombi përmban shkrimtarë të mëdhenj dhe shkrimtarë dytanikë, të cilëve nuk u duhet mohuar rëndësia. Shpesh në dytanikët, shpirti i mshehtët autokton shfaqet i vetvetishëm e i kulluar dhe na zbulon veti të panjohura të brumit tonë kombëtar. Nëse në letërsinë shqipe të shekullit XIX dhe tri dhjetëvjetëshat e parë të fillimshekullit XX ndjenjën e vetmisë e gjejmë më shumë si përjetim dhimbjeje e pikëllimi për atdheun e munguar, ku autori i identifikuar herë me Unin lirik, herë me njërin nga personazhet e veprës e vuan thellë faktin e të qenurit larg Shqipërisë, pas viteve '30, me shfaqjen e autorëve si: Migjeni, Poradeci, Koliqi, Kuteli etj., vetmia vendoset në raporte të tjera, të reja, moderne me individin dhe shqiptarin. Objekt i punimit tonë do të jetë pikërisht kjo prerje e re tematike e përjetimeve shpirtërore, e vetmisë së individit shqiptar, e universitarit të viteve 1930-të, i cili në përballje me botën e qytetëruar jashtë reflekton mbi përmbajtjen e realitetit shqiptar, duke e parë këtë si pjesë të zinxhirit të zhvillimeve europiane, ku shpesh herë përthyhen shëmtuar disa prej veseve të së ashtuquajturës “jetë moderne”. Siç është vënë në dukje nga studiuesit, autori V. Stafa ka pikëtakime me Migjenin, Kolë Mirditën dhe Gaspër Palin, qoftë për disa motive të cilat kalojnë në të katra penat, qoftë për një rastësi fatkeqe në jetë: të gjithë bashkë, fare të rinj në moshë, u larguan nga kjo botë nga sëmundja e tuberkulozit. Shfaqjet e vetmisë në krijimtarinë letrare të Veli Stafës do t'i analizojmë përmes hulumtimit të teksteve të veçanta që u lëvruan nga autori gjatë periudhës 1934-1936, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në prozën e tij dhe në faqet e ditarit që autori e botoi te revista “Bota e re”. Nëpërmjet analizës krahasuese mbi shkrimet e botuara në faqet e periodikëve dhe përmbledhjes thujse të plotë të krijimtarisë së autorit, bërë pas vdekjes së tij nga i vëllai dhe nga Andrea Varfi, bashkëkohës dhe njëherazi shok me V. Stafën, do të evidentojmë ndryshimet që kanë pësuar tekstet. Fokusi i analizës sonë këtu do të jetë proza dhe, në veçanti ditari që i riu Veli Stafa e titulloi thjesht: “Nga ditari i një universitari”, zhanër ku zëri autorial, për vetë natyrën që i dikton subjektit shkruar ky lloj rrëfimi, është i pastër në emocionet dhe mendimet që i përcjell lexuesit të tij. Jemi me mendimin se krijimtaria e Veli Stafës, nxënësit të dalluar të një emri markues në historinë e letërsisë shqipe, siç është Ndre Mjedja, e pasuroi tematikën e përjetimeve shpirtërore të të riut shqiptar që jetoi në vitet e hovit kulturor (1930), por gjithashtu zhvilloi e pasuroi zhanret e letërsisë shqipe, në mënyrë domethënëse atë të ditarit, që

është rrëfimi intim i tij.

Abstract:

The name of Veli Stafa, otherwise presented to the reader as Platonius, the loved nickname chosen by the author himself, which made him famous in the most known Albanian periodicals of the last century, belongs to that category of writers who, although aren't the first violins in the symphony of a national literary system, however they are important for the researcher to extend the view and to understand even more the history of Albanian literature of the 30s of the XX century, a period when the poetic momentum was the strongest in creative styles and individualities. Ernest Koliqi says that, the literary wealth of a nation contains great writers and secondary writers, whose importance should not be denied. Often in the secondary writers, the indigenous spirit appears spontaneous and pure and reveals to us unknown features of our national dough. If in the Albanian literature of the XIX century and the first three decades of the early XX century we find loneliness more as an experience of pain for the missing homeland, where the author, identified sometimes with the lyrical I, sometimes with one of the characters of his work, suffers deep loneliness of being away from Albania, after the '30s, with the show of authors such as: Migjeni, Poradeci, Koliqi, Kuteli etc., loneliness is placed in others, new and modern relationships with the Albanian. The object of our paper work will be this new thematic cut of spiritual experiences, of the loneliness of the Albanian student of the 1930s, who faced with the civilized world abroad reflects on the content of the Albanian reality, seeing this as part of the chain of European developments, where many times some of the habits of the so-called "modern life" are often ugly been reflected. As noted before by the researchers, Veli Stafa has points of contact with Migjeni, Kole Mirdita and Gaspër Pali, whether in some motives which pass from one to another, or even for an unfortunate coincidence in their lives: all together, very young in age, left this world from tuberculosis disease. We will analyze the manifestations of loneliness in the literary works of Veli Stafa through the research of his texts created by the author during the period 1934-1936, focusing in particular on his prose and the pages of the diary that he published at "Bota e Re" magazine. Through the comparative analysis of the articles published in the pages of periodicals with the almost complete opera of the author's, made after his death by his brother and Andrea Varfi, contemporary and at the same time friend of V. Stafa, we will identify the changes of the texts. Here, the focus of our analysis will be prose and, in particular, the diary that the young author Veli Stafa simply titled: "From the diary of a university student", a genre where the authorial voice, for the nature that dictates to the writing subject this kind of lecture, is pure in the emotions and thoughts that transmit to its reader. We share the opinion that the creativity of Veli Stafa, the distinguished student of a big name in the history of Albanian literature, such as Ndre Mjedja, enriched the theme of the spiritual experiences of the young Albanian who lived in the years of cultural glow (1930), but also developed and enriched the genres of Albanian literature, significantly that of the diary, which is his intimate narrative.

Masnavia dhe rubaia persiane në poetët minorë shqiptarë

The Masnavi and persian rubaiyat in Albanian minor poets

BLERINA HARIZAJ
Universiteti "Aleksandër Moisiu"
Durrës, ALBANIA
harizajblerina@yahoo.com

Fjalë çelës: masnavia, rubaia, letërsia persiane, poetë minorë shqiptarë
Keywords: Masnavi, Rubaiyat, Persian literature, Albanian minor poets

Përmbledhja:

Letërsia shqipe sikundër edhe letërsitë e tjera botërore ka qenë e hapur për marrëdhënie me sistemet e tjera letrare. Në këtë mënyrë letërsia shqipe si një letërsi periferike apo minore në raport me letërsitë e tjera të ashtuquajtura burimore është gjithmonë në marrëdhënie interferenciale, e cila ka huazuar prej këtyre sistemeve letrare modele, tema apo edhe lloje poetike që i ka bërë pjesë të traditës së saj letrare, por duke ruajtur gjithmonë identitetin e vet origjinal. Qëllimi i kumtesës është pikërisht huazimi i dy formave poetike persiane, masnavia dhe rubaia nga poetët minorë shqiptarë, si: Habib Skënderi, Jorgo Lipe, Nexhip Ejupi, Pëllumb Ahmeti etj, të cilët e përvetësuan më së miri atë, duke u bërë kështu pjesë e repertorit tonë letrar. Ndikimi i rubaisë dhe e masnavisë të shkrimtarët tanë vihet re në strukturën tekstore, por edhe metrike, në disa prej tyre rubaia zotëron më shumë si në rrafshin metrik dhe atë retorik. Ndërsa masnavia persiane në poetët minorë të ditëve të sotme risillet në formën e distikut, disa prej të cilëve i kanë qëndruar besnikë këtij lloji poetik si në aspektin metrik ashtu edhe në përmbajtje. Por ka edhe nga ata poetë minorë shqiptarë, të cilët kanë sjellë risi duke e pasuruar këtë lloj poetik në përmbajtje. Rubaia është një poemë e shkurtër e përbërë prej katër vargësh, që rimon sipas skemës aaba dhe aaaa, e cila ka pavarësinë e vet, duke na pohuar një të vërtetë morale apo edhe filozofike. Ndërkohë që masnavia përbëhet nga vargje që rimojnë njëri me tjetrin, sipas skemës metrike aa, bb, cc, dd në varësi të numrit të vargjeve. Vargjet e masnavisë krahasohen me distikun apo dyvargëshin, dhe secili prej tyre ka një fund të dallueshëm poetik. Këto dy forma poetike patën një përdorim të gjerë në letërsinë sufite persiane të shekullit të 11-12-të, nga poetët si; Mevlana Rumi, Omar Khajami, Saadi etj. Po të hedhim një vështrim retrospektiv, rubaia u bë e njohur për lexuesin shqiptar përmes përkthimit gjenial të “Rubairave” të Omar Khajamit nga Fan Noli në vitin 1926 dhe dijetarit Hafiz Ali Korça, “Katrorët e Umar Khajamit” në vitin 1942. Rëndësia e punimit qëndron në faktin se poetët minorë shqiptarë gjetën te format poetike me burim të huaj, një model ideal për të trajtuar tema filozofike, erotike, sociale, didaktike dhe morale, gjithnjë duke i dhënë ngjyrë bashkëkohore një forme poetike të lashtë. Poetët minorë shqiptarë janë përpjekur ta lëvrojnë masnavinë dhe rubainë persiane në një shkallë të admirueshme poetiko-semantike, duke sjellë edhe risi në përmbajtjen e këtyre modeleve poetike me burim oriental, në pasurimin e tyre me mesazhe filozofike dhe socio-politike që nuk ka qenë tipare dalluese të tyre. Por në letërsinë shqipe përveç këtyre formave poetike, janë lëvruar edhe forma të tjera si gazeli apo nefesi, sidomos në letërsinë bektashiane. Ndikimi i vjershërimit oriental në letërsinë shqipe ka sjellë një ndihmesë të madhe në traditën tonë letrare. Metoda e ndjekur është ajo historiko-krahasuese, e gërshetuar me elementë të analizës tekstuale që nxjerrë në pah të dhëna të sakta për punimin tonë.

Abstract:

Albanian literature as well as other world literatures has been open to relations with other literary systems. In this way, Albanian literature as a peripheral or minor literature in relation to other so-called source literatures is always in interferential relations, which has borrowed from these literary models, themes or even poetic types that have become part of its tradition literary, but always preserving its original identity. The purpose of this paper is precisely the borrowing of two Persian poetic forms, "The Masnavi" and "Rubaiyat" by minor Albanian poets, such as: Habib Skënderi, Jorgo Lipe, Nexhip Ejupi, Pëllumb Ahmeti, etc, who were the best to adopt it, becoming part of our literary repertoire. The influence of "Rubaiyat" and "Masnavi" on our writers it was noticed in the textual structure, but also metric, in some of them "Rubaiyat" dominates both, in the metric and rhetorical plane. While the Persian "Masnavi" in the minor poets of today is revived in the form of a "Disticu", some of whom have remained faithful to this type of poetry both in terms of metrics and content. But there are also those minor Albanian poets who have brought innovation by enriching this kind of poetry in content. "Rubaiyat" is a short poem consisting of four verses, rhyming according to the "aaba" and "aaaa" scheme, which has its own independence, affirming to us a moral or even philosophical truth. While "Masnavi" consists of strings that rhyme with each other, according to the metric scheme "aa", "bb", "cc", "dd" depending on the number of verses. The "Masnavi" verses are compared to the "Distic" or couplet, and each has a distinct poetic ending. These two poetic forms had a wide use in Persian Sufi literature of the 11th-12th century, by poets such as; Mevlana Rumi, Omar Khajami, Saadi etc. "The Masnavi" is a series of six books of poetry that together amount to around 25,000 verses or 50,000 lines. It is a spiritual text that teaches Sufis how to reach their goal of being truly in love with God. Taking a retrospective thought, "Rubaiyat" became known to the Albanian reader through the genius translation of Omar Khajami's "Rubaira" by Fan Noli in 1926 and the scholar Hafiz Ali Korça, "Umar Khajami's Squares" in 1942. Importance of the work lies in the fact that minor Albanian poets found in poetic forms of foreign origin, an ideal model to address philosophical, erotic, social, didactic and moral themes, giving always contemporary color to an ancient poetic form. Albanian minor poets have tried to deliver the Persian "Masnavi" and "Rubaiyat" on an admirable poetic-semantic scale, bringing innovations in the content of these poetic models with oriental source, in their enrichment with philosophical and socio-political messages that have not been features their distinctive. work. But in Albanian literature there have found a poetic format, other forms such as 'gazeli' or 'nefesi', in which they have been delivered, especially in Bektashi literature. The influence of oriental poetry on Albanian literature has brought a great help to our literary tradition. The method followed is the historical-comparative one, intertwined with elements of textual analysis that highlight accurate data for our work.

Balada e Lalë Bajramit

The ballad of Lala Bajram

ZEQIRJA NEZIRI

pensionist

Shkup, NORTH MACEDONIA

zeqirjaneziri@gmail.com

Fjalë çelës: balada, mbishtresim, transformim, motiv, rinjohje.

Keywords: ballad, overlay, transformation, motive, recognition.

Përmbledhja:

Balada e Lalë Bajramit bën pjesë në grupin e baladave të rinjohjes së burrit me gruan. Tema e kësaj balade është ndërkombëtare. Atë e njohin pothuaj të gjithë popujt e botës. Strukturimi i veprimit të saj, ashtu si ndryshon midis popujve, ndryshon edhe brenda letërsisë gojore të një populli ose të një krahine të tij. Subjekti në këto balada zhvillohet rreth të riut të sapomartuar, i cili tri ose pesë ditë pas martesës rekrutohet ushtar dhe kthehet në shëtpi pas nëntë vjetësh, kur nusja është në prag të martesës me burrin e dytë. Këtë motiv letërsia gojore shqiptare e njej në të gjithë territorin e saj, si në atë etnik, ashtu edhe në diasporë, te arbëreshët e Italisë. Kjo dëshmon se ky motiv historikisht është shumë i vjetër. Lashtësia e tij do të kërkuar shumë thellë në të kaluarën historike. Në vija të përgjithshme, ngritja e narracionit është e njëjtë, si te arbëreshët e Italisë, ashtu edhe te shqiptarët e Ballkanit. Ndryshon vetëm mënyra e organizimit, theksimi më i dukshëm dhe vlerësimi, zëvendësimi ose eliminimi i plotë ose i pjesëshëm i ndonjë skene a situatë, si dhe përqendrimi i vëmendjes më të madhe në njërin nga tri episodet standarde të kompozicionit, si dhe heshtja ose eliminimi i plotë i ndonjë episodi. Të gjitha këto veçori përputheje e shmangieje sa janë pasojë e aftësisë krijuese dhe fuqisë improvizuese të rapsodit, po aq lidhen dhe me aftësinë e tij absorbuese të teknikës së këndimit epik, sidomos të aftësisë së tij të përshtatjes rrethanave të reja shoqërore ekonomike të mjedisit. Në traditën shqiptare njej tri etapa të mbishtresimit e të transformimit. Etapa e parë i lidhet me periudhën mesjetare. Është kultivuar te varianti arbëresh, te të cilët elementi pagan është ve-shur me elementin e krishterë: emri i personazhit është Kostantini i Vogëlith, për nusen në mungesë të trimit kujdeset i ati i tij, rinjohja bëhet në kishë; etapa e dytë i përket periudhës së sundimit osman: veshja e personazhit ka marrë elementet islame: ai është Y(Imer) Agai, për nusen kujdeset e ëma ose gjyshja e tij, rinjohja bëhet në rrugë; etapa e tretë lidhet me periudhën e pas-su-n-di-mit os-man të shekujve XIX-XX: personazhi quhet Bajram, për nusen kujdeset e ëma dhe motra, ai kthehet në shëtpi me tren, lajmet përhapen me anë të gazetave etj. Kësaj etape të tretë i përkasin baladat me kryepersonazh Lalën Bajram të rajonit të Gostivarit, Kërçovës e Tetovës. Balada e Lalës Bajrëm është regjistruar fillimisht në fshatin Gradec të Gostivarit dhe në fshatrat e Tetovës e të Kërçovës. Artikulli merret me studimin e mbishtresimit e të transformimit të këtij motivi, si në rrafshin e strukturimit kompozicional, ashtu edhe në rrafshin e ngritjes së rrjedhës rrëfimore. Analiza mbështetet në krahasimin midis tyre të baladave të këtij motivi të regjistruara brenda rajonit të Gostivarit e të Maqedonisë së Veriut, me baladat e këtij motivi të krahinave të tjera shqiptare e të diasporës (të arbëreshëve të Italisë). Ballafaqimi i teksteve të rajonit të Gostivarit me ato të regjistruara në anët e tjera të kombit dhe te arbëreshët e Italisë ndihmon të gjenden e të veçohen elementet e përbashkëta të të gjitha krahinave shqiptare, si dhe dallimet që paraqiten brenda secilës prej tyre. Krahas kësaj ai ndihmon të shpjegohet edhe fe-nomeni i mbishtresimit dhe i transformimit të këtij motivi nëpër periudha

të ndryshme historike.

Abstract:

The ballad of Lala Bajram is part of the group of ballads of reunion of a man and a woman. The theme of this ballad is international. It is known by almost all the peoples of the world. The structure of its action, as it varies between nations, also varies within the oral literature of a nation or a province of it. The subject in these ballads takes place around the newly married young man, who three or five days after the marriage is recruited as a soldier and returns home after nine years, when the bride is on the eve of marriage with her second husband. This motif is known in the Albanian oral literature throughout its territory, both in the ethnic and in the diaspora, to the Arbëresh of Italy. This proves that this motive is historically very old. Its antiquity will be sought very deeply into the historical past. In general, the rise of the narrative is the same for both the Arbëresh of Italy and the Albanians of the Balkans. Only the way of organization changes, the most obvious emphasis and evaluation, the replacement or complete or partial elimination of any scene or situation, as well as the concentration of the greatest attention on one of the three standard episodes of the composition, as well as the silence or completely elimination of any episode. All these features of harmony and avoidance, as a consequence of the creative ability and improvisational power of the rhapsodist, are equally related to his absorption ability of the epic singing technique, especially his ability to adapt to the new socio-economic circumstances of the environment. In the Albanian tradition it recognizes three stages of superimposition and transformation. The first stage is related to the medieval period. It is cultivated in the Arbëresh variant, in which the pagan element is covered with the Christian element: the name of the character is Constantine the Younger, for the bride takes care his father in the absence of the brave, the reunion takes place in the church; the second stage belongs to the period of Ottoman rule: the character's outfit has taken on Islamic elements: he is Y(I)mer Agai, his mother or grandmother takes care of the bride by, re-acquaintance takes place on the street; the third stage is related to the period of Ottoman rule of the XIX-XX centuries: the character is called Bajram, his mother and sister take care of the bride, he returns home by train, the news are spread through newspapers etc. To this third stage belong the ballads with the main character Lala Bajram from the region of Gostivar, Kichevo and Tetovo. The ballad of Lala Bajrëm is imprimis recorded in the village of Gradec in Gostivar and in the villages of Tetovo and Kicevo. The article deals with the study of the overlapping and transformation of this motif, both in terms of compositional structuring and in terms of increasing the narrative flow. The analysis is based on the comparison between the ballads of this motif recorded within the region of Gostivar and Northern Macedonia, with the ballads of this motif of other Albanian provinces and the diaspora (of the Arbëresh of Italy). Comparing the texts of the Gostivar region with those recorded in other parts inhabited by Albanians and the Arbëresh of Italy helps to find and distinguish the common elements of all Albanian provinces, as well as the differences that are presented within each of them. In addition, it helps to explain the phenomenon of superimposition and transformation of this motif through different historical periods.

Digjitalizimi i bazës dialektore të shqipes Digitalization of the Albanian dialectal basis

MUSTAFA IBRAHIMI
Universiteti Nene Tereza
Shkup, NORTH MACEDONIA
mustafaibra@gmail.com

Fjalë çelës: Digjitalizim, baza dialektore, të folme shqipe, dialekte

Keywords: Digitalization, dialectal basis, Albanian dialects, dialects

Përmbledhja:

Mbrojtja digjitale e të folmeve shqipe si trashëgimi shpirtërore ka një rëndësi të veçantë për dialektologjinë shqiptare dhe gjuhën shqipe. Materiali dialektologjik i cili gjendet nëpër kartoteka, fjalorë, monografi të botuara, teza masteri, doktorate dhe sidomos materiali i pa vjel në terren duhet sa më shpejtë të grumbullohet dhe të regjistrohet, duke e digjitalizuar në një vend të caktuar. Në këtë mënyrë deri te ky material do të kenë qasje të gjithë të interesuarit dhe studiuesit albanologë dhe ballkanolog nga të gjitha anët e botës. Skenimin dhe vendosja mekanike e të dhënave në databazën e caktuar do të bëhet nga kartotekat dhe fjalorët e botuar dialektor dhe toponomastik për të folmet shqipe në të gjitha trevat shqiptare. Ky proces mund të zhvillohet nëpërmjet Katedrave albanologjike, instituteve etj. Qëllimi është ta mbrojmë trashëgiminë kulturore. Lënda e interesimit tonë do të jenë fjalët e rralla nëpër vendbanimet shqiptare, si dhe toponimet që përdoren nga popullata lokale. Krijimi i korpusit dialektor të shqipes duhet të ketë, pra, këto qëllime: të regjistrojë dhe të përpunojë korpusin dialektor të shqipes; të sjellë tekste të përzgjedhura dhe fjalorët e studimeve krahinore, pastaj revistat, librat e vjetra etj. Cila është rëndësia e këtij projekti dhe pse ka rëndësi të shumëfishtë sidomos për dialektet e shqipes ky projekt? Ana e parë: Mund të thuhet se përfundimi i fazës së parë të punës - realizimi i programit të grumbullimit të databazave të leksikut dialektor dhe vënia në përdorim e tij në institucionet tona shtetërore - administrative, në institucionet tona arsimore e shkencore, në shtëpitë tona informative, në ndërmarrjet ekonomike e në përdorimin individual - do të ndikojë në përmirësimin cilësor të pamjes sonë gjuhësore. Ana e dytë e vlefshmërisë së këtij programi është ekonomizimi, jo vetëm i kohës, për studime dialektore, në kohë optimale. Ata që kanë punuar dhe punojnë me studimet e të folmeve e dinë më së miri rëndësinë e tij. Ana e tretë, që për kah rëndësia nuk mbetet prapa dy të parave, është funksioni dialektor i të folmeve. Krijimi i një database të tillë duhet të jetë edhe rezultat i përpjekjeve tona për t'u përfshirë në zhvillimin e qytetërimit elektronik I tërë lekiskun dialektor. Një ndërmarrje e tillë duhet të realizohet e t'i ketë mbështetës financiar institucionet shtetërore në Shqipëri, Kosovë e në Maqedoninë e Veriut Gjedhe si duhet të duket e si duhet të funksionojë një databazë e tillë dialektore në internet ka me qindra në sajtet e bibliotekave nacionale - amerikane, britanike, franceze, gjermane, italiane, madje edhe të fqinjëve tanë: bullgarëve, kroatëve e të tjerëve. Nuk duhet të harrojmë se interneti është mënyra më e mirë për afirmimin dhe për lidhjen e kulturave dhe të popujve. Dialektologjia shqiptare e meriton një përfaqësim dhe një prezantim të denjë në internet. Ajo nuk e meriton inferioritetin në të cilin e kemi sjellë në raport me kulturat përreth, të cilat kanë arritur rezultate të vërejtshme në këtë rrafsh. Krijohet përshtypja se për kulturën shqiptare sot "lodhen" vetëm individë entuziastë, dashamirës të saj, se nuk jemi ende të ndërgjegjshëm për rëndësinë e komunikimit elektronik dhe për ndikimin e tij çdo herë e më të madh për pamjen e një kulture dhe në përgjithësi për pamjen dhe prestigjin një

populli.

Abstract:

The digital protection of Albanian dialects as a spiritual heritage has a special importance for the Albanian dialectology and the Albanian language. The dialectological material which is found in files, dictionaries, published monographs, master theses, doctorates and especially the unharvested material in the field should be collected and recorded as soon as possible, digitizing it in a certain place. In this way, this material will be accessible to all interested and albanologists and Balkanologists from all over the world. The scanning and mechanical placement of data in the designated database will be done from the published dialect and toponymic files and dictionaries for Albanian dialects in all Albanian territories. This process can be developed through Albanological Chairs, institutes, etc. The goal is to protect cultural heritage. The subject of our interest will be the rare words in Albanian settlements, as well as the toponyms used by the local population. The creation of the Albanian dialect corpus should therefore have the following purposes: to register and process the Albanian dialect corpus; bring selected texts and dictionaries of regional studies, then magazines, old books, etc. Scanning dialect material (rare words) from published dictionaries, files in departments and institutes and from collecting material in the field. Recording dialect material on the computer, through special software where they will be recorded according to linguistic and semantic norms, somewhere illustrated with photos or audio recordings. It will include rare words, phraseologies, toponyms, etc. The material will be collected in all settlements where Albanians live, also as basic material will be taken dialect dictionaries, master and doctoral theses and seminar papers of students of the Departments of Albanian language and literature. What is the importance of this project and why is this project of multiple importance, especially for the Albanian dialects? First side: It can be said that the completion of the first phase of work - the realization of the program of collecting databases of dialect lexicon and its use in our state-administrative institutions, in our educational and scientific institutions, in our information houses, in economic enterprises and in individual use - will affect the qualitative improvement of our linguistic appearance. The second side of the validity of this program is the economy, not only of time, for dialect studies, in optimal time. Those who have worked and are working with dialect studies know best its importance. The third aspect, which in terms of importance does not lag behind the first two, is the dialectal function of the dialects. The creation of such a database should also be the result of our efforts to get involved in the development of electronic civilization The whole dialectal lexicon. Such an enterprise should be realized and have financial support to state institutions in Albania, Kosovo and Northern Macedonia. - American, British, French, German, Italian, and even our neighbors: Bulgarians, Croats and others. We must not forget that the internet is the best way to affirm and connect cultures and peoples. Albanian dialectology deserves a worthy representation and presentation on the Internet. It does not deserve the inferiority in which we have brought it in relation to the surrounding cultures, which have achieved remarkable results in this regard. The impression is created that for the Albanian culture today only "enthusiastic" individuals "get tired" of it, that we are not yet aware of the importance of electronic communication and its ever-increasing impact on the appearance of a culture and in general on the appearance and the prestige of a people.

Gazetaria shqiptare në Maqedoni në vitet e para të pasluftës (1945)

Albanian journalism in Macedonia during first years after the WW2 (1945)

SEVDAIL DEMIRI

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të

Shqiptarëve

Shkup, NORTH MACEDONIA

sevdaildemiri@yahoo.com

Fjalë çelës: gazetaria, informimi, radio, gazeta, kultura, paslufta.

Keywords: journalism, information, radio, newspapers, culture, post war period.

Përmbledhja:

Mbarimi i Luftës së Dytë Botërore, solli ndryshime rrënjësore në të gjitha sferat e veprimtarive shoqërore. Kështu, popujt e shtypur nën regjimin serbo-kroato-sloven ndërmjet dy luftërave botërore, në mesin e të cilëve bënë pjesë edhe shqiptarët dhe maqedonasit, filluan një jetë krejtësisht të re, e cila si e tillë reflektohej sidomos në planin arsimor, kulturor dhe informativ. U hapën shkollat e para në gjuhët amtare dhe filluan të merrnin kahe edhe një sërë veprimtarish kulturore - informative, si radioja, gazetata, teatri etj. Nga fakti i pamohueshëm se sfera e informimit gjithëherë ka qenë e një rëndësie të veçantë për shtetin dhe shoqërinë, menjëherë pas mbarimit të luftës, filluan përgatitjet për ta funksionalizuar programin e radios dhe për të filluar botimi i gazetave të para në gjuhë amtare, nënkuptohet në gjuhën shqipe. Fraza e njohur “Ju flet Radio Shkupi”, për herë të parë u dëgjua më 28 janar të vitit 1945, nga zëri i folësit Vllado Maleski, duke shënuar një etapë të re të gazetarisë shqiptare në Maqedoninë e pasluftës. Dy muaj më vonë, saktësisht më 4 prill 1945, dritën e botimit për herë të parë e pa gazeta “Flaka e Vëllazërimit”, e cila ishte organ i Shtabit Kryesor të Frontit Popullor të Maqedonisë, kurse më vonë organ i Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës të Maqedonisë. Drejtor dhe kryeredaktor i parë i gazetës “Flaka e Vëllazërimit”, ishte Petro Janura, i cili punoi me një ekip shumë të vogël bashkëpunëtorësh që përbëhej nga jo më shumë se 4-5 veta. “Flaka e Vëllazërimit” ishte kroniste korrekte e kohës. Ajo regjistronte gati të gjitha ndodhitë e problemet në RSFJ, respektivisht RSM, me theks të veçantë te shqiptarët. Rubrika kulturore-arsimore e gazetës “Flaka e Vëllazërimit”, ishte në një nivel të lartë profesional. Bashkëpunëtorë kanë qenë gazetarë e shkrimtarë të njohur, profesorë e intelektualë të ndryshëm të kohës. Gazetaria shqiptare në Maqedoninë e Veriut, në vitet e para të pasluftës (1945) zhvillohej në kushte e rrethana jashtëzakonisht të vështira, meqë mungonin jo vetëm kushtet minimale materiale-teknike, por edhe kadri i gazetarëve profesionalë shqiptar. Madje, nëse mbështetemi te emri i folësit të parë të radios apo ndonjë bashkëpunëtori të gazetës, ata nuk “tingëllojnë” shqip. Mirëpo, për rrethanat e kohës këto ishin zgjidhjet e vetme të mundshme për ta nisur procesin e informimit masiv në gjuhën që e fliste një komunitet mjaft i madh i popullsisë së Maqedonisë. Në këtë punim do të flasim për gjenezën e lindjes, të krijimit e të formimit të mediave të para shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilat filluan të përhapin lajmet në gjuhën shqipe para publikut të gjerë shqiptar të saj. Do t’i analizojmë rrethanat dhe kushtet nën të cilat punuan Radio Shkupi, si dhe u botua gazeta “Flaka e Vëllazërimit” në vitet e para të pasluftës, si për cilësinë, rolin dhe rëndësinë e tyre në informimin e publikut të gjerë shqiptar të këtij krahu të kombit. Studimi ndihmon në njohjen e rrethanave të lindjes,

krijimit, formimit, si dhe historinë ecurinë e gazetarisë shqiptare në Maqedoninë e Veriut në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore.

Abstract:

The end of the Second World War brought about radical changes in all spheres of social activities. Thus, the oppressed peoples under the Serbo-Croatian-Slovenian regime between the two world wars, among which were Albanians and Macedonians began a completely new life, reflected especially in the education, culture and information. The first schools in mother language were opened and series of cultural-informational activities such as radio, newspapers, theater, etc. started functioning. Having into account the undeniable fact that the information has always been of special importance to the state and society, immediately after the end of the war, preparations began to make the radio program functional and to open the first newspapers in mother language. The well-known phrase "Radio Skopje speaks to you" was first heard on January 28, 1945, by the speaker Vlado Maleski, marking thus a new era of the Albanian journalism in post-war Macedonia. Two months later, on April 4, 1945, the newspaper "Flaka e Vëllazërimit"/"Flame of Brotherhood", which was a body of the Main HQ of the Macedonian People's Front, and later a body of the Socialist League of Working People of Macedonia was published for the first time. The first director and editor-in-chief of the newspaper "Flaka e Vëllazërimit" was Petro Janura, who worked with a very small team consisting of no more than 4-5 people. "Flaka e Vëllazërimit" was a correct chronicler of the time, which recorded almost all events and problems in the SFRY, respectively SRM, with special emphasis on Albanians. The cultural-educational section of the newspaper "Flaka e Vëllazërimit" was at a high professional and artistic level, authors of which were well-known journalists, writers, professors and intellectuals. Albanian journalism in Macedonia in the first years after the war (1945), started up with extremely poor facilities and conditions. It lacked not only material and technical supply, but human resources as well. As far as we can see from the names of the first speaker of the radio or the first editor-in-chief of the newspaper, neither one of them is Albanian, but at that time they were the only solution in order to start a process of mass information in the language spoken by a fairly large community of Macedonia. In this paper we will introduce the genesis of the first media that began to broadcast in Albanian language for the Albanian public of Macedonia in general. We will see the circumstances and conditions under which Radio Shkupi and the newspaper "Flaka e Vëllazërimit" worked during the first years of the post-war period, as well as their importance in informing the Albanian public. Do t'i analizojmë rrethanat dhe kushtet nën të cilat punuan Radio Shkupi, si dhe u botua gazeta "Flaka e Vëllazërimit" në vitet e para të pasluftës, si për cilësinë, rolin dhe rëndësinë e tyre në informimin e publikut të gjerë shqiptar të këtij krahu të kombit. Studimi ndihmon në njohjen e rrethanave të lindjes, krijimit, formimit, si dhe historinë ecurinë e gazetarisë shqiptare në Maqedoninë e Veriut në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore.

Huazimet në gjuhën shqipe në aspekt sinkronik dhe diakronik

Borrowings in albanian language in synchronic and diachronic aspect

ISMAIL KAMBERI

Kolegji Dardania

Gostivar, NORTH MACEDONIA

ismail.kamberi@unite.edu.mk

Fjalë çelës: Aspekti historik i huazimeve, llojet dhe prejadhja

Keywords: Historical aspect of borrowing, types and origin

Përmbledhja:

Punimi merret me aspektin historik dhe kronologjik të huazimeve në përgjithësi: prejadhja, mënyra e kalimit nga gjuha dominuese në tjera dhe llojet e tyre. Historia e gjuhës dhe etimologjia i ndajnë elementet e huazuara nga elementet vetjake. Nga burimi, leksikun e një gjuhe e ndajmë në dy shtresa: shtresa vetjake dhe shtresa e huazuar, p.sh. kjo mund të vërehet lehtësisht dhe në gjuhën shqipe, për të cilën nëse themi se është gjuhë indoeuropiane, nuk duhet kuptuar që gjithë pasuria e saj leksikore është trashëgimi e fondit të vjetër indoeuropian. Veç këtyre, në disa raste janë huazuar fjalë edhe për shkak të prirjes së disa të folmeve profesionale për të qenë “sa më të përgjithshme, sa më ndërkombëtarë”. Kjo gjë vërehet në leksikun e fushave të artit, të modelistëve, të biznesit, të financave, të informatikës, të turizmit etj. dhe lidhet me fushën, por edhe me kulturën e atyre që i përdorin fjalët e huaja. Gjithashtu në punim janë të paraqitura huazimet sipas prejadhjes së tyre. Disa huazime janë nga fusha e shkencës dhe teknikës: filozofi, gramatikë, gjeografi, gjeologji, histori, mikroskop, radio, tank, telegraf, traktor etj.; në fushën e artit: akuarel, orkestër, peizazh, personazh, poemë, portret, roman, skenë, teatër etj.; gjithashtu në fushën e transportit, të sportit dhe mjekësisë etj. Sipas burimit: fjalët ndërkombëtare janë kryesisht me prejardhje nga greqishtja: filozofi, fonetikë, gramatikë, gjeografi, histori, homonim, morfologji, sinonim, sintaksë; nga latinishtja: kushtetutë, linguistikë, republikë, senat etj.; nga italishtja: kanto, solo, soprano, tenor; nga frëngjishtja: adresë, burokrat, deklaratë, ekip etj.; nga anglishtja: basketboll, futboll, volejball, ragbi, fitbek, begraund, miting trend, fans, sendviç, hot-dog, internet, interviu, shopping, relaks etj. Në punim janë cekur edhe huazimet në gjuhën shqipe, aspekti sinkronik dhe diakronik duke i cekur edhe periudhat dhe nga cilat gjuhë e kanë prejardhjen. Ceken edhe huazime nga greqishtja, latinishtja, turqishtja, serbishtja që i takojnë periudhës së hershme gjatë sundimit të tyre në këto treva. Gjithashtu, në punim janë paraqitur huazimet e shekullit XX nga italishtja në fushën e armatimit dhe muzikës, nga frëngjishtja të administratës dhe të fundit nga anglishtja të sportit, inovacioneve dhe teknologjia e fundit. Kalket janë fjalë të formuara me brumin e shqipes; në to është i huaj vetëm ndërtimi i fjalës. Të tilla janë edhe asgjësoj, bashkëjetesë, bashkëtingëllore, drejtpeshim, drejtshkrim, fuqimisht, kryevepër, ndajfolje, ndërgegje, nënshtroj, nënvizoj, njëkohësisht, përshtypje, hekurudhë, lulelakre etj. Në ditët tona gjuha shqipe është e hapur përballë gjuhëve të huaja, sidomos përballë anglishtes e veçanërisht ndër emigrantët përballë italishtes e greqishtes, prej të cilave ka marrë e do të marrë fjalë që nuk i ka vetë. Shumë emërtime të fushës së informatikës, të financave, të ekonomisë së tregut, të biznesit, të arteve moderne etj., që sot kanë marrë zhvillim të veçantë, vijnë në shqip bashkë me konceptet që shprehin dhe mbushin zbrazëtitë e leksikut. Ky huazim ka vlerën e vet pasuruese, por, nëse bëhet pa kurrëfarë kontrolli e pengese, kthehet në një dukuri të dëmshme për gjuhën tonë, sidomos kur mbushet me fjalë të huaja ligjërimi i folur ose shtresa leksikore e përdorimit të përgjithshëm. Prandaj duhet të

bëhen përpjekje për të penguar huazimin e fjalëve nga gjuhë të tjera ose për të hedhur jashtë përdorimit fjalët e huaja, kur për ato kemi fjalë shqipe, plotësisht me të njëjtin kuptim, më të njohura, të përpikëta e të qarta për folësit e shqipes. Më në fund kemi paraqitur pikëpamjet e studiuesve më të çmuar të gjuhësisë, ata shqiptarë dhe të huaj, të cilët kanë dhënë mendime shkencore rreth problematikës së huazimeve në përgjithësi.

Abstract:

ABSTRACT

The paper deals with the historical and chronological aspect of borrowings in general, the origin, the way of transition from the dominant language to others and their types. The history of language and etymology separate the borrowed elements from the personal elements. From the source, we divide the lexicon of a language into two layers: the personal layer and the borrowed layer, for example, this can be easily noticed in the Albanian language, which if we say that it is an Indo-European language, we should not understand that all its richness lexical is the legacy of the old Indo-European fund. In addition, in some cases words have been borrowed due to the tendency of some professional dialects to be "as general as possible, as international as possible". This is observed in the lexicon of the fields of art, modeling, business, finance, informatics, tourism, etc. and relates to the field, but also to the culture of those who use foreign words. Also in the paper are presented the loans according to their origin. Some borrowings are from the field of science and technology: philosophy, grammar, geography, geology, history, microscope, radio, tank, telegraph, tractor, etc. ; in the field of art: watercolor, orchestra, landscape, character, poem, portrait, novel, stage, theater, etc. ; also in the field of transport, sports, and medicine etc. According to the source: international words are mainly derived from Greek: philosophy, phonetics, grammar, geography, history, homonym, morphology, synonym, syntax; from Latin: constitution, linguistics, republic, senate, etc.; from Italian: canto, solo, soprano, tenor; from French: address, bureaucrat, statement, team, etc.; from English: basketball, football, volleyball, rugby, fitbek, begraund, trend rally, fans, sandwich, hot-dog, internet, interview, shopping, relaxation etc. The paper also mentions borrowings in the Albanian language, the synchronic and diachronic aspect, mentioning the periods and from which language they originate. The borrowings from Greek, Latin, Turkish, Serbian that belong to the early period during their rule in these areas are also mentioned. Also presented in the paper are twentieth-century borrowings from Italian in the field of armaments and music, from the French administration and funfd from English sports, innovations and the latest technology. Chalks are words formed with Albanian dough; in them only the construction of the word is foreign. Such are also annihilate, coexistence, consonant, balance, spelling, powerfully, masterpiece, adverb, conscience, subdue, underline, at the same time, impression, railroad, cauliflower, etc. Nowadays, the Albanian language is open to foreign languages, especially English, and especially among immigrants to Italian and Greek, from which it has received and will receive words that it does not have itself. Many names in the field of informatics, finance, market economy, business, modern arts, etc., which today have received special development, come in Albanian together with the concepts that express and fill the gaps in the lexicon. This borrowing has its enriching value, but, if done without any control or hindrance, it turns into a harmful phenomenon for our language, especially when the spoken discourse or lexical layer of general use is filled with foreign words. Therefore, efforts should be made to prevent the borrowing of words from other languages or to discard foreign words, when for them we have Albanian words, completely with the same meaning, more familiar, accurate and clear to the speakers of Albanian. Finally, we have presented the views of the most valuable linguistic scholars, Albanian and foreign, who have given scientific opinions on the issue of borrowing in general.

Sistemi tatimor i fshatarsisë dhe efekti që pati në ekonomi në regjimin komunist

The tax system of the peasantry and the effect it had on the economy under the communist regime

ELONA GJELAJ

Drejtorja e Pergjithshme e Tatimeve

Tiranë, ALBANIA

gjelaj.elona@yahoo.com

Fjalë çelës: Sistem Tatimor, Partia Komuniste, Grumbullim, Furnizim, Fshatarësia

Keywords: Tax System, Communist Party, Collection, Supply, Peasantry

Përmbledhja:

Pavarësisht masave të marra për rimbëkëmbjen e ekonomisë dhe normalizimin e jetës së vendit, ende kishte mungesa të theksuara sidomos për artikujt e konsumit të gjerë. Në vend të çmimeve të lira u vendosën çmime të caktuara. Tregtarët dhe sipërmarrësit vendas dhe të huaj qillimisht nuk nxirrnin mallra në treg duke shkaktuar ngritjen e çmimeve në tregun e zi. Me ndalimin e grumbullimit i drithit për shitje nga tregtarët privatë situata u bë edhe më e turbulltë. Shteti vendosi monopolin për grumbullimin dhe shitjen e tij duke caktuar çmime të njësuara për blerjen dhe shitjen e drithit nga shteti. Një veprim i tillë sillte veç turbullime në jetën ekonomike dhe shkaktonte vështirësi në jetesën e punonjësve. Një rol të rëndësishëm në përkeqësimin e gjendjes në sektorin e bujqësisë duket se ka luajtur sistemi fiskal dhe sistemi i detyrimeve shtetërore në fshat. Mospasja e një sistemi fiskal unik bëri që zbatimi i tij të kishte ndikimet e veta në ekonominë e vendit. Në korrik të 1945-ës doli ligji mbi tatimin e ri të produkteve bujqësore. Sipas këtij ligji vendosja e detyrimeve tatimore, do të bëhej në mënyrë të përshkallëzuar, në shifrat nga 3 - 33% të fitimeve të realizuara në prodhim. Për sigurimin e një shpërndarjeje sa më të drejtë të sendeve ushqimore, në shtator 1946 do të vihej në zbatim sistemi i triskëtitimit. Sipas këtij sistemi punonjësve që punonin në degët më të rëndësishme të ekonomisë u caktoheshin norma furnizimi me sende ushqimore më të larta se pjesës tjetër të popullsisë. Në situatën e rëndë që kalonte vendi, vendosja e triskëtitimit ishte tepër i domosdoshëm në një kohë kur fondi i sendeve ushqimore ishte tepër i kufizuar. Sistemi i grumbullimit të drithërave, rezultonte një nga problemet më të mprehta të pushtetit të kohës. Ky vinte si rezultat i pa aftësisë që ishte treguar në grumbullimin e drithërave. Mënyra e marrjes të gjithë drithit fshatarit, duke i lënë vetëm racionin e bukës, ishte një nga mënyrat e gabuara e bërë nga pushteti. Ky sistem i grumbullimit e ka dembelizuar fshatarin e aq më tepër ta nxitë në shtimin e prodhimit e drithit. Paaftësia, por edhe mungesa e çdo gjëje bëri që shteti t'i kërkonte fshatarit veç sasisë që i takon sipas rregullit që ka për hektar, duke e lënë fshatarin e lirë për t'i shitur tepricat. Sipas tyre kjo jo vetëm e nxit fshatarin, por e detyron për t'i shtuar sipërfaqet e mbjella, për të prodhuar sa më shumë, pse në bazë të këtij sistemi fshatari detyrohet t'ia shesë shtetit drithin në bazë të hektarëve që ka. Nga të gjithë hapat e ndërmarrë për kryerjen e grumbullim-furnizimit të popullsisë, pushteti i kohës e kishte të pamundur të dilte nga ajo krizë në të cilën ndodhej vendi. Pikërisht e gjithë kjo politikë e bërë nga ana e udhëheqësve, por edhe nga ana e grupeve të organizatave politike patjetër që do të jepte rezultat. Ky sistem arriti që ta nxiste fshatarin të prodhonte më shumë duke furnizuar popullsinë e qytetit, kështu kishim një bashkëpunim ndërmjet qytetit dhe fshatit, një ekonomi të centralizuar, heqjen e të drejtës themelore të njeriut për t'u ushqyer sipas nevojave vetjake, e përveç kësaj kemi marrjen në

dorë të gjithë jetës ekonomike dhe sociale nga pushteti i kohës.

Abstract:

Despite the measures taken to recover the economy and normalize the life of the country, there were still significant shortages, especially for consumer goods. Certain prices were set instead of cheap ones. Domestic and foreign traders and entrepreneurs deliberately did not bring goods to market causing prices to rise on the black market. With the ban on collecting grain for sale by private traders the situation became even more turbulent. The state established a monopoly on its collection and sale by setting uniform prices for the purchase and sale of grain by the state. Such an action only brought turmoil to the economic life and caused difficulties in the livelihood of the workers. An important role in the deterioration of the situation in the agricultural sector seems to have played, the fiscal system and the system of state obligations in the village. The lack of a unique fiscal system made its implementation have its impact on the country's economy. In July 1945, the law on the new tax on agricultural products came out. According to this law, the imposition of tax liabilities would be done in an escalated manner, in figures from 3 - 33% of profits realized in production. In order to ensure the fairest possible distribution of food items in September 1946, the tricot system would be implemented. According to this system, workers working in the most important branches of the economy were assigned food supply rates higher than the rest of the population. In the difficult situation the country was going through, the placement of the trisk was extremely necessary at a time when the fund of food items was extremely limited. The grain collection system turned out to be one of the most acute power problems of the time. This came as a result of the incompetence that had been shown in the gathering of cereals. The way of getting all the grain to the peasant, leaving only the ration of bread, was in one of the wrong ways done by the government. This collection system has made the peasant lazy and even more so to encourage him to increase the production of grain. The inability but also the lack of everything made the state demand from the peasant except the amount that belongs to him according to the rule per hectare, leaving the peasant free to sell the surplus. According to them, this not only encourages the peasant but is forcing him to increase the planted areas, to produce as much as possible, because according to this system the peasant is forced to sell the grain to the state based on the hectares he has. From all the steps taken to carry out the gathering and supply of the population, the power of the time found it impossible to get out of that crisis in which the country was. Exactly all this policy made by the leaders but also by the groups of political organizations would definitely give results. This system managed to encourage the peasant to produce more by supplying the population of the city, so we had a cooperation between the city and the village, a centralized economy, the abolition of the basic human right to eat according to personal needs, and in addition we have in the hands of all economic and social life from the power of time.

Vizita parë e një Sekretari të Përgjithshëm të OKB-së, në Tiranë dhe çështja e Kosovës

First visit of a UN Secretary in Tirana, and Kosovo issue

BLERTA DERHEMI

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Tiranë, ALBANIA

blertaderhemi@yahoo.com

Fjalë çelës: OKB, Kosova, Ish Jugosllavia, Lufta e Ftohtë

Keywords: UN, Kosovo, Former Yugoslavia, Cold War

Përmbledhja:

Viti 1990 shënon një moment të rëndësishëm historik për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe për Shqipërinë në veçanti. Fundi i Luftës së Ftohtë, detanta e marrëdhënieve SHBA-BRSS, shënoi fillimin e një epoke të re për Ballkanin. Në ish Jugosllavi kishin filluar lëvizjet për pavarësimin e republikave të federatës, ndërsa në Shqipëri vetizolimit dhe regjimit komunist po i vinte fundi. Pikërisht në këtë vit nga 11 deri në 13 Maj, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Perez de Cuellar vizitoi Tiranën, e para vizitë e tillë në vend. Ky punim synon të hedh dritë mbi bisedimet e zhvilluara gjatë kësaj vizite mes de Cuellarit dhe drejtuesve të qeverisë shqiptare. Një nga tezat e bisedimeve të qeverisë shqiptare ishte gjendja në ish Jugosllavi, pozitat e shqiptarëve në Kosovë, nën represionin e autoriteteve të ish Jugosllavisë dhe pozicionimi i qeverisë shqiptare në këtë kuadër. Artikulli është një kërkim cilësor i bazuar në të dhëna parësore, të cilat janë mbledhur nga një hulumtim relativisht i gjatë në kohë në arkivin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë si dhe në arkivin elektronik të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Së bashku me burimet e arkivore, janë shfrytëzuar edhe publikime të tjera në lidhje me këtë vizitë. Teza kryesore e artikullit lidhet me trajtimin që iu bë çështjes së Kosovës nga autoritetet shqiptare dhe sa vëmendje ajo mori nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Risia e këtij punimi vjen nga shqyrtimi i burimeve arkivore të OKB-së, duke synuar të sjellë të dhëna të reja në lidhje me këtë vizitë si dhe për të kuptuar nëse pozicionimi i Perez de Cuellar ndaj çështjes së Kosovës ishte ose jo objektiv dhe i paanshëm. Deri më tani kjo vizitë është studjuar vetëm në lidhje me rëndësinë që pati për hapjen e Shqipërisë dhe fillimin proceseve demokratike. Ardhja e de Cuellarit në Shqipëri, u përdor nga qeveria shqiptare e kohës për të siguruar legjitimitetin e saj. Nga shqyrtimi i deritanishëm nuk rezulton që ndonjë autor të jetë ndalur pikërisht në trajtimin që i është bërë çështjes së Kosovës gjatë kësaj vizite, për më tepër parë nga kënvështrimi i lobimit që shtete të ndryshme kanë bërë pranë de Cuellarit, përpara se ai të vinte në Shqipëri në maj 1990, por edhe pas kësaj vizite. Parë nga të dy kënvështrimet tabloja do të jetë më e qartë dhe e plotë. Ky punim do të jetë një vlerë e shtuar për diplomatët shqiptarë të Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe për këdo studjues tjetër të interesuar mbi këtë çështje, për të kuptuar edhe ngjarjet e viteve të mëvonshme që i hapën rrugën pavarësisë. Nuk mund të pretendohet se trajtimi i temës është shterues, për aq kohë sa të tjera burime Arkivore si ato ish Jugosllavisë, Austrisë, BRSS, etj. mund sjellin më shumë dritë për historinë dhe fatin e shqiptarëve të Kosovës në atë periudhë. Pa dashur të hidhet poshtë rëndësia dhe vlera e vizitës së de Cuellarit në Shqipëri thellimi i kërkimeve zbulon se edhe në të ka pasur prapaskena të pazbuluara ende nga historia. Ndaj punimi ndër të tjera është një nxitje për tu hapur rrugën kërkimeve të tjera më të thelluara mbi

këtë çështje.

Abstract:

The year 1990 is a cornerstone of international relations' history and particularly for Albania. The end of the Cold War and the détente on US-USSR relations, marked the beginning of a new era for the Balkans region too. In former Yugoslavia, movements for the independence of the federal republics had begun, while in Albania, self-isolation and the communist regime were coming to an end. This year, from 11 to 13 May, the Secretary-General of the United Nations, Javier Perez de Cuellar, paid an official visit in Tirana. This was the first-ever visit of a Secretary-General in Tirana. The article is a qualitative research based on primary data, which are collected from relatively long research in time in the archive of the Ministry of Europe and Foreign Affairs of Albania as well as in the electronic archive of the United Nations. Along with archival sources, other publications related to this visit have been used. The main thesis of the article is related to the treatment of the Kosovo issue by the Albanian authorities and how much attention it received from the Secretary-General of the United Nations. The novelty of this paper comes from the research of the UN archival sources, aiming to bring new data related to this visit and to understand whether the position of Perez de Cuellar on the issue of Kosovo was objective and impartial or not. So far, this visit has been studied only in relation to the importance it had for the opening of Albania and the beginning of its democratization process. De Cuellar's arrival in Albania was used by the Albanian government of the time to secure its legitimacy. In the research done until nowadays, it does not appear that any author has been focused on the treatment of the issue of Kosovo during this visit, moreover from the point of view of lobbying those various countries might have done near de Cuellar, before he came to Albania in May 1990, or even after he went back from this visit. Seen from both perspectives the picture will be clearer and more complete. This article aims to be an added value for the Albanian diplomats of Albania and Kosovo, as well as for any other researcher interested in this issue. It might also help them in understanding better even events that come years later in the history of Kosovo, paving the way to its independence. It cannot be pretended that the treatment of the topic is exhaustive if other archival sources such as those of the former Yugoslavia, Austria, the USSR, etc. can bring more light to the history and fate of Kosovo's Albanians in that period. Without wanting to deny the importance and value of de Cuellar's visit to Albania, the deepening of the research reveals that even in it there were backstage still undiscovered by history. Therefore, the work is, among other things, an incentive to pave the way for other more in-depth research on this issue helping historians to write history objectively and fairly.

Tregimi "Njerka" - Faik Ballanca

"The Stepmother" story by Faik Ballanca

BLETA BERISHA
Shkolla "Hasan Prishtina"
Prishtinë, KOSOVA
bletabb@yahoo.com

Fjalë çelës: prozë, tregim, personazh, letërsi, narracion.
Keywords: prose, story, character, literature, narration.

Përmbledhja:

"Njerka" i Faik Ballancës është vlerësuar si një nga tregimet e tij më të bukur. Ashtu si në gjithë prozën e tij edhe në këtë tregim gjuha është e thukët e sintetike, me pak fjalë arrin të thotë shumë. Ajo është e saktë dhe e qartë. Ai krijon tipa dhe karaktere me pak detaje, duke na sjellë botën e tyre të brendshme, luftën e tyre psikologjike. Çdo lëvizje, çdo veprim, mjedisi në të cilin janë vënë personazhet, monologu, dialogu, paralelizmi janë në funksion të idesë dhe mesazhit që përcjell autori tek lexuesi. Kjo bën që personazhet të duken vërtet realë, të vërtetë, të zakonshëm dhe të dashur për lexuesin. Faik Ballanca arrin që këtë realitet të thjeshtë ta transformojë me mjeshtëri në lëndë letrare dhe artistike. Në tregimin "Njerka" nuk ka konflikt të thellë, të hapur, të zhurmshëm. Aty konflikti është i brendshëm, psikologjik dhe merr ngjyrimë dramatike për atë që i përjeton. Në të nuk ka fjalë të tepërta, shumë prej hollësive i mbeten lexuesit t'i nënkuptojë, t'i marrë me mend dhe i mbetet po atij që ta vazhdojë apo ta plotësojë situatën në mënyrën e vet, sipas gjendjes emocionale apo situatës në të cilën ndodhet vetë lexuesi. Kështu edhe komunikimi i veprës me lexuesin është më i afërt më i dashur dhe çdo lexim i ri i prozës së Faik Ballancës, mund të sjellë një mbresë të re, një përjetim të ri. Tipar i veçantë i prozës së Faik Ballancës është edhe struktura e narracionit. Në tregimet e tij gjejmë mënyra të ndryshme rrëfimi dhe kombinim zërash rrëfyesh. Pjesa më e madhe dhe më e arrirë e tregimeve të tij, janë ndërtuar në vetën e parë, sigurisht të ndërthurura me elemente si monologu i brendshëm, dialogu, komenti i personazhit rrëfyesh etj. Këtu kemi personazhin rrëfyesh i cili e zbulon intrigën dhe personazhet e tjera rreth të cilëve zhvillohet kjo intrigë. Rrëfimi në vetën e parë shpreh idetë dhe qëndrimet e autorit. Përmes zërit rrëfyesh, këndvështrimit dhe syrit të tij vëzhgues, na zbulohet personazhi bosht, rreth të cilit ndodh ngjarja. Hyrja në tregimin "Njerka" të Ballancës është e thjeshtë dhe befasuese. Edhe përfundimi po ashtu, gjithmonë në harmoni me ngjarjen. Faik Ballanca mes tjerash trajtoi edhe tema të konsumuara sië është rasti me këtë tregim, por mënyra origjinale e trajtimit të këtyre temave dhe këndvështrimi i veçantë nga i cili i trajtoi këto tema, si dhe mënyra e veçantë e strukturimit kompozicional të ndodhisë bënë që proza e tij t'i përmbysë skemat dhe shabllonet dhe në këtë mënyrë edhe t'i shpëtojë konformizmit dhe skemave të realizmit socialist. Stili i ngrohtë dhe i thjeshtë nga jashtë, por i mbushur plot emocion jetësor ku rrezaton humanizmi, dashuria për njerëzit, për vendin, për traditën, historinë, e bëjnë prozën e Faik Ballancës që t'i rezistojë kohës dhe vepra e tij të jetë e bukur dhe e freskët edhe sot. Studimi i këtyre elementëve rrëfimorë është i rëndësishëm si për Faik Ballancën, ashtu edhe për historinë e letërsisë, sidomos të prozës shqipe të periudhës së realizmit socialist.

Abstract:

"The Stepmother" by Faik Ballanca has been appraised as the most beautiful of all his stories. Like in all his prose, he uses a solid synthetic language by which he manages to say a lot with a few words.

His language is straight and clear. He creates types and characters with much fewer details, bringing us more of their inner world, their psychological battles. Every move, action, the environment in which the characters are set, monologue, dialogue, and parallelism are in function of the idea and the message that the writer transfers to the readers, making the characters realistic, ordinary, and dear to them. Faik Ballanca masterfully transforms the simple reality into literary and artistic subjects. There are no deep, open conflicts in the prose of Faik Ballanca. The conflict is within, psychological, and it saturates in dramatical overtones for those who experience it. There are no redundant words, and most of the details are to be implicated by the readers themselves, and according to their own emotional state, they would have to imagine the way to complete the situations. Thus, a more intimate and affectionate communication between the piece and the reader makes each reread a new experience. A particular characteristic of the prose of Faik Ballanca is the structure of the narration. We find in his stories a different combination of the narration voices. Most of his stories and the most successful ones are built, like "The Stepmother", in the first person, intertwined with the elements of inner monologue, dialogue, and the narrative character's commentary. The narrative character discovers the intrigue as well as the other characters of the part. Storytelling in the first person expresses the ideas and beliefs of the author. The core character is discovered through the narrating voice, its point of view, and its observant eye. The introduction is simple and surprising, just like the closing, always in complete harmony with the event. The story's theme has already been consumed. Nevertheless, the author surprises us by bringing an entirely new character from what we were used to reading. His original approach, treating the topic through his own perspective and his unique composition of the event's structure make this, and other stories of this author fresh and resistant throughout the time. Further studies of the narrative elements are critical for the opus of Faik Ballanca and the history of literature, especially for the Albanian prose of the socialist-realism period. Studimi i këtyre elementëve rrëfimorë është i rëndësishëm si për Faik Ballancën, ashtu edhe për historinë e letërsisë, sidomos të prozës shqipe të periudhës së realizmit socialist.

Leksiku i veprës së Azem Shkrelit

Azem Shkreli's Works Vocabulary

ALI ÇAKA
UP Hasan Prishtina
Prishtinë, KOSOVA
ali.caka@gmail.com

Fjalë çelës: Azem_Shkreli, leksik, fjalor, konkordancë, concordancier
Keywords: Azem_Shkreli, vocabulary, dictionary, concordance, concordancer

Përmbledhja:

Punimi Leksiku i veprës së Azem Shkrelit, ka për qëllim analizën gjuhësore dhe statistikore të leksikut të veprës së tij të plotë me qëllim nxjerrjen e leksikut të plotë të përdorur në veprën e tij dhe paraqitjes së tij sipas kategorive themelore leksiko-gramatikore, të para dhe nga aspekti i fjalëformimit. Leksiku i nxjerrë do të shërbejë për hartimin e Fjalorit të veprës së plotë të Azem Shkrelit i cili do t'u shërbejë leksikografëve për pasurimin e fjalorëve ekzistues, ndërsa studiuesve për ta studiuar edhe më tej veprën e Azem Shkrelit, kurse poetëve e krijuesve të tjerë për ta pasuruar leksikun e tyre, e studiuesve të gjuhës shqipe si udhërrëfyes i hartimit të fjalorëve të tipit të këtyllë. Fjalori i veprës së plotë të Azem Shkrelit do të krahasohet me Fjalorin e gjuhës shqipe (1954) për të parë se çka është përfshirë nga ky fjalor në leksikun e Azem Shkrelit dhe çka mund të përfshihet nga leksiku i tij në fjalorin e shqipes së sotme, dhe nga ky krahasim do nxirren fjalët e fjalësit të veprës së plotë të Azem Shkrelit që nuk janë në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954. Fjalësi i përfutur kësajsoj do të shërbejë si referencë e përcaktimit të fjalëve të krijuara nga Azem Shkreli dhe njëkohësisht edhe si visar i nevojshëm për pasurimin e Fjalorit të shqipes së sotme. Po ashtu do të mundohemi të hapim shtigje të reja në gjuhësinë shqiptare lidhur me krahasimin e korpuseve të specializuara, si dhe të shtjellojmë problemet që dalin gjatë përpilimit të korpuseve të specializuara dhe gjatë zbatimit të softuerëve gjuhësorë (teknologjive gjuhësore), dhe të përcaktojmë problemet të cilat do të duhej të zgjidheshin me punimet e tjera, si p.sh. problemi i krahasimit të fjalorit të veprës së Azem Shkrelit me korpusin sinkronik të shqipes së kohës kur u krijuar vepra e tij, që sipas nesh do të mbetet edhe një kohë të gjatë problem i pazgjidhur për shkak të pamundësisë së përpilimit të korpusit të plotë diakronik të gjuhës shqipe. Këta fjalorë do t'u shërbejnë leksikografëve për pasurimin e fjalorëve ekzistues, ndërsa studiuesve për ta studiuar edhe më tej veprën e Azem Shkrelit, kurse poetëve e krijuesve të tjerë për ta pasuruar leksikun e tyre, e studiuesve të gjuhës shqipe si udhërrëfyes të hartimit të fjalorëve të tipit të këtyllë. Për trajtim janë marrë 16 vepra të Shkrelit, të botuara në harkun kohor 1960- 1997, prej të cilave: a. Tetë përmbledhje poezish; b. Tri romane; c. Tri përmbledhje esesh; dhe ç. Dy drama. Për të parë dhe analizuar leksikun e veprës së Azem Shkrelit do të bëhet skanimi dhe digjitalizimi i teksteve të veprës së tij të plotë, kryesisht botuar nga Ndërmarrja grafike-botuese "Rilindja" Prishtinë. Skanimi, digjitalizimi dhe njohja e teksteve të veprës së plotë të Azem Shkrelit do të na shërbejë shërbyer për krijimin e korpusit tekstor të veprës së tij të plotë. Ndarja e korpusit të krijuar me digjitalizimin e veprës së tij të plotë do të bëhet sipas gjinive letrare: poezi, prozë, dramë dhe publicistikë, e po ashtu edhe sipas periudhës gjuhësore: gegërisht (1955 - 1968) dhe gjuhë standarde (1968 - 1997). Në këtë punim do të analizohen edhe veçoritë e leksikut të veprës së plotë të Azem Shkrelit për të parë se a ka veçori leksikore varësisht nga gjinitë letrare dhe tematika, po ashtu do të shqyrtohet lidhmënia (kohezioni) leksikor i shkrimit të Azem Shkrelit, dhe do të bëhet klasifikimi i leksikut, për të parë kontributin e Azem Shkrelit për pasurimin e fjalorit të gjuhës së sotme

shqipe. Fjalëformat e veprës së plotë të Azem Shkreli, të nxjerra me konkordancier, do të na shërbejnë për hartimin e Fjalorit të veprës së plotë të Azem Shkreli dhe njëkohësisht edhe për të parë se a i është përmbajtur gjuhës letrare të parastandardit dhe të standardit pasi që krijimtaria e tij letrare përfshin një periudhë rreth 45-vjeçare. Fjalët të cilat vështirë mund të kuptohen, për shkak të përdorimit të tyre të rrallë a për shkak të përdorimit të tyre rajonal, do të jepen në kontekst - pra me konkordancat e tyre të plota.

Abstract:

The paper Azem Shkreli's Works Vocabulary, is the linguistic and statistical analysis of the vocabulary of his complete work, with the aim of extracting the full lexicon used in his body of work. This is presented according to basic lexical-grammatical categories, also considering the aspects of word formation. The extracted lexicon will facilitate the compiling the Azem Shkreli's Complete Work Vocabulary, will assist lexicographers in enriching existing vocabularies, scholars in further studying Azem Shkreli's works, poets and other creators in enriching their lexicon, while also serving as a guide to Albanian language scholars in compiling such type of vocabularies. The Azem Shkreli's Full Work Vocabulary has been compared to the Albanian Language Dictionary (1954) to check what is included in Azem Shkreli's Vocabulary from this vocabulary. It also includes Today's Albanian Language Dictionary from his vocabulary, and this comparison reveals the words of the word list of Azem Shkreli's complete works that are not to be found in the 1954 Albanian Language Dictionary. The word list obtained in such manner will serve as a reference for defining words created by Azem Shkreli. At the same time as a necessary tool for the enrichment of the Dictionary of Today's Albanian Language. As to the Azem Shkreli's Complete Works Frequency Dictionary, it will be of assistance in determining the keywords of Azem Shkreli's body of work, opening up Azem Shkreli's poetic world. Likewise, this PhD thesis is an attempt at clearing new paths in Albanian linguistics regarding the comparison of specialized corpora, as well as at elaborating on the issues arising during the compilation of specialized corpora and in the application of language software (language technologies). It also aims at determining the problems that should be resolved through more research, such as the problem of comparing the vocabulary of Azem Shkreli's body of work with the synchronous corpus of the Albanian Language of the time when his work was created. This is likely to remain an unresolved problem for long, due to the impossibility of compiling the complete diachronic corpus of the Albanian language. These vocabularies will assist lexicographers in enriching the existing vocabularies, scholars in further studying Azem Shkreli's work, poets and other creators in enriching their lexicon, while also serving as a guide to Albanian language scholars in compiling such type of vocabularies. The research was conducted on 16 works by Shkreli, published in the period 1960-1997, of which: a. Eight poetry collections; b. Three novels; c. Three essay collections; and d. Two plays. To examine and analyze Azem Shkreli's vocabulary, his complete body of work, mainly published by the "Rilindja" Publishing House in Prishtina, will be scanned and digitized. To establish the textual corpus of his complete body of work, the scanning, digitization and recognition of the texts of Azem Shkreli's complete body of work will be applied. The corpus established through the digitization of his complete body of work will be divided done according to literary genres: poetry, prose, drama and journalistic pieces, and also according to the language period: Gheg dialect (1955 - 1968) and Standard Language (1968 - 1997). In this paper, the features of the Azem Shkreli's Complete Work Vocabulary will be analyzed to see whether there are lexical features depending on the literary genres and themes, while also reviewing the lexical cohesion of Azem Shkreli's writing, and classifying the lexicon, to examine Azem Shkreli's contribution to the enrichment of the Dictionary of Today's Albanian Language. The tokens of Azem Shkreli's complete body of work, extracted via the concordancer, have assisted us in compiling the Azem Shkreli's Complete Work Vocabulary, while also examining whether he has written in the pre-standard and standard literary language, since his

literary creativity spans a period of about 45 years. Words that are hard to understand, due to their rare or regional usage, will be contextualized - i.e. provided with their full concordances.

Pastërtia e gjuhës problem gjithnjë i mprehtë për gjuhën shqipe (Me rastin e 60-vjetorit të ndarjes nga jeta të prof. Aleksandër Xhuvanit 1961-2021)

The language purity remains a sensible issue for the Albanian (On the 60th anniversary of Prof. Aleksandër Xhuvani's death, 1961-2021)

EMIL LAFE

Akademia e Shkencave e Shqiperise

Tiranë, ALBANIA

emilafe1@mail.com

Fjalë çelës: gjuha shqipe, pastërtia gjuhësore, fjalori, sintaksa, programimkompjuterik

Keywords: Albanian language, language purity, lexicon, syntax, computerprogramming

Përmbledhja:

Prof. Aleksandër Xhuvani (1880-1961) njihet gjerësisht për punën e tij këmbëngulëse dhe të frytshme edhe në fushën e pastërtisë së gjuhës shqipe. Si vijues i traditës gjuhësore të Rilindjes sonë Kombëtare, ai dha shembullin e përdorimit të një gjuhe sa më të pastër shqipe si në fushën e fjalorit, ashtu edhe në fushën e sintaksës. Shkrimet e tij të kësaj tematike u përmbloodhën dhe u botuan më 1956 në librin “Për pastërtinë e gjuhës shqipe”, i cili vijoi dhe thelloi një traditë të frytshme të gjuhësisë shqiptare. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë e ka vijuar dhe pasuruar këtë traditë me fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe (1954, 1980, 1984, 2002, 2006, 2020) dhe serinë e fjalorë terminologjikë; po ashtu edhe fjalorët më cilësorë gjuhë e huaj - shqip kanë sjellë një ndihmesë me vlerë për të bërë të njohur barasvlerësit shqip të fjalëve të huaja përkatëse. Më 1998 Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë botoi librin “Për pastërtinë e gjuhës shqipe. Fjalor”, që përfaqëson njëfarë përmbledhjeje të këshillimeve për mënjanimin e fjalëve të huaja deri në atë kohë. Sot, pas më se 20 vjetësh, është e nevojshme që ky libër të ribotohet i rishikuar dhe i plotësuar. Fjalët e huaja dhe fjalët shqipe që këshillohet të përdoren në vend të tyre, janë mjaft të ndryshme nga vjetërsia e denduria e përdorimit dhe nga kuptimet e lidhjet që kanë përfutuar në ligjërim. Prandaj edhe mundësitë e zëvendësimit të tyre nuk janë gjithmonë të barabarta. Përgjithësisht mund të dallohen tri grupe: a) Fjalë që zëvendësohen plotësisht e në të gjitha kuptimet me fjalë të shqipes, p.sh.: argravohet, argravim - përkeqësohet, rëndohet, përkeqësim, rëndim; bazik, bazal - themelor; definitiv, definitivisht - përfundimtar, përfundimisht; demantoj, demantim - përgënjeshtroj, përgënjeshttrim; nspiroj, inspirohëm, inspirim, i inspiruar - frymëzohem, frymëzohem, frymëzim, i frymëzuar; hezituj, hezitim - ngurroj, ngurrim; gratis - falas etj. b) Çerdhe fjalësh, ku një a disa prej tyre zëvendësohen plotësisht në të gjitha kuptimet, ndërsa të tjerat zëvendësohen pjesërisht ose nuk zëvendësohen fare, p.sh.: aktivitet - veprimtari, aktivist - veprimtar, por: aktivizoj, aktivizohem, aktivizim; determinoj, determinant - përcaktoj, përcaktues, por: determinizëm. c) Fjalë e çerdhe fjalësh që zëvendësohen pjesërisht, d.m.th. në një ose në disa kuptime (zakonisht në kuptimet kryesore), p.sh.: agrar - bujqësor, por: reformë agrare, çështja agrare; esencë - thelb (në kuptim të figurshëm), por: esencë lulesh etj. Në ditët tona përdorimi krejt pa nevojë i fjalëve të huaja, për të cilat gjuha shqipe ka fjalët e veta, është bërë një shqetësim i mprehtë shoqëror. Herë-herë vihet re njëfarë manie për të përdorur fjalë të huaja edhe krejt pa vend, si p.sh. fjala i aksesueshëm, që ka hyrë në njoftime të tilla si: qendrat arkeologjike janë të aksesueshme

(në vend të: janë të hapura, të vizitueshme), tuneli do të jetë i aksesueshëm në verën e ardhshme (në vend të: tuneli do të jetë gati për qarkullim në verën e ardhshme) etj. Dashamirët e gjuhës shqipe dhe shumë njerëz të letrave kanë ngritur zërin herë pas here kundër vërshimit të fjalëve të huaja sidomos në media dhe në ligjërimin publik. Kjo kumtesë synon të sjellë edhe një herë në vëmendje të anëtarëve të Institutit Alb-Shkenca dhe më gjerë nevojën e një ndërhyrjeje më të organizuar për të nxjerrë nga përdorimi fjalët e huaja të panevojshme, si edhe për të ruajtur karakterin original të gjuhës shqipe në ndërtimet sintaksore. Duke u ndërlidhur me temën e këtij takimi “Epoka e digjitalizimit dhe efekti i saj për një zhvillim të qëndrueshëm”, në kumtesë synohet të kërkohen rrugë dhe qasje të reja për të sjellë një përmirësim progresiv dhe të qëndrueshëm në ruajtjen e pastërtisë së gjuhës shqipe. Autori, si pjesëmarrës në projektin “Gjuha dhe kompjuteri” që po zhvillon me sukses Qendra për Edukim dhe Përparim (Prishtinë), sugjeron që në kuadrin e këtij projekti të ndërtohet një program i posaçëm për mënjanimin e fjalëve të huaja të panevojshme, duke këshilluar fjalën shqipe përkatëse në kontekstin e dhënë.

Abstract:

Prof. Aleksandër Xhuvani (1880-1961) is widely known for his perseverant and fruitful activity also on the field of linguistic purity of Albanian. Continuing the linguistic tradition of the Albanian National Rebirth he gave the example of a pure Albanian usage in the field of lexicon and of syntax. His contributions on this issue were collected and published in 1956 in a volume entitled “Për pastërtinë e gjuhës shqipe” (On the purity of the Albanian Language), which continued and focussed on a fruitful tradition of the Albanian linguistics. The Institute for Linguistics and Literature has continued and enriched this tradition with the monolingual dictionaries of Albanian (1954, 1980, 1984, 2002, 2006, 2020) and the series of the terminological dictionaries; the most qualitative bilingual dictionaries foreign language - Albanian have also brought a valuable contribution to make known the Albanian equivalents of the respective foreign words. In 1998 the Institute published “Për pastërtinë e gjuhës shqipe. Fjalor” (On the purity of Albanian language. Vocabulary) which constitutes a kind of collection of linguistic advices, aiming at avoiding the use of foreign words up to that time. Today, after more than 20 years, a new revised and completed edition of the same volume is necessary. The foreign and the Albanian words which are recommended to be used instead differ according to their age and usage frequency and also to the meanings and relations they have acquired in the speech process. Therefore, the ways of their substitution are not always the same. Generally speaking, three groups can be identified: a) Words which can be fully and, in every meaning, substituted with Albanian words, e.g., *agravohet*, *agravim* ‘aggravate, aggravation’ - *përkeqësohet*, *rëndohet*, *përkeqësim* - *rëndim*; *definitiv*, *definitivisht* ‘definitive, definitively’ - *përfundimtar*, *përfundimisht*; *inspiroj*, *inspirohem*, *inspirim*, *i inspiroar* ‘inspire, inspiration, inspired’ - *frymëztoj*, *frymëzohem*, *frymëzim*, *i frymëzuar*; *hezitoj*, *hezitim* ‘hesitate, hesitation’ - *ngurroj*, *ngurrim*; *gratis* - *falas* etc. b) Word clusters in which one or more of them can be fully and in every meaning substituted with Albanian words, while the others can be partially substituted or not at all, e.g., *aktivitet* ‘activity’ - *veprimtari*, *aktivist* ‘activist’ - *veprimtar*, but: *aktivizoj* ‘activate’, *aktivizohem* ‘be active’, *aktivizim* ‘activation’; *determinoj* ‘determine’, *determinant* - *përcaktoj*, *përcaktues*, but: *determinizëm* ‘determinism’. c) Words and word clusters which can be partially substituted, i.e., in one or some meanings (usually in the main meanings), e.g., *agrar* ‘agrarian’ - *bujqësor*, but: *reformë agrare* ‘agrarian reform’, *çështja agrare* ‘the agrarian question’; *esencë* - *thelb* (in a figurative meaning), but: *esencë lulesh* ‘flower essence’ etc. Nowadays the use of unnecessary foreign words, for which the Albanian language has its own word, has become a sensible social preoccupation. Sometimes a certain tendency of using and spreading quite unnecessary foreign words is observed, as the example of *i aksesueshëm* ‘accessible’ shows, which can be heard in such formulations as: *qendrat arkeologjike janë të aksesueshme* ‘the archaeological sites are accessible’ (instead of: *janë të hapura*, të

vizitueshme ‘are open, can be visited), tuneli do të jetë i aksesueshëm në verën e ardhshme ‘the tunnel will be accessible next summer’ (instead of: tuneli do të jetë gati për qarkullim në verën e ardhshme ‘will be viable/ready/open next summer’) etc. People who care about Albanian and many literates have often expressed their concern regarding the flood of foreign words, especially in the language of media and in the public speech. This paper aims to recall the attention of the members of Alb-Shkenca Institute and of a wider circle on the need for a more organized intervention aiming to avoid unnecessary foreign word in Albanian and to preserve its original syntactic character. Regarding the thematic of this meeting “The digitalisation epoch and its consequences for a sustainable development” the present paper aims to search new ways and approaches for a progressive improvement to preserve the Albanian linguistic purity. The Author, being a member of the project “Gjuha dhe kompjuteri” (Language and computer) developed successfully by the Centre for Education and Progress (Prishtinë), proposes, in the frames of this project, the development of a special program aiming to avoid unnecessary foreign words, suggesting the respective Albanian word in a given context.

Abstracts

Applied Computer Science Conference (IASH-ACSC)


The Sixteenth International Annual Meeting of Alb-Science Institute
Shkup, 01 - 03 October 2021

Të gjitha përmbledhjet e këtij dokumenti janë regjistruar në sistemin **ALPA**[®] nga vetë autorët e tyre. Rrjedhimisht, ndonjë gabim i mundshëm drejtshkrimor apo tjetër në përmbledhje dhe informacionin përkatës është i autorit apo autores përkatëse.

Të drejten për kopjimin dhe shumëfishimin e përmbledhjeve në këtë dokument e ruan ekskluzivisht Instituti Alb-Shkenca (IASH): www.alb-shkenca.org

Gjeneruar më 10 Tetor 2021.

Ky dokument është gjeneruar në mënyrë automatike nga sistemi **ALPA**[®].



ALPA - *Albanian Papers*
mali Information Technologies
<http://alpa.mali-it.eu>

Përdorimi i teknologjive blockchain për të përmirësuar votimin me kusht

Using blockchain technologies to improve conditional voting

VEHBI NEZIRI

University of Prishtina

Prishtinë, KOSOVA

vehbi.neziri@uni-pr.edu

BLERIM REXHA

University of Prishtina

Prishtinë, KOSOVA

blerim.rexha@uni-pr.edu

RAMADAN DERVISHI

UP-FIEK

Prishtinë, KOSOVA

ramadan.dervishi@uni-pr.edu

ISAK SHABANI

University of Prishtina

Prishtinë, KOSOVA

isak.shabani@uni-pr.edu

Fjalë çelës: blockchain, conditional voting, smart contracts, elections

Keywords: blockchain, conditional voting, smart contracts, elections

Përmbledhja:

Lëvizshmëria e përdoruesit përfundimtar po bëhet në ditët e sotme një supozim standard për çdo aplikacion softuerik. Por lëvizshmëria kërkon më shumë siguri. Për shkak të kësaj lëvizshmërie, por edhe për shkak të dyshimeve në procesin zgjedhor, si dhe vonesave në procesin e numërimit, shumë vende kanë zhvilluar ose po zhvillojnë sisteme të avancuara të votimit. Përmes teknologjive, mund të ngrihen sisteme të avancuara të votimit për t'u mundësuar të gjithë qytetarëve të votojnë shpejt dhe saktë, ndërsa subjektet politike që marrin pjesë në zgjedhje kanë kontroll të fortë dhe të saktë të rezultateve të cilat mund të publikohen menjëherë pas përfundimit të procesit zgjedhor. Votimi elektronik është një aplikacion që ka nevojë përveç lëvizshmërisë dhe sigurisë edhe privatësisë, anonimitetin dhe besueshmërisë, prandaj është e nevojshme të përdoren algoritme kriptografike për të siguruar këto veçori. Në shumë sisteme zgjedhore, qytetarët, të cilët nuk janë në gjendje të hedhin votën në vendvotimin e tyre, lejohen të votojnë "me kusht" në çdo vendvotim. Numërimi i votave të kushtëzuara është pothuajse një pjesë integrale e të gjithë procesit të votimit sepse ato duhet të verifikohen nëse votuesit kishin të drejtë të votojnë dhe nëse kanë votuar më shumë se një herë dhe gjithashtu duhet të pasohet nga saktësia, transparencja, efikasiteti dhe privatësia e votimit. Në këtë punim ne propozojmë përdorimin e teknologjive të shpërndara, si blockchain dhe kontrata të mençura për të mundësuar besueshmërinë e sistemit të votimit. Blockchain është një lloj i bazës së të dhënave, regjistrit ose sistemit të regjistrimit të informacionit i cili jo vetëm që ruhet në një vend si shumica e bazave të të dhënave tradicionale, por është i decentralizuar dhe gjithashtu ruan transaksionet në librin digjital në mënyrë të verifikuar dhe të përhershme. Ky libër transaksionesh kopjohet dhe shpërndahet në të gjithë rrjetin e të gjitha pajisjeve që janë në blockchain. Mënyra e decentralizuar dhe e shpërndarë e bën blockchain një teknologji të dobishme për shumë procese, por edhe për votimin elektronik, pasi nuk menaxhohet nga një autoritet i vetëm, i cili mund të ndikojë ose ndryshojë përmbajtjen. Përdorimi i blockchain për regjistrimin e qytetarëve, të cilët kanë votuar do të parandalojë votimin me kusht më shumë se një herë, por zbatimin e kontratave të zgjuara mund të parandalojë ose lejojë votuesit të votojnë sipas kritereve të përcaktuara nga komisioni zgjedhor. Ekzistojnë sisteme të ndryshme votimi me kritere të ndryshme dhe në disa prej tyre lejohet të votohet më shumë se një herë, por vota e fundit mbishkruan fletëvotimet e mëparshme.

Kriteret e vendosura nga komisionet zgjedhore mund të përmbushen në mënyrë të kënaqshme përmes zbatimit të kontratave të mençura. Kontratat e mençura janë zakonisht marrëveshje midis dy palëve, të shkruara në formën e një programi softuerik, dhe në rastin e votimit ato mund të jenë marrëveshje sipas akteve ligjore që përcaktojnë kushtet e votimit me kusht. Këto njihen si programe softuerike të ruajtura në blockchain e që funksionojnë dhe ekzekutohen automatikisht kur kushtet e paracaktuara janë plotësuar dhe verifikuar. Përdorimi i kontratave të mençura përmirëson shpejtësinë, efikasitetin dhe saktësinë sepse pasi kushtet e kontratës të përmbushen dhe verifikohen, kontratat ekzekutohen menjëherë. Ekzekutimi i menjëhershëm rrit efikasitetin dhe saktësinë pasi nuk ka nevojë për përfshirjen e palëve të treta për të kryer punë manuale, e cila punë mund të mos jetë e besueshme nëse menaxhohet nga një autoritet i vetëm. Teknologjia Blockchain mund të parandalojë shumë lloje të mashtrimit të votuesve në zgjedhje, kështu që mund të jetë teknologjia e së ardhmes. Përdorimi i librit digjital të transaksioneve shpërndahet në të gjithë rrjetin e sistemeve kompjuterike në blockchain, dhe çështjet e mundshme të privatësisë të ngritura trajtohen gjithashtu.

Abstract:

Mobility of end user is becoming nowadays a standard assumption on every software application. But mobility requires more security. Due to this mobility, but also due to doubts in the election process, as well as delays in the counting process, many countries have developed or are developing advanced voting systems. Through technologies, advanced voting systems can be set up to enable all citizens to vote quickly and accurately, while political entities participating in elections have strong and accurate control of the results which can be published immediately after completion of the electoral process. Electronic voting is an application that needs in addition to mobility and security also privacy, anonymity and reliability therefore it is necessary to use cryptographic algorithms to provide these features. In many election systems citizens, who are not able to cast their vote at their home polling station are allowed to vote “conditionally” at any polling station. Conditional vote counting is almost an integral part of the whole voting process because they need to be verified if voters were eligible to vote and if they have voted more than once, and it must also be followed by accuracy, transparency, efficiency and voting privacy. In this paper we propose the usage of distribution technologies, such blockchain and smart contracts to enable the reliability of the voting system. Blockchain is a type of database, register or information recording system which is not only stored in one location as most traditional databases, but is decentralized and also stores the transactions in the digital ledger book in a verifiable and permanent manner. This transactions book is copied and distributed throughout the network of all devices that are in the blockchain. Decentralized and distributed mode makes blockchain a useful technology for many processes, but also for electronic voting, as it is not managed by a single authority, which can influence or change the content. Using the blockchain to register citizens, who have voted will prevent conditional voting more than once, but the implementation of smart contracts can prevent or allow voters to vote according to the criteria set by the election commission. There are different voting systems with different criteria and in some of them it is allowed to vote more than once, but the last ballot overwrites the previous ballots. The criteria set by the election commissions can be satisfactorily met through implementing smart contracts. Smart contracts are usually agreements between two parties, written in the form of a software program, and in the case of voting they can be agreements according to legal acts that define the conditions of conditional voting. These are known as software programs stored on a blockchain that run and executed automatically when predetermined conditions have been met and verified. The use of smart contracts improves speed, efficiency and accuracy because once the terms of the contract are met and verified, the contracts are executed immediately. Immediate execution increases efficiency and accuracy as there is no need for third party involvement to perform manual work, which work may not be reliable if managed by a single authority. Blockchain techno-

logy can prevent many types of voter fraud in the election, so it can be the technology of the future. Using digital ledger of transactions is distributed throughout the network of computer systems in the blockchain, and potential privacy issues raised are addressed as well.

Aplikimi i teknologjisë blockchain në Open Banking / PSD2, siguria e të dhënave dhe privatësia

Application of Blockchain technology in Open Banking / PSD2, data security and privacy

RAMADAN DERVISHI

UP-FIEK

Prishtinë, KOSOVA

ramadan.dervishi@uni-pr.edu

BLERIM REXHA

University of Prishtina

Prishtinë, KOSOVA

blerim.rexha@uni-pr.edu

VEHBI NEZIRI

University of Prishtina

Prishtinë, KOSOVA

vehbi.neziri@uni-pr.edu

KADRI SYLEJMANI

UP-FIEK

Prishtinë, Kosovo, KOSOVA

kadri.sylejmani@uni-pr.edu

Fjalë çelës: Open Banking, PSD2, Blockchain, Security, encryption, hashing

Keywords: Open Banking, PSD2, Blockchain, Security, encryption, hashing

Përmbledhja:

Sistemeve të centralizuara dhe mos ndarjes së informatave, çdo ditë e më shumë po i vjen fundi. Në hovin e zhvillimeve industriale dhe adaptimit të shpejtë të produkteve në mënyrë që të plotësohen kërkesat e ndryshme të klientëve, ndarja e informatave dhe lehtësimi i qasjes tani për tani është një kërkesë në rritje. Koha për liferim të produkteve në industri e sidomos në institucione financiare pothuajse është duke kaluar në kohë që një ditë do të ofrohet në “kohë reale” (duke mos pasur kohë që të pritët në adaptim të sistemit për produktin e ri). Si përgjigje e kërkesave të shpejta për implementim, institucionet financiare së fundi në fillim të vitit 2018 kanë aprovuar rregulloren Open Banking/ PSD2. Kjo mundëson që institucionet e ndryshme financiare të kenë mundësinë e qasjes në informata përmes palëve të treta të licencuara. Kjo është krijuar për të lehtësuar procesin e transferove ndërmjet bankave e gjithashtu edhe të kenë një çmim më të lirë. Në këtë punim, ne po trajtojmë sfidat e ngritura në lidhje me sigurinë dhe privatësinë e të dhënave të përdoruesit, kur te Bankimi i hapur zbatohet teknologjia blockchain. Blockchain përdor librin kryesor të shpërndarë dhe të decentralizuar për ruajtjen e të dhënave të përdoruesve përfundimtarë dhe ndërtimin e zinxhirit të transaksionit të pandryshueshëm duke përdorur algoritme kriptografike. Qasja e propozuar do të eksplorojë mundësitë e zbatimit të PSD2 në teknologjinë Blockchain. Përdorimi i kësaj teknologjie do të ofrojë përveç disponueshmërisë më të mirë të sistemit, gjithashtu siguri më të lartë për sa i përket pandryshueshmërisë dhe sigurisë së informacionit. Përdorimi i algoritmeve të enkriptimit së bashku me nënshkrimet digjitale mund të plotësojnë kriteret e kërkuara nga GDPR (Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave). Përparësia e përdorimit të sistemeve të decentralizuara qëndron në faktin se nuk ka asnjë pikë të vetme dështimi si në aspektin e teknologjisë ashtu edhe në aspektin e monopolizimit të procesit. Bankimi i hapur / PSD2 duke përdorur palë të treta të licencuara edhe pse kemi lehtësim të procesit ende pala e tretë është një pikë e vetme e dështimit në aspektin teknik dhe në aspektin e monopolizimit. Meqenëse me blockchain shmangen teknologjitë e palëve të treta në procese, aplikimi i kësaj teknologjie përmirëson përparësitë aktuale të Bankimit të Hapur/ PSD2 Aplikimi i teknologjisë blockchain hap çështje të tjera që duhet të adresohen,

të tilla si: ndarja e informacionit, siguria për sa i përket qasjes të paautorizuar në të dhëna (kërkesa e GDPR), çështja e performancës pasi kemi procese enkriptimi dhe nënshkrimi digjital, etj. Në sistemet e shkëmbimit të informacionit, kërkesa kryesore nga rregullatori dhe personat ose kompanitë gjithashtu, është autorizimi nga pronari i informacionit, p.sh. Për informatat personale të klientit nevojitet autorizim nga klienti, për kompanitë nevojitet autorizim nga pronari / aksionarët e kompanisë etj. Këto autorizime mund të zbatohen duke përdorur algoritme të njohura të nënshkrimeve digjitale pa pasur nevojë për miratim me nënshkrim të shkruar me dorë në letër, pasi në rast të refuzimit nënshkrimi digjital është i vlefshëm njësoj si nënshkrimi i shkruar me dorë. Të gjitha këto çështje do të trajtohen në këtë punim duke propozuar një zgjidhje të re duke përdorur metodat dhe teknikat më të fundit. Algoritmet që do të përdoren për enkriptim do të jenë më të njohurit dhe që janë vërtetuar deri më tani, si RSA, AES, dhe disa raste 3DES, për më tepër për nënshkrimet digjitale, nevojiten edhe certifikata digjitale X.509. Përdorimi i të gjitha këtyre teknikave siguron një zgjidhje gjithëpërfshirëse që do të ofrojë zgjidhje optimale, pasi deri më tani të gjitha transaksionet financiare kryhen duke përdorur këto teknika në ekosistemin digjital pa probleme të theksuara. Duke shtuar këto çështje, me karakteristikat e ofruara nga blockchain do të arrihet një sistem në të cilin do të përmbushen kërkesat më të rëndësishme nga institucionet financiare, si dhe rregullatorët.

Abstract:

Centralized systems and non-sharing of information are slowly coming to an end. In the wake of industrial developments and rapid product adaptation in order to meet different customer requirements, information sharing and ease of access is currently a growing demand. The time for product delivery in the industry, especially in financial institutions, is almost passing in time that one day will be offered in "real time". In response to prompt requests for implementation, financial institutions have recently approved the Open Banking / Payment Services Directive (PSD) 2 regulation in early 2018. This enables various financial institutions to have access to information through licensed third parties, facilitating the process of transfers between banks and at a cheaper price. In this paper we are addressing the challenges raised concerning user data security and privacy, when Open Banking is implemented by blockchain technology. Blockchain uses distributed and decentralized ledger for storing end user data and building the chain of immutable transaction using cryptographic algorithms. The proposed approach will explore the possibilities of implementing PSD2 in Blockchain technology. The use of this technology will offer in addition to better system availability, also higher security in terms of immutability and information security. Using encryption algorithms together with digital signatures can also meet the criteria required by the GDPR (General Data Protection Regulation). The advantage of using decentralized systems lies in the fact that we do not have a single point of failure both in terms of technology and in terms of process monopolization. Open Banking/PSD2 using licensed third parties even though we have process facilitation still third party is a single point of failure in technical terms and in terms of monopolization. Since with blockchain are avoided third parties technology to the processes, the application of this technology improve the advantages of current Open Banking / PSD2 The application of blockchain technology opens other issues that need to be addressed, such as: information sharing, security in terms of unauthorized access to data (GDPR request), the issue of performance as we have encryption and digital signature processes, etc. Implementing data security and privacy in any system causes many negative effects not only in terms of performance, also in the memory space required to save and process the encrypted data. Every implementation should take into consideration the structure of data and architecture of the existing system in order to have zero impact on existing functionalities. Issues like those mentioned above will be part of this study.

All these issues will be addressed in this paper by proposing and finding the solution using the methods and techniques of the time. The algorithms that will be used for encryption will be the most well-known and that has been proven so far, such as RSA, 3DES, AES, then for digital signatures, X.509 digital certificates are also needed. By using these we ensure that we will have optimal solutions

since so far all financial transactions are carried out using these techniques and the world of informatics works with them without significant problems. To this are added the features of the blockchain, then a system will be achieved in which there will be the fulfillment of many aspects required by financial institutions as well as regulations

Zbatimi i një modeli për identifikimin e autorësisë bazuar në machine-learning për gjuhën shqipe

Application of authorship identification model based on machine-learning for Albanian language

MIRANDA HARIZAJ

Universiteti Politeknik i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
miranda.harizaj@gmail.com

ARLI MINGA

Instituti Kanadez i Teknologjisë(Canadian
Institute of Technology)
Tiranë, ALBANIA
arli.minga@cit.edu.al

VILMA TOMÇO

Fakuleti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
vilma.tomco@unitir.edu.al

ALFONS HARIZAJ

Instituti Kanadez i Teknologjisë(Canadian
Institute of Technology)
Tiranë, ALBANIA
alfons.harizaj@cit.edu.al

Fjalë çelës: Përpunimi i gjuhës natyrale, identifikimi i autorit

Keywords: NLP, ML, textmining, authorship identification

Përmbledhja:

Natural Language Processing është një fushë studimi, e cila ka marrë një rëndësi të veçantë dhe hov zhvillimi vitet e fundit, ku analizimi i teksteve të shkruara nëpërmjet teknikave të ndryshme të “text mining” dhe nxjerrja e të gjitha veçorive të tyre është një kërkesë paraprake për t’u përdorur dhe zbatuar me tej për qëllime të ndryshme. Një rast i veçantë dhe me interes është dhe zbatimi në gjuhën shqipe. Në këtë punim do të krahasohen disa nga teknikat dhe algoritmet më efektive përse i përket “text mining”, për të parashikuar autorësinë e një teksti të shkruar në gjuhën shqipe, duke pasur si fond të trajnimit të modelit artikuj të disa prej analistëve të njohur të gazetarisë shqiptare. Kur flasim për gjetjen e autorësisë së një teksti duhet të kemi parasysh shumë elementë të rëndësishëm si: numri i fjalive, struktura e ndërtimit të fjalive, numri i fjalëve në një fjali, përsëritja e së njëjtës fjalë, gjatësia e fjalëve të përdorura, frekuenca e përdorimit të shenjave të pikësimit, figurat letrare të përdorura; elemente të cilat shfaqin më së miri stilin unik të narracionit për secilin autor. Ky punim mund të shërbejë si një pikënisje e mirë për të shkuar më tej në objektivin e saj specifik, parashikimin e autorësisë së një teksti anonim, por edhe për zbatime të tjera në lidhje me “text mining”, referuar gjuhës shqipe. Në rastin e këtij punimi, por edhe në raste të tjera kur Natural Language Processing mund të zbatohet për gjuhën shqipe, sfidat më të mëdha që hasen janë kryesisht gjuhësore dhe jo teknike. Algoritmet që propozohen nga “machine learning” po evoluojnë dhe përmirësohen çdo ditë, dhe janë sfidë më vetë në zgjedhjen e algoritmit të duhur dhe trajnimin e tij për probleme specifike. Sfida kryesore në detyrën tonë është kompleksiteti që përfaqëson gjuha shqipe në aspektin linguistik, si në fjalor ashtu edhe në gramatikë e bën arritjen e qëllimit tonë të vështirë, por jo të pamundur. Një sfidë tjetër gjatë ndërtimit të një modeli efektiv për identifikimin e autorësisë për gjuhën tonë është mungesa e një fondi të pasur me libra elektronikë dhe një fjalori elektronik “open-source”. Modeli i ndërtuar është bazuar në përdorimin e algoritmit “Logistic Regression”, i cili është një algoritëm që mund të shihet si një metodë

që qëndron diku midis “machine learning” dhe “deep learning”, pasi është lehtësisht i konceptueshëm si një “one-layer neural network”. Ky algoritëm është me efikas në rastet kur duhet të vendosim midis dy zgjedhjeve të mundshme: në rastin tonë nëse një autor e ka shkruar apo jo një tekst specifik. Për komponentin software është zgjedhur gjuha e programimit Python, duke patur parasysh edhe gamën e gjerë të librarive që mund të përdoren në fushën e “data science” dhe “text mining”. Në përfundim konstatojmë se rezultatet e arritura gjatë simulimit janë të kënaqshme; teksa modeli që kemi ndërtuar, i trajnuar mbi një fond, i cili duhet thënë se është i kufizuar sa i përket numrit të shkrimeve që janë përfshirë; ku në mbi 65% të rasteve gjetja e autorësisë së artikujve të shkruar në mediat shqiptare nga analistët që kemi përzgjedhur, është e suksesshme.

Abstract:

Natural Language Processing (NLP) is a field of study, which has gained a special importance and development momentum in recent years, where the analysis of written texts through various techniques of "text mining" and the extraction of all their features is a prerequisite to be used and be further implemented for various purposes. A special case of interest is the implementation in the Albanian language. In this paper we will compare some of the most effective techniques and algorithms in terms of "text mining", to predict the authorship of a text written in the Albanian language, using for training the model, a fund of articles written by some of the most well-known bloggers of Albanian journalism. When talking about finding the authorship of a text we must keep in mind many important elements such as: number of sentences, sentence structure, number of words in a sentence, repetition of the same word, length of words used, frequency of the use of punctuation, literary figures used; elements which best display the unique narrative style for each author. This paper can serve as a good starting point to go further to its specific objective, predicting the authorship of an anonymous text, but also for other applications related to "text mining", referring to the Albanian language. In the case of this paper, but also in other cases when Natural Language Processing can be applied to the Albanian language, the biggest challenges encountered are mainly linguistic and not technical. The algorithms proposed by machine learning are evolving and improving every day, and it is a challenge itself, to choose the right algorithm and train it for specific problems. The main challenge in our task is the complexity that the Albanian language represents in terms of linguistics, both in vocabulary and grammar, which makes the achievement of our goal difficult, but not impossible. Another challenge in building an effective model for identifying authorship for our language is the lack of a rich fund of e-books and an open-source electronic dictionary. The built model is based on the use of the "Logistic Regression" algorithm, which is an algorithm that can be seen as a method that lies somewhere between "machine learning" (ML) and "deep learning", as it is easily conceived as a "one-layer neural network". This algorithm is most effective in cases where we have to decide between two possible choices: in our case whether or not an author has written a specific text. The Python programming language has been chosen for the software component, taking into account the wide range of libraries that can be used in the field of "data science" and "text mining". In conclusion we evaluate that the results achieved during the simulation are satisfactory; as the model we have built, trained on a fund, which should be said that is limited in terms of the number of articles involved; where in over 65% of cases finding authorship of articles written in the Albanian media by the bloggers we have selected, is successful.

Integrimi i Industrisë 4.0 në sistemet e kontrollit Ethernet të makinave me kontroll numerik

Integration of Industry 4.0 in CNC Ethernet control systems

MIRANDA HARIZAJ

Universiteti Politeknik i Tiranës

Tiranë, ALBANIA

miranda.harizaj@gmail.com

IGLI BISHA

Fakulteti i Inxhinierise Elektrike, Universiteti

Politeknik i Tiranës

Tiranë, ALBANIA

igli.bisha@fie.edu.al

Fjalë çelës: Makinat me kontroll numerik, Industria 4.0, kontrolluesi Ethernet

Keywords: Numerical control machines, Industry 4.0, Ethernet controller

Përmbledhja:

Industria 4.0 po transformon procesin e prodhimit në mënyrë të shpejtë dhe në të gjithë komponentët e mjedisit industrial. Ky transformim kërkon kryesisht nga prodhuesit dhe projektuesit e makinave të prodhimit integrimin në Industrinë 4.0 në procesin e automatizimit dhe kontrolluesve të makinave të prodhimit. Këta kontrollues duhet të mbështesin karakteristika teknike të kërkuara, të cilat mundësojnë integrimin në nivele të ndryshme të mjedisit të prodhimit, nga sensorët te serverat në “cloud”. Fokusi i punimit synon të jetë së pari në vlerësimin e teknologjive aktuale të kontrollit në ‘cloud’ të cilat zbatohen nëpërmjet përdorimit të teknologjive “machine learning” dhe “artificial intelligence” për të identifikuar në mënyrë të veçantë njohuritë dhe trajnimin e veprimeve operacionale të kontrollit që mund të zbatohen në industri. Zhvillimi i mëtejshëm i tyre do të mundësojë ndërfaqen digjitale për ekzekutimin dhe kontrollin e detyrës së kontrollit në industri, në mënyrë që sa herë të jetë e nevojshme të ndërmerren veprime të sakta dhe të menjëhershme. Në këtë punim propozohet një arkitekturë sistemi kontrolli e ndryshme nga “tradicionalet”, e cila bazohet në kontrollin “software” të automatizimit të makinave inteligjente dhe që është e aftë të ekzekutohet në çdo makinë industriale. Në të njëjtën kohë në këtë punim është prezantuar zbatimi konkret i kësaj arkitekturë, në funksion të plotësisht të kërkesave dhe integritit me Industrinë 4.0. Kjo arkitekturë e propozuar zbatohet në sistemet e kontrollit Ethernet për makinat me kontroll numerik. Ajo ofron mundësinë e konvergimit të rrjeteve të ndryshme të komunikimit, si dhe mundësinë e zbatimit dhe adaptimit të saj për aplikime të ndryshme të kontrollit të lëvizjes. Kërkesa të tjera pjesë e detyrës së këtij sistemi kanë ardhur për shkak të nevojës në rritje dhe një numri të konsiderueshëm të veprimeve operacionale në ndërveprim me sisteme të tjerë duke përdorur protokolle industriale të ndryshme. Të tilla veprime mund të jenë: dërgim të skedarëve në makinat me kontroll numerik, dërgim i njoftimeve të alarmit, regjistrim i ngjarjeve në një skedar etj. Avantazhi i këtij ndërveprimi midis njeriut, makinës dhe Industrisë 4.0 është që makina CNC punon në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe bën të mundur që të dhënat të ruhen në një mjedis “cloud”. Problemet e ekzekutimit të procesit, të cilat kërkojnë zgjidhje në shumë raste të menjëhershme nuk do të jenë të varura vetëm nga njohuritë e operatorit apo supervizorit. Nëse një proces apo problem i ngjashëm është ekzekutuar apo identifikuar më parë, ky informacion ruhet në mjedisin virtual dhe përdoret për operacione të tjera të procesit, duke ndihmuar në zgjidhjen më të shpejtë dhe efikase. Transmetimi i të dhënave mundësohet nga sistemi nëpërmjet infrastrukturës fiziko-kibernetike, ku përfshihen sensorë të avancuar dhe platforma IoT, që ndihmojnë në shkëmbimin e të dhënave në kohë reale. Rezultatet e marra nga zbatimi i këtij sistemi tregojnë edhe njëherë avantazhet e integritit të Industrisë 4.0 në

sistemet e automatizuara të prodhimit industrial. Projektimi dhe përdorimi në industri, si në rastin e aplikimit për sistemet e kontrollit Ethernet të makinave me kontroll numerik ka rritur efijensën e punës së prodhimit nëpërmjet reduktimit të kohës dhe kostos së prodhimit, si dhe rritjes së përfitimeve financiare, që mundësohen dhe nga reduktimi i energjisë së përdorur dhe nga rritja e cilësisë së produkteve të prodhuara. Gjithashtu kjo arkitekturë kontrolli mbështet ndërtimin e fabrikave ‘smart’, të afta për të ekzekutuar në mënyrë të automatizuar dhe në kohë reale veprime korigjuese dhe optimizuese të proceseve industriale të prodhimit.

Abstract:

Industry 4.0 is transforming the manufacturing process so quickly and across all components of the industrial environment. This transformation mainly requires manufacturers and designers of production machines to integrate into Industry 4.0 the process of automation and controllers of production machines. These controllers must support the required technical features, which enable integration at different levels of the production environment, from sensors to cloud servers. The focus of the paper, first of all, is to evaluate the current control technologies in the ‘cloud’ which are applied through the use of technologies “machine learning” and “artificial intelligence” to specifically identify the knowledge and training of operational operations of control that can be applied in industry. Their further development will enable the digital interface for defining and executing the control task in the industry, so that whenever necessary accurate and immediate actions will be taken. This paper proposes a control system architecture different from the “traditional” ones, which is based on the “software” control of intelligent machine automation and which is capable to be executed in any industrial machine. At the same time in this paper is presented the concrete implementation of this architecture, in order to meet the requirements and integration with Industry 4.0. This proposed architecture applies to Ethernet control systems for numerically controlled machines. It offers the possibility of convergence of different communication networks, as well as the possibility of its implementation and adaptation for different motion control applications. Other requirements part of the task of this system have come due to the growing need and a considerable number of operational actions in interaction with other systems using different industrial protocols. Such actions can be: sending files to numerically controlled machines, sending alarm notifications, recording events in a file, etc. The advantage of this interaction between man, machine and Industry 4.0 is that the CNC machine works comprehensively and enables data to be stored in a cloud environment. Process execution problems, which require solutions in many immediate cases, will not depend solely on the knowledge of the operator or supervisor. If a similar process or problem has been previously executed or identified, this information is stored in the virtual environment and used for other process operations, helping to resolve it more quickly and efficiently. Data transmission is performed by the system through physical-cybernetic infrastructure, which includes advanced sensors and IoT platforms, which help in the exchange of data in real time. The results obtained from the implementation of this system show once again the advantages of integrating Industry 4.0 into automated industrial production systems. Design and use of this system in industry, as in the case of application for Ethernet control systems of numerically controlled machines has increased the efficiency of production work by reducing production time and cost, as well as increasing financial benefits which are enabled and by reducing used energy and by increasing the quality of produced products. This control architecture also enables the construction of “smart” factories, capable of executing automatically and in real time corrective and optimizing operations of industrial production processes.

Efekt i dizajnit të arkitekturës si komponentë jo -dixhitale në zhvillimin e industrisë dixhitale - rast studimi Prishtinë, Kosovë

The effect of architecture design as the non-digital component to the digital industry development - case study Prishtina, Kosovo

ARTA BASHA - JAKUPI

Faculty of Architecture - University of Prishtina
Prishtinë, KOSOVA

arta.jakupi@uni-pr.edu

GRESA KULETA

Faculty of Architecture - University of Prishtina
Prishtinë, KOSOVA

gresa.kuleta@uni-pr.edu

VLORA NAVAKAZI

Faculty of Architecture - University of Prishtina
Prishtinë, KOSOVA

vlor.navakazi@uni-pr.edu

Fjalë çelës: Qendra teknologjike, arkitektura e qëndrueshme, ripërdorim adaptues

Keywords: Tech Hub, Sustainable Architecture, Adaptive Re use

Përmbledhja:

Ndërtesat që dikur ishin makineri prodhimi, jo vetëm në aspektin ekonomik por edhe në aspektin social, që ndërsa tani ato hapësira kanë mbetur të boshtisura, kërkojnë për vëmendje dhe në të njëjtën kohë për ndërhyrje me metodat e kohës bashkëkohore në mënyrë që si të tilla të u rikthehet vitaliteti dhe mundësia për t'i ofruar më shumë lagjes. Objektet industriale të neglizhuara si ajo e "Fabrikës së Tullave" në Prishtinë, do të jenë pika e studimit të këtij punimi. Ky studim dhe analizë do të përpiqet t'i japë një funksion të ri gjendjes aktuale të objektit dhe mundësive të reja rreth tij. Teknologjitë dixhitale janë përhapur me shpejtësi të madhe në botë dhe në shumë raste teknologjitë dixhitale kanë nxitur zhvillimin, kanë zgjeruar mundësitë për aftësim profesional, kanë përmirësuar shërbimin dhe në të njëjtën kohë kanë ofruar një bazë të madhe punësimi. Për të përfutur plotësisht nga k[to zhvillime dixhitale, ky studim synon të kuptojë më mirë sesi teknologjia ndërvepron me faktorë të tjerë jo-teknologjik, por që janë të rëndësishëm për zhvillimin e saj - ndaj dhe ky studim vë theksin në arkitekturën e ndërtesës dhe rrethinën e saj, si segmente jo-dixhitale për zhvillimin e industrisë dixhitale. Në rastin e Qendrës Teknologjike, pjesa jo-dixhitale përfshin çështjen si zgjedhja e vendndodhjes së duhur, zhvillimi i një arkitekture të qëndrueshme dhe dizajni të përshtatshëm urban, realisht mënyra sesi është rrethosur kjo qendër në kontekstin e një vendi/lagjeje dhe mënyra se si realizohet e jetësohet në vend. Ka shumë raste kur objektet që janë ndërtuar kohë më parë nuk i përshtaten më destinacionit për të cilin janë ndërtuar, kjo ndodh edhe me 'Fabrikën e Tullave' sepse hapësirat e saj janë braktisur dhe si rrjedhojë, këto hapësira të vjetruara dhe të lëna pas dore janë mjaft sfiduese, por edhe të mirëpritura për rivitalizim, i cili do të përdoret si një metodë për të rikrijuar hapësira prodhimi të reja dhe bashkëkohore që do të ndihmonin komunitetin për të promovuar zhvillimin në aspektin ekonomik dhe social. Përfshirja, kompetenca, inovacioni janë mjetet kryesore me të cilat teknologjitë dixhitale stimulojnë rritjen. Sidoqoftë, ata gjithashtu demonstrojnë një shkallë të konsiderueshme dështimi dhe shkallë të ndryshme suksesi. Ky hulumtim shqyrton organizimin e arkitekturës, si komponentë jo-dixhitale për teknologjitë dixhitale. Një pjesë të rëndësishme të analizave do të marrë studimi i hapësirave të brendshme dhe të jashtme brenda fabrikës së tullave, për të parë situatën aktuale dhe mundësinë e përdorimit të tyre në mënyra të

tjera bashkëkohore. Pjesë e analizës do të jenë gjithashtu intervistat dhe hulumtimet që do të bëhen me komunitetin përreth që preket nga ekzistenca e fabrikës në çdo aspekt. Të gjitha hulumtimet, analiza në terren, intervistat do të ndihmojnë në arritjen e një propozimi konkret për rigjallërimin e hapësirave brenda dhe jashtë fabrikës. Qëllimi i qendrave digjitale është të përmirësojë mjedisin dixhital lokal që mund të jetë i disponueshëm për komunitetin, bizneset ose autoritetet lokale, dhe ofron mundësi të mëtejshme për të transformuar mënyrën se si njerëzit jetojnë dhe punojnë në zona të pazhvilluara. Me zgjidhjen e duhur të arkitekturës së qëndrueshme që tejkalon vetveten, duke sjellë jo vetëm funksionin dhe modelin e duhur, por edhe qëndrueshmërinë bazuar në parimet dhe konceptet e hapësirave të shëndetshme urbane.

Abstract:

When buildings that were once the machinery of production, not only economically but also influenced the social relations of the inhabitants, while now that space remains 'dead', questions and at the same time requires to intervene with the methods of contemporary time in order to such to restore vitality and give more to the neighborhood. Neglected industrial facilities of the Brick Factory in Prishtina, will be the point of study. This study and analysis will strive to give a new function to the current state of the object and new opportunities around it. Digital technologies have spread rapidly in the world and in many instances digital technologies have boosted growth, expanded opportunities, and improved service and at the same time have provided great basis of employment. To take full advantage of the digital shares this study aims to better understand of how technology interacts with other, non-technical factors that are important for development— highpoint the architecture of the building and its surrounding that host such activities, and which may be considered as the non-digital segments to digital development but really important in the way how it is rooted in the context of a place and implemented in the ground. In the case of Tech Hubs, the non-digital part involves issues like choosing the right location, developing an appropriate architecture and urban planning arrangement, beside the government and academic support on the role of Tech Hubs. There are many cases when the facilities that were built some time ago no longer fit the destination for which they were built, this also happens with the 'Brick Factory' because its spaces have been abandoned and as a result, these outdated and neglected spaces are quite challenging, but also welcome for revitalization, which would be used as a method to re-create new and contemporary production spaces that would help the community to promote development in economic and social aspect and recall the times of the formerly industrialized and well developed area. Inclusion, competence, novelty are the main tools by which digital technologies stimulate growth. However, they also demonstrate a high failure rate and varying degrees of success. This research examines the architecture arrangements, the non-digital supplements that they provide to the digital technologies. An important part will take the study of interior and exterior spaces within the brick factory, to see the current situation and the possibility of using them in other contemporary ways. Part of the analysis will be interviews and research that will be conducted with the surrounding community that is affected by the existence of the factory in any aspect. All the research, field analysis, interviews will help to reach a concrete proposal for the revitalization of the spaces inside and outside the factory. Digital hubs goal is to improve the local digital setting that can be available to the local people, businesses, or local authorities, and offers further opportunities to transform the way people live and work in underdeveloped areas. With the required sustainable architecture transcending itself, by not only bringing about the right function and design but also sustainability based on the principles and concepts of healthy urban spaces.

Arsimi i lartë në epokën e digjitalizimit shikuar nga këndvështrimi i teknologjisë blockchain

Higher education in the age of digitalization viewed from the perspective of blockchain technology

ALI CAKA
UP Hasan Prishtina
Prishtinë, KOSOVA
ali.caka@gmail.com

VEHBI NEZIRI
UP Hasan Prishtina
Prishtinë, KOSOVA
vehbi.neziri@gmail.com

Fjalë çelës: Teknologjia blockchain, arsimi i lartë, epoka digjitale, proces mësimor, TIKM
Keywords: Blockchain technology, higher education, digital era, learning process, ICTM

Përmbledhja:

Përdorimi dhe zbatimi i teknologjive të reja zhvillimore në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimeve e Multimediave - TIKM në epokën e digjitalizimit po bëhen dita ditës më të rëndësishme dhe gjithëpërfshirëse. Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimeve e Multimediave ka marrë hov të madh përdorimi po njëkohësisht edhe keqpërdorimi dhe keqinterpretimi. Sot e tëra që bëhet me mjetin/pajisjen kompjuter ndërlidhet me digjitalizim, sa që edhe mësimi i mbajtur on-line quhet mësim digjital. Pajisjet/kompjuterët duhen dalluar dhe veçuar nga veglat softuerike dhe programet aplikative që janë të instaluar në to e sidomos nga teknologjitë e specializuara zhvillimore të cilat ndihmojnë në simulimin dhe vizualizimin e procesit mësimor a të fenomeneve të ndryshme natyrore. Sa për ilustrim: shkurimet me ngjyra që dikur i përdornin për të shkruar në dërrasat e zeza e edhe dje e sot flomasterët që i përdornin për të shkruar të tabelat e bardha, nuk e bëjnë mësimin kolor. Mediumi gjithëbotëror - Interneti e ka bërë të tijën dhe është bërë vend gjurmimi e hulumtimi për studiuesit e shumtë e njëkohësisht edhe tejet joshës për shtrembërim të fisnikërisë akademike dhe të mashtrimit gjatë paraqitjes së të arriturave shkencore a edhe të vet portfolisë së studiuesve e që institucioneve të arsimit të lartë i kanë shkaktuar dhe krijuar në fushëbetejë ku ato po dalin humbëse edhe përkundër kujdesit dhe mbështetjes në teknologjitë e reja qofshin përdoruese o zhvillimore. Sot, pothuajse nuk ka institucione të larta arsimore që nuk përballen me plagjiaturën e studentëve a edhe të vet të studiuesve; që nuk përballen me profilet e rreme qofshin të studentëve a të mësimdhënësve/profesorëve, e po ngjashëm edhe institucionet e kujdesit dhe krijimit të politikave zhvillimore të vendit. Institucionet e arsimit të lartë humbin orë të shumta në verifikimin e vërtetësisë së dokumentacionit që krijon zvarritje të proceseve administrative a edhe të vet procesit të mësimit dhe prapëseprapë atyre u vihen letra dhe punime të rreme të cilat symbyllazi arkivohen në arkivat e paqasshëm. Moskrijimi i arkivave të qasshme me verifikim të vërtetësisë u ka krijuar, po u krijon dhe do t'ju krijojë raste mashtrimi në sistemin e arsimit të lartë e ndërlidhsim edhe në institucionet e administratës, qoftë universitare a shtetërore. Prandaj ky punim mëton që duke eksploruar mundësitë e teknologjisë blockchain të krijojë një udhërrëfyes të duhur e njëkohësisht ndihmues për proceset e ndryshme në institucionet e arsimit të lartë, e sidomos tu ndihmojë atyre kur ato përballen me akreditimin a me verifikimin e kualifikimeve dhe të vet cilësisë arsimit. Po ashtu punimi do të merret me mundësitë që sot ofron teknologjia blockchain e që ndërlidhen me përmbajtjet të cilat krijohen duke e pamundësuar përhapjen e pakontrolluar në Internet e njëkohësisht edhe përdori-

min e paautorizuar të informacionit akademik duke ua mundësuar autorëve një ruajtje dhe magazinim të sigurte të informacionit në një zinxhir (chain) të enkriptuar mirë dhe fuqishëm që ofron qasje vetëm për shfrytëzuesit e autentikuar të rrjetit përkatës. Si dhe me mundësitë që ofron në krijimin e platformave të reja të mësimit on-line ku e tëra vëzhgohet dhe monitorohet për të ndihmuar vlerësimin e duhur të studentëve e njëkohësisht e të rritjes së vet performancës. Prandaj zbatimi i teknologjisë blockchain në institucionet e arsimit të lartë dukshëm do ta transformojë mënyrën e deritashme të procesit mësimor dhe administrativ në institucionet e arsimit të lartë duke krijuar siguri të informacionit akademik dhe duke parandaluar dhe pamundësuar që të bëhet keqpërdorimi i të njëjtit.

Abstract:

The use and implementation of new development technologies in the field of Information and Communication Technology and Multimedia in the era of digitalization are becoming more and more important and comprehensive. Information and Communication Technology and Multimedia - ICTM has received a great boost of use, as well as misuse and misinterpretation. Today everything that is done with the computer tool/device is related to digitalization, so much so that the lesson held online is called digital learning. Equipment/computers should be distinguished from software tools and application programs that are installed in them, and especially from specialized development technologies, which help in simulating and visualizing the learning process or various natural phenomena. As an illustration: the crayons that were once used to write on blackboards and even yesterday and today the felt-tip pens that are used to write on whiteboards do not make color learning. The worldwide medium - the Internet, has done its own and has become a place of tracing and research for many scholars. And at the same time extremely tempting to distort academic honesty and cheating during the presentation of scientific achievements or of the portfolios of researchers, and have caused and created to higher education the battlefield where they are losing out despite the care and reliance on new technologies whether user or development. Today, there are almost no higher education institutions that do not face students' plagiarism or even of scholars themselves; who do not face false profiles of either students or teachers/professors, and similarly the state institutions of care and development of policies. Higher education institutions waste many hours verifying the authenticity of documentation, which creates delays in administrative processes or on the learning process itself, and yet they get fake documents and papers that are archived blindly in the inaccessible archives. Failure to create accessible archives with authentication has created, is creating, and will create cases of fraud in the higher education system and interconnected in administrative institutions, whether university or state. Therefore, this paper aims to explore the possibilities of blockchain technology to create a proper guide and at the same time helpful for various processes in higher education institutions, and especially to help them when they face accreditation or verification of qualifications and quality education. The paper will also deal with the opportunities offered today by blockchain technology that relate to the content that is created by preventing uncontrolled dissemination on the Internet and at the same time unauthorized use of academic information enabling authors' safe storage and storage of information. in a well-encrypted and robust chain that provides access only to authenticated network users. As well as the opportunities it offers in creating new online learning platforms where everything is monitored and monitored to help properly assess students and at the same time increase their own performance. Therefore, the application of blockchain technology in higher education institutions will significantly transform the current way of teaching and administrative process in higher education institutions by creating security of academic information by preventing the misuse of the same.

Abstracts

Conference of Law Sciences section


The Sixteenth International Annual Meeting of Alb-Science Institute
Shkup, 01 - 03 October 2021

Të gjitha përmbledhjet e këtij dokumenti janë regjistruar në sistemin **ALPA**[®] nga vetë autorët e tyre. Rrjedhimisht, ndonjë gabim i mundshëm drejtshkrimor apo tjetër në përmbledhje dhe informacionin përkatës është i autorit apo autores përkatëse.

Të drejten për kopjimin dhe shumëfishimin e përmbledhjeve në këtë dokument e ruan ekskluzivisht Instituti Alb-Shkenca (IASH): www.alb-shkenca.org

Gjeneruar më 10 Tetor 2021.

Ky dokument është gjeneruar në mënyrë automatike nga sistemi **ALPA**[®].



ALPA - *Albanian Papers*
mali Information Technologies
<http://alpa.mali-it.eu>

Paditja e mundshme e Serbisë nga Kosova para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë: Potenciali i një rasti bazuar në Konventën kundër Gjenocidit

The possible lawsuit by Kosovo against Serbia before the International Court of Justice: The potential for such a case based the Convention Against Genocide

GENTIAN ZYBERI

Norwegian Centre for Human Rights, University
of Oslo

Oslo, NORWAY

gentian.zyberi@gmail.com

Fjalë çelës: GJND, gjenocid, përgjegjësi shtetërore, reparacione.

Keywords: ICJ, genocide, state responsibility, reparations.

Përmbledhja:

Ky punim është një reflektim mbi potencialin e një rasti që mund të silltet nga Kosova kundër Serbisë para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND ose gjykatë) në bazë të nenit IX-të të Konventës mbi Parandalimin dhe Dënimin e Gjenocidit (KKGJ) të vitit 1948. Kohët e fundit është folur shumë mbi mundësinë dhe pasojat e sjelljes së një rasti të tillë kundër Serbisë para GJND-së. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë është një nga gjashtë organet kryesore të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB-së) dhe organi kryesor gjyqësor i saj. Kjo gjykatë ka juridiksion mbi mosmarrëveshje ndërshtetërore si dhe jep vendime këshillimore bazuar në kërkesa të dërguara nga organet kryesore të OKB-së ose agjencitë e specializuara. Vendimet e gjykatës janë të detyrueshme për palët në gjykim. Ky punim do të analizojë fillimisht çështje të argumentimit të juridiksionit të gjykatës për trajtimin e një çështje të tillë, duke pasur parasysh se Kosova nuk është anëtare e OKB-së dhe për pasojë as e Statutit të GJND-së. Neni IX i KKGJ-së thotë se mosmarrëveshjet midis Palëve Kontraktuese në lidhje me interpretimin, zbatimin ose përmbushjen e kësaj Konvente, përfshirë ato që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e një shteti për gjenocid ose për ndonjë nga aktet e tjera të renditura në nenin III, mund të paraqitet në GJND me kërkesë të njëres prej palëve në mosmarrëveshje. Pastaj, në pjesën e dytë të punimit fokusi do të kalojë në meritat e një padie të tillë dhe mundësinë që gjykata ta gjejë fajtoresh Serbinë për kryerjen e gjenocidit në Kosovë, gjatë viteve 1989-1999, dhe sidomos gjatë konfliktit të armatosur të viteve 1998-1999. Kjo analizë do të bazohet kryesisht mbi dy rastet bazuar mbi KKGJ-në të sjella përkatësisht nga Bosnia dhe Herzegovina dhe nga Kroacia kundër Serbisë, mbi rastet e gjykuara nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNIJ), dhe literaturën e shkruar mbi këto raste dhe mbi përgjegjësinë shtetërore për krime serioze nën të drejtën ndërkombëtare. Në rastin e sjellë nga Bosnja kundër Serbisë, gjykata e gjeti fajtoresh Serbinë për mosparandalimin e gjenocidit në Srebrenicë dhe për mosbashkëpunimin me TPNIJ për dorëzimin e dy të akuzuarve për krimin e gjenocidit, përkatësisht Karaxhiqit dhe Milladiqit. Në rastin e sjellë nga Kroacia, gjykata nuk e gjeti fajtoresh Serbinë për krimin e gjenocidit. Kuptohet se një rast i sjellë nga Kosova ka karakteristikat e veta specifike, por gjithsesi këto raste janë me rëndësi për trajtimin nga gjykata të detyrimeve shtetërore nën KKGJ-në si dhe për çështjen e juridiksionit. Rastet e TPNIJ me rëndësi për këtë çështje janë ata sjellë kundër zyrtarëve të lartë shtetërorë serbë për krimet e kryera në Kosovë nga forcat ushtarake dhe paraushtarake serbe. Këtu duhet thënë se ndonëse

përgjegjësia penale individuale është e ndryshme nga përgjegjësia shtetërore, krimet e kryera në Kosovë që janë hetuar dhe gjykuar nga TPNIJ përbëjnë një material me rëndësi për këtë analizë. Format e kryerjes së këtij krimi janë përfshirë në nenin III që parashikon se aktet e mëposhtme janë të dënueshme: (a) gjenocidi; (b) komploti për të kryer gjenocid; (c) nxitja e drejtpërdrejtë dhe publike për të kryer gjenocid; (d) përpjekja për të kryer gjenocid; (e) bashkëpunimi në gjenocid. Pjesa e tretë e këtij punimi do të trajtojë mundësinë e gjetjes së përgjegjësive shtetërore nga ana e Serbisë dhe pasojat juridike duke përfshirë edhe mundësinë e dhënies së reparacioneve. Pjesa e fundit përbëhet nga konkluzionet e punimit.

Abstract:

This paper provides some reflections on the potential of a case that could be brought by Kosovo against Serbia before the International Court of Justice (ICJ or Court) under Article IX of the 1948 Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide (Convention Against Genocide). There has been a lot of talk recently about the possibility and consequences of bringing such a case against Serbia before the ICJ. The ICJ is one of the six main organs of the United Nations (UN) and its principal judicial body. This court has jurisdiction over interstate disputes and issues advisory opinions based on requests submitted by the main UN organs or specialized agencies. The Court's judgments are binding on the parties to the case. This paper will first analyze issues concerning the jurisdiction of the Court to deal with such a case, given that Kosovo is not a member of the UN and consequently not a party to the ICJ Statute. Article IX of the Convention Against Genocide states that disputes between Contracting Parties concerning the interpretation, application or fulfillment of this Convention, including those relating to a State's responsibility for genocide or any of the other acts listed in Article III, may be submitted to the ICJ at the request of one of the parties to the dispute. Then, in the second part of the paper, the focus will shift to the merits of such a case and the possibility that the Court will find Serbia guilty of committing genocide in Kosovo, during the years 1989-1999, and especially during the armed conflict of 1998-1999. This analysis will be based mainly on two cases brought before the ICJ by Bosnia and Herzegovina and Croatia against Serbia, on cases adjudicated by the International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia (ICTY), and scholarly writing on these cases and on state responsibility for serious crimes under international law. In the case brought by Bosnia against Serbia, the Court found Serbia guilty of failing to prevent the Srebrenica genocide and failing to co-operate with the ICTY in handing over two genocide indictees, namely Karadzic and Mladic. In the case brought by Croatia, the Court did not find Serbia guilty of the crime of genocide. While a potential case brought from Kosovo has its own specific characteristics, still these abovementioned cases are important for the treatment by the Court of state obligations under the Convention Against Genocide as well as for the issue of jurisdiction. ICTY cases relevant to this paper are those brought against senior Serbian state officials for crimes committed in Kosovo by Serbian military and paramilitary forces. It should be noted here that although individual criminal responsibility is different from state responsibility, crimes committed in Kosovo that have been investigated and tried by the ICTY constitute an important material for this analysis. The forms of commission of this crime are included in Article III which provides that the following acts are punishable: (a) genocide; (b) conspiracy to commit genocide; (c) direct and public incitement to commit genocide; (d) attempting to commit genocide; (e) complicity in genocide. The third part of this paper will address the possibility of state responsibility on the part of Serbia and the legal consequences, including the possibility of granting reparations. The last part consists of the conclusions of the paper.

Transformimet e së Drejtës së Pronësisë gjatë Shekullit XX në Shqipëri

The Transformation of Property Law during the XX Century in Albania

ERVIN PUPE

Gjykata e Lartë

Tiranë, ALBANIA

pupe.pupe1973@gmail.com

Fjalë çelës: Albania, Democratic Principles, Property Law

Keywords: Shqipëria, E Drejta e Pronës, Parimet Demokratike,

Përmbledhja:

Gjatë shekullit XX, Shqipëria ka kodifikuar tre kode të ndryshme, të cilat kristalizojnë norma dhe rregulla specifike të pangjashme me njëri-tjetrin. Në fillim të shekullit XX, më saktësisht, në vitin 1929, parlamenti shqiptar miratoi kodin e parë civil laik. Ky Kod u votua en bllok nga pothuajse të gjithë deputetët shqiptarë dhe u bazua në Kodin Civil Francez të vitit 1804. Midis të tjerëve, ka dy arsye kryesore të kësaj zgjedhjeje. Së pari, Franca, si ashtu dhe Shqipëria, nga ana administrative, është një vend i centralizuar. Së dyti, dhe mbase edhe më e rëndësishme, Shqipëria kishte një marrëdhënie të ngushtë me Italinë, e cila po zbatonte gjithashtu përvojën franceze në së drejtës civile. Një shembull i qartë i ndikimit francez në kodin civil të vitit 1929 është fakti se disa koncepte në Kodin Civil të 1929 janë të shkruara në gjuhën origjinale franceze. Megjithëse gjatë regjimit komunist disa ligje u miratuan duke e bërë të pamundur aplikimin e Kodit të parë laik shqipëtar të 1929, vetëm në vitin 1982, Parlamenti shqiptar miratoi tekstin ligjor të quajtur Kodi Civil. Ky kod është shumë i ngjashëm me kodin civil rus të vitit 1961, i cili ishte bazuar në kodin civil gjerman (Bürgerliches Gesetzbuch) të vitit 1900. Pas rënies së Komunizmit dhe shpalljes së kushtetutës së parë demokratike në 1991, në 1993, u formua një Task Forcë. Kjo Task Forcë ishte e përbërë nga ekspert shqiptar dhe të huaj. Për më pak se një vit punë intensive, Task Forca ishte në gjendje të paraqiste një draft të Kodit Civil, i cili pasqyronte parimet e reja demokratike. Duke u ndalur tek pjesa e pronësisë, kodi i ri civil i vitit 1994 pasqyron principet demokratike. Këto parime demokratike, janë shumë të ngjashme me parimet demokratike të kodifikuar jo vetëm në të drejtën civile shqiptare të 1929 por gjithashtu dhe në të drejtën romake. Ky punim jep disa shembuj konkret. Ashtu si të gjitha vendet demokratike, ndërsa pronat private dhe publike mbrohen në mënyrë të barabartë nga ligji, ligjvënësi shqiptar, në mënyrë që të maksimizojë solidaritetin, ka vendosur disa kufizime në pronën private. Megjithatë, prona publike përcaktohet vetëm me ligj. Me fjalë të tjera, prona publike është një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm ku prova private është themelore për zhvillimin ekonomik të shoqërisë. Për më tepër, Shqipëria, si vendet e tjera bazuar në përvojën civile franceze, ka nënvizuar rëndësinë e veprimit juridik konsensual; neni 164 thotë pronësia fitohet me anë të kontratës, pa qenë e nevojshme të bëhet dorëzimi i sendit. Veç kësaj, ndryshe nga kodi civil i vitit 1982, kodi demokratik i viteve '90, gjithashtu ri-prezanton institucionet e servitutit. Gjithashtu, Kodi Civil i vitit 1994 prezantoi për herë të parë institutin e bashkëpronësisë midis anëtarëve të familjes bujqësore, e ngjashme me institutin e impresa di famiglia, e rregulluar nga neni 230bis i Kodit Civil italian. Në përfundim, ky kontribut del në përfundimin që ligji shqiptar i pronësisë i kodifikuar në Kodin Civil të vitit 1994 konsideron disa nga parimet më të rëndësishme demokratike.

Në veçanti, Kodin Civil aktual, megjithëse bazohet në principet romake, është shumë i ngjashëm me kodin civil italian (p.sh. fitimi i pronësis), si dhe me kodin civil francez (p.sh. servitutet vullnetare), ose kodin civil zviceran (p.sh. mbrojtja e posedimit).

Abstract:

During the twentieth century, Albania has codified three different codes, which crystallize different norms and rules. At the beginning of the twentieth century, more precisely, in 1929, the Albanian parliament adopted the first secular civil code. This Code was voted un bloc by almost all Albanian deputies and was based on the French Civil Code of 1804. Among others, there are two main reasons for this choice. First, France, as Albania, from an administrative point of view, is a centralized country. Second, and perhaps even more important, Albania had a close relationship with Italy, which was also applying the French experience in civil law. A clear example of the French influence in the Civil Code of 1929 is the fact that some concepts in the Civil Code of 1929 are written in the original French language. Although during the communist regime some laws were passed by making it impossible to apply the first Albanian secular Code of 1929, only in 1982, the Albanian Parliament adopted the legal text called the Civil Code. This code is very similar to the Russian civil code of 1961, which was based on the German civil code (Bürgerliches Gesetzbuch) of 1900. After the fall of Communism and the promulgation of the first democratic constitution in 1991, in 1993, a Task force was formed. This Task Force was composed of Albanian and foreign experts. In less than a year of intensive work, the Task Force was able to present a draft of the Civil Code, which reflected new democratic principles. Focusing on the Book II (Property Law), the new civil code of 1994 reflects democratic principles. These democratic principles are very similar to the democratic principles codified not only in the Albanian civil code of 1929 but also in Roman law. This contribution gives some concrete examples. As all democratic countries, while private and public property are equally protected by law, the Albanian legislator, in order to maximize solidarity, has established some restrictions on private property. However, public property is determined only by law. In other words, public property is an exception to the general rule where private property is fundamental to the economic development of the society. Moreover, Albania, like other countries based on the French civil experience, has underlined the importance of consensual legal transaction; article 164 states that ownership is acquired through a contract, without the need to release the object. In addition, differently from the civil code of 1982, the democratic code of the '90s, it also re-introduces the institutions of servitude. Also, the Civil Code of 1994 introduced for the first time the institute of co-ownership among members of the agricultural family, similar to the institute of *impresa di famiglia*, ruled by Article 230bis of the Italian Civil Code. In the conclusion, this contribution concludes that the Albanian property law codified in the Civil Code of 1994 considers some of the most important democratic principles. In particular, the current Civil Code, although based on Roman principles, is very similar to the Italian Civil Code (e.g. the acquisition of property), as well as the French Civil Code (e.g. the voluntary easements), or the Swiss Civil Code (e.g. the protection of the possession).

Shpëtimi në Det, nga një "Detyrim i Angazhimit" në "E Drejta për Zbarkim" analizë e të Drejtës Ndërkombëtare të Njeriut

Rescue at Sea, from an 'Obligation of Conduct' to 'Right to Disembark' in light of International Human Rights Law

ENKELEJDA KOKA
Universiteti European i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
enkelejidakoka@gmail.com

ISLI ADDIU
Universiteti European i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
iabdiu2@uet.edu.al

Fjalë çelës: Shpëtim në det, Vendi i Sigurisë, Zbarkimi

Keywords: Rescue at Sea, Place of Safety, Disembarkation

Përmbledhja:

Në dekadën e fundit, Italia dhe Malta janë përballur me ardhje masive të emigrantëve të parregullt ku udhëtojnë me anije të pa-lundrueshme në Detin Mesdhe Qendror. Pa-lundrueshmëria e anijës, ka bërë që migrantët e parregullt të mbyten rregullisht në det. Siç është raportuar nga UNHCR, numri i vdekjeve të migrantëve që vijnë nga Libia në Evropë në mënyrë të parregulltë është rritur nga 2.52% në 2016 në 10.8% në 2019. Në përputhje me detyrimet e saj sipas ligjit ndërkombëtar të detit, Italia dhe Malta kanë detyrimin të garantojnë zbarkimin e shpejtë në një vend të sigurt për ata njerëz që gjenden në ankth në det, dmth 'detyrim angazhimi'. Sidoqoftë, nëse nuk është e mundur që këto shtete bregdetare të garantojnë një vend alternativ sigurie diku larg portit të tyre, atëherë ky detyrim angazhimi bëhet një 'detyrim për t'u zbarkuar' në territorin e tyre. Është përgjegjësi ligjore e Italisë dhe Maltës të interpretojë detyrimet e tyre mbi zbarkimin bazuar në të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe ligjin e refugjatëve. Disa shtete bregdetare dhe studiues të kufizuar kanë interpretuar të Drejtën Ndërkombëtare Detare që të mos detyrojë zyrtarisht shtetin bregdetar të zbarkojë njerëzit e shpëtuar në territorin e tij, por më tepër një detyrim të thjeshtë të angazhimit. Sipas detyrimeve të së drejtës detar ndërkombëtar, një shtet ka detyrimin të garantojë zbarkimin e shpejtë në një vend të sigurt për ata njerëz që gjenden në ankth në det, domethënë "detyrim sjelljeje". Sidoqoftë, nëse nuk është e mundur që shteti të garantojë një vend alternativ sigurie diku larg portit të tij, atëherë ky detyrim sjelljeje bëhet një "detyrim për të zbarkuar" në territorin e tij. Është përgjegjësi ligjore e Italisë dhe Maltës të interpretojë detyrimet e saj mbi zbarkimin duke u bazuar në të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe ligjin e refugjatëve. Sidoqoftë, argumentohet në këtë punim se "detyrimi i angazhimit" kthehet në një "detyrim për të zbarkuar" në momentin kur siguria e njerëzve të shpëtuar nuk mund të garantohet nëse ata nuk zbarkohen në një port ku njihet si "i sigurt" në përputhje me ligjin ndërkombëtar detar dhe të drejtat e njeriut. Kështu, ky punim argumenton se ndryshimet në Konventën Ndërkombëtare për Kërkimin dhe Shpëtimin Detar (Konventa SAR) dhe Konventën Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det (Konventa SOLAS) kan prezantuar konceptet e 'Vendit të Sigurisë' dhe 'E Drejta për Zbarkim'. Detyra për të shpëtuar nuk përmbushet thjesht përmes aktit të shpëtimit. Përkundrazi, konsiderohet e përmbushur me plotësimet rrjedhuese të detyrimit për të zbarkuar të shpëtuarit në një "vend të sigurt", pra "e drejta për të zbarkuar". "E drejta për zbarkim" është njohur dhe pranuar nga Gjykata Italiane e Lartë, e cila përcaktoi një "Vend të Sigurisë" në përputhje me Udhëzimet për Trajtimin e Personave të Shpëtuar në Det, përkatësisht paragrafët 6.12 deri 6.15, duke deklaruar "një vend ku siguria e jetës së të mbijetuarve nuk kërcënohet më dhe ku nevojat e tyre themelore njerëzore (të tilla si ushqimi, strehimi dhe nevojat mjekësore) mund

të plotësohen”. Megjithëse sovraniteti shtetëror i jep një shteti të drejtën të lejojë ose mohojë hyrjen në territorin e tij ose portet kombëtare, ai duhet ta bëjë këtë sipas detyrimeve të tij sipas ligjit detar.

Abstract:

In the last decade, Italy and Malta have been confronted with massive arrivals of irregular migrants travelling on unseaworthy boats in the Central Mediterranean Sea. The un-seaworthiness of the vessel, have caused irregular migrants to regularly drown at sea. As reported by the UNHCR, the number of irregular migrant deaths coming from Libya to Europe has increased from 2.52% in 2016 to 10.8% in 2019. In accordance with its obligations under international maritime law, Italy and Malta have the obligation to guarantee swift disembarkation in a place of safety to those people found in distress at sea, i.e. ‘obligation of conduct’. However, if it is not possible for these coastal states to guarantee an alternative place of safety somewhere away from its port, then this obligation of conduct becomes an ‘obligation to disembark’ in its own territory. It is the legal responsibility of Italy and Malta to interpret its obligations on disembarkation based on international human rights and refugee law. Some coastal states and limited scholars have interpreted International Maritime Law not to formally obligate the coastal state to disembark rescued people in its own territory, but rather a mere obligation of conduct. However, it is argued in this paper that the ‘obligation of conduct’ turns into an ‘obligation to disembark’ at the moment when the safety of the rescued people cannot be guaranteed unless they are disembarked in a port where it is recognised as ‘safe’ in accordance with international maritime and human rights law. Under its obligations under international maritime law, a state has the obligation to guarantee swift disembarkation in a place of safety to those people found in distress at sea, i.e. ‘obligation of conduct’. However, if it is not possible for the state to guarantee an alternative place of safety somewhere away from its port, then this obligation of conduct becomes an ‘obligation to disembark’ in its own territory. It is the legal responsibility of Italy and Malta to interpret its obligations on disembarkation based on international human rights and refugee law. Under its obligations under international maritime law, a state has the obligation to guarantee swift disembarkation in a place of safety to those people found in distress at sea, i.e. ‘obligation of conduct’. However, if it is not possible for the state to guarantee an alternative place of safety somewhere away from its port, then this obligation of conduct becomes an ‘obligation to disembark’ in its own territory. It is the legal responsibility of Italy and Malta to interpret its obligations on disembarkation based on international human rights and refugee law. Thus, this paper argues that the amendments to the International Convention on Maritime Search and Rescue (SAR Convention) and the International Convention for the Safety of Life at Sea (SOLAS Convention) introduced the concepts of ‘Place of Safety’ and the ‘Right to Disembark’. The duty to rescue is not fulfilled simply through the act of rescue. On the contrary, it is deemed fulfilled with the consequent fulfilment of the obligation to disembark the rescued in a ‘safe place’, hence the ‘right to disembark’. The ‘Right to Disembark’ has been recognised and accepted by the Italian Court of Cassation, which defined a ‘Place of Safety’ in accordance with the Guidelines on the Treatment of Persons Rescued at Sea, namely paragraphs 6.12 to 6.15, stating ‘a place where the survivors’ safety of life is no longer threatened and where their basic human needs (such as food, shelter and medical needs) can be met’. Although state sovereignty gives a state the right to allow or deny access to its territory or national ports, it must do so under its obligations under maritime law.

Partneriteti Publik-Privat në ofrimin e të mirave/shërbimeve publike. Rasti i Shqipërisë dhe vështrim krahasues kryesisht me vendet e rajonit dhe vendet e BE -së.

Partnership Public-Private in providing public goods/services. The case of Albania and comparative view mainly with the countries in the region and EU countries.

RENATA KAU
Universiteti Europian i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
renata.kau@uet.edu.al

SOFJANA VELIU
Universiteti Europian i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
sofjana.veliu@uet.edu.al

Fjalë çelës: Partneritetet Publiko Private, krahasim, ofrues rregullator

Keywords: Public Private Partnerships, comparison, regulator, provider.

Përmbledhja:

Ky punim ka për qëllim të ofrojë një reflektim mbi temën e modeleve të marrëdhënieve të Partneritetit Publik Privat në një perspektivë krahasuese me Shtetet Kryesore Evropiane, duke theksuar çështjet kryesore të diskutuara. Vendet e marra në konsideratë janë Britania e Madhe, Spanja, Franca, Gjermania dhe Italia. Metoda e përdorur në këtë punim shkencor, është ajo empirike e realizuar nëpërmjet analizës cilësore dhe krahasuese. Debatimi mbi këto çështje, së bashku me tkurrjen e përgjithshme të investimeve publike në vitet e fundit, pjesërisht për shkak të nevojës për të mbajtur shpenzimet publike të imponuara nga Traktati i Maastrichtit në vitin 1992, ka ushqyer një interes në rritje në Evropë ndaj modeleve alternative për financimin e punëve publike dhe, në veçanti, drejt formave të Partneritetit Publiko Privat (PPP). Me këtë shprehje në synojmë t'u referohemi të gjitha atyre "formave të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve publike dhe botës së biznesit që synojnë të garantojnë financimin, ndërtimin, rinovimin, menaxhimin ose mirëmbajtjen e një infrastrukture ose ofrimin e një shërbimi". (European Commission, Green Paper, 2004, 327 of 30 April 2004). Nuk është e lehtë të përcaktohet vëllimi i transaksioneve të kryera në PPP në vendet e ndryshme evropiane, pasi nuk ka kritere uniforme të klasifikimit për operacione të tilla që lejojnë një krahasim. Megjithatë, është e mundur që të përdoren të dhënat në dispozicion për të provuar disa krahasime, megjithëse në një nivel tregues. Krahasimi i të dhënave në dispozicion së bashku me analizën e veçantive rregulluese të Shteteve Anëtare të marra në konsideratë mund të përbëjnë një kontribut të rëndësishëm në debatin kombëtar mbi çështjet kritike të një natyre rregulluese që nuk favorizojnë pjesëmarrjen e privatëve në ndërtimin e veprave publike infrastrukturore. Tema e financimit të infrastrukturës kohët e fundit ka marrë një rëndësi të veçantë në nivel evropian, gjithashtu duke pasur parasysh kontributin që zhvillimi i infrastrukturës është potencialisht në gjendje të ofrojë për zhvillimin e konkurrencës dhe rritjen ekonomike. Një literaturë e gjërë dhe në thelb uniforme mbështet, në fakt, ekzistencën e një lidhjeje kauzale midis një infrastrukture të një vendi dhe zhvillimit ekonomik. Nga ana tjetër, ekziston një debat i gjallë për faktin se financimi i infrastrukturës duhet të bëhet me investime publike: mekanizmat kontabël krijues mund të maskojnë në formën e investimeve publike, shpenzimet që duhet të klasifikohen si shpenzime korrente, gjithashtu investimet publike mund të zhvendosin investime potencialisht më produktive. Në këtë kuptim, miratimi i partneriteteve publike private mund të ndihmojë në identifikimin e përzierjes më të mirë. Gjithsesi

ky debat ende nuk ka çuar në përpunimin e një disipline të njëjtë në nivel Komunitar dhe ka paqartësi në klasifikimin e disa operacioneve. Pyetja e Komisionit Evropian është në lidhje me përshtatshmërinë e ligjit të Komunitetit me karakteristikat specifike të PPP. Ekzistojnë modele të ndryshme të aplikuara në Shtetet Anëtare individuale dhe në çdo rast të rregulluara ndryshe. Komisioni është veçanërisht i shqetësuar për të siguruar që këto forma të bashkëpunimit në asnjë mënyrë nuk i shmangin rregullat e konkurrencës. Po modeli i ofruar nga Legjislacioni shqiptar në lidhje me Partneritetet Publike Private garanton nje aplikim te suksesshem të këtyre partneriteteve, në shpërndarjen e riskut apo në trasparençën në procesin e përzgjedhjes? A janë këto ligje të përafërt me rekomandimet dhe Konventat e BE-së? Në rastin e Shqipërisë në vështrim krahasues me modelet më të mira të vendeve të BE -së, mund të konkludoj se legjislacioni shqiptar në lidhje me PPP ka ndjekur rekomandimet dhe direktivat e BE-së, modeli i tij është shumë i ngjashëm me modelin francez, por ka të pranishme edhe elemente spanjolle, angleze dhe gjermane. Megjithatë, nevojitet një legjislacion më i detajuar për të garantuar transparencën në procedura dhe ndarjen e barabartë të rrezikut. Kjo është arsyeja pse unë rekomandoj një hartim të normave antikorrupsion në lidhje me PPP dhe një përpunim të legjislacionit ekzistues në mënyrë që të shpërndahet më mirë rreziku dhe të përcaktohen procedurat e tenderit. Në veçanti, unë rekomandoj një rregullore të veçantë dhe të detajuar për koncesionet dhe PPP -të pasi ligji shqiptar nuk bën dallim në shumë drejtime, për shembull në lidhje me kushtet dhe mënyrat e aplikimit. Gjithashtu, për të kryer projekte për përmirësimin e shërbimit kolektiv, ne kemi nevojë për një shtet të aftë që përmes organizmave të tij qendrorë, rajonale dhe lokale, të identifikojë nevojat e qytetarëve dhe bizneseve, të hartojë shërbime të tilla, të sigurojë një mënyrë konkurruese që privatët të ndërtojnë një infrastrukturë materiale dhe jomateriale dhe menaxhimin e tyre, të hartojë thirrje, të hartojë dhe të zbatojë rregulla, të verifikojë rezultate, të marrë vendime të shpejta dhe të ndjekë pasojat. Për të arritur këto rezultate, duhet të zbatohen reforma thelbësore dhe kapacitete të zhvilluara mirë, ose mënyra veprimi në administratat publike të cilat, kur fitohen, bëhen funksionale, dhe zbatohen më shumë, përmirësojnë cilësinë e shërbimeve kolektive.

Abstract:

The present work is intended to offer a reflection on the theme of the most important models in Public Private Partnership relations in a comparative perspective with the main European States, highlighting the main issues discussed. The countries taken into consideration are Great Britain, Spain, France, Germany and Italy. The method used in this scientific paper is the empirical one realized through qualitative and comparative analysis. The debate on these issues, together with the generalized contraction of public investments in recent years, partly due to the need to contain public spending imposed by the Treaty of Maastricht in 1992, has fed a growing interest in Europe towards alternative models for financing public works and, in particular, towards forms of Public Private Partnership (PPP). With this expression we intend to refer to all those "forms of cooperation between public authorities and the business world that aim to guarantee the financing, construction, renovation, management or maintenance of an infrastructure or the provision of a service".(European Commission, Green Paper, 2004, 327 of 30 April 2004). It is not easy to define the volume of transactions carried out in PPPs in the various European countries, as there are no uniform classification criteria for such operations that allow a comparison. However, it is possible to use the available data to try some comparisons, albeit at an indicative level. The comparison of the available data together with the analysis of the regulatory peculiarities of the Member States taken into consideration may constitute an important contribution to the national debate on the critical issues of a regulatory nature that do not favor the participation of privates in the construction of infrastructural public works. The theme of infrastructure financing has recently taken a particular importance at an European level, also in consideration of the contribution that the infrastructural development is potentially able to offer to the resumption of the competitiveness

and to the economic growth. A vast and substantially uniform literature supports, in fact, the existence of a causal link between a country's infrastructural endowment and the economic development. On the other hand, there is a lively debate about the fact that infrastructure financing must take place with public investments: creative accounting mechanisms can mask in the form of public investments, costs that should be classified as current expenditure, also public investments could displace other potentially more productive investments. In this sense, the adoption of private public partnerships could help to identify the best mix. However this debate has not yet led to the elaboration of a same discipline at a Community level and there is uncertainty in the classification of some operations. The European Commission's question is about the compatibility of Community law with the specific characteristics of PPP. There are different models applied in individual Member States and in each case regulated differently. The Commission is particularly concerned about ensuring that these forms of cooperation do not in any way circumvent competition rules. What about the model offered by the Albanian Legislation regarding Public Private Partnerships? Does it guarantee a successful application of these partnerships, in risk distribution or in transparency in the selection process? Are Albanian laws in line with EU recommendations and Conventions? In the case of Albania in comparative view with the best models of the EU countries, I can conclude that the Albanian legislation regarding the PPP has followed the EU recommendations and directives, its model is much similar to the French model but there are present Spanish, English and German elements. However a more detailed legislation is needed in order to guarantee transparency in the procedures and equal risk sharing. That's why I recommend a drafting of anticorruption norms regarding PPP and an elaboration of the existing legislation in order to better distribute the risk and define the procedures of tender. In particular, I recommend a separate and detailed regulation in order to the concessions and PPPs as the Albanian law does not make a distinction on many directions for example concerning the terms and ways of application. Also, in order to carry out projects for the improvement of collective service, we need a state capable through its central, regional and local organizations, to emerge and identify the needs of citizens and businesses, to design such services, to provide a competitive way for private people to build tangible and intangible infrastructure and their management, to draw up calls, to write and enforce rules, to verify results, to make rapid decisions and to follow these consequent actions. In order to achieve these results, incisive reforms and well-developed capacities are to be implemented, or modes to operate of public administrations which, when acquired, made operational, increasingly applied, improve the quality of collective services.

Abstracts

Conference of Agriculture Sciences section


The Sixteenth International Annual Meeting of Alb-Science Institute
Shkup, 01 - 03 October 2021

Të gjitha përmbledhjet e këtij dokumenti janë regjistruar në sistemin **ALPA**[®] nga vetë autorët e tyre. Rrjedhimisht, ndonjë gabim i mundshëm drejtshkrimor apo tjetër në përmbledhje dhe informacionin përkatës është i autorit apo autores përkatëse.

Të drejten për kopjimin dhe shumëfishimin e përmbledhjeve në këtë dokument e ruan ekskluzivisht Instituti Alb-Shkenca (IASH): www.alb-shkenca.org

Gjeneruar më 10 Tetor 2021.

Ky dokument është gjeneruar në mënyrë automatike nga sistemi **ALPA**[®].



ALPA - *Albanian Papers*
mali Information Technologies
<http://alpa.mali-it.eu>

“Përdorimi i energjisë diellore për furnizimin me energji të fabrikës së përpunimit të frutave “Kop. Frut”. Krahasim i përfitimit Energjetik dhe Ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe Gjermanisë”

"Using solar energy to power the fruit processing plant "Kop. Frut". Comparison of Energy and Economic benefit between Albania and Germany”

KRISTJANA SULEJMANI
Universiteti Bujqësor i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
sulejmanikristjana@gmail.com

ALEKSANDER PEQINI
Universiteti Bujqësor i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
aleksander.peqini@hotmail.com

ETLEVA JOJIÇ
Universiteti Bujqësor i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
etlevajojic@yahoo.com

Fjalë çelës: Energji diellore, rrezatimi diellor, ekonomia, klima
Keywords: Solar energy, solar radiation, economy, climate

Përmbledhja:

Industria është përgjegjëse për rreth një të tretën e konsumit total të energjisë në botë dhe kërkesa globale e energjisë po rritet për shkak të aktivitetit industrial dhe përparimet teknologjike në vendet në zhvillim dhe ato të zhvilluara. Në këtë studim fokusi u përqëndrua në përdorimin e energjisë diellore për të furnizuar me energji elektrike fabrikën e përpunimit të lëngjeve të frutave “Kop.Frut”. Fabrika kryen procese të tilla si klasifikimi, larja, tharja, shtypja/shtrydhja, pasterizimi, ftohja, ruajtja dhe paketimi. Procese këto, që konsumojnë një sasi të konsiderueshme të energjisë në këtë fabrikë. Objektivi kryesor i këtij studimi ishte shqyrtimi i furnizimit me energji për proceset në prodhimin e lëngut të frutave përmes paneleve fotovoltaike dhe për të vlerësuar përfitimin ekonomik përmes këtij investimi. Për këtë qëllim, të dhënat e studimit u morën nga fabrika e përpunimit të lëngjeve të frutave "Kop.Frut", e cila ndodhet në Shqipëri në rrethin e Dibrës. Fabrika harxhon rreth 10,000 kWh energji elektrike për cdo muaj për periudhën Tetor - Mars, që përkon me vjeljen e futave që përdoren për prodhim lëngu. Duke qenë se në muajt e tjerë të vitit në fabrikë nuk ka tepër konsum, shpenzimi vjetor është rreth 75.000 kWh. Një sistem fotovoltaike do të instalohet në tarracën e sheshtë të ndërtesës së fabrikës me një sipërfaqe prej 1000 m². Numri maksimal i moduleve për këtë sipërfaqe do të jetë 360 copë, ku modulet janë me fuqi 300 W dhe një fuqi totale e instaluar prej 108 kWp. Ky sistem u simulua nëpërmjet PvSol software, nga rezultatet e marra rezultoi se do të prodhohet 117.762 kWh energji në vit, në bazë vjetore fabrika shpenzon rreth 75.000 kWh pra në dukje se energjia vjetore e prodhuar përmbush kërkesat e fabrikës me energji, por nëse vërejmë në bazë mujore prodhimet mujore të energjisë nuk i përmbushin totalisht kërkesat e fabrikës me energji. Përkatësisht në Tetor parashikohet të prodhohet 4076.1 kWh, në Nëntor 2020 kWh, në Dhjetor 1536.9 kWh, në Janar 1699.3 kWh, në Shkurt 2210.1 kWh, në Mars 8395 kWh. Duke qenë se në këtë periudhë energjia që shpenzohet është rreth 10.000 kWh për cdo muaj, rezulton se energjia e prodhuar nuk i plotëson të gjitha kërkesat e fabrikës me

energji elektrike, përgjithësisht gjatë muajve të vjeshtës dhe dimrit ku kërkesat për energji në fabrikë janë të mëdha, kështu që do të nevojitet një strategji për të kombinuar energjinë elektrike nga rrjeti i OSHEE (Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike) dhe energjinë e prodhuar nga panelet, ose për të përmbushur këto kërkesa shihet premtuese në të ardhmen instalimi i një sistemi Agrivoltaik i cili mund të vendoset mbi pemishte. Me të dhënat e marra nga Kompania e Frutave "Kop.Frut" supozohej se e njëjta ndërtesë ndodhej në Hanover Gjermani, ku u përllorarit prodhimi i energjisë dhe periudha e shlyerjes së kostos fillestare. Sipas simulimit në Gjermani, prodhohej 76,768 kWh/Vit, pra krahasuar kjo me Shqipërinë vërehet se në Gjermani prodhohet rreth 1.5 herë më pak energji për të njejtën fuqi të instaluar. Kostoja e instalimit të sistemit diellor është 162.000 \$, e cila nga përlloraritjet rezultojnë se për të njëjtën shumë parash të investuar në Hanover, Gjermani dhe Peshkopi, Shqipëri periudha e shlyerjes është e ndryshme. Rezultatet tregojnë se kostoja fillestare e investimit shlyhet pas 7, 8 vitesh në Shqipëri dhe pas 9, 7 vitesh në Gjermani. Faktorët që kanë ndikuar në këto rezultate janë rrezatimi diellor dhe faktori i klimës i ndryshëm për vendet e marra në studim.

Abstract:

Industry is responsible for about a third of the world's total energy consumption and global energy demand is growing due to industrial activity and technological advances in developing and developed countries. In this study, the focus was on the use of solar energy to supply electricity to the "Kop. Frut" fruit juice processing plant. The factory performs processes such as sorting, washing, drying, pressing/squeezing, pasteurization, cooling, storage and packaging. These processes consume a significant amount of energy in this plant. The main objective of this study was to examine the energy supply for the processes in the production of fruit juice through photovoltaic panels and to assess the economic benefit through this investment. For this purpose, the study data were obtained from the fruit juice processing factory "Kop. Frut", which is located in Albania in the district of Dibra. The factory consumes about 10,000 kWh of electricity every month for the period October - March, which coincides with the harvesting of the fruits used for fruit juice production. Since in the other months of the year in the factory there is not much consumption, the annual consumption is about 75,000 kWh. A photovoltaic system will be installed on the flat roof of the factory building about 1000 m². The maximum number of modules for this surface will be 360 pieces, where the modules are with power 300 W, the total installed power is 108 kWp. This system was simulated through PvSol software, from the results obtained it resulted that 117,762 kWh of energy will be produced per year, on an annual basis the factory consumes about 75,000 kWh so it seems that the annual energy produced meets the factory requirements with energy, but if we notice monthly basis monthly energy products do not fully meet the requirements of the power plant. Respectively in October it is forecasted to produce 4076.1 kWh, in November 2020 kWh, in December 1536.9 kWh, in January 1699.3 kWh, in February 2210.1 kWh, in March 8395 kWh. Given that in this period the energy consumed is about 10,000 kWh per month, it turns out that the energy produced does not meet all the requirements of the factory with electricity, generally during the autumn and winter months where the energy requirements in the factory are high, so a strategy will be needed to combine electricity from the OSHEE grid (Electricity Distribution Operator) and energy produced by the panels, or to meet these requirements looks promising in the future the installation of an Agrivoltaic system which can be placed on orchards. The data obtained from the Fruit Company "Kop. Frut" assumed that the same building was located in Hanover Germany, where the energy production and the period of repayment of the initial cost were calculated. According to the simulation in Germany, 76,768 kWh/Year was produced, so compared to Albania it is noticed that in Germany is produced about 1.5 times less energy for the same installed power. The cost of installing the solar system is \$ 162,000, which from the calculations shows that for the same amount of money invested in Hanover, Germany and Peshkopi, Albania the payback period is different. The results show

that the initial investment cost returns after 7, 8 years in Albania and after 9, 7 years in Germany. Factors that have influenced these results are solar radiation and different climatic factors for the countries taken in the study.

Vleresimi i ekosistemit pyje - kullota dhe impakti ne mjedis, Komuna Antigone, Gjirokaster.

The environmental assessment of the forest and pasture ecosystem in Antigone administrative unit, Gjirokaster.

KLEVIS DAJLANI
Universiteti Bujqesor i Tiranes
Tiranë, ALBANIA
klevis.dajlani@yahoo.com

LIRI MIHO
Universiteti Bujqesor i Tiranes
Tiranë, ALBANIA
liri-miho@hotmail.com

ARDIAN MACI
Universiteti Bujqesor i Tiranes
Tiranë, ALBANIA
amaci@ubt.edu.al

Fjalë çelës: vleresimi mjedisor, ekosistem, pyje, kullota

Keywords: environmental assessment, ecosystem, forest, pasture

Përmbledhja:

Në vitet e fundit, një nga çështjet kryesore në vendin tonë mbetet vlerësimi i ekosistemeve dhe menaxhimi i burimeve natyrore, veçanërisht ai i pyjeve dhe kullotave. Zona ne studim njësia administrative Antigone ka si drejtim kryesor zhvillimin e blegtorise, kjo lidhet ngushtë me kullotat te cilat disponon kjo zone si dhe zonat e saj pyjore, rreth 84% e sipërfaqes totale të kësaj njësie administrative është e zënë nga pyjet dhe kullotat. Bazuar në drejtimin kryesor ekonomik të kësaj njësie administrative (blegtozia) ne e konsiderojmë të nevojshme kryerjen e një vlerësim mjedisor të ekosistemit pyje-kullotë dhe ndikimin e tyre në mjedis. Qëllimi i studimit tonë është që të marrim një analizë dhe njohuri më të mirë të ekosistemit pyjor dhe kullor në këtë njësi administrative. Vlerësimi mjedisor çon në një njohuri më të mirë të ruajtjes së ekuilibrave mjedisorë dhe drejtimit ekonomik të njësisë administrative Antigone. Kjo gjithashtu çon në një përmirësim të mundshëm të gjendjes së burimeve natyrore, të tilla si pyjet dhe kullotat dhe përdorimin e tyre ne menyre të integruar. Metoda e punës për mbledhjen e të dhënave nga zona e studimit u bë përmes pyetësorëve drejtuar banorëve të zonës dhe institucioneve shtetërore të mjedisit. Si dhe rishikimi i disa projekteve ekzistuese në lidhje me zonën si dhe një vlerësim aktual në terren i këtyre ekosistemeve. Rezultatet e studimit tregojnë se në përgjithësi kullotat dhe pyjet e njësisë administrative Antigone nuk plotësojnë të gjitha nevojat ushqyese të bagëtive. Nga llogaritjet e bëra, rezulton se pyjet dhe kullotat e njësisë administrative ofrojnë rreth 30% të nevojave vjetore për bazë ushqimore të bagëtisë. Bazuar në këto të dhëna, duhet theksuar se për numrin e bagëtive që mbarështrihen nga fermerët për vetë potencialin prodhues të burimeve natyrore të zonës, duhet të sigurojnë burime të tjera për ushqimin e blegtorise, në mënyrë që të mos dëmtohen pyjet dhe kullotat e njësisë administrative Antigone. Zakonisht kullotja e bagëtive bëhet në gjendje të lirë. Ky konsiderohet si faktor negativ për arsye, sepse shoqërohet me disa probleme, siç janë: kullotja disa herë brenda së njëjtës zonë duke mos lejuar ripërteritjen e barit dhe dëmtimin e sipërfaqes së tokës, etj. Kjo është një arsye që zvogëlon produktivitetin e kullotave duke mos përmbushur nevojat e mjaftueshme për mbarështrim. Njësi administrative Antigone është e dominuar nga kullotat dimërore. Këto kullota dimërore u krijuan si rezultat i shpyllëzimit të terrenit kodrinor gjatë kohës së monizmit. Për hir të zhvillimit të bimesise

polifite gjatë kohës së monizmit u shpyllëzuan kodrat, pasojat e të cilës vazhdojnë ndihen dhe në ditët e sotme duke ndikuar në raportin biomase-rendiment, gjithashtu dhe efekte të tjera negative si: renia e pjellorise se tokës, rritja erozionit, shpëlarja e elementeve ushqyese të tokës etj. Rëndësia e ekosistemit pyje-kullota dhe rreziqet që i kërcënojnë janë gjithmonë domosdoshmëri vlerësimi për gjendjen mjedisore të ekosistemeve. Shumë probleme shpesh nuk vihen re menjëherë, por kur ato bëhen të dukshme e të matshme koha që do të duhet për rikuperimin e dëmit do të jetë edhe më e gjatë. Ndaj është e rëndësishme vlerësimi i vazhdueshëm i këtyre ekosistemeve, duke i marrë në konsideratë dhe në harmoni të pandashme cilësinë e habitateve me biodiversitetin e tyre.

Abstract:

In recent years, one of the major issues in our country remains the assessment of ecosystems and the management of natural resources, especially that of forests and pastures. Antigone administrative unit has as its primary direction the development of livestock, this is closely related to the available pastures and its forest areas, about 84% of the total area of this administrative unit is occupied by forests and pastures. Based on the main economic direction of this administrative unit (livestock) we consider it necessary to carry out an environmental assessment of the forest-pasture ecosystem and their impact on the environment. The purpose of our study is to get better analysis and knowledge of the forest and pasture ecosystem in this administrative unit. The environmental assessment leads to a better knowledge of the preservation of environmental balances and the economic direction of the Antigone administrative unit. This also leads to a possible improvement of the state of natural resources, such as forests and pastures and their integrated use. The working method for collecting data from the study area was done through questionnaires addressed to the residents of the area and state environmental institutions. As well as review of some existing projects related to the area and a current field assessment of these ecosystems. The results show that in general the pastures and forests of the Antigone administrative unit do not meet all the nutritional needs of the livestock. From the calculations made, it results that the forests and pastures of the administrative unit provide about 30% of the annual needs for food base of livestock. Based on these data, it should be noted that for the number of livestock raised by farmers for the production potential of the area's natural resources, they must provide other sources for livestock feed, so as not to damage the forests and pastures of the Antigone administrative unit. Usually the grazing of livestock is done in free condition, this is considered a negative factor for reasons because it is associated with some problems such as: grazing several times within the same area not allowing the renewal of grass and damage to the soil surface, etc. This is a reason which reduces the productivity of pastures by not meeting sufficient needs for foliar breeding. The Antigone administrative unit is dominated by winter pastures. These winter pastures were created as a result of deforestation of hilly terrain during the time of monism. For the sake of the development of polyphytic vegetation during the time of monism the hills were deforested, the consequences of which are still felt today affecting the biomass-yield ratio, as well as other negative effects such as: increased erosion, soil erosion, etc. The importance of the Forest-Pasture ecosystem and the risks that threaten it are always a necessity to assess the environmental condition of ecosystems. Many problems are often not noticed immediately, but when they become visible and measurable the time it will take to repair the damage will be even longer. It is therefore important to continuously assess these ecosystems.

Abstracts

Conference of Environmental Sciences section


The Sixteenth International Annual Meeting of Alb-Science Institute
Shkup, 01 - 03 October 2021

Të gjitha përmbledhjet e këtij dokumenti janë regjistruar në sistemin **ALPA**® nga vetë autorët e tyre. Rrjedhimisht, ndonjë gabim i mundshëm drejtshkrimor apo tjetër në përmbledhje dhe informacionin përkatës është i autorit apo autores përkatëse.

Të drejten për kopjimin dhe shumëfishimin e përmbledhjeve në këtë dokument e ruan ekskluzivisht Instituti Alb-Shkenca (IASH): www.alb-shkenca.org

Gjeneruar më 10 Tetor 2021.

Ky dokument është gjeneruar në mënyrë automatike nga sistemi **ALPA**®.



ALPA - *Albanian Papers*
mali Information Technologies
<http://alpa.mali-it.eu>

MASKAT - NDIKIMI I TYRE NË MJEDIS

MASKS - THEIR IMPACT ON THE ENVIRONMENT

FLORIJE TAHIRI

MMPHI

Prishtinë, KOSOVA

floravk@gmail.com

Fjalë çelës: maska, pandemi, ndotje, mjedis, OBSH.

Keywords: masks, pandemic, pollution, environment, WHO.

Përmbledhja:

Si të gjitha vendet e botës edhe vendi ynë është prekur nga Pandemia Covid -19, e njohur gjithashtu si pandemia e koronavirusit, e shkaktuar nga sindroma e rëndë akute e frymëmarrjes koronavirus 2 (SARS-CoV-2). Virusi u identifikua për herë të parë në dhjetor 2019, në Wuhan-Kinë dhe prej 11 Marsit të vitit 2020, OBSH e deklaroi sëmundjen Pandemi. Virusi me lehtësi shpërndahej, duke prekur mbi 184 milion raste të konfirmuara dhe 3.99 milion vdekje të konfirmuara, atakonte te dy gjinitë dhe të gjitha moshat duke shkaktuar probleme të shumëta shëndetësore deri në vdekje. Nga OBSH një ndër masat parandaluese dhe të domosdoshme për t'u mbrojtur nga përhapja e virusit në ajër përmes teshtitjes, kollitjes ose spërklave, ishte bartja e maskave, duke mbuluar gojë dhe hundë edhe pse dyshohej se kishte edhe forma të tjera të përhapjes. Rekomandohej bartja e maskave mjekësore, por në pamundësi të sigurimit të tyre (pasiqë e tërë bota ishte e papërgatitur për një fluks të tillë të përhapjes), sepse kishte mungesë në treg dhe gjendja ekonomike e dobët e qytetarëve edhe në vendin tonë bëri që të përdoren edhe maska të punuara nga tekstili. Grupe interesi në hulumtim kanë qenë: profesionistët shëndetësor, qytetarët, shitësit me pakicë të maskave, ekspertët mjedisor dhe mbledhësit e mbeturinave. Fokus studimi kanë qenë komunat Prishtinë dhe Mitrovicë. Metoda e studimit ka qenë mbledhja e të dhënave, përmes intervistimit me pyetësor të grupeve të interesit dhe përpunimi i tyre. Janë konsultuar materiale dhe raporte mjedisore dhe shëndetësore. Të dhënat nga intervista janë analizuar, përpunuar me metoda statistikore, janë punuar diagrame janë krahasuar të dhënat. Nga rezultatet e studimit është gjetur, se me përhapjen e pandemisë edhe vendi ynë është prekur, duke varfëruar qytetarin tonë dhe njëherit duke ndotur mjedisin nga rritja e sasisë së mbeturinave në deponi legale dhe ilegale të mbeturinave. Pandemia ka bërë diskriminim racor, rajonal, shëndetësor, në nivel shtresash të qytetarëve (analizat, trajtimi, vaksinat) dhe atë ekonomik. Nuk ka pas qasje të drejtë në mes të urdhërave për kufizime të shëndetit publik dhe të drejtave individuale. Në mungesë të maskave mjekësore, çmimi i lartë i tyre, mundësia e përdorimit vetëm njëherë e tyre, denimet nga mosbartja e maskës, ka bërë që qytetarët të gjejnë një zgjidhje më ekonomike për ta, duke i përdorur maskat e tekstilit, të cilat kanë pas mundësi pastrimi dhe ripërdorimi (edhe pse nuk janë të rekomanduara për mbrojtje nga pandemia). Ka ekspert shëndetësor që thonë se maska mund të ketë edhe efekt të kundërt nëse nuk barten si duhet. Maskat sot janë edhe biznes, mund ti gjeshë kudo, nga më të ndryshmet deri te ato artizanale edhe pse çmimet ende janë të larta por tani janë më të arsyeshme se në fillim të pandemisë. Disa qytetarë janë të pakujdesshëm dhe maskat i hedhin edhe në rrugë ose afër objekteve shëndetësore, e shpesh ato përfundojnë edhe në lumenjë duke i ndotur ata. Numri i maskave të përodurra është shumë i madh, dhe pothuajse të gjitha hedhen me mbeturina shtëpiake në deponi për mbeturinat komunale. Përdorimi i numrit të madh të maskave, krijimi i sasisë së madhe të mbeturinave nga maskat, hedhja e tyre kudo në vende

jo adekuate, na tërheq vëmendjen dhe na detyron të mendojmë për një çasje të drejtë ndaj këtij problemi. Disa vende sot maskat i përdorin si material riciklues në fusha të ndryshme të industrisë, duke ndihmuar në mbrojtje të mjedisit dhe në ekonomi. Si zgjidhje në mbrojtjen e mjedisit nga ndotja prej maskave, do të ishte si pikënisje në mos përhapjen e pandemisë edhe vetëdijësimi i qytetarëve, se maska pas përdorimit, duhet trajtuar si objekt që ndot dhe duhet të hedhet në vend të veçantë. Sterilizimi i maskave mjekësore dhe riciklimi i tyre në materiale të nevojshme si material izolimi ose produkte të reja në ndërtimtari do të ishte i mundshëm. Ripërdorimi i maskave nga tekstili dhe riciklimi i tyre duke i shndërruar në ndonjë aksesor ose duke i kthyer në materiale përdoruese në industrinë e tekstitit si: mbushëse, thurëse, endjes së qilimave dhe produkte tjera të nevojshme do të ishin ndihmuese dhe kreative për këtë industri. Përdorimi i të dy metodave të fundit do të ishte zgjidhja më e mirë mjedisore dhe ekonomike për vendin tonë dhe vendet tjera.

Abstract:

Like all countries in the world, our country is affected by the Covid-19 Pandemic, also known as the coronavirus pandemic, caused by severe acute coronavirus 2 (SARS-CoV-2) respiratory syndrome. The virus was first identified in December 2019, in Wuhan-China and as of March 11, 2020, the WHO declared the disease Pandemic. The virus spread easily, affecting over 184 million confirmed cases and 3.99 million confirmed deaths, attacking both sexes and all ages causing numerous health problems up to death. From the WHO one of the preventive and necessary measures to protect against the spread of the virus in the air through sneezing, coughing or spraying, was the wearing of masks, covering the mouth and nose even though it was suspected that there were other forms of the spread. It was recommended to wear medical masks, but in the impossibility of providing them (since the whole world was unprepared for such an influx of spread), because there was a shortage in the market and the poor economic situation of citizens in our country made them use even textile masks. Stakeholders in the research were: health professionals, citizens, mask retailers, environmental experts and waste collectors. The focus of the study was the municipalities of Prishtina and Mitrovica. The method of the study was data collection, through interviewing stakeholders with a questionnaire and processing them. Environmental and health materials and reports were consulted. Data from the interview were analyzed, processed by statistical methods, diagrams were made and data were compared. From the results of the study it was found that with the spread of the pandemic our country is also affected, impoverishing our citizens and at the same time polluting the environment by increasing the amount of waste in legal and illegal landfills. The pandemic has discriminated racial, regional, health, at the level of citizens (analysis, treatment, vaccines) and economic. There has been no fair access between orders for restrictions on public health and individual rights. In the absence of medical masks, the high price, the possibility of using them only once, the penalties for not wearing the mask, has made citizens find a more economical solution for them, using textile masks, which have been cleaned and reused (although not recommended for pandemic protection.) There are health experts who say masks can have the opposite effect if not worn properly. Masks today are also a business, you can find them everywhere, from the most diverse to the artisan, although the prices are still high, but now they are more reasonable than at the beginning of the pandemic. Some citizens are careless and throw their masks on the street or near health facilities, and often they end up in the river polluting them. The number of masks used is very large, and almost all are thrown away with household waste in the municipal waste landfill. Using a large number of masks, creating a large amount of waste from the masks, throwing them everywhere in inadequate places, attracts our attention and forces us to think about a fair approach to this problem. Some countries today use masks as recycling material in various fields of industry, helping to protect the environment and the economy. As a solution to protect the environment from pollution from masks, it would be as a starting point in preventing the spread of the pandemic and the awareness of citizens

that masks after use, should be treated as an object that pollutes and should be thrown in a special place. Sterilization of medical masks and their recycling into necessary materials such as insulation material or new construction products would be possible. Reusing textile masks and recycling them into an accessory or turning them into materials used in the textile industry such as fillers, knitting, carpet weaving and other necessary products would be helpful and creative for this industry. Using the last two methods would be the best environmental and economic solution for our country and other countries.

Abstracts

Conference of Economical Sciences section


The Sixteenth International Annual Meeting of Alb-Science Institute
Shkup, 01 - 03 October 2021

Të gjitha përmbledhjet e këtij dokumenti janë regjistruar në sistemin **ALPA**® nga vetë autorët e tyre. Rrjedhimisht, ndonjë gabim i mundshëm drejtshkrimor apo tjetër në përmbledhje dhe informacionin përkatës është i autorit apo autores përkatëse.

Të drejten për kopjimin dhe shumëfishimin e përmbledhjeve në këtë dokument e ruan ekskluzivisht Instituti Alb-Shkenca (IASH): www.alb-shkenca.org

Gjeneruar më 10 Tetor 2021.

Ky dokument është gjeneruar në mënyrë automatike nga sistemi **ALPA**®.



ALPA - *Albanian Papers*
mali Information Technologies
<http://alpa.mali-it.eu>

Meta - Analizë: Pronësia e Aksioneve të Punonjësve dhe Kostoja e Kapitalit

A Meta - Analysis: Employee Stock Ownership and the Cost of Capital

FISNIK MORINA

Universiteti "Haxhi Zeka"

Pejë, KOSOVA

fisnik.morina@unhz.eu

Fjalë çelës: pronësia, aksionet, punonjësit, kapitali, kostoja, struktura.

Keywords: ownership, stock, employees, capital, cost, structure.

Përmbledhja:

Qëllimi i këtij studimi është të ofroj një qasje shpjeguese sa i përket raportit ndërmjet pronësisë së aksioneve të punonjësve dhe koston së kapitalit. Esenca qëndron në sqarimin e raportit midis këtyre dy variablave, përkatësisht çfarë indikacioni sjellë pronësia e aksioneve të punonjësve në koston e kapitalit të ndërmarrjeve. Pyetja kërkimore e këtij studimi është: “Përqindja më e lartë e aksioneve në pronësi të punonjësve, a ka ndikim rritës apo zvogëlues në koston e kapitalit të firmave?” Përveç pjesës shpjeguese-teorike të këtyre koncepteve në fjalë, në këtë studim është paraqitur një meta-analizë e bazuar në rishikime të punimeve nga autorë të ndryshëm të kësaj çështje. Bazuar në meta-analizën e bërë, ka rezultuar se sa më e lartë të jetë përqindja e aksioneve që janë në pronësi të punonjësve, në firma të caktuara, aq më e ulët është kostoja e kapitalit të atyre firmave. Pra, firmat apo ndërmarrjet duhet të zhvillojnë qasje të tillë që të angazhojnë punonjësit të marrin pjesë në pronësi të aksioneve, në një formë të bëhen bashkëpronarë në ndërmarrje. Kjo iu mundëson atyre që të marrin përgjegjësi në lidhje me çështjet më të rëndësishme me të cilat preokupohen ndërmarrjet dhe aksionerët e tyre. Qëllimi i këtij punimi është të jap një kuptim të korrelacionit midis pronësisë së aksioneve të punonjësve dhe koston së kapitalit, d.m.th. koston mesatare të ponderuar të kapitalit (WACC), e përbërë kjo nga kapitali neto dhe kostoja e borxhit. WACC është përcaktuesi kryesor i krijimit të vlerës së aksionerëve, i përdorur në llogaritjen e vlerës së shtuar ekonomike (EVA). EVA është matësi i performancës financiare dhe i kontabilitetit. Kërkimet mbi pronësinë e aksioneve të punonjësve (ESO - Employee Stock Ownership), gjatë viteve të fundit, janë përqendruar në ndikimin e kësaj politike organizative në bashkëpunimin e punonjësve dhe nivelin e performancës së firmës. Menaxhmenti, si dhe fuqia punëtore, duket se janë të interesuar në pronësinë e aksioneve të punonjësve për disa arsye: punonjësit që kursejnë mendohet të jenë më të besueshëm, punonjësit që zotërojnë aksione duhet të kuptojnë më mirë problemet e menaxhimit, humbja e materialeve mund të zvogëlohet, prodhimi mund të rritet dhe kapitali i shtuar mund të vihet në dispozicion. Sot, më shumë punonjës se kurrë më parë kanë aksione pronësie në firmat e tyre përmes Planeve të Pronësisë së Aksioneve të Punonjësve (ESOP - Employee Stock Ownership Plans) dhe planeve të pronësisë së aksioneve të bazuara në firma, marrin opsione aksionesh të kufizuara vetëm në drejtuesit e lartë dhe janë të mbuluar nga planet e ndarjes së fitimit. Pronësia e punonjësve është forma kryesore e kapitalizmit të përbashkët pasi që është një situatë në të cilën punonjësit zotërojnë një pjesë të kapitalit të firmës. Përmes skemave të pronësisë së aksioneve të punonjësve, punonjësit mund të rrisin pasurinë e tyre personale dhe janë më të lidhur me suksesin e firmës. Sidoqoftë, vendimi për zbatimin dhe zhvillimin e pronësisë së punonjësve shpesh i takon menaxhmentit. Dy motivime

kryesore qëndrojnë në themel të vendimit të menaxherëve për të promovuar pronësinë e aksioneve të punonjësve: stimulimi i punonjësve, duke rritur kështu performancën e korporatave; ose mbajtja e pozicionit të tyre për shkak të një tendence që pronarët e punonjësve të votojnë në favor të menaxhmentit në rastin e një kërcënimi të marrjes së pushtetit. Struktura e kapitalit të një kompanie ndërthuret me koston e kapitalit të kompanisë. Kostoja e kapitalit është kthimi që duhet të sigurohet për përdorimin e fondeve të një investitori. Nëse fondet janë huazuar, kostoja ka të bëjë me interesin që duhet të paguhet për kredi. Nëse fondet janë kapital, kostoja është kthimi që investitorët presin, si nga vlerësimi i çmimit të aksioneve ashtu edhe nga dividendët. Kostoja e kapitalit është një koncept marginal.

Abstract:

The purpose of this study is to provide an explanatory approach in terms of the correlation between employee stock ownership and cost of capital. The essence lies in clarifying the correlation between these two variables, namely what indication brings employee stock ownership in the cost of capital of enterprises. The research question of this study is: "Does the higher percentage of employee stock ownership have an increasing or decreasing impact on the cost of capital?" In addition to the explanatory-theoretical part of these concepts in question, in this study is presented a meta-analysis based on reviews of papers by various authors of this issue. Based on the meta-analysis made, it has resulted that the higher the percentage of employee stock ownership, in certain firms, the lower the cost of capital of those firms. So firms or enterprises must develop such an approach as to engage employees to participate in the ownership of stock, in some way to become co-owners in the enterprise. This enables them to take responsibility for the most important issues that concern companies and their shareholders. The purpose of this paper is to give an understanding of the correlation between employee stock ownership and the cost of capital, i.e. weighted average cost of capital (WACC), consisting of equity and the cost of debt. WACC is the main determinant of shareholder value creation, used in the calculation of economic value added (EVA). EVA is the measure of financial performance and accounting. Employee Stock Ownership (ESO) research in recent years has focused on the impact of this organizational policy on employee collaboration and the firm's level of performance. Management, as well as the workforce, appear to be interested in owning employee share for several reasons; employees with savings habit are thought to be more reliable, employees who own shares need to better understand management problems, material loss can be reduced, output can be increased and added capital can be made available. Today, more employees than ever before own shares in their firms through Employee Stock Ownership Plans (ESOP) and firm-based share ownership plans, take stock options once limited only in senior executives and are covered by profit-sharing plans. Employee ownership is the main form of joint capitalism as it is a situation in which employees own a portion of the firm's capital. Through employee stock ownership schemes, employees can increase their personal wealth and are more connected to the success of the firm. However, the decision to implement and develop employee ownership often rests with management. Two main motivations underlie managers' decision to promote employee share ownership: employee incentives, thus enhancing corporate performance; or maintaining their position due to a tendency for employee owners to vote in favor of management in the event of a threat of taking power. The capital structure of a company is intertwined with the cost of company capital. The cost of capital is the return that must be provided for the use of an investor's funds. If the funds are borrowed, the cost is related to the interest to be paid on the loan. If the funds are equity, the cost is the return investors expect, both from the stock price estimate and from dividends. The cost of capital is a marginal concept. This means that the cost of capital is the cost associated with raising one more dollar of capital.

Abstracts

Conference of Natural Sciences section


The Sixteenth International Annual Meeting of Alb-Science Institute
Shkup, 01 - 03 October 2021

Të gjitha përmbledhjet e këtij dokumenti janë regjistruar në sistemin **ALPA**[®] nga vetë autorët e tyre. Rrjedhimisht, ndonjë gabim i mundshëm drejtshkrimor apo tjetër në përmbledhje dhe informacionin përkatës është i autorit apo autores përkatëse.

Të drejten për kopjimin dhe shumëfishimin e përmbledhjeve në këtë dokument e ruan ekskluzivisht Instituti Alb-Shkenca (IASH): www.alb-shkenca.org

Gjeneruar më 10 Tetor 2021.

Ky dokument është gjeneruar në mënyrë automatike nga sistemi **ALPA**[®].



ALPA - *Albanian Papers*
mali Information Technologies
<http://alpa.mali-it.eu>

Vlerësimi i elementeve metalike në *Primula veris* L., Primulaceae në Kosovë

Evaluation of metallic elements in *Primula veris* L., Primulaceae in Kosovo

ARJANA YLLI

Departamenti i Bioteknologjise, Universiteti i

Tiranes

Tiranë, ALBANIA

arianaylli@gmail.com

LAURA BINXHIA

Departamenti i Bioteknologjise, Universiteti i

Tiranes

Tiranë, ALBANIA

laurabinxhija@yahoo.com

Fjalë çelës: *Primula veris*, bimë mjekësore, metale, tokë

Keywords: *Primula veris*, medicinal plants, metals, soil

Përmbledhja:

Bimët mjekësore janë shumë të përhapura në Kosovë. Kushtet klimatike dhe gjeografike i favorizojnë ata të kenë një cilësi të mirë dhe një zhvillim të madh. Prej vitesh *Primula veris* L., Primulaceae është e njohur si një bimë mjekuese për veprimet farmakologjike. Nga studimet e ndryshme rajonet më të pasura me bimë mjekësore dhe aromatike janë Malet e Sharrit, Alpet Shqiptare, rajonet e Kamenicës, Gollakut (pjesa lindore e Kosovës) dhe Mitrovica. *Primula veris* L., Primulaceae është një bimë shumëvjeçare me gjethe ovale dhe lule të verdha. Kjo bime është e përhapur në rajone të ndryshme të Kosovës, në zonat malore dhe kodrinore dhe në kullotat subalpine dhe alpine. *Primula veris* L. është njëra nga bimët aromatike dhe mjekësore më të rëndësishme që rritet në territorin e Kosovës. Për shkak të kërkesës në rritje të industrisë farmaceutike për këtë bimë kohët e fundit ka pasur një tendencë për të kaluar nga mbledhja e bimëve të egra në natyrë, në kultivimin e disa popullatave të primulaceve me rendiment të lartë në prodhimin e luleve dhe rrënjëve. Në këtë studim ne synojmë të vlerësojmë përmbajtjen e metaleve të rënda dhe shpërndarjen e tyre në rrënjë, gjethe dhe lule të *Primula veris*. Ne zgjodhëm dy zona të Kosovës si zona studimi, Novobërd - lokaliteti Artanë dhe lokaliteti Badovc - Graçanica, të njohura si zona të pastra mjedisore. Materialet e bimëve të *Primula veris* dhe tokat u mblodhën në këto dy zona të Kosovës gjatë dy viteve të njëpasnjëshme: 2015 dhe 2016. Gjatë monitorimit dyvjeçar ne kemi mbledhur dhe analizuar materialet bimore të popullatës së *Primula veris*. Grumbullimi i metaleve të rënda në bimë u mat në rrënjët, kërcell dhe gjethet dhe mostrat e luleve të marra nga përfaqësuesi i bimës i mbledhur në zonat e përzgjedhura. Përveç kësaj, ne kemi marrë mostra të tokës ku ishin rritur këto bimë. Bazuar në përdorimin specifik të kësaj bime nga industria farmaceutike, ne kemi analizuar pjesët vegetative siç janë rrënjët, kërcelli dhe gjethet dhe lulet e verdha. Ne i analizuam ato duke përdorur teknikën ICP-OES, sipas metodës EPA 6010C: 2007. Materialet bimore u analizuan për 6 elementë si Cd, Cu, Fe, Ni, Pb, Zn. Përmbajtja e elementeve në tokë u krahasua me nivelet e elementeve të rëndë në pjesë të ndryshme të bimëve *Primula veris*. Gjatë studimit të vitit 2015, në zonën e Badovcit, ndotja e Pb në tokë, gjethe dhe lule ishte përkatësisht 111.84 ppm, 2.86 ppm dhe 1.70 ppm, ndërsa në zonën e Novobërd - Artanë përmbajtja e Pb në tokë, gjethe dhe lule ishte respektivisht 520.34 ppm, 11.62 ppm dhe 0.79 ppm. E rëndësishme është që vetëm një përqindje e vogël e plumbit u transferua në lule, si pjesa kryesore e konsumueshme. Gjatë dy viteve të njëpasnjëshme të studimit 2015 dhe 2016 ne synuam të vëzhgojmë nëse situata e shpërndarjes së elementeve të rëndë në *Primula veris* do të mbetet e njëjtë për dy zonat e përzgjedhura. Nga të dhënat e marra gjatë vitit 2016

ne mund të rendisim grupet e ndryshme të elementeve të rëndë me përmbajtje më të lartë në rrënjët e *Primula veris* në zonën Novobërd - Artanë: Fe - 966.76 ppm, Zn - 59.48 ppm dhe Cu - 33.63 ppm, ndërsa në zonën e Badovcit: Fe - 686.47 ppm, Ni - 120.12 ppm, Pb - 28.17 ppm dhe Zn - 66.16 ppm. Në këtë mënyrë grupi i elementeve me përmbajtje të lartë mbetet i njëjtë gjatë 2015 dhe 2016. Për grupin e elementeve të rëndë si Fe, Cu dhe Zn ne kemi vërejtur një shpërndarje të barabartë të metaleve të rënda midis kërcellit dhe gjetheve dhe luleve. Përqendrimi i Cd ishte shumë i ulët në të dy zonat. Nivelet e ulëta të ndotjes së metaleve të rënda në lulet *Primula veris* janë shumë të rëndësishme për përdorim si bimë mjekësore.

Abstract:

Medical plants are very widespread in Kosovo. There are the climatic and geographical conditions that favor them to have a good quality and large development. For years it is well known as a medicinal plant for pharmacological actions. From different survey the richest regions with medicinal and aromatic plants are Sharri Mountains, Albanian Alps, regions of Kamenica, Goollak (eastern part of Kosovo) and Mitrovica. *Primula veris* L., Primulaceae is a perennial plant with oval leaves and yellow flowers. It is widespread in different regions of Kosovo, in mountainous and hilly areas and in subalpine and alpine pastures. *Primula veris* L. is one of the most important aromatic and medicinal plants grown in the territory of Kosovo. Due to the increasing demand of pharmaceutical industry for this plant recently there has been a tendency to switch from the collection of the wild plants in nature, to the cultivation of some cowslip populations with high yield in the production of flowers and roots. In this study we intend to evaluate the heavy metal contents and their distributions in roots, leaves and flowers of *Primula veris*. We had selected two areas of Kosovo as areas of study, Novobërd - Artanë locality and Badovc - Graçanica locality, known as clean environmental areas. *Primula veris* materials and soils were collected in these two areas of Kosovo during two consecutive years: 2015 and 2016. During two-year monitoring we had collected and analyzed plant materials of the population of *Primula veris*. Heavy metal accumulation in plants was measured in roots, stalks & leaves and flowers samples taken from the representative of the plant collected on each site. In addition, we had taken samples of the soil where these plants were grown. Based in specific use of this plant from pharmaceutical industry, we had analyzed vegetative parts such as roots, stems, stalks & leaves and yellow flowers. We analyzed them using ICP-OES technique, according to the EPA method 6010C: 2007. Plant materials were analyzed for 6 elements such as Cd, Cu, Fe, Ni, Pb, Zn. The element contents in soil were compared with levels of heavy elements in different parts of *Primula veris* plants. During 2015 survey, in Badovc area, Pb contamination in soil, leaves and flowers was 111.84 ppm, 2.86 ppm and 1.70 ppm respectively, whereas in Novobërd - Artanë area Pb content in soil, leaves and flowers was 520.34 ppm, 11.62 ppm and 0.79 ppm respectively. It is important that only a small percent of lead was transferred to flowers, as the main consumable part. During the two consecutive years 2015 and 2016 survey we intended to observe if the situation of heavy elements distribution in *Primula veris* will stay the same for the two separates selected areas. From the data obtained during 2016 we could list the different groups of heavy elements with highest content in roots of *Primula veris* in Novobërd - Artanë area: Fe - 966.76 ppm, Zn - 59.48 ppm and Cu - 33.63 ppm, while in Badovc area: Fe - 686.47 ppm, Ni - 120.12 ppm, Pb - 28.17 ppm and Zn - 66.16 ppm. In this way the group of elements with high content remain the same during 2015 and 2016. For the group of heavy elements as Fe, Cu and Zn we observed an equal distribution of heavy metals be between stalks & leaves and flowers. The Cd concentration was very low in the two areas. The low levels of heavy metal contamination in the *Primula veris* flowers are very important for the use as medicinal plants.

Vlerësimi i absorbimit të dritës nga karboni i zi në ajër për grimcat PM2.5 të mbledhura në rrethinat urbane të Tiranës

Enhanced Light Absorption of Black Carbon Aerosols in PM2.5 collected in Tirana urban outskirts

LOTAR KURTI

Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar,
Universiteti i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
lotar_09@yahoo.com

FOTION MITRUSHI

Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar,
Universiteti i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
fotionmitrushil10@gmail.com

FATOS YLLI

Instituti i Fizikes Berthamore te Zbatuar,
Universiteti i Tiranes
Tiranë, ALBANIA
fatosylli@yahoo.com

Fjalë çelës: Monitorimi i ajrit, PM2.5, karboni i zi.

Keywords: Air monitoring, PM2.5, Black Carbon,

Përmbledhja:

Aerosolet atmosferike përfshijnë aerosolin primar i cili emetohet në formë grimcash, dhe aerosolin sekondar i cili formohet nga lëndët e gazta përmes proceseve atmosferike. Aerosolet atmosferike shpesh ndikohen nga lëndët karbonike, të cilat përfshijnë karbonin organik dhe jo-organik. Pjesa e karbonit jo-organik është kryesisht nga burimet primare dhe zakonisht njihet si karboni elementar, ose karboni i zi. Aerosoli i karbonit të zi, i quajtur shpesh blözë, është forma më dominante e absorbimit të dritës nga aerosolet në atmosferë. Karboni i zi është emetuar nga proceset e djegies jo e plotë si njerëzore (qymyri, nafta, biokarburantet dhe djegiet e tjera të biomasës) dhe ato natyrore (psh, zjarret ne pyje). Aerosolet atmosferikë mund të ndikojnë në klimën e tokës dhe të luajnë një rol të rëndësishëm në rrezatimin atmosferik dhe ndryshimin e klimës. Aerosolet e karbonit të zi mund të absorbojnë në mënyrë efektive rrezatimin diellor në brezat e dukshëm dhe infra të kuqe për të ngrohur atmosferën dhe për të ndikuar në klimën dhe cilësinë e ajrit dhe për këtë arsye luajnë një rol unik dhe të rëndësishëm në sistemet klimatike. Në fakt aerosolet e karbonit të zi janë një kontribut të rëndësishëm në ngrohjen globale dhe janë bërë faktori i dytë kryesorë i ngrohjes pas CO₂. Ky punim paraqet rezultatet nga matjet e bëra në një stacion të vendosur në zonën urbane të Tiranës, të vendosur në veri të qytetit të Tiranës. Sistemi i monitorimit mostrave për PM2.5 dhe PM10 të mbledhura çdo 3 ditë janë pompat Sven Leckel. Filtrat e përdorur për të marrë PM2.5 janë PTFE (Polytetrafluoroethylene) me madhësi poresh 2 μm me një diametër 47 mm dhe një sipërfaqe ekspozimi prej 12.88 cm². Pompa ishte përditësuar për grumbullimin e PM2.5 me një normë konstate të rrjedhjes së ajrit 2.3 m³/h. Mbledhja e grimcave PM2.5 u bë në një periudhë kohore nga Shtatori 2020 deri në Qershor 2021 çdo tre ditë. Filtrat mbahen në desikator për një periudhë 24 orësh për të arritur ekuilibrin. Masa e grimcave PM2.5 llogaritet nga diferenca e filtrit të ngarkuar nga grimcat me filtrin e bardhë. Lidhur me vlerësimin e karbonit të zi është përdorur një pajisje portative me shumë gjatësi vale për absorbimin e karbonit të zi (Multi-ëavelength Absorption Black Carbon MABI) me gjatësi vale duke filluar nga 405 deri në 1050 nm. MABI është projektuar

dhe prodhuar nga ANSTO (Australian Nuclear Science and Technology) mat vlerat e I0 (trasmetimi matur i dritës përmes filtrit të pa ekspozuar, filtri bosh) dhe I (trasmetimi i matur i dritës përmes filtrit të ekspozuar, ngarkuar me grimcat PM2.5) për shtatë gjatësi vale të ndryshme të cilat përdoren për të përcaktuar koeficientin e absorbimit të dritës nga karboni i zi dhe përqëndrimet e karbonit të zi në secilën nga këto gjatësi vale. Ky instrument mat absorbimin e dritës së grimcave të karbonit të zi të depozituar në filtra në shtatë gjatësi vale (405, 465, 525, 639, 870, 940, 1050 nm). Njësia MABI nuk bën një llogaritje automatike të përqëndrimit të karbonit të zi në $\mu\text{g}/\text{m}^3$. Para se të llogaritim përqëndrimin e karbonit të zi duhet të llogaritim koeficientin e absorbimit të dritës për karbonin e zi. Nga monitorimi i vazhdueshëm u arrit në përfundimin se përqëndrimi më i lartë i grimcave PM2.5 është në periudhën e dimrit (Dhjetor 2020- Shkurt 2021) në të cilin përqëndrimi arrin vlera nga $18 \mu\text{g}/\text{m}^3$ në $36 \mu\text{g}/\text{m}^3$. Kjo është për shkak të përdorimit të lartë të biomasës dhe drurit për ngrohje. Matjet për karbonin e zi për gjatësinë ve valës 639 nm përqëndrimi i karbonit të zi arrit vlerën $3 \mu\text{g}/\text{m}^3$ në $4 \mu\text{g}/\text{m}^3$, krahasuar me vlerat e marra gjatë Shtator-Tetor 2020 vlerat e të cilit luhaten në intervalin $1 \mu\text{g}/\text{m}^3$ deri në $2 \mu\text{g}/\text{m}^3$. Përsa i përket gjatësisë së valës 940 nm përqëndrimi i karbonit të zi luhetet nga $2.5 \mu\text{g}/\text{m}^3$ deri në $2.9 \mu\text{g}/\text{m}^3$ në krahasim me përqëndrimin gjatë periudhës Shtator-Tetor 2020 vlerat e të cilit luhaten në intervalin $1.7 \mu\text{g}/\text{m}^3$ deri në $1.9 \mu\text{g}/\text{m}^3$.

Abstract:

Atmospheric particulate matter (PM) includes the primary aerosol, which is emitted in particulate form, and the secondary aerosol, which is formed from gaseous species through atmospheric processing. Atmospheric particulate matter is frequently influenced by carbonaceous species, which include both organic and non-organic carbon. The non-organic carbon fraction is predominantly from primary sources and it is typically known as Elemental Carbon, or Black Carbon. Black carbon (BC) aerosol, often called soot, is the dominant form of light absorbing particulate matter in the atmosphere. BC is emitted by incomplete combustion processes, both human (coal, diesel fuels, biofuels and other biomass burnings) and natural (e.g., wildfire). Atmospheric aerosols can affect the earth's climate and play important roles in atmospheric radiation and climate change. Black Carbon aerosols can effectively absorb solar radiation in the visible and infrared bands to heat the atmosphere and affect the climate and air quality and therefore play a unique and important role in the climate systems. Actually, BC aerosols make an important contribution to global warming and have become the second major warming factor after CO₂. This paper presents the results from measurements done in a station located in Tirana urban area, located in North of Tirana city. The sample monitoring system for collected PM_{2.5} and PM₁₀ every 3 day were Sven Leckel pumps. The filters used to obtain PM_{2.5} were PTFE (Polytetrafluoroethylene) with pore size of $2 \mu\text{m}$ with a diameter of 47 mm and an exposure surface of 12.88 cm^2 . The pump had been updated for collection of PM_{2.5} with a constant airflow rate $2.3 \text{ m}^3 / \text{h}$. The collection of PM_{2.5} particles was done in a time period from September 2020 to June 2021 every three days. The filters are held in the desiccator for a period of 24 hours to achieve equilibrium. The mass of PM_{2.5} particles is calculated from the difference of the filter charged by the particles with the white filter. Related the Black Carbon evaluation was using a portable device Multi-wavelength Absorption Black Carbon Multi-wavelength Absorption Black Carbon (MABI) with wavelengths ranging from 405 to 1050 nm. MABI is designed and manufactured by ANSTO (Australian Nuclear Science and Technology) measures the values of I₀ (measured light transmission through exposed filter, blank filter) and I (measured light transmission through exposed filter, charged with PM_{2.5} particles, for seven different wavelengths which are necessary to show the coefficient of absorption of light by carbon black and the concentrations of carbon black in each of these wavelengths. This instrument measures the light absorption of black carbon particles deposited in filters at seven wavelengths (405, 465, 525, 639, 870, 940, 1050 nm). The MABI unit does not make an automatic calculation of the concentration of black

carbon in $\mu\text{g} / \text{m}^3$. Before calculating the concentration of black carbon, we need to calculate the light absorption coefficient. From the continuous monitoring it was concluded that the highest concentration of PM_{2.5} particles is in the winter period (December 2020 - February 2021) in which the concentration reaches values from $18 \mu\text{g}/\text{m}^3$ to $36 \mu\text{g}/\text{m}^3$. This is due to high usage of biomass and wood for heating. Measurements for Black Carbon for the wavelength 639 nm the concentration of BC reached the value from $3 \mu\text{g}/\text{m}^3$ to $4 \mu\text{g}/\text{m}^3$, compared to the values obtained during September - October 2020 which fluctuate in the range $1 \mu\text{g}/\text{m}^3$ to $2 \mu\text{g}/\text{m}^3$. Concerning the wavelength 940 nm the concentration of black carbon fluctuate from $2.5 \mu\text{g}/\text{m}^3$ to $2.9 \mu\text{g}/\text{m}^3$ compared to the concentration during September - October 2020, which fluctuate in the range $1.7 \mu\text{g}/\text{m}^3$ to $1.9 \mu\text{g}/\text{m}^3$.

Ndryshimet fiziko-kimike të vajit të farës së kungullit gjatë pjekjes së farës dhe ndikimi në stabilitetin e lipideve të vajit të farës së kungullit të pjekur

Physicochemical changes of pumpkin seed oil during seed roasting and impact in lipid stability of roasted pumpkin seed oil

FATOS REXHEPI

Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë
Mitrovicë, KOSOVA
fatos.rexhepi@umib.net

AZIZ BEHRAMI

Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë
Mitrovicë, KOSOVA
aziz.behrani@umib.net

Fjalë çelës: pjekja, Spektroskopia FTIR, stabiliteti oksidativ, lipids.

Keywords: roasted, FTIR Spectroscopy, oxidative stability, lipids.

Përmbledhja:

Farat e kungullit Cucurbita Pepo L. fara të kungullit pa lëvore të njohura si ari i gjelbër të cilat kultivohen kryesisht në Austrinë jugore por ato tash kjo kulturë është edhe në Kosovë. Këto fara të kungullit përdoren kryesisht për të përfituar vaj por procesi i pjekjes së tyre konsiderohet të jetë faza kryesore për ta përfituar vajin me shije dhe aromë karakteristike e cila buron nga komponimet e shumta që janë përfituar në procesin e pjekjes dhe të cilat përveç efekteve antioksiduese kanë edhe shumë efekte të tjera shëndetësore. Është konfirmuar se këto komponime burojnë si rezultat i reaksioneve të peroksidimit të lipideve, reaksioneve të Maillardit dhe Degradimi Strecker por akoma është e paqartë në cilën temperaturë cili nga reaksionet është dominues dhe si rrjedhojë cila temperaturë e saktë e pjekjes është më optimale për të përfituar produktin më të mirë. Stabiliteti oksidativ dhe karakteristikat përbërëse të vajit të farës së kungullit (VFK) u studiuan gjatë procesit të pjekjes nga 90-130°C. Përveç ndryshimeve kimike të vërejtura është përcjellur edhe stabiliteti i vajit para dhe pas procesit të pjekjes nga GC/MS dhe FTIR Spektroskopi FTIR. Parametrat fiziko-kimike si dendësia dhe numri jodik u rritën ndjeshëm gjatë pjekjes dhe maksimumi i tyre ishte për vajin e pjekur në temperatura nga 90-110°C. Gjithashtu mostrat e pjekura në këtë temperaturë kanë stabilitet më të lartë për të dy parametrat gjë që konfirmon rritjen e qëndrueshmërisë pas pjekjes. Përmbajtja relative e acideve yndyrore të pangopura (PUFA) u ul në 87.7%, dhe acidet yndyrore të ngopura (SFA) u rritën në 112.5% në mostrën e papjekur, pas trajtimit termik. Nga ana tjetër, pas pjekjes së mostrave veçanërisht në temperaturën 90 dhe 110°C, përmbajtja relative e poli të pangopura u ul në 95 %, dhe acidet e ngopura u rritën në 101.6 % pas trajtimit të tyre termik dhe kjo është dëshmi e një stabiliteti të rritur tek mostra që ka pjekje paraprake. Spektroskopia FTIR e aplikuar për grupet e ndryshme funksionale dhe raporti i intensitetit të disa grupeve vibruese kimike sigurojnë të kuptuarit e mekanizmit të ndryshimeve kimike të farës gjatë procesit të pjekjes dhe si rezultat identifikimi i komponimeve përgjegjëse për rritjen e qëndrueshmërisë termike të lipideve të vajit. Raporti i intenzitetit të frekuencave 3007/2853 (karakteristike e grupeve vibracionale =C-H dhe -CH₂-) dhe 3007/1747 (=C-H dhe C=O) është përdorur si indikator të oksidimit të lipideve për mostrat e përcjellura para dhe pas procesit të pjekjes tregon në cilat temperatura zhvillohet oksidimi i lipideve dhe më pas intensiteti i pikeve në frekuencat 2924, 2853 dhe 1745 janë përdorur si indikatorë të detektimit të reaksioneve Maillard. Raportet e njejta janë përdorur për përcjelljen e stabilitetit termik të vajit të përfituar duke bërë krahasimin ndërmjet mostrave të papjekura dhe ato të pjekura me ç'rast vaji i

përfituar nga mostrat me pjekje kanë treguar stabilitet të lipideve dukshëm më të lartë sidomos mostrat e pjekura në temperatura nga 90 deri 110°C në krahasim me mostrat e vajit të përfituara pa pjekje të farës së kungullit. Këto korrelacione konfirmojnë se spektroskopia FTIR është një metodë e thjeshtë, e shpejtë dhe shumë e dobishme për matjen e oksidimit të lipideve dhe mundësinë e identifikimit të reaksionit Maillard në ushqime me matricë komplekse por pa ndonjë trajtim të veçantë të mostres si psh., ekstraktimi ose ndonje derivatizim tjetër kimik.

Abstract:

Pumpkin seeds Cucurbita Pepo L. without shell known as green gold which are cultivated mainly in southern Austria but they now this crop is also in Kosovo. These pumpkin seeds are mainly used to obtain oil but their roasting process is considered to be the crucial step to obtain the oil with characteristic taste and aroma which stems from the many compounds that are obtained in the roasting process and which in addition to antioxidant effects have many other health effects as well. It has been confirmed that these compounds originate as a result of lipid peroxidation reactions, Maillard reactions and Strecker degradation but it is still unclear at which temperature exactly obtained oxidized compounds and which of the reactions is dominant at which temperature and consequently which exact roasting temperature is most optimal to obtain the better product. The oxidative stability and compositional characteristics of the pumpkin seed oil (PSO) were studied during roasting process from 90-130°C. Besides observe of chemical changes it was observed and oil stability before and after roasting process by GC/MS and FTIR Spectroscopy. The physicochemical parameters such as density and iodine value were significantly increased during roasting and their maximum was for oil roasted at temperatures from 90-110°C. Also samples roasted at this temperature has higher thermal stability for both parameters which confirms increasing stability after roasting process. The relative contents of polyunsaturated fatty acids (PUFAs) were decreased to 87.7%, and saturated fatty acids (SFAs) were increased to 112.5% in unroasted sample, after thermal treatment. On the other hand, after roasted samples especially at temperature 90 and 110°C, the relative contents of PUFAs were decreased to 95 %, and SFAs were increased to 101.6% after their thermal treatment and this is evidence of increased stability in the sample having pre-roasting. FTIR Spectroscopy applied for different functional groups and intensity ratio of some chemical vibrational groups provide to understand mechanism of chemical changes of seed during roasting process and as a results which of obtained compounds are responsible for increasing thermal stability of oil lipids. Frequency intensity ratio 3007/2853 (characteristic of vibrational groups = CH and -CH₂-) and 3007/1747 (= C-H and C = O) was used as an indicator of lipid oxidation for samples taken before and after the roasting process shows at what temperatures lipid oxidation takes place and then the intensity of the points at frequencies 2924, 2853 and 1745 which are responsible for Maillard products and same are used as an indicator of Maillard product detection. The same ratios were used to monitor the thermal stability of the oil obtained by comparing the unroasted and roasted samples in which case the oil obtained from the roasted samples showed significantly higher lipid stability, especially the samples roasted in temperature from 90 to 110°C in comparison with oil samples obtained without roasting pumpkin seeds. These correlations confirm that FTIR spectroscopy is a simple, rapid and very useful method for measuring lipid oxidation and possibility of detection of Maillard reaction in complex matrix of foods samples without any special sample treatment such as extraction or other chemical derivatization.

Abstracts

Conference of Medical Sciences section


The Sixteenth International Annual Meeting of Alb-Science Institute
Shkup, 01 - 03 October 2021

Të gjitha përmbledhjet e këtij dokumenti janë regjistruar në sistemin **ALPA**[®] nga vetë autorët e tyre. Rrjedhimisht, ndonjë gabim i mundshëm drejtshkrimor apo tjetër në përmbledhje dhe informacionin përkatës është i autorit apo autores përkatëse.

Të drejten për kopjimin dhe shumëfishimin e përmbledhjeve në këtë dokument e ruan ekskluzivisht Instituti Alb-Shkenca (IASH): www.alb-shkenca.org

Gjeneruar më 10 Tetor 2021.

Ky dokument është gjeneruar në mënyrë automatike nga sistemi **ALPA**[®].



ALPA - *Albanian Papers*
mali Information Technologies
<http://alpa.mali-it.eu>

Impakti psikoemocional që shkaktoi pandemia e Covid-19 tek studentët e infermierisë

The psycho-emotional impact that caused the Covid-19 pandemic on nursing students

VALBONA ALLIU

Fakulteti Shkencave Mjekesore Teknike
Tiranë, ALBANIA
alliu.valbona@yahoo.com

ALKETA QOSJA (HOXHA)

Fakulteti i Mjeksisë
Tiranë, ALBANIA
hoxhaalketa@yahoo.com

RUDINA PIRUSHI

Fakulteti Shkencave Mjekesore Teknike
Tiranë, ALBANIA
pirushirudi@yahoo.com

Fjalë çelës: mësimi online, pandemi, stres, ulja e motivimit,

Keywords: online learning, pandemic, stress, reduced motivation,

Përmbledhja:

Hyrje Masat parandaluese kundër përhapjes së COVID-19, siç është kryerja e mësimin në format online ka ndikuar në arsimin e lartë në të gjithë botën. Sistemi universitar në vendin tonë i është nënshtruar disa sfidave dhe ndërprerjeve të mësimin në auditore siç ishin greva e studentëve- 2019, tërmeti i fundvitit 2019-të dhe pandemia nga Covid-19-të, nga marsi 2020 e në vazhdim. Efekti i kësaj karantine është më i keq për shëndetin mendor dhe lumturinë e një studenti, ai/ajo nuk është në gjendje të takojë miqtë e tij/saj dhe të shijojë atë që ata bënin në ditët e para pandemisë nga COVID-19. Mundësitë e mëdha që ata kishin në përdorim në jetën e tyre të përditshme tani janë bllokuar. Ne po vazhdojmë studimin me ndihmën e platformave të ndryshme dixhitale të mësimin, por a po i plotësojmë në të vërtetë nevojat e tyre?

Qëllimi i studimit Ky studim eksploron ankthin dhe stresin e perceptuar dhe heton qëndrimet e studentëve ndaj të mësuarit online, duke përfshirë aftësitë e studimit dhe jetën studentore.

Metodologjia Studimi është i tipit hulumtues, i kryer online, me studentët e degës Infermieri, viti i parë, Bachelor. Pyetësori u është dërguar të gjithë studentëve të vitit të parë, por është plotësuar nga 56 prej tyre. Pyetësorët kanë përmbajtur pyetje të lidhura me shëndetin mendor të studentëve, aftësitë e tyre në përdorimin e pajisjeve elektronike, shqetësimet e tyre të lidhura me jetën sociale, sjellja dhe mundësitë tyre në pandemi dhe marrëdhëniet me profesorët e tyre. Këto pyetësorë janë analizuar nga ana statistikore dhe kanë dalë rezultatet e mëposhtme.

Rezultatet Pyetësorit ju përgjigjen 56-të studentë që ndjekin studimet Bachelor, ku shumica ishin femra, 91% e tyre. Nga analizimi i përgjigjeve rezultoi që shumica e studentëve (64.7%) nuk ishin dakord se mësimi online mund të zbatohet lehtë. 54% e studentëve ranë dakord se bashkëbisedimi dhe diskutimi është shumë i vështirë për tu arritur me anë të mësimin online. Vetëm 21% ranë dakord që mësimi online mund të përdoret për aspektet klinike. 82% e studentëve mendojnë që ndërprerja e mësimin si rezultat i pandemisë ka ndikuar në aftësitë e tyre për të vazhduar studimin online, ndërsa 45% e tyre janë përgjigjur se aftësia e tyre dëgjuese është ulur gjatë mësimdhënies online. Rreth 55% e studentëve mendojnë se janë të aftë të përballen me situatën dhe ta pranojnë atë pasi 62.5% e tyre kanë burimet e nevojshme dhe ndihmën për të studiuar online në këtë periudhë pandemie. Rreth 52% e studentëve mendojnë se studimi online është shumë stresues dhe ajo që është surprizuese (jo për mirë) është fakti

që rreth gjysma e tyre e konsiderojnë komunikimin me miqtë dhe profesorët e shkollës stresues. Rreth 38% e studentëve konsiderojnë si problemin më të madh gjatë studimit online, përfundimin e detyrave dhe kushtimin e vëmendjes dhe 40% e tyre ndihen shumë të stresuar nga mungesa e aktiviteteve fizike, mësimet online, frika e të humburit të një personi të dashur, problemet financiare dhe nga dëshira që kanë për rikthimin e jetës normale si më parë. Pothuajse të gjithë studentët dëshirojnë që të kthehen sërish në auditore dhe të fillojnë kryerjen e praktikave.

Konkluzione dhe diskutime Në këtë studim, ne vumë re se shumica e studentëve të infermierisë kishin akses ndaj pajisjeve elektronike dhe ishin në gjendje t'i përdorin ato. Ne gjithashtu vërejtëm se studentët e infermierisë shfaqën nivele të ndryshme të njohurive, qëndrimeve dhe praktikave në lidhje me mësimin online. Studentët zbuluan se angazhimi në mësimin online u mundësoi atyre që të largonin vëmendjen nga pandemia, ndërsa mbështetja emocionale nga mësimdhënësit ua lehtësoi atyre që të përballeshin me këtë periudhë. Ky studim kishte për qëllim të vlerësonte rrethanat e studentëve të infermierisë gjatë pandemisë COVID-19, dhe të vlerësonte njohuritë, qëndrimet dhe praktikatat e tyre në lidhje me mësimin elektronik, i cili u propozua si një platformë për ofrimin e edukimit mjekësor gjatë karantinës. Një nivel i lartë ankthi dhe depresioni u gjet në mesin e studentëve të infermierisë. Sidoqoftë, mungesa e vëmendjes dhe e përqendrimit, ulja e motivimit për të ndjekur leksionet dhe për të mësuar, hapësira e kufizuar në shtëpi, shpërqendrimi nga familja dhe marrja e detyrave të shumta teorike dhe moskryerja e praktikës gjatë periudhës së pandemisë ishin sfidat kryesore me të cilat përballen studentët nga mësimi online.

Abstract:

Introduction Preventive measures against the use of COVID-19, such as relocation and online learning, have affected higher education worldwide. The university system in our country has been subjected to several challenges and interruptions of teaching in auditoriums such as the student strike-2019, the earthquake incident-2019 and the pandemic of Covid-19, from March 2020 onwards. The effect of this quarantine is worse for a student's mental health and happiness because the students can't enjoy what they used to do in the pre-COVID days. The great potential they used in their daily lives is now blocked, we are continuing to study with the help of various digital learning platforms, but are we really being successful in satisfying their needs?

Aim This study explores perceived anxiety and stress and investigates student attitudes toward online teaching, enhancing study and student life skills.

Methodology The study is of a research type, conducted online, with students of Nursing branches, first year, Bachelor. The questionnaire was sent to all freshmen but was plotted by only 56 of them. The questionnaires contained questions about the students' mental health, their skills in operating an electronic device, their concerns and their social life and their relationships with their professors. Questionnaires have been statistically analysed and their results have been published.

Results The questionnaire was answered by 56 students attending Bachelor studies, where the majority were female, 91% of them. From the analysis of the answers it resulted that the majority of students (64.7%) did not agree that online learning could be easily implemented. 54% of students agreed that conversation and discussion is very difficult to be achieved through online learning. Only 21% agreed that learning online can be used for clinical aspects. 82% of students think that the interrupting as a result of the pandemic has affected their ability to continue studying online, while 45% of them responded that their hearing ability has decreased during online lessons. About 55% of students think they are capable of dealing with the situation and accepting it and 62.5% of them have the necessary resources and help to study online during this pandemic period. About 52% of students think online study is very stressful and what is surprising (not for good) is the fact that about half of the students consider the communication with friends and the school professors as being very stressful. About 38% of students understand as the biggest problem when studying online, completing tasks and requests and 40% of them agree that they have been stressed by lack of physical activity, online lessons, fear of losing a

loved one, financial problems and from the desire that they have for the return to their normal life as before. All the students want to go back to the auditoriums to continue their lessons as before because they are much more proficient.

Conclusions In this study, it turned out most medical students had access to electronic devices and were able to use them. We also found that students displayed different levels of knowledge, attitudes and practices related to online learning. The students realised that the engagement in online learning was able to relieve them of their stress and the emotional support from their professors was able to help them out. This study aimed to assess the circumstances of nursing students during the COVID-19 pandemic and to assess their knowledge, attitudes and practices regarding e-learning and which proposed a platform for providing medical education during the quarantine. A high level of anxiety and depression was found among nursing students. Finally, lack of performance and concentration, decreased motivation to follow the lessons and learn, limited space at home, disturbance by the family and the taking on of multiple tasks and lack of practices during the pandemic period were the main challenges which students were faced with during online learning.

TE DHENA EPIDEMIOLOGJIKE TE INTERVENTEVE KIRURGIKALE PLASTIKE NE REGJIONIN E KOKE-QAFES

EPIDEMIOLOGICAL DATA OF PLASTIC SURGERY INTERVENTIONS IN THE HEAD-NECK REGION

BESNIK FASKAJ

Universiteti i Mjekesise, Tirane

Tiranë, ALBANIA

piet_amy@yahoo.com

Fjalë çelës: Regjioni i Koke qafes , Djegie, Trauma,

Keywords: Head and neck region, Burn, Trauma

Përmbledhja:

HYRJE Regjioni i koke-qafes është regjioni me kritik në trupin e njeriut ku vendosen të gjitha shqisat dhe ku rezultatet e nderhyrjeve kirurgjikale performojnë pamjen e jashtme vizive të personit me të cilën ai prezantohet dhe kryen aktivitetet e tij të përditshme në shoqërinë civile. Nga ana tjetër është një regjion ku kryhen një gamë e gjërë ndërhyrësesh plastike me qëllim restaurimin e regjioneve të prekura duke patur si objeksion rekonstrukcionin e çdo shtrese anatomike deri në mbylljen e perfundimtare të lekures me transplant ose me lembo. Në çdo qendër djegieje në bote pacientet që mund të trajtohen aty, ndahen në tre prioritete. Prioriteti I parë përfshin trajtimin e pacientëve të djegur, demtimi termik I të cilëve përcaktohet sipas protokolleve nga American Burn Association si dhe nga kriteret e çdo vendi. Pacientet e prioritetit të parë janë pacientë me : Djegie të rënda, Demtimet elektrikë, Djegie respiratore, djegie në fëmijë, në të moshuar, në pacientë me sëmundje shoqërore dhe Toxic Epidermal necrolysis. Pacientet e përfshirë në prioritetin e dytë janë pacientë të cilët kanë trauma multiple ose penetruese, demtime maksilo-faciale si dhe rekonstrukcion pas traumës I regjioneve kritike Pacientet e përfshirë në prioritetin e tretë janë kirurgjia rekonstruktive me aplikimin e lembove, kirurgjia kranio-faciale dhe kirurgjia të tjera plastike për trajtimin e defekteve dhe tumorëve të indeve të buta.

QELLIMI Studimi i të gjitha rasteve me patologji të lokalizuara në regjionin e koke-qafes që kërkojnë trajtim kirurgjikal plastik gjatë periudhës 2010-2019 në Sherbimin e Djegie-Plastikes, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tirane.

REZULTATET Aktiviteti kirurgjikal I Sherbimit të Djegie-Plastikes ka konsistuar në kryerjen e 12633 ndërhyrësesh në total me një mesatare 1263.3 ± 313.1 ndërhyrësesh në vit. Ndërhyrësit e kryerë në regjionin e koke -qafes ($n=5561$) përbëhen nga : ndërhyrësit për djegien dhe traumën, për pasojat e djegieve, për patologjitë e lindura, tumorët beninjë, tumorët malinjë dhe ndërhyrësit estetikë. Djegiet në regjionin e kokës që mund të përfshijnë edhe trupin ose jo kanë qenë 520 raste ose 34.3% e djegieve të rënda. Moshë mesatare e pacientëve me djegie që përfshijnë koken ka qenë 29.3 ± 25.9 vjeç , mediana ishte 26 vjeç, me minimum 1 vjeç dhe maksimum 91 vjeç. Përse I përket grup-moshës një numër I konsiderueshëm 205 raste (%) ishin fëmijë deri 10 vjeç, me pas rastet ndjekin një shpërndarje normale ku me shumë janë rastet e grup-moshës 40-69 vjeç Raporti M:F ishte 1.88:1, pra një predominancë e seksit mashkull. Rastet e operuara me diagnozë traumën e djegieve ishin 347 nga të cilat në rastet vetëm me djegie u krye nekrectomi dhe transplant në 295 ose 85% e tyre , ndërsa rastet vetëm me trauma ishin 52 ose 15 % e ndërhyrësesh për këto grupime patologjish. Raste të operuara me pasojat e djegieve kanë qenë 184 ku % me të madhe e zënë cikatrikset aurikulare, faciale , capitis, alopecia dhe me pas vijne cikatrixfrontal, labi, mikrooris, ektropion etj. Ndërhyrësi që është kryer me shumë ka qenë Ekcizim+

Suture ne 72% te rasteve (132 raste), Ekcizim + Lembo ne 15% te rasteve (28), Ekcizim + Transplant ne 7% ose 13 raste ndersa Skin Expander eshte vendosur ne 6% (10 raste) kryesisht ne paciente me diagnose Alopecia, (Cicatrix capitis ose Cikatrix temporal). Patologji te lindura kane qene 113 raste. Me te shpeshta kane qene Hemangiomat Faciale (28%), me pas Hemangioma Labi Inferior dhe Hemangioma Capitis (17% secila). Vendin kryesor te interventeve e zene rastet me Ekcizim+Suture ne 84%, me pas Ekcizim + Lembo ne 12% dhe me pak Ekcizim+ Transplant ne 4% te tyre. 1237 interverte jane kryer per tumoret beninje, 66 (5%) raste ishin me diagnozen Lipoma, 485 (39%) ishin Nevuse, 31 (3%) ishin Polipe, 19 (2%) ishin Fibroma, 585(47%) ishin Ciste, 45 (4%) ishin Hiperkeratoza dhe 6 raste (0.1%) ishin Ksantelazma. Raste te operuara me tumore malinje kane qene 3359 raste. Verehet se rastet me te shpeshta kane qene Ca Faciale (N=843), Ca Nazi (n=641), ndersa Ca Temporal, Auricular, Frontal, Capitis kane qene ne numur te perafert (rreth 300 raste) pasuar nga Ca Labi Inferior me 210 raste, ndersa ne pjeset e tjera kane qene ne numur me te pak. Gjate periudhes ne studim jane kryer tre lloj interventesh estetike: Otoplastika, Rhinoplastika dhe Blefaroplastika per diagnozat respective: Prominaureus, Gibus nazi dhe Ptosis Palpebralis. Interventet konsistojne ne Rhinoplastikat me 172 raste (62%), me pas Otoplastikat me 86 raste (31%) dhe ne fund renditen Blefaroplastikat me 19 raste ose 7% e totalit. Nuk jane kryer interverte te tjera estetike. PERFUNDIME Trajtimi kirurgjikal eshte pjesa kryesore e trajtimit kompleks te pacienteve me patologji ne regjionin e koke-qafes, por ajo duhet te kombinohet me trajtimet e tjera per te arritur permiresimin e cilesise se jetes te ketyre pacienteve.

Abstract:

INTRODUCTION The head-neck region is the most critical region in the human body where all the senses are located and where the results of surgical interventions perform the visual appearance of the person with whom he introduces himself and performs his daily activities in civil society. On the other hand, it is a region where a wide range of plastic interventions are performed having as object the reconstruction of each anatomical layer until the final closure of the skin with transplant or with lembo. In every burn center in the world, the patients who can be treated there are divided into three priorities. The first priority includes the treatment of burn patients, whose thermal damage is determined according to the protocols of the American Burn Association and the criteria of each country. The first priority patients are patients with: Severe burns, Electrical injuries, Respiratory burns, burns in children, in the elderly, in patients with concomitant diseases and Toxic Epidermal necrolysis. Patients included in the second priority are patients who have multiple or penetrating trauma, maxillofacial damage and post-trauma reconstruction of critical regions Patients included in the third priority are reconstructive surgery with the application of limbs, cranio-facial surgery and other plastic surgery for the treatment of defects and soft tissue tumors. **AIM** Study of all cases with pathologies localized in the head-neck region that require plastic surgery treatment during the period 2010-2019 in the Burn-Plastic Service, University Hospital Center "Mother Teresa", Tirana. **RESULTS** The surgical activity of the Burn and Plastic Service consisted of performing 12633 interventions in total with an average of 1263.3 ± 313.1 interventions per year. Interventions performed in the head-neck region (n = 5561) consist of: interventions for burns and trauma, for the consequences of burns, for congenital pathologies, benign tumors, malignant tumors and aesthetic interventions. Burns in the head region that may or may not involve the body have been 520 cases or 34.3% of severe burns. The mean age of patients with burns involving the head was 29.3 ± 25.9 years, the median was 26 years, with a minimum of 1 year and a maximum of 91 years. Regarding the age group, a considerable number of 205 cases (%) were children up to 10 years old, then the cases follow a normal distribution where there are more cases of the age group 40-69 years old. The ratio M: F was 1.88: 1, hence a predominance of male sex. Cases operated with a diagnosis of burn trauma were 347 of which in cases only with burns necrectomy and transplantation were performed in 295 or 85% of them, while cases with trauma alone were 52 or 15%

of interventions for this group of pathologies. Cases operated with the consequences of burns have been 184 where the largest% are occupied by auricular scars, facial, capitis, alopecia and then come scarffrontal, lab, microroris, ectropion etc. The intervention that was performed the most was Excision + Suture in 72% of cases (132 cases), Excision + Lembo in 15% of cases (28), Excision + Transplant in 7% or 13 cases while Skin Expander was placed in 6% (10 cases) mainly in patients diagnosed with Alopecia (Cicatrix capitis or Cikatrix temporal). Congenital pathologies were 113 cases. The most common were Facial Hemangiomas (28%), followed by Labi Hemangioma Inferior and Hemangioma Capitis (17% each). The main place of interventions is occupied by the cases with Excision + tSuture in 84%, then Excision + Lembo in 12% and less Excision + Transplant in 4% of them. 1237 interventions were performed for benign tumors, 66 (5%) cases were diagnosed with Lipoma, 485 (39%) were Nevus, 31 (3%) were Polyps, 19 (2%) were Fibroma, 585 (47%) were Cysts , 45 (4%) were Hyperkeratosis and 6 cases (0.1%) were Xanthelasma. Cases operated on malignant tumors were 3359 cases. It is noted that the most frequent cases were Ca Facial (N = 843), Ca Nazi (n = 641), while Ca Temporal, Auricular, Frontal, Capitis were in approximate number (about 300 cases) followed by Ca Labi Inferior with 210 cases, while in other parts they were in smaller numbers. During the study period, three types of aesthetic interventions were performed: Otoplasty, Rhinoplasty and Blepharoplasty for the respective diagnoses: Prominaureus, Gibus nazi and Ptosis Palpebralis. The interventions consist of Rhinoplasties with 172 cases (62%), then Otoplastics with 86 cases (31%) and finally Blepharoplasties with 19 cases or 7% of the total. No other aesthetic interventions were performed. CONCLUSIONS Surgical treatment is the main part of the complex treatment of patients with pathology in the head-neck region, but it must be combined with other treatments to achieve the improvement of the quality of life of these patients.

Zakonet e të ushqyerit dhe stili i të jetuarit tek adoleshentët në qytetin e Prishtinës

Dietary Habits and Lifestyle among Adolescents in the Pristina City

LAURA BINXHIJA QESKA
Nutrition and Phytotherapeutic Center
Prishtinë, KOSOVA
laurabinxhija@yahoo.com

Fjalë çelës: Fjalët kyçe: Adoloshenca, ushqimi, aktiviteti fizik

Keywords: Keywords: Adolescence, lifestyle, eating habits, physical activity

Përmbledhja:

Hyrje: Adoloshenca është moshë kur ndodhin ndryshime të mëdha fizike, psikologjike, sociale. Ushqimi dhe aktiviteti fizik luajnë rrol kyq në përkrahjen e këtyre proceseve. Sasia dhe kualiteti i ushqimit, shprehjet e të ushqyerit, aktiviteti fizik dhe gjumi i mirë determinojnë shëndetin tani dhe në të ardhmen si të rritur. Qëllimi: Ky studim ka për qëllim të shqyrtohen, analizohen shprehjet e të ushqyerit, qëndrimet, njohuritë për rëndësinë e ushqimit të shëndetshëm dhe stilit të jetuarit të shëndetshëm të adoleshentëve në qytetin e Prishtinës. Metoda: Mostra konsiston në 209 nxënës të moshave 12-15 vjeq ku prej tyre 54% meshkuj dhe 46% femra, 51% vijnë nga shkollat në pjesën periferike të Prishtinës dhe 49% vijnë nga shkollat e qytetit të Prishtinës. Pjesëmarrja e grupmoshave është proporcionale. Mbledhja e të dhënave është kryer duke përdorur një pyetësor anonim i cili përfshinte informacion të përgjithshëm në lidhje me të anketuarin, si dhe çështje që lidheshin me zakonet e të ushqyerit dhe stilit të jetës. Rezultatet: Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, përqindja e nxënësve nga qyteti ishte gjithsejtë 102 nxënës krahasuar me zonat rurale gjithsejtë 109 nxënës nga gjithësejtë 5 shkolla. Lidhur me kategoritë sipas Indeksit të masës trupore (IMT), pjesa më e madhe e nxënësve kanë peshë normale gjithsejtë 60%, rezultatet tona tregojnë për adoleshentët në qytet me ndërpeshe prej 24% dhe më e shprehur në zonat rurale me 32%. Me mbipeshë 12% dhe tek kategoria më e vogël rezultatet tregojnë 3% obezitet. Peshë mesatare e subjekteve ishte 56.6 kg dhe lartësia mesatare ishte 165 cm. Shpresëdhënësia del të jetë që 86% e nxënësve e konsiderojnë si shumë të rëndësishme të ushqehen shëndetshëm. Shumica e të anketuarve në sondazh konsumojnë tre vakte kryesore: 93% mëngjes, 97% drekë dhe 94% darkë. Sa i përket zamrave në bazë të rezultateve, 36% e të anketuarve marrin një zamër ose vakt të lehtë midis drekës dhe darkës, ndërsa 25% marrin zamrën midis mëngjesit dhe drekës, dhe 29% e tyre pas darkës. Sa i përket aktivitetit fizik 99% e të anketuarve mirren me aktivitet fizik, ushtrojnë të paktën një lloj sporti, 50% e të anketuarve luajnë futboll, (43%) mirren me vrapim, (36%) mirren me voleyboll, (35%) mirren me basketboll, (30%) me çiklizëm, (21%) kapërcimi i litarit dhe (20%) mirren me gjimnastikë. Orët mesatare të gjumit të subjekteve ishin 8.7 orë në ditë. Përfundime: Nga rezultatet e bazuara në përgjigjet e të anketuarve, vërehet se ata nuk kanë njohuri të mjaftueshme për ushqimin dhe një mënyrë jetese të shëndetshme. Shumica konsumojnë tre vakte kryesore dhe nuk i anashkalojnë vaktet, një pjesë e konsiderueshme nuk e di nëse ushqimi që ata po konsumojnë është i shëndetshëm. Vërehet gjithashtu një mbingarkesë ushqimi në pasdite ku darka konsumohet vonë dhe ushqimet me një përqindje më të lartë midis drekës, darkës dhe pas darkës. Roli i prindërve tek fëmijët në formimin e zakoneve të shëndetshme të jetesës është shumë i rëndësishëm, dhe është po aq e rëndësishme të

mblidhen rreth tryezës së familjes gjatë vakteve kryesore ditore, gjithashtu ndikojnë strategjitë për të rritur ndërgjegjësimin për përshtatjen dhe përfshirjen e fëmijës në kuzhinë gjatë gatimit. Këto ndërhyrje ndihmojnë adoleshentët të konsumojnë një dietë të shëndetshme. Shumica e të anketuarve, 86%, e konsiderojnë ushqimin dhe ndikimin e tij në shëndetin e tyre shumë të rëndësishëm. Institucionet përgjegjëse duhet ta përdorin këtë qëndrim pozitiv ndaj ushqimit për të gjetur mënyrën e duhur për të arritur edukimin e duhur të fëmijëve, dietën e duhur dhe stilin e jetesës së shëndetshme, qoftë përmes rekomandimeve, përmes udhëzimeve të përshtatshme, ose përmes përfshirjes së informacionit në lëndë mësimore.

Abstract:

Introduction: Adolescence is the age when significant physical, psychological, social changes occur. Food and physical activity play a key role in supporting these processes. The quantity and quality of food, timing of regular daily meals, eating habits, physical activity, and good sleep determine health now and in the future as adults. **Aim:** This study aims at examining, analyzing eating habits, attitudes, knowledge about the importance of a healthy diet and healthy lifestyle of adolescents in the city of Prishtina. **Method:** The sample consists of 209 students aged 12-15 years of which 54% are male and 46% are female, 51% come from schools in the suburbs of Prishtina and 49% come from schools in the city of Prishtina. The participation of age groups is proportional. Data collection was performed using an anonymous questionnaire which included general information about the respondent as well as issues related to eating habits and lifestyle. **Results:** Of the total number of respondents, the percentage of students from the city was a total of 102 students compared to rural areas that were a total of 109 students from 5 schools. Regarding categories according to BMI, most of them, about 60% have a normal weight, the results show that 24% of adolescents in the city are underweight and a correlation was found between girls with rural demographic backgrounds and underweight categories, where 32% of girls were with rural demographic backgrounds. Overweight resulted at 12% of the sample and in the smallest category, the results show obesity by 3%. The average weight of the subjects was 56.6 kg and the average height was 165 cm. It turns out to be hopeful that 86% of students consider it very important to eat healthily. Most respondents to the survey consume three main meals: 93% breakfast, 97% lunch, and 94% dinner. 36% of respondents get a light snack or meal between lunch and dinner, while 25% get a snack between breakfast and lunch, and 29% of them after dinner. In terms of physical activity 99% of respondents engage in physical activity, exercise at least one type of sport, 50% of respondents play football, (43%) engage in running, (36%) engage in volleyball, (35%) deal with basketball, (30%) in cycling, (21%) jumping rope and (20%) with gymnastics. The average sleep hours of the subjects were 8.7 hours per day. **Conclusion:** From the results based on the responses of the respondents, it is noticed that they do not have enough knowledge about food and a healthy lifestyle. Most of them consume three main meals and do not skip meals, a significant portion does not know if the food they are consuming is healthy. There is also an overload of food in the afternoon so the dinner is consumed late and foods with a higher percentage between lunch and dinner and after dinner. The role of parents in children in shaping healthy living habits is very important, and it is equally important to gather around the family table during the main daily meals, also strategies to raise awareness of the child's adaptation and involvement in the kitchen during cooking have their influence. These interventions help adolescents to facilitate a healthy diet. The majority of respondents, 86%, consider food and its impact on their health very important. Responsible institutions should use this positive attitude towards food to find the right way to achieve proper education of children, proper diet, and healthy lifestyle, either through recommendations, through appropriate guidelines, or the inclusion of information in subjects.

Abstracts

Conference of Engineering and Information Technology Sciences section


The Sixteenth International Annual Meeting of Alb-Science Institute
Shkup, 01 - 03 October 2021

Të gjitha përmbledhjet e këtij dokumenti janë regjistruar në sistemin **ALPA**® nga vetë autorët e tyre. Rrjedhimisht, ndonjë gabim i mundshëm drejtshkrimor apo tjetër në përmbledhje dhe informacionin përkatës është i autorit apo autores përkatëse.

Të drejten për kopjimin dhe shumëfishimin e përmbledhjeve në këtë dokument e ruan ekskluzivisht Instituti Alb-Shkenca (IASH): www.alb-shkenca.org

Gjeneruar më 10 Tetor 2021.

Ky dokument është gjeneruar në mënyrë automatike nga sistemi **ALPA**®.



ALPA - *Albanian Papers*
mali Information Technologies
<http://alpa.mali-it.eu>

Modelimi matematikorë i afatit të shfrytëzimit të litarëve të çelikut në minierën “Trepça” Stan Tërg

Mathematical modeling of using time - period for the steel ropes at the “Trepça” mine Stan Tërg

UJMIR UKA

Universiteti Isa Boletini Mitrovicë
Mitrovicë, KOSOVA
ujmir.uka@hotmail.com

IRFAN VOCA

Universiteti Isa Boletini Mitrovicë
Prishtinë, KOSOVA
irtex60@hotmail.com

EGZON FETAHU

Segment
Mitrovicë, KOSOVA
egzon.fetahu@hotmail.com

Fjalë çelës: Miniera, litari, afati i shërbimit, model matematikorë.

Keywords: Mine, ropes, service time, mathematical model

Përmbledhja:

Në këtë punim synohet të studiohet afati i shërbimit të litarit ngritës prej çeliku i cili përdoret në minierën Trepça Stan Tërg bazuar në të dhënat e laboratorit i cili ka testuar litarët. Për të arritur një organizim të qëndrueshëm të punës, duhet të kemi njohuri se çfarë lloje të makinave dhe pajisjeve teknike që disponon teknika bashkëkohore, gjithashtu duhet të dihet edhe kosto e tyre dhe si në mënyrë racionale mund të shfrytëzohen në përputhje me kushtet që na i ofrojnë minierat duke marrë parasysh edhe përvojat. Rëndësi të madhe ka çështja e projektimit, ndërtimit dhe funksionimit të sigurt të pajisjeve ngritëse sepse me anë të pajisjeve minerare ngritëse krijohet një lidhje në mes të horizonteve të minierës dhe sipërfaqes. Afati i shërbimit të litarit ngritës prej çeliku është i definuar nga kushtet komplekse mekanike dhe ngacmohet me korrozionin mbizotërues në pusin e minierës. Prandaj, çdo 6 muaj (sipas Rregullores së Minierave), duhet të prehet një pjesë e litarit, me gjatësi prej 2 [m] me qëllim që të bëhen testet laboratorike 1 [m] dhe 1 [m] ruhet. Në vijim, do të paraqesim rastin e testimit të litarit të çeliktë që është ekzaminuar: Litari i skipit të gjelbër $d=44\text{mm}$. Të dhënat karakteristike të litarëve të ekzaminuar : Prodhuesi HASÇELIK, Turqi Konstruksioni i litarit $6 \times 19 \text{ W} = 6 \times [1 + 6 + (6 + 6)]$ - Diametri nominal i litarit 44 mm Metoda indirekte e ekzaminimit të litarëve prej çelikut përfshinë : Matjen e diametrit të litarit, Matjen e diametrit të telave, Ekzaminimin e telave në përkulje, Ekzaminimin e telave në tërheqje (caktimin e forcës së këputjes dhe sforcimit në tërheqje), dhe Vlerësimi i cilësisë së telave dhe të litarit. Tabela 3. Rezultatet e testeve laboratorike të litarit ngritës në skipin e gjelbër Numri rendor i matjeve Forca totale këputjes së litarit ΣF [N] Forca mesatare tërheqëse e litarit R [U+0305] [MPa] Testi I (Prill, 2012) 1723530 247536 Testi II (Dhjetorë, 2014) 1476916 224749.09

Në bazë të të dhënave nga tabela e ekzaminimit të litarit të çeliktë [U+1D6BD] 44[mm]-litari i skipit të gjelbër forca e shumave këputjes së litarit është : Σ [U+2592] $F=1476.916$ [kN] Forca e këputjes për telat të cilët nuk i plotësojnë kushtet e standardit është : Σ [U+2592] $F_z=45.494$ [kN] Aftësia mbajtëse e litarit është diferenca midis forcës së shumave këputëse reale të litarit dhe shumës së forcave tërheqëse të telave të cilët nuk përmbushin standardin: $F_v=\Sigma$ [U+2592] $F-\Sigma$ [U+2592] [U+3016] $F_z=1476.916-45.494=1431.422$ [kN] [U+3017] Koeficienti i sigurisë së litarit në lidhje me aftësinë mbajtëse të litarit është: $k_{vs}=(F_v \bullet k_s)/F_{log}=(1431.422 \bullet 6)/1131=7.593$ Diametrat nominale të telave në gërs-heta : Shtresa e jashtme $d_1 = 2,38$ mm (6 fije)+ 3,20 mm (6 fije) Shtresa e brendshme $d_2 = 3,10$ mm

(6 fije) Thelbit $d_3 = 3,28$ mm Lloji dhe kahja e thurjes Litari dhe gërshetat janë të thurur s/Z Gjatësia e litarit 1080 [m] Masa e litarit për metër gjatësi 7,632 [kg/m] Qëndrueshmëria në tërheqje $R_m = 1770$ [N/mm²] Forca e llogaritur e këputjes $F = 1131$ [kN] Koeficienti i sigurisë $k_s = 6$

Në bazë të rezultateve të matjeve dhe ekzaminimit të litarit bartës që përdoret në minierën e Stantërgut për ngritjen e skipit të gjelbër me këto karakteristika 44-6x19W-1770 s/Z i plotësojnë kërkesat e standardit DIN 3059 si dhe standardit EN 12358 - 4 ashtu që mund të përdoret në makinën ngritëse të xehe në minierën "Trepça" - Stan Tërg. Bazuar rezultateve të matjeve dhe ekzaminimit të litarit bartës që përdoret në minierën e Stan Tërg - ut, Trepçës për ngritjen e skipit të gjelbër me këto karakteristika 44-6x19W-1770 s/Z propozoi modelin matematikorë $Z=1898.833-1427.69 \bullet t$, i cili mundëson për të parashikuar një moment të arritjes së kufizuar të vlerave mesatare të forcës në tërheqje $R [U+0305]$ dhe forcën totale të këputjes së litarit F , dhe në këtë mënyrë të parashikohet afati i shërbimit të litarit gjatë operacioneve mekanike të ngritje

Abstract:

In this paper, is intended to study the service time of the steel lifting rope used in the Trepca Stan Tërg mine based on the data of the results of ropes testing laboratory. In order to achieve a sustainable organization of work, we need to know what types of machineries and technical equipment that has modern technology owns, and also have to know their cost and how can rationally be used in accordance with the conditions that we provide mines considering their experiences as well. Of great importance is the issue of the design, construction and safe operation of lifting equipment, because by means of lifting mining equipment there is a connection between the mine and surface horizons. The service time of steel hoisting rope is defined by complex mechanical conditions and is exacerbated by the predominant corrosion in the mine well. Therefore, every 6 months (according to the Mining Regulation), a piece of rope with a length of 2 [m] should be cut in order to make laboratory tests 1 [m] and 1 [m] stored.

Next we will present the case of testing the steel rope that has been examined: Green skip, rope $d = 44$ mm. Characteristic of the examined rope: Manufacturer HASÇELIK, Turkey Rope construction 6 x 19 W = 6 x [1 + 6 + (6 +6) Nominal rope diameter 44 mm The indirect method of examining steel ropes includes: Measurement of rope diameter, Measuring the diameter of wires, Examination of wires in bending, Examination of tensile wires (determination of breaking force and tensile stress), and Evaluation of the quality of wires and rope. Table 3. The results of the laboratory tests of the rope for raised in the green skip Serial number of measurements Total rope breaking strength ΣF [N] Average traction force of rope $R [U+0305]$ [MPa] Testi I (April, 2012) 1723530 247536 Test II (December, 2014) 1476916 224749.09

According to the data from the steel rope examination table [U+1D6BD] 44 [mm] - for green skip rope the strength and breaking amounts of the rope is:

$$\Sigma [U+2592] F=1476.916 \text{ [kN]}$$

The breaking strength for wires that do not meet the standard requirements is: $\Sigma [U+2592] F_z = 45.494$ [kN] The bearing capacity of the rope is the difference between the force of the real breaking amounts of the rope and the sum of the tensile forces of the wires which do not meet the standard: $F_v = \Sigma [U+2592] F - \Sigma [U+2592] [U+3016] F_z = 1476.916 - 45.494 = 1431.422$ [kN] [U+3017] The safety factor of the rope in relation to the bearing capacity is: $k_{vs} = (F_v \bullet k_s) / F_{log} = (1431.422 \bullet 6) / 1131 = 7.593$ Nominal wire diameters in braids: The outer layer $d_1 = 2,38$ mm (6 fije) + 3,20 mm (6 fije) Inner layer $d_2 = 3,10$ mm (6 fije) Essence $d_3 = 3,28$ mm Type and direction of knitting The rope and braids are knitted s/Z Rope length 1080 [m] Rope measure per meter of length 7,632 [kg/m] Tensile strength $R_m = 1770$ [N/mm²] Calculated breaking force $F = 1131$ [kN] Security factor $k_s = 6$

Based on the results of measurements and examination of the carrying rope used in the Stan Tërg mine for the erection of green skip with these characteristics 44-6x19W - 1770 s / Z meet the requirements of standard DIN 3059 and standard EN 12358 - 4 so can be used in the ore lifting machine in the mine "Trepça" - Stan Tërg. Based on the results of measurements and examination of the carrier rope

used in the mine of Trepca Stan Terg, for the establishment of the green skip with these characteristics 44-6x19W - 1770 s / Z proposed the mathematical model $Z = 1898.833 - 1427.69 \bullet t$, which enables to predict a moment of limited attainment of the average values of tensile force R [U+0305] and the total rupture force of the rope F , and thus to predict the service time of the rope during mechanical lifting operations.

Ndikimi i zgjyrës së granular në përmirësimin i vetive të asfalt betoneve të derdhura

The influence of granulated slag on the improvement of properties of poured concrete asphalt

IZET IBRAHIMI

UIBM

Mitrovicë, KOSOVA

izet.ibrahimi@umib.net

NURTEN BELIGRADI-DEVA

UIBM

Mitrovicë, KOSOVA

nurten.deva@umib.net

MUSA RIZAJ

UIBM

Mitrovicë, KOSOVA

mrizaj@hotmail.com

Fjalë çelës: granulim thatë, asfalt betone të derdhura,

Keywords: dry granulation , poured asphalt concrete,

Përmbledhja:

Zgjyra e furrës elektrike për prodhimin e ferronikelit vështruar sipas parametrave operativ të procesit, si dhe përbërjes kimike-mineralogjike paraqet mes produkt më të rëndësishëm të procesit të prodhimit të ferronikelit lëndor. Sipas praktikës aktuale të prodhimit dhe përpunimit ajo është kthyer nga një mes produkt me vlefshmëri të mundshme të lartë në një mbetje me potenciale të larta ndotëse. Aktualisht skema e derdhjes dhe ngurtësimit të zgjyrës nga furra elektrike në „Shkritoren e Ferronikelit” në Drenas nuk garanton kontroll të procesit të ngurtësimit, dhe të vetive mekanike-fizike të agregateve të saj. Zgjyra e granular sipas kësaj metode ka lagështi të madhe (15-20%), duke vështirësuar dhe rritur kostot e përpunimit të saj të mëtejshëm. Granulimi nën presionin e vrshkullit të ujit i rrit fazat kristalore, degradon aftësitë lidhëse dhe ngrit përqendrimin e fraksioneve të imta, duke kufizuar aplikimin e saj. Përpunimi dhe shfrytëzimi zgjyrës së FE, sipas “qasjes së re” për mes granulimit të thatë të integruar” do mundësonte transformimin e saj në një nga agregat më vlera të larta për industrinë e ndërtimit dhe industrinë në përgjithësi. Nëse gjatë prodhimit dhe përpunimit të zgjyrës së furrës elektrike për prodhimin e ferronikelit sipas metodës granulimi i thatë i integruar do të merren në konsideratë; përmirësimi i përbërjes kimike-mineralogjike të zgjyrës në llogari të rritjes së vetive lidhëse dhe minimizimit të fazës qelqore, përmirësimin të ndërtimit granulo metrik, formës së kokrrizave, porozitetit (thithshmërisë së ujit), rezistencës ndaj harxhimit (LA), rezistencës ndaj korrozionit (mikro Deval) dhe më theks të veçantë krijimin e kushteve për përqendrime minimale të papastërtive përcjellëse në zgjyrë, të shfaqura si pasojë e raporteve të proporcionale të Fe²⁺ dhe Fe³⁺, sulfiteve të metaleve, oksidi i bariumit, argjilës dhe përqendrimit minimal të përbërësve organik. Vetitë dhe përbërja e zgjyrës së tillë, përgjithësisht do të rrisnin mundësitë e shfrytëzimit të saj në industri, e veçanërisht aplikimin si një nga agregatet kryesor për prodhimin e asfalt betoneve të derdhura. Mbi bazën e të dhënave nga kontrolli dhe analiza XRD e produkteve dhe mes produkteve të procesit të prodhimit të ferronikelit në Shkritoren e “Ferronikelit” në Drenas, si dhe PPP dhe shqyrtimeve tjera të kryera për llojin e mostrave; AD 04E; AD 08 B50/70 me bazë nga zgjyra e furrës elektrike të granular sipas kushteve në studim, sipas metodës kuantitative, kualitative, Marshal dhe metodës HRN EN 1097-8 në laboratorin për vlerësimin e cilësisë së mate-

rialeve të ndërtimit “AHN Group: në Fushë Kosovë do të rezultonte me; përmirësim të koeficientit të rrëshqitjes, qëndrueshmërisë ndaj deformimeve, qëndrueshmërisë ndaj kushteve klimatike dhe aspektit mjedisor. Kështu që gjykuar nga përbërjeve dhe vetive e zgjyrës së furrës elektrike të prodhuara dhe përpunuara sipas “qasjes së re”, gjegjësisht granulimit të thatë të integruar , mund të konstatohet se zëvendësimi i agregateve gurore të imëta me agregatet e zgjyrës së furrës elektrike për prodhimin e asfalt betoneve të derdhura AD 04 dhe 08 do të rezultonte me përmirësimin e gjitha karakteristikave fiziko-mekanike, e veçanërisht do të shprehte efekte të ndjeshme për sa i përket përmirësimit të rezistencën së rrëshqitjes, porozitetit, thithshmëria e ujit, rritjes së rezistencës ndaj harxhimit së shtresë AD, ka avancuar në vlera të larta (PSV) sa i përket qëndrueshmërisë ndaj polirimit-llustrimit dhe rezistencës ndaj paraqitjes së auto gjurmëve. Aplikimi i kësaj qasje prodhimi dhe përpunimi të zgjyrës së furrës elektrike, si dhe shfrytëzimi i zgjyrës së granuluar në të thatë si agregat dhe imtësi gurore tek prodhimi i asfalt betoneve të derdhura, po ashtu do të shprehej në favor të shfrytëzimit racional të burimeve natyrore dhe energjisë për mes ruajtjes së lëndëve të para dhe rigjenerimit-rikthimit të nxehtësisë nga ftohja e zgjyrës në proces, në reduktimin e kostove prodhuese, në përmirësimin dhe kontrollin e cilësisë së produkteve të ndërtimit dhe mbi të gjitha do të ishte një nxitje e fuqishme për një zhvillim industrisë së riciklimit, menaxhimit të deponive me mbetje industriale dhe mbrojtjes së mjedisit

Abstract:

Slag of electric furnace for ferronickel production observed according to the operational parameters of the process, and chemical-mineralogical composition, present one of the most important nus-product of the ferronickel production process. According to the current practice of production and processing, slag it has been turned from a nus-product with potentially high value into a waste with high pollutant potentials. Currently the scheme of pouring and solidification of slag from the electric furnace in the "Ferronikel Foundry" in Drenas does not guarantee control of the solidification process, and the mechanical-physical properties of its aggregates. Granulated slag according to this method has high humidity (15-20%), complicating and increasing the costs of its further processing. Granulation under the pressure of water turbidity, increases the crystalline phases, degrades the bonding abilities and increases the concentration of fine fractions, limiting its applicability. The processing and use of FE slag, according to the "new approach" through integrated dry granulation "would enable its transformation into one of the most valuable aggregates for the construction industry and industry in general. If during the production and processing of electric furnace slag for the production of ferronickel according to the method of dry integrated granulation would be taken into account; Improving the chemical-mineralogical composition of slag in favor of increasing the bonding properties and minimizing the glass phase, Improving granulometric structure, granule shape, porosity (water absorption), resistance to consumption, Resistance to corrosion (micro Deval) and in particular the creation of conditions for minimum concentrations of conductive impurities in the slag, manifested as a result of disproportionate ratios of Fe²⁺ and Fe³⁺ , metal sulfides, barium oxide, clay and the minimum concentration of organic constituents. The properties and composition of such slag, in general, would increase the possibilities of its use in industry, especially the application as one of the main aggregates for the production of poured concrete asphalt. On the basis of XRD control and analysis of products and nus-products of the ferronickel production process at the Ferronickel Foundry in Drenas, as well as PPP and other reviews conducted for the type of samples; AD 04E; AD 08 B50 / 70 with base of granulated slag from electric furnace , according to the conditions of study, according to quantitative and quality method. Marshal and method HRN EN 1097-8 in the laboratory for the evaluation of the quality of construction materials “AHN Gropu: in Fushë Kosovë would result in; improvement of slip coefficient, resistance to deformations, resistance to climatic conditions and environmental acceptability. Thus, judging by the composition and properties of electric furnace slag produced and processed according to the "new ap-

proach", respectively integrated dry granulation, it can be concluded that the replacement of aggregates and quarry fines with slag aggregates of electric furnace for the production of poured concrete asphalt AD 04 and 08 would result in the improvement of all physical-mechanical characteristics, and in particular would express significant effects in terms of improving slip resistance, porosity, water absorption, increased resistance to towards the AD layer, has advanced in high values (PSV) in terms of durability against polishing-polishing and resistance to the appearance of auto-traces. The application of this approach to the production and processing of electric furnace slag, as well and the use of dry granulated slag as aggregate and quarry fines in the production of poured concrete asphalt, would also be expressed in favor of the rational use of natural resources and energy through the saving of raw materials and the regeneration-recovery of heat from the cooling of slag in the process, in the reduction of production costs, in the improvement and quality control of construction products, and above all it would be a powerful impetus for a development of the recycling industry, industrial landfill management and environmental protection.

Rëndësia e kombinimit të imazheve të sentinel 1 dhe 2 për minierën e bitumit në Selenice, Shqipëri

Importance of combining sentinel 1 and 2 images of Selenica bitumen mine in Albania

PIETRO BELBA

Universiteti Politeknik Tirane

Tiranë, ALBANIA

pietro.belba@fgj.edu.al

Fjalë çelës: Sentinel 1, Sentinel 2, maskë uji, kombinim i imazheve

Keywords: Sentinel 1, Sentinel 2, water mask, combining images

Përmbledhja:

HYRJE Për aksesimin e të dhënave të Sentineleve, kërkuesit përdorin disa web site, ndër të cilat “Copernicus Open Hub”. Misioni Copernicus Sentinel-1 përfshin një sistem të dy satelitëve me orbitë polare, që veprojnë ditën dhe natën duke kryer realizimin e imazheve radare me bandën C. Një imazh radar është rezultat i rindërtimit të jehonave të rikuperuara në antenë pas emetimit të impulseve të mikrovalëve që quhet “backscattering”. Formimi i imazhit të radarit nga jehonat e regjistruara bëhet në sistemin e referencës së sensorit të përbërë nga azimuti dhe boshti i Range. Aksi Azimuth është drejtimi përgjatë gjurmës së udhëtimit satelitor. Aksi Range është drejtimi nëpër shtegun e udhëtimit satelitor, i cili është projeksioni i rrezes. Misioni Copernicus Sentinel-2 përfshin një konstelacion të dy satelitëve me orbita polare të vendosur në të njëjtën orbitë sinkrone diellore, me fazë në 180° me njëri-tjetrin. Kombinimi i skenave Sentinel 1 dhe 2 është i dobishëm sepse marrim informacione nga Mikrovalët (Sentinel 1-banda të polarizuara) dhe Visible / Infrared (Sentinel 2 -12 banda) duke zgjeruar spektrin e valëve. QELLIMI Qëllimi i studimit është të japë teknikisht të dhëna për kombinimin e dy imazheve të rajonit me interes Minierës së Bitumit në Selenice nga të dhënat Sentinel 1 dhe Sentinel 2. Ne përdorim për studimin tone Sentinel Application Platform (SNAP). Për efektet e demonstruara të kombinimit të Sentinel 1 dhe Sentinel 2 ne aplikojmë “Band math” me anën e maskave të ujit për identifikimin e ujit dhe zonave jo bimore në imazh. REZULTATET Përpara kombinimit të imazheve nga Sentinel 1 dhe Sentinel 2 është e nevojshme para procesimi. Në rastin e imazheve nga Sentinel 1 ky procesim konsiston në krijimin e një “subset”, vazhdon me kalibrimin radiometrik, filtrimin “speckle”, kthimin e bandave në shkallë logaritmike, korrigjimi i terrenit “range doppler” dhe aplikimi i “band ratio”. Kalibrimi radiometrik është i nevojshëm pasi kushtet e regjistrimit mund të ndryshojnë ndërmjet datave të ndryshme dhe kalibrimi radiometrik korrigjon këto ndryshime dhe siguron vlera të krahasueshme të pikselit. “Speckle”t janë këto pamje “salt and pepper” në imazh që ngurtësojnë interpretimin e tyre. Ato rezultojnë nga ndërhyrja e rastësishme ose e zhurmshme e të gjithë shpërndarësve të vetëm nga një qelizë me rezolucion. Filtrat përpiqen të zvogëlojnë këtë zhurmë me filtrim hapësinor ose kohor. Pastaj është korrigjimi i terrenit që zbaton një lartësi dixhitale në skenën e sentinelit 1 dhe korrigjon shtrembërimet gjeometrike të distancës që rezultojnë nga topografia dhe gjeometria e regjistrimit të sensorit të sentinelit 1. Në rastin e imazheve të Sentinel 2 pre procesimi konsiston vetëm në krijimin e “subset”. Kjo është e dobishme pasi nxjerrim vetëm një pjesë hapësinore shumë të vogël me interes të të gjithë skenës Sentinel 2 e cila zvogëlon ndjeshëm madhësinë e skedarit dhe kufizon kohën e llogaritjes. Sipas të dhënave tona, Sentinel 2 mund të mos ketë në saktësi në paraqitjen e pellgjeve të ujit, por

identifikon me sukses lumin. Sentinel 1 nuk e jep me qartësi lumin, por jep informacion shtesë në zonat me re. Maska nga Sentinel 2 identifikon me sukses zonat e hapura por gjithashtu identifikon strukturën urbane si dhe zonën e reve si jo-bimore. **PERFUNDIME** Aplikimi i maskave për identifikimin e zonave ujore nga imazhet Sentinel 1 dhe Sentinel 2 kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre, por potenciali i madh i produktit të bashkuar është se ne mund të përdorim informacionin për të pasur një më të plotë në përfundim produkti përfundimtar shërben si një imazh i ri që zotëron karakteristikat e dy imazheve fillestare të marra nga Sentinel 1 dhe Sentinel 2

Abstract:

INTRODUCTION For Accessing Sentinel data the scientists use some websites one of them is the Copernicus Open Hub. The Copernicus Sentinel-1 mission comprises a constellation of two polar-orbiting satellites, operating day and night performing C-band synthetic aperture radar imaging. A radar image is the result of the reconstruction of the echoes recovered in the antenna after the emission of microwave pulses which is called backscattering. The formation of the radar image from the recorded echoes is done in the sensor reference system composed of the azimuth and range axis. The Azimuth axis is the direction along the satellite travel track. The Range axis is the direction across the satellite travel track, which is the beam projection. The Copernicus Sentinel-2 mission comprises a constellation of two polar-orbiting satellites placed in the same sun-synchronous orbit, phased at 180° to each other. Combination of Sentinel 1 and Sentinel 2 scenes is helpful because we take information from Microwave (Sentinel 1-different polarization bands) and Visible/Infrared (Sentinel 2 -12 bands) having a broad wave data. **AIM** The aim of the study is to give technically data for the combination of the two images of region of interest Selenica Bitumen Mine from Sentinel 1 and Sentinel 2 data. We use the Sentinel Application Platform (SNAP) for our study. For demonstrated the effects of combining Sentinel 1 and Sentinel 2 we apply the band math (water mask) for identifying water bodies and non -vegetated areas. **RESULTS** Before combining Sentinel 1 and Sentinel 2 images it is necessary Preprocessing. In Sentinel 1 images it is composed of creating a subset, radiometric calibration, speckle filtering, band conversion to dB, range doppler terrain correction and band ratio. The radiometric calibration is necessary as recording conditions may vary between different dates and the radiometric calibration corrects these differences and it provides comparable pixel values. Speckles are these salt and pepper grains in the image which harden their interpretation They result from random or noisy interference of all the single scatterers from within one resolution cell. Speckle filters try to reduce this noise by spatial or temporal filtering. Then it is the terrain correction which applies a digital elevation to the sentinel 1 scene and corrects the geometric distance distortions which result from the topography and the recording geometry of the sentinel 1 sensor. In Sentinel 2 images preprocessing consists only in creating a subset. This is useful as we extract only one very small spatial part of interest of the whole Sentinel 2 scene which considerably reduces file size and limits computation times. According our data, Sentinel 2 misses the water ponds but successfully identifies the river. The sentinel 1 misses the river but delivers additional information in the cloudy areas. The mask from Sentinel 2 successfully identifies the open pit areas but also identifies urban structure as well as cloud area as non-vegetated. **CONCLUSIONS** Both water masks from Sentinel 1 and Sentinel 2 images have their advantages and disadvantages but the great potential of the merged product is that we can use the merged information to have a more comprehensive one. The merged product should serve as a new image with many characteristics of both images from Sentinel 1 and Sentinel 2 scenes.

Vlerësimi i efijencës së paneleve fotovoltaike të instaluara në godinën e agromekanikës, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Evaluation of the efficiency of photovoltaic panels installed in the building of agromechanics, Agricultural University of Tirana

ETLEVA JOJIC
Universiteti Bujqësor i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
etlevajojic@yahoo.com

EDMOND DEMOLLARI
Universiteti Bujqësor i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
edemollari@ubt.edu.al

ALEKSANDER PEQINI
Universiteti Bujqësor i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
aleksander.peqini@hotmail.com

OLSID MEMA
Universiteti Bujqësor i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
omema@ubt.edu.al

NDOC VATA
Universiteti Bujqësor i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
nvata@ubt.edu.al

Fjalë çelës: Energji elektrike, Efienca, Impiant fotovoltaike, Fuqia
Keywords: Electrical energy, Efficiency, Photovoltaic plant, Power

Përmbledhja:

Energjia diellore është energjia më e madhe që mund të ketë rruzulli tokësor. Ndryshe nga llojet e tjera të energjive, kjo energji përmirëson cilësinë e ajrit në vend, zvogëlon emetimet e karbonit në ajër dhe ka një kosto të ulët shfrytëzimi. Kapja dhe shfrytëzimi i energjisë diellore realizohet në dy forma: natyrale dhe aktive. Forma aktive është forma që shfrytëzohet nga instalimi i paneleve diellore. Kjo është forma më e përhapur duke u instaluar dhe përdorur në institucione, shtëpi private apo ndërtesa të ndryshme. Panelet fotovoltaike kanë qenë një nga pionierët e teknologjive rinovuese për gati një dekadë. Instalimi i paneleve fotovoltaike në tarracat e këtyre ndërtesave po përhapet shumë pasi këto sipërfaqe të ndërtesave qëndrojnë bosh dhe mund të përdoren për qëllime të tjera pa humbur hapësirën e banuar/përdorim primar. Duke marrë parasysh potencialin diellor në Shqipëri, një sasi e konsiderueshme e gjenerimit të energjisë elektrike është e mundur duke përdorur teknologjinë aktuale të paneleve fotovoltaike. Për këtë arsye, është marrë në konsideratë ndërtesa mësimore 3-katëshe e Agromekanikës, e cila është pjesë e Universitetit Bujqësor të Tiranës. Godina e Agromekanikës e pozicionuar në gjerësinë gjeografike 41°21'48.86"N dhe gjatësinë gjeografike 19°45'52.85"E, është pjesë e Njesisë Administrative Nr.11, Bashkia Tiranë dhe ndodhet në pjesën Veri-Lindore të korpusit të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Kjo godinë, përbëhet nga 3 kate dhe përfshin auditorë mësimi (5), sallë laboratorij kompjuterësh (1), zyrë specialisti (1), zyrë personeli akademik (5) dhe tualete (2). Vlerësimi i efijencës u realizua duke krahasuar kërkesat mesatare mujore për energji elektrike në godinë dhe sasinë mesatare mujore të energjisë elektrike që prodhon impianti fotovoltaike i instaluar në tarracën e godinës. Panelet fotovoltaike (20) të këtij impianti, janë instaluar në tarracën e godinës. Në mbështetje të orarit të miratuar mësimor të vitit akademik, u përcaktuan orët për leksion dhe seminar që pedagogët ushtruan

në mjediset e godinës së Agromekanikës. U llogarit energjia elektrike e harxhuar mesatare nga pajisjet elektronike dhe llambat ose neonet e mbajtur ndezur në këtë periudhë kohore. Nga ana tjetër, u llogarit sasia e prodhuar e energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik po në këtë periudhë kohore. Prodhimtaria mesatare e impiantit arriti në vlerën 2.7 kWh/kWp. Në këtë studim, fokusi ishte në përcaktimin e sasisë së energjisë që mbulohet nga impianti fotovoltaiik në tarracën e godinës. Për këtë qëllim u vlerësuan të gjitha kërkesat energjetike për të gjitha facilitetet (ndriçim, pajisje elektronike dhe elektrike), nisur nga fuqia (wat) e tyre dhe përdorimi mesatar ditor (orë). Kërkesat e ndriçimit, pajisjet elektronike, ngrohjen, ftohjen dhe pajisje të tjera të përdorshme u përcaktuan në bazë mesatare mujore, pasi edhe diferenca impiant fotovoltaiik - rrjet elektrik, realizohet mbi këtë bazë. Prodhimtaria e energjisë elektrike të këtij impianti fotovoltaiik në pik arrin në 5 kWh/kWp (në 230V, 50Hz) kurse në vlera mesatare mujore arrin në rreth 2.7 kWh. Efiçenca maksimale arrin në 98.3%. Kjo energjie elektrike e prodhuar arrin të mbulojë ndriçimin e godinës si dhe pajisjet elektronike që ndodhen në ndërtesë. Kërkesat dhe intervalet që operon ky impiant janë: kategoria klimatike sipas IEC 60721-3-4, klasa: 4K4H (temperaturat e operimit -25°C deri në +60 °C; lagështia 0 % deri në 100 %; kufiri minimal dhe maksimal i presionit të ajrit: 79.5 kPa deri në 106 kPa). Si përfundim, nga llogaritjet e realizuara, u vu re se impianti fotovoltaiik plotëson nevojat për energji elektrike të godinës së Agromekanikës në 6.91% të totalit të saj.

Abstract:

Solar energy is one of the forms of renewable energy sources from which other energy sources are derived. The use of solar energy directly affects the improvement of air quality, reduces carbon emissions into the air and has low operating costs. The capture and use of solar energy is realized in active and passive form. One of the active forms of use is the use of electricity produced by photovoltaic panels (PV). This is the most common form being installed and used in state institutions, land surfaces, private houses or various buildings. Photovoltaic panels have been one of the pioneers of renewable technologies for almost a decade. The installation of photovoltaic panels on the terraces of these buildings is spreading widely as these building surfaces remain empty and can be used for other purposes without losing residential space / primary use. Given the potential of solar energy in Albania, a significant amount of electricity generation is possible using current photovoltaic panel technology. The efficiency assessment, in the production of electricity, was carried out for the photovoltaic panel installed in the Agromechanics building. The building of Agromechanics is positioned at latitude 41 ° 21'48.86 "N and longitude 19 ° 45'52.85" E, and is part of Administrative Unit No.11, Municipality of Tirana and is located in the North-Eastern part of the University building Agricultural of Tirana. This building consists of 3 floors and includes 5 classrooms, 1 computer lab room, 1 specialist office, 5 academic staff offices and 2 toilets. The study was conducted by comparing the average monthly electricity requirements in the building and the average monthly amount of electricity produced by the photovoltaic plant installed on the roof of the Agromechanics building. Energy requirements were calculated based on average monthly consumption. Photovoltaic panels of this plant are installed on the terrace of the building. The average monthly electricity requirements in the building were calculated based on the installed capacity of lighting, heating and cooling equipment, water supply, computers, projectors, laboratory equipment, printers, etc. The average monthly electricity demand in the building is estimated at an average of 4000 kWh referring to the current installed power. The amount of electricity produced by the photovoltaic plant was calculated in the same period of time. The peak electricity production of this photovoltaic plant reaches the value of 5 kWh / kWp (at 230V, 50Hz) while at average daily values it reaches about 2.7 kWh. The maximum efficiency reaches 98.3%, per kWp. Requirements and intervals that this plant operates are: climate category according to IEC 60721-3-4, class: 4K4H (operating temperatures -25 ° C to +60 ° C; humidity 0% to 100%; minimum limit and maximum limit of air pressure: 79.5 kPa up to 106 kPa). The photovoltaic plant installed in the building generates an average of 567 kWh of elec-

tricity per month. Based on the electricity requirements and the amount produced by the photovoltaic panel (PV), mounted on the terrace of the building, on average 14.1 % of the total electricity demand in the building is covered. This indicates that the PV installed on the terrace of the building covers the lighting and water supply of the building of Agromechanics.

Ndikimi ekonomik dhe mjedisor i shfrytëzimit të lymit anodik të bakrit sekondar

Economic and environmental impact of secondary copper anodic slum utilization

NURTEN BELIGRADI-DEVA
UIBM
Mitrovicë, KOSOVA
nurten.deva@umib.net

IZET IBRAHIMI
UIBM
Mitrovicë, KOSOVA
izet.ibrahimi@umib.net

MUHARREM ZABELI
UIBM
Mitrovicë, KOSOVA
muharrem.zabeli@umib.net

Fjalë çelës: bakri sekondar, lymi anodik, produkti final
Keywords: secondary copper, anode slime, final product

Përmbledhja:

Vetë titulli i punimit është mjaftë indikativ dhe kjo është një temë mjaftë aktuale për hulumtimet shkencore dhe vazhdon të jetë objekt studimi i shumë institucioneve shkencore hulumtuese dhe kapaciteteve prodhuese. Lymi anodik (LA-balta anodike) paraqet një prodhim sekondar shumë komponentësh të procesit të rafinimit elektrolitik (RE) të metaleve i cili përbëhet nga komponimet e patretshme të bakrit(Cu), arit(Au), argjendit(Ag), platinin(Pt), paladit(Pd), Iridit(Ir), etj. Me një përgatitje të mirë të lëndës së parë në rastin tonë konkret LA të Cu sekondar si dhe shfrytëzimin e tij racional do të optimizohet procesi i përfitimit të metaleve për të cilin është i dedikuar. Për këtë arsye janë kryer prova të shumta laboratorike, gjysmë industriale dhe industriale me LA të Cu, të cilat kanë dhënë rezultate të lakmueshme, sa i përket procesit të ndarjes së metaleve të çmuara(MÇ) dhe metaleve të grupit të platinin (MGP).Lymet e metaleve të ndryshme paraqesin një bazë të mirë për ekstraktimin e metaleve dhe përfaqësojnë lëndën e parë mjaftë të çmuar për industri. Hulumtimet në lidhje me vlerësimet kuantitative dhe kualitative të lymeve anodike të përfituara gjatë procesit të RE të M rezultojnë se nuk janë duke u shfrytëzuar si burime sekondare për përfitimin e tyre dhe MGP, kështu që edhe njohurit lidhur me sjelljen e tij gjatë procesit të përpunimit të tij janë ende në nivel të ulët. Përcaktues kryesor i fushave të shfrytëzimit të LA janë:

- marrëdhënia në mes vetive fizike, kimike dhe mineralogjike; - aplikimi i metodave teknike standarde të prodhimit dhe përpunimi; - pajtueshmëria në mes karakteristikave fiziko kimike të lymit si dhe mundësia që të shfrytëzohet si material burimor për përfitimin e M dhe MGP; - aftësia e lymit për të plotësuar kërkesat standarde teknike për produktet finale;

Vlerësimi i kualiteteve dhe konsekuencave si dhe hartimi i një programi në lidhje me shfrytëzimin e këtyre lymeve, do të ndikonte pozitivisht në zhvillimin e programeve të përpunimit, identifikimin e skemave adekuate të prodhimit të tyre dhe zhvillimin e programeve për një qëndrueshmëri afatgjate mjedisore. Promovimi i drejtë i politikave të shfrytëzimit të lymeve, si dhe zgjedhja e metodës adekuate të prodhimit, përcaktimi i kushteve teknike, identifikimi i metodave të përpunimit, hulumtimi dhe vlerësimi i performancës të lymeve janë disa nga indikatorët që na mundësojnë të identifikojmë fushat e aplikimit dhe efektet e shfrytëzimit të tij në industri. Rezultatet e hulumtimeve dhe konkluzionet e këtij punimi do të shërbenin në: - inkurajimin e programeve të përpunimit dhe shfrytëzimit të LA, -

optimizmin e procesit të përpunimit të LA si nënprodukt gjatë RE të metaleve, - menaxhimin e drejtë të mbetjeve ujore industriale me qëllim të mbrojtjes së ambientit; - uljen e kostove nga procesi i përpunimit të metaleve, ruajtjen dhe shfrytëzimin racional të energjisë, - inkurajimin e programeve për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, - zgjerimin e bazës prodhuese dhe në nxitjen e qasjeve të reja për përpunim të lymit,

Përveç vlerësimeve kuantitative-kualitative dhe përcaktimin e fushave të aplikimit të këtij produkti metalurgjik, qasja jonë konsiston edhe në inkurajimin për solucione të reja projektuese të cilat do të përmirësonin konceptet e përpunimit të lymeve, uljen e vëllimit të komponentëve ndotëse nga procesi i prodhimit dhe rritjen e performancës së produktit final. Ka kohë që në të gjitha debatet e integritimeve globale dominon diskursi i vendosjes së balancimit në mes shfrytëzimit racional të burimeve natyrore dhe energjisë, zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe qëndrueshmërisë mjedisore. Mbi bazën e këtyre konstatimeve, mund të themi se shumica nga industritë metalurgjike kanë si objektive kyç riciklimin e mbetjeve të ngurta të metaleve që përfitohen si mes produkte gjatë procesit të përfitimit të tyre. Shumica e industrive botërore, shikuar nga aspekti i prodhimit dhe përpunimit të lymeve ende nuk janë në nivel të kënaqshëm të shfrytëzimit të tyre.

Abstract:

The title of the paper itself is quite indicative and this is a very current topic for scientific research and continues to be the object of study of many scientific research institutions and production capacities. Anode slime present a secondary product of many components of the electrolytic refining (ER) process of metals which consists of insoluble compounds of copper (Cu), gold (Au), silver (Ag), platinum (Pt), palladium (Pd), Iridit (Ir), etc. With a good preparation of the raw material in our case anode slime of secondary Cu, as well and its rational use will be optimized the process of obtaining the metals for which it is dedicated. For this reason numerous laboratory, semi-industrial and industrial tests have been performed with Cu - AS, which have given enviable results, in terms of the separation process of precious metals and platinum group metals. Slimes of various metals presents a good basis for metal extraction and represent a very valuable raw material for industry. Research on the quantitative and qualitative assessments of anode slimes obtained during the electrolytic refining process of precious metals shows that they are not being used as secondary sources for their benefit and PGM, so and knowledge about their behavior during the processing process are still at a low level. The main determinants of anode slime areas of use are: • the relationship between physical, chemical and mineralogical properties; • application of standard technical methods of production and processing; • compatibility between the physicochemical characteristics of slime as well and possibility to be used as a source material for the benefit of precious metals and PGM; • slime ability to meet technical standards requirements for final products; Assessing the qualities and consequence, and designing of program related to the use of these slimes, would have a positive impact on the development of processing programs, identifying adequate schemes of their production and developing programs for long-term environmental sustainability. Proper promotion of slime utilization policies, and the selection of adequate production method, determination of technical conditions, identification of processing methods, research and evaluation of slime performance are some of the indicators that enable us to identify areas of application and the effects of its exploitation in industry. The research results and conclusions of this paper would serve: • in encouraging AS processing and utilization programs; • in optimizing the AS processing process as a by-product during metal ER; • in the proper management of industrial water waste in order to protect the environment; • in reducing costs from the process of metal processing, conservation and rational use of energy; • encouraging programs for sustainable economic development; • expanding the production base and promoting new approaches to slime processing. In addition to quantitative-qualitative assessments and defining the areas of application of this metallurgical product, our approach also consists

of encouraging new design solutions which would improve the concepts of anodes slime treatment, reduce the volume of polluting components from the production process and increase the final product performance. The discourse of balancing the rational use of natural resources and energy, sustainable economic development and sustainable living environment has long dominated in the debates over global integration. Based on these findings, we can say that most of the metallurgical industries have as key objectives the recycling of solid metal wastes that are obtained as intermediate products during the process of their extraction. Most of the world's industries, in terms of production and processing of sludge, are still not at a satisfactory level of utilization.

Rindërtimi 3D CAD i modeleve të serisë NPL të karenave të shpejta dislokuese më fund të rrumbullakosur

3D CAD reconstruction of models of the NPL systematic series of fast displacement round bilge hull forms.

BLENARD XHAFERAJ

Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali"

Vlorë, ALBANIA

blenardxhaferaj@yahoo.it

Fjalë çelës: Modelim Gjeometrik, 3D CAD, Projektim Anije

Keywords: Geometric Modeling, 3D CAD, Ship Design, .

Përmbledhja:

Projektimi i karenës së anijes është një element shumë i rëndësishëm i procesit të projektimit të anijes, në të cilin përqendrohet vëmendja kryesore e këtij procesit. Në fakt prej formës së karenës së anijes dhe parametrave kryesore të saj varen shumë prej cilësive lundimore të anijes, si për shembull stabiliteti i anijes, rezistenca dhe fuqia e nevojshme për lëvizjen e saj me një shpejtësi të caktuar sipas kërkesave të porositesit të anijes, lëkundshmëria dhe drejtueshmëria e saj. Të gjithë këto elementë kushtëzojnë edhe aspekte të lidhura me sigurinë lundimore të anijes, konfortin në bord, konsumin e karburantit, ndotjen mjedisore nga emetimet e anijeve, kostot operacionale të mjetit, etj. Ndër metodat kryesore që ndiqen në procesin e projektimit të formës së karenës së anijes, janë projektimi i drejtpërdrejtë i karenës së anije, përdorimi i serive sistematike të karenave të anijeve dhe transformimi i formave ekzistuese. Seritë sistematike të karenave të anijes paraqesin për projektuesin avantazhin se ato bazohen mbi praktikën më të mira të industrisë detare, si dhe kanë të gjithë informacionin e nevojshëm për vlerësimin e parametrave hidrodinamike të anijes, kryesisht ato të lidhura me rezistencën dhe propulSIONIN. Seria sistematike NPL është një seri modelesh të karenave të anijeve dislokuese të shpejtësisë së lartë, e karakterizuar nga forma fundore të rrumbullakëta të karenës. Modelet e karenave të kësaj serie mund të shfrytëzohen në fazën e projektimit të mjeteve të shpejta dislokuese detare, si barka lundruese që punojnë me ngarkesë të madhe, anije të shpejta patrulluese, anije të vogla pasagjerësh për lundrimet bregdetare, si dhe anije të vogla për qëllime argëtimi, që mund të projektohen për të lundruar në rangun e numrit të Froudit në diapazonin $FN=0.3-1.2$. Në kushtet aktuale të zhvillimit të turizmit detar në Shqipëri modelet e serisë sistematike NPL janë shumë të përshtatshme sepse këto modele paraqesin karakteristika të mira të stabilitetit, rezistencës dhe propulSIONIT, si dhe të stabilitetit drejtimor të anijes. Zhvillimet aktuale në fushën e kompjuterëve dhe softuerëve aplikativ CAD i mundësojnë projektuesit të përfitojnë jo vetëm nga avantazhet që ofrojnë vetë seritë sistematike, por edhe modifikime, përmirësime dhe analiza të shpejta në platforma CAD-CAE të projektit të zhvilluar duke përzgjedhur midis tyre variantin më të mirë që i përshpikat kërkesave për anijen që duhet projektuar. Por natyrisht për të mundësuar këtë është i nevojshëm që fillimisht të disponojmë një model 3D CAD mbi bazën e të cilit të bëhen modifikimet dhe transformimet e nevojshme. Në aspektin projektues, disponimi i modelit CAD do të thotë një analizë dhe vlerësim i shpejtë i karakteristikave hidrostatike dhe të stabilitetit, verifikim i përmbushjes së kriterëve të stabilitetit të parashikuara nga kërkesat e Regjistrave Detare dhe Organizata Ndërkombëtare e Detarisë (IMO) si dhe një procesim në platforma të avancuara CAE. Në aspektin e prodhimit, disponimi i modelit CAD, mundëson transferimin e shpejtë dhe të saktë të informacionit

për procesin e prodhimit, si dhe mundësi shumë të mira për automatizimin e proceseve të prodhimit. Punimi paraqet një procedurë dhe rezultatet e rindërtimit 3D CAD të serisë sistematike NPL, e cila bazohet në rindërtimit CAD nisur nga vizatimet teorike dhe/ose një tabelë gjysmë gjerësish.

Abstract:

Ship hull design is a very important element of the ship design process, Ship crew design is a very important element of the ship design process, where is focused the main attention of this process. In fact, from the shape of the hull of the ship and its main parameters depends many of navigational qualities of the ship, for example the stability of the ship, the resistance and power required to move the at a certain speed according to the requirements of the ship owner, seakeeping and manoeuvrability. All these elements also condition aspects related to the safety of navigation, the comfort on board, fuel consumption, environmental pollution from ship emissions, operational costs of the vehicle, etc. Among the main methods followed in the process of the design of the hull of the ship, direct ship hull design, use of methodical systematic hull series and the transformation of an existing hull form. Methodical systematic ship hull series represent for ship designer the advantage that they are based on best practices of the maritime industry, as well as they contain all the necessary information for the assessment of the hydrodynamic performances and characteristics of the ship, mainly related to resistance and propulsion. The NPL methodical systematic series is a series of models of hulls of high speed displacement ships, characterized by round bilge form. Hulls models of this series can be used for the design phase of fast displacement marine vessels, such as working boats heavy loaded, fast patrol boats, small passenger ships for coastal navigations, as well as small boats for recreational purposes, which can be designed to navigate in the range of Froude numbers $FN = 0.3-1.2$. In the current conditions of the development of maritime tourism in Albania models of NPL series systematic are very suitable because these models present good characteristics of stability, resistance and propulsion as well as directional stability of the ship. Current developments in the field of computers and CAD applicative software enable ship designers to benefit not only from the advantages offered by the systematic series itself, but also quick modifications, improvements and analysis on CAD-CAE platforms of the project developed by selecting among them the best variant that fits better the requirements for the ship to be designed. But of course to enable this it is necessary to have initially a 3D CAD model on the basis of which to make the necessary changes and transformations. In terms of design, the availability of the CAD model means a rapid analysis and evaluation of hydrostatic and stability characteristics, verification of the fulfilment of the stability criteria required by standard rules of Maritime Classification Societies and of the International Maritime Organization (IMO). In terms of production the availability of the CAD model enables fast and accurate transfer of information for the production process, as well as very good opportunities for automation of production processes. The paper presents the procedure and results of 3D CAD reconstruction of the NPL systematic series, which is based on CAD reconstruction based on ship lines plan and/or a table of offsets.

Hulumtimi i metaleve të rënda në frutat e mollëve të kultivuara në fshatrat e rajonit të Mitrovicës

Research of heavy metals in apple cultivated fruits in the villages of Mitrovica region

MILAIM SADIKU

Universiteti "Isa Boletini"

Mitrovicë, KOSOVA

milaim.sadiku@umib.net

SADIJA KADRIU

Universiteti "Isa Boletini"

Mitrovicë, KOSOVA

sadija.kadriu@umib.net

YLLKA MEHANA

Universiteti "Isa Boletini"

Mitrovicë, KOSOVA

yllka.mehana@umib.net

BURIM HOXHAXHIKU

Universiteti "Isa Boletini"

Mitrovicë, KOSOVA

burim.hoxhaxhiku@umib.net

Fjalë çelës: frutat, metalet e rënda, zingjiri ushqimor

Keywords: fruits, heavy metals, food chain

Përmbledhja:

Mitrovica ka qenë e njohur si qytet industrial me Kombinatin Xehetaro-Metalurgjik-Kimik "Trepça". Krahas veprimtarisë minerare, përpunuese dhe prodhuese janë krijuar edhe mbetjet industriale përkatësisht janë krijuar deponitë me mbetje industriale që përmbajnë kryesisht metale të rënda. Me qëllim të hulumtimit të ndikimit të deponive industriale në zinxhirin ushqimor, janë marrë për hulumtim prania e metaleve të rënda në frutat e mollëve të kultivuara në fshatra ku ndikimi i deponive është më i theksuar, veçmas i deponisë në Kelmend dhe asaj në Parkun Industrial në Mitrovicë. Në fshatrat Kelmend dhe Frashër, dhe në fshatrat që janë më larg deponive, Akrashticë, Zhabar, Suhodoll dhe Vidimiriq. Për hulumtim janë marrë mostra të frutave të mollëve dhe mostra të dheut ku janë kultivuar mollët. Për njehsime dhe krahasim të vlerave të lejuara është marrë vlera mesatare e vlerave të fituara. Mostrat për hulumtim janë marrë në prona provat. Janë hulumtuar këto metale: kadmiumi, plumbi, mangani, nikeli, bakri dhe hekuri. Frutat janë marrë të freskëta. Mostrat e dheut janë marrë në nivelin 0-20 cm. Pas mineralizimit të mostrave, përcaktimi përkatësisht përqendrimi i metaleve në mostrat e frutave të mollëve është bërë me aparaturën MP-AES 4200 (Microwave Plasma Atomic Emission Spectroscopy). Ndërsa analizat e dheut janë bërë me pajisjen Thermo Scientific Niton XRF. Krahas përcaktimit të përqendrimit të metaleve të rënda është llogaritur edhe koeficienti i bartjes të metalit nga dheu në frutin e mollës. Sipas Rregullores së Komisionit (EC) No 1881/2006, vlera e lejuar e plumbit në fruta është 0.1 mg/kg, kurse e kadmiumit 0.05 mg/kg. Duke i referuar këtyre vlerave rezulton se përqendrimi i plumbit në frutat e mollëve të kultivuara në fshatin Akrashticë është 1.02 mg/kg, në Frashër 1.17 mg/kg kurse në fshatin Kelmend 1.22 mg/kg, që tregon se përqendrimi i plumbit në frutat e mollëve në të tri fshatrat tejkalon vlerën e lejuar për 1020%, 1170% përkatësisht 1220%. Plumb nuk është gjetur tek frutat e mollëve të kultivuara në fshatrat Zhabar, Suhodoll dhe Vidimiriq. Nga rezultatet e fituara shihet ndikimi i mbetjeve industriale (deponive) në ndotjen e mjedisit përkatësisht në zinxhirin ushqimor. Tri fshatrat e para janë nën ndikimin direkt të ndotjes nga deponitë në krahasim me fshatrat e fundit që probabiliteti i ndikimit të ndotjeve nga deponitë është fare i vogël. Kadmiumi i hulumtuar si

element toksik nuk është gjetur në asnjërin nga mostrat e hulumtuara. Sipas FAO/WHO (1984), vlera e lejuar e bakrit në bimët ngrënëse është 3 mg/kg. Në të gjitha mostrat e hulumtuara, vlerat e fituara për bakër janë nën vlerën limit. Vlera e lejuar e nikelit në bimët ngrënëse sipas FAO/WHO (1984) është 1.62 mg/kg. Nga mostrat e hulumtuara rezulton se nikeli nuk është identifikuar fare. Vlera e lejuar e manganit sipas FAO/WHO (1984) në bimët ngrënëse është 2 mg/kg. Në mostrat e frutave të mollëve të kultivuara në fshatrat Akrahticë, Frashër dhe Kelmend përqendrimi i manganit është nën vlerat e lejuara, kurse në frutat e mollëve në fshatrat Zhabar, Suhodoll dhe Vidimriq janë, 18.56 mg/kg, 14.57 mg/kg dhe 11.07 mg/kg, shumë më të larta se vlerat e lejuar. Limiti për hekurin në bimët e ngrënshme sipas FAO/WHO (1984) është 20 mg/kg. Përqendrimi i hekurit në të gjitha mostrat e frutave të mollëve në fshatrat Akrahticë, Frashër dhe Kelmend janë nën vlerën e lejuar përkatësisht 6.62 mg/kg, 1.78 mg/kg dhe 1.84 mg/kg. Në mostrat e mollëve të hulumtuara në fshatrat Zhabar dhe Suhodoll janë tejkualuar vlera e lejuar. Vlerat e fituara janë 27.68 mg/kg përkatësisht 21.58 mg/kg. Në fshatin Vidimriq përqendrimi mesatar i hekurit në fruta të mollëve është 18.92 mg/kg. Për krahasimin e nivelit të metaleve të rënda në vend mostrimet me vlerat e lejuara, për metalet e rënda në tokat bujqësore të Bashkimit Evropian me implikime në sigurinë e ushqimit, jemi bazuar në standardin EU (2002). Sipas këtij standardi, vlera e lejuar për hekur është 1500 mg/kg. Në të gjitha vend mostrimet kjo vlerë tejkalohe. Përqendrimet janë nga 22217,73-27600 mg/kg. Vlera e lejuar e plumbit në tokat bujqësore është 300 mg/kg. Tejkallim të vlerave të lejuara rezultojnë tri vend mostrime, Suhodoll, Kelmend dhe Frashër. Intervali i përqendrimit është nga 341.68-695 mg/kg. Përqendrimi i manganit në të gjitha vend mostrimet është nën vlerat e lejuara përkatësisht 1500 mg/kg. Tejkallim të vlerave të lejuara të nikelit kanë rezultuar në mostrat në fshatrat Akrahticë dhe Suhodoll. Vlera e lejuar e nikelit është 75 mg/kg. Vlera e lejuar e bakrit është 140 mg/kg. Në të gjitha vend mostrimet rezulton se prania e bakrit është nën vlerën e lejuar. Nga rezultatet e fituara mund të konstatojmë se, ndikimi i deponive industriale në ndotjen e tokave bujqësore e kjo pastaj në zinxhirin ushqimor është i pakontestueshëm.

Abstract:

Mitrovica has been known as an industrial city with the Mining-Metallurgical-Chemical Combine "Trepça". In addition to the mining, processing and production activity, industrial waste has been created, respectively landfills with industrial waste have been created that contain mainly heavy metals. In order to investigate the impact of industrial landfills on the food chain, the presence of heavy metals in apple fruits cultivated in villages where the impact of landfills is more prominent, particularly the landfill in Kelmend and the one in the Industrial Park in Mitrovica. Thus, in the villages of Kelmend and Frashër, and in the villages that are further away from the landfills, Akrahtica, Zhabar, Suhodoll, and Vidimriq. To proceed within research, samples of apple fruits and soil samples where apples were cultivated are taken into consideration. For calculations and comparison of allowed values, the average value of the obtained values is taken. Samples for research were taken on trial properties. The following metals have been investigated: cadmium, lead, manganese, nickel, copper, and iron. The fruits are obtained fresh. Soil samples were taken at the level of 0-20 cm. After mineralization of the samples, the determination of the concentration of metals in the samples of apple fruits was done with the apparatus MP-AES 4200 (Microwave Plasma Atomic Emission Spectroscopy). While soil analyzes were done with the Thermo Scientific Niton XRF device. In addition to determining the concentration of heavy metals, the coefficient of metal transfer from the soil to the apple fruit was also calculated. According to Commission Regulation (EC) No 1881/2006, the permissible value of lead in fruit is 0.1 mg / kg, and of cadmium 0.05 mg / kg. Referring to these values, it results that the concentration of lead in apple fruits cultivated in the village of Akrahtica is 1.02 mg/kg, in Frashër 1.17 mg/kg and in the village of Kelmend 1.22 mg/kg, which shows that the concentration of lead in apple fruits in all three villages exceeds the allowed value by 1020%, 1170% respectively 1220%. Lead was not found in apple

fruits grown in the villages of Zabar, Suhodoll, and Vidimiriq. The obtained results depict the impact of industrial waste (landfills) on environmental pollution, respectively in the food chain. The first three villages are under the direct influence of landfill pollution, compared to the last villages where the probability of impact of landfill pollution is trivial. Cadmium investigated as a toxic element was not found in any of the samples examined. According to the FAO / WHO (1984), the permissible value of copper in edible plants is 3 mg/kg. In all samples examined, the values obtained for copper are below the limit value. The permissible value of nickel in edible plants according to FAO / WHO (1984) is 1.62 mg/kg. From the investigated samples it results that nickel has not been identified at all. The permissible value of manganese according to FAO / WHO (1984) in edible plants is 2 mg/kg. In the samples of apple fruits cultivated in the villages of Akrashtica, Frashër, and Kelmend, the concentration of manganese is below the allowed values, while in the apple fruits in the villages of Zhabar, Suhodoll and Vidimiriq are 18.56 mg/kg, 14.57 and 11.07, higher than the allowed values. The limit for iron in edible plants according to FAO / WHO (1984) is 20 mg/kg. The concentration of iron in all samples of apple fruits in the villages of Akrashtica, Frashër, and Kelmend are below the allowed value respectively 6.62 mg/kg, 1.78 mg/kg, and 1.84 mg/kg. In the samples of apples researched in the villages of Zhabar and Suhodoll, the allowed value was exceeded. The values obtained are 27.68 mg / kg respectively 21.58 mg / kg. In the village of Vidimiriq, the average concentration of iron in apple fruit is 18.92 mg/kg. For the comparison of the level of heavy metals in the sampling sites with the allowed values, for heavy metals in the agricultural lands of the European Union with implications for food safety, we are based on the EU standard (2002). According to this standard, the permissible value for iron is 1500 mg/kg. In all sampling sites, this value is exceeded. Concentrations are from 22217.73-27600 mg / kg. The allowable value of lead in agricultural lands is 300 mg/kg. The allowed values results exceeded in three sampling sites, Suhodoll, Kelmend, and Frashër. The concentration range is from 341.68-695 mg / kg. The concentration of manganese in all samples is below the allowed values, respectively 1500 mg/kg. Examples of exceeding the allowed values of nickel resulted in samples in the villages of Akrashtica and Suhodoll. The permissible value of a nickel is 75 mg/kg. The permissible value of copper is 140 mg/kg. In all sampling sites, it turns out that the presence of copper is below the allowable value. From the obtained outcomes we can conclude that the impact of industrial landfills on the pollution of agricultural lands and then on the food chain is undisputed.

Cilësia e ujit të pijshëm të puseve në fshatrat Novolan e Brusnik të Vushtrrisë- Kosovë

The quality of drinking water of wells in Novolan and Brusnik villages of Vushtrria- Kosovo

SADIJA KADRIU

Universiteti "Isa Boletini"

Mitrovicë, KOSOVA

sadija.kadriu@umib.net

MILAIM SADIKU

Universiteti "Isa Boletini"

Mitrovicë, KOSOVA

milaim.sadiku@umib.net

ARBËR HYSENI

Universiteti "Isa Boletini"

Mitrovicë, KOSOVA

arber.hyseni@umib.net

Fjalë çelës: cilësia, uji, puse, monitorimi, ndotja

Keywords: quality, water, wells, monitoring, pollution

Përmbledhja:

Sikurse në të kaluarën edhe sot, mungesa e mjaftueshme e ujit të pijes, të këtij elementi jetik pa të cilin nuk mund të mendohet jeta në tokë, ka qenë dhe është preokupim serioz për njerëzimin në përgjithësi. Një mungesë e tillë e ujit, jo vetëm që ka krijuar lëvizje të mëdha demografike në botë, po si në të kaluarën edhe tani ka pasur dhe ka raste kur janë zhvilluar konflikte sporadike e herë- herë edhe lufta të mëdha për zotërimin e burimeve të bollshme ujore. Në shumë vendbanime të Kosovës, edhe tani, mungesa e ujit ka krijuar realitete të reja demografike, pasi që me shtimin e popullsisë, rezervat e pamjaftueshme të ujit, kanë ndikuar në lëvizjen e banorëve nga një vendbanim në tjetrin. Pikërisht, për këtë arsye, fokusin e hulumtimit tonë e kemi pozicionuar në analizimin dhe vlerësimin të cilësisë së ujit të pijes të disa puseve, në fshatrat Novolan e Brusnik, që shtrihen në afërsi të masivit malor të Qyqavicës, gjegjësisht në pjesën perëndimore të Komunës së Vushtrrisë. Për të pasur një pasqyrë sa më reprezentative lidhur me cilësinë e ujërave të puseve që banorët e këtyre fshatrave i shfrytëzojnë për pije, në zonën tonë të hulumtimit, kemi krijuar rrjetin e monitorimit me gjithsej gjashtë pika monitoruese, të shënuara me: M1, M2, M3, M4, M5 dhe M6. Pikat monitoruese M1, M2 dhe M3 paraqesin vend mostrimet e fshatit Novolan, ndërsa M4, M5 dhe M6 paraqesin vend mostrimet e piketuara në fshatin Brusnik. Mostrat janë marrë dhe analizuar gjatë muajve janar e korrik, të vitit 2021, dhe janë përcaktuar parametrat organoleptikë, fiziko-kimikë dhe mikrobiologjikë. Gjatë punës hulumtuese, me qëllim që analizat të jenë sa më të sakta, kujdes të veçantë i kemi kushtuar procesit të marrjes së mostrave. Mënyra e marrjes së mostrave, sasia e mostrës së marrë, transporti dhe koha maksimale që mund të qëndrojë mostra para analizës kimike, është bërë në përputhje me metodën ISO 5667:1, ISO 5667:3 dhe ISO 5667:11. Për përcaktimin e parametrave organoleptikë, si: era, shija e ngjyra, jemi bazuar në metodën sensorike (shqisore), ndërsa për përcaktimin veç e veç të parametrave fiziko-kimikë, jemi bazuar në metodat standarde, si: ISO 10523:2012 (temperatura); ISO 7027:1999 (turbiditeti); ISO 7888:1985 (përçueshmëria); ISO 10523:2008 (pH); ISO 5814:2012 (oksigjeni i tretur); ISO 15705:2002 (shpenzimi i oksigjenit të tretur); EN ISO 6878:2004 (fosfatet); ISO 7150-1:1984 (amoniaku), DIN 38405-9 : 2011 (nitratet); ISO 677 7:1984 (nitritet); ISO 9297:1989 (kloruret)

dhe ISO 6059:1984(fortësia e përgjithshme). Për parametrat mikrobiologjikë kemi bazuar në metodën EN ISO 6222 që ka të bëjë me numrin e përgjithshëm të bakteve të gjalla në 1ml në 370C. Rezultatet e mostrave të analizuar e të pasqyruara në mënyrë tabelore, i kemi krahasuar me vlerat referente të Udhëzimit Administrativ të Kosovës, UA16/2012, që ka të bëjë me cilësinë e ujit për konsum nga njeriu dhe që është në pajtueshmëri të plotë me Direktivën e BE-së 98/83 EC. Rezultatet e fituara dhe të krahasuara me vlerat referente, pasqyrojnë se nga të gjashtë mostrat e marra për analizë në tri prej tyre kemi gjetur tejkalim të vlerave referente, me nitrate në vend mostrimin M1(19.6mg/l) dhe M5(17.4mg/l). Përveç ndotjes me nitrate, në vend mostrimin M1 kemi hasur edhe në ndotjen mikrobiale që rezultojnë me 80 CFU/ml, ndërsa në vend mostrimin M4 analizat mikrobiale kanë rezultuar me prani të mykut të bardhë. Bazuar në elaborimin e rezultateve, del se një ndotje e tillë e ujërave të pijes, në vend mostrimit e fshatrave Novolan e Brusnik ka ndodhur për arsye se nuk janë respektuar masat mbrojtëse, sanitare, pasi që në afërsi të puseve ndodheshin stallat e kafshëve, stivat me plehra të stallave, rrjetit të dobët i kanalizimit dhe shfrytëzimit pa kriter në afërsi të puseve i kemikateve bujqësore. Prandaj, kujdesi për ujin do të duhej të ishte prioritet për kryefamiljaret dhe anëtarët tjerë të familjes, pasi që uji është produkti esencjal pa të cilin nuk do të kishte jetë në planetin tonë. Para Institucioneve lokale e shtetërore në Kosovë, shtrohet si nevojë e domosdoshme që të hartojnë projekte të veçanta për shpërndarjen e rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm, jo vetëm për banorët e fshatrave Novolan e Brusnik, ku është gjetur ndotja, po edhe për banorët tjerë të zonave rurale në Kosovë, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të ruhet dhe të mbrohet, jo vetëm uji i pastër, po edhe shëndeti i mijëra banorëve të Kosovës.

Abstract:

As in the past and today, the lack of sufficient drinking water, of this vital element without which life on the earth cannot be contemplated, has been and is a serious preoccupation for mankind in general. Such a lack of water, not only has created great demographic shifts in the world but as in the past and now there have been and are cases when sporadic conflicts have developed and sometimes even great struggles for possession of abundant resources. water. In many settlements of Kosovo, even now, the lack of water has created new demographic realities, as with the increase of population, insufficient water reserves have affected the movement of inhabitants from one settlement to another. Precisely for this reason, we have positioned the focus of our research on the analysis and evaluation of drinking water quality of several wells, in the villages of Novolan and Brusnik, which are located near the mountain massif of Qyqavica, respectively in the western part of the Municipality of Vushtrri. To have a more representative overview regarding the water quality of the wells that the inhabitants of these villages use for drinking, in our research area, we have created a monitoring network with a total of six monitoring points, marked with M1, M2, M3, M4, M5, and M6. Monitoring points M1, M2, and M3 represent the sampling sites of Novolan village, while M4, M5, and M6 represent the sampling sites in Brusnik village. Samples were taken and analyzed during January and July 2021, and organoleptic, physicochemical, and microbiological parameters were determined. During the research work, for the analyzes to be as accurate as possible, we paid particular attention to the sampling process. The method of sampling, the quantity of the sample taken, the transport, and the maximum time that the sample can stand before the chemical analysis, is done following the method ISO 5667: 1, ISO 5667: 3, and ISO 5667: 11. For the determination of organoleptic parameters, such as: smell, taste and color, we are based on the sensory method (sensory), while for the determination of Physico-chemical parameters, we are based on standard methods, such as: ISO 10523: 2012 (temperature) ; ISO 7027: 1999 (turbidity); ISO 7888: 1985 (conductivity); ISO 10523: 2008 (pH); ISO 5814: 2012 (dissolved oxygen); ISO 15705: 2002 (dissipation of dissolved oxygen); EN ISO 6878: 2004 (phosphate); ISO 7150-1: 1984 (ammonia), DIN 38405-9: 2011 (nitrate); ISO 677 7: 1984 (nitrite); ISO 9297: 1989 (chlorides) and ISO 6059: 1984 (total hardness). For microbiological parameters, we are based on the EN ISO 6222 method which deals

with the total number of live bacteria in 1ml at 37 0C. The results of the analyzed samples and presented in tabular form, are compared with the reference values of the Administrative Instruction of Kosovo, AI16 / 2012, which has to do with the quality of water for human consumption and which is in full compliance with the Directive of EU 98/83 EC. The results obtained and compared with the reference values, show that out of the six samples taken for analysis in three of them we found exceeding the reference values, with nitrates at the sampling site M1 (19.6mg/l) and M5 (17.4mg / l). In addition to nitrate contamination, at sample M1 we encountered microbial contamination resulting in 80 CFU / ml, while at sample M4 microbial analysis resulted in the presence of white mold. Based on the elaboration of the results, it turns out that such a pollution of drinking water, in the sampling sites of the villages Novolan and Brusnik occurred because the protection and sanitary measures were not respected, since near the wells were animal stables, piles with stable manure, poor sewerage network and indiscriminate use in the vicinity of wells of agricultural chemicals. Therefore, water care should be a priority for heads of households and other family members, as water is the essential product without which there would be no life on our planet. Before the local and state institutions in Kosovo, there is a necessary need to design special projects for the distribution of the drinking water supply network, not only for the inhabitants of the villages Novilan and Brusnik, where the pollution was found but also for other inhabitants. of rural areas in Kosovo, because only in this way can be preserved and protected, not only clean water but also the health of thousands of inhabitants of Kosovo.

Përcaktimi i dozës optimale të koagulantit në procesin e kthjellimit të ujit

Determination of the optimal coagulant dose in the water cleaning process

MEHUSH ALIU

Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë
Mitrovicë, KOSOVA
mehush.aliu@umib.net

MENSUR KELMENDI

Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë
Mitrovicë, KOSOVA
mensur.kelmendi@umib.net

Fjalë çelës: pH, doza e koagulantit, JAR testi, turbiditeti

Keywords: pH, coagulant dose, JAR test, turbidity

Përmbledhja:

Pastërtia e ujit zakonisht matet nga turbullira e tij. Papastërtitë të cilat ndërhyjnë në kthjelltesinë e ujit mund të jenë materialet koloidale të argjilës, lymit, fragmentet e shkëmbinjve dhe oksidet e metaleve nga toka, fibrat e bimëve, mikroorganizmat, etj. Matja e turbullirës është një faktor i rëndësishëm që lidhet me cilësinë e ujit të pijshëm. Në procesin e trajtimit të ujit, koagulimi dhe flokulimi janë mënyrat e zakonshme përmes të cilave përdorimi i koagulantëve shpie në paqëndrueshmërinë e grimcave dhe formimin e grimcave më të mëdha dhe më të rënda, duke rezultuar në përmirësimin e proceseve të sedimentimit dhe filtrimit. Ujërat e turbullta, që përmbajnë grimca koloidale, normalisht trajtohen me anë të koagulimit-flokulimit, të ndjekur nga sedimentimi. Procesi i koagulimit dhe flokulimit është një nga operacionet më të rëndësishme në kuadër të procesit të pastrimit të ujit, por efektiviteti i tij ndikohet për shkak të llogaritjes së dozës së koagulantit, e cila kryhet përmes Jar testit. Procesi i koagulimit përdoret në trajtimin e ujit të ndotur. Përmes tij realizohet ndarja e grimcave të ngurta, qofshin ato në trajtë suspensioni apo koloidale. Procesi i dytë është flokulimi që nënkupton procesin e krijimit të flokulave nga grimcat e ngurta të destabilizuara dhe kërkon përzierje të ngadalshme për të lejuar goditje efikase midis grimcave për të formuar flokula, të cilat mund të largohen nga uji përmes procesit të sedimentimit. Procesi i tretë është sedimentimi, i cili largon grimcat e padëshiruara të suspenduara (rëra, balta) dhe disa kontaminantë tjerë nga uji nën ndikimin e forcës së gravitetit, duke përmirësuar cilësinë vizuale të ujit dhe duke e bërë atë më të pranueshme nga ana e konsumatorit. Ekzistojnë disa lloje të kimikateve që mund të përdoren si koagulant, por zgjedhja e koagulantëve kimik varet nga natyra e grimcave të ngurta të suspenduara që duhet të largohen, konditat e ujit të papërpunuar, dizajni i impiantit dhe kostoja e kimikateve të nevojshme. Eksperimentet e Jar testit u kryen për vlera të ndryshme të turbullirës së ujit. Mostra e ujit kanë pasur vlera fillestare të turbiditetit prej 70 NTU, 140 NTU dhe 250 NTU. Një seri eksperimentesh të Jar testit u realizuan për të gjetur pH-në optimale dhe dozën e koagulantit. Eksperimentet e Jar testit janë zhvilluar për vlera të ndryshme të pH-së prej 5.5, 7 dhe 8.5. Për të rregulluar pH-në e mostrave është përdorur acidi sulfurik me përqendrim 0.0516M dhe hidroksidi i natriumit me përqendrim 0.097M. Sasia e koagulantit të shtuar ka qenë (10 mg/L për enën e parë, 20 mg/L për enën e dytë, 30 mg/L për enën e tretë, 40 mg/L për enën e katërt). Përzierja e shpejtë (koagulimi) është kryer për kohën prej 1.5 minutave dhe me shpejtësi prej 120 rrotullime për minutë, përzierja e ngadalshme (flokulimi) është kryer për kohën prej 25 minutave dhe me shpejtësi prej 20 rrotullime për minutë dhe sedimentimi është kryer për kohën 30 minutave. Në këtë punim si koagulantë janë përdorur sulfati i aluminit dhe kloruri i hekurit. Të dy koagulantët e përdorur treguan

efikasitet të lartë në largimin e turbullirës nga uji. Rezultatet treguan se largimi i turbullirës së ujit varet nga pH-ja, doza e koagulantit, si dhe turbullira fillestare e ujit për të dy koagulantët e përdorur. Efikasiteti më i lartë i përqindjes së largimit të turbiditetit duke e përdorur si koagulantë sulfatin e aluminit ka qenë në vlerën e pH-së 7, ndërsa efikasiteti më i lartë i përqindjes së largimit të turbiditetit duke e përdorur si koagulantë klorurin e hekurit ka qenë në vlerën e pH-së 8.5.

Abstract:

The purity of water is usually measured by its turbidity. Impurities which interfere with the clarity of water can be colloidal materials of clay, sludge, rock fragments and metal oxides from the soil, plant fibers, microorganisms, etc. Turbidity measurement is an important factor related to the quality of drinking water. In the water treatment process, coagulation and flocculation are common ways through which the use of coagulants leads to particle instability and the formation of larger and heavier particles, resulting in improved sedimentation and filtration processes. Turbid waters, which contain colloidal particles, are normally treated by coagulation-flocculation, followed by sedimentation. The coagulation and flocculation process is one of the most important operations within the water purification process, but its effectiveness is affected due to the calculation of the coagulant dose, which is performed through the Jar test. The coagulation process is used in the treatment of wastewater. Through it, the separation of solid particles is realized, whether they are in the form of suspension or colloidal. The second process is the flocculation which means the process of creating flocs from destabilized solid particles and requires slow mixing to allow efficient blows between the particles to form flocs, which can be removed from the water through the sedimentation process. The third process is sedimentation, which removes unwanted suspended particles (sand, clay) and some other contaminants from the water under the influence of gravity, improving the visual quality of water and making it more acceptable to the consumer. There are several types of chemicals that can be used as coagulants, but the choice of chemical coagulants depends on the nature of the suspended solid particles to be removed, the raw water conditions, the plant design and the cost of the chemicals needed. Jar test experiments were performed for different values of water turbidity. The water samples had initial turbidity values of 70 NTU, 140 NTU and 250 NTU. A series of Jar test experiments were performed to find the optimal pH and coagulant dose. Jar test experiments were conducted for different pH values of 5.5, 7 and 8.5. Sulfuric acid with a concentration of 0.0516M and sodium hydroxide with a concentration of 0.097M were used to adjust the pH of the samples. The amount of coagulant added was (10 mg/L for the first container, 20 mg/L for the second container, 30 mg/L for the third container, 40 mg/L for the fourth container). Rapid mixing (coagulation) was performed for a time of 1.5 minutes and at a speed of 120 rotations per minute, slow mixing (flocculation) was performed for a time of 25 minutes and at a speed of 20 rotations per minute and sedimentation was performed for a time of 30 minutes. In this paper the Aluminum sulfate and iron chloride were used as coagulants. Both coagulants used showed high efficiency in removing turbidity from water. The results showed that the removal of water turbidity depends on the pH, coagulant dose, as well as the initial water turbidity for both coagulants used. The highest efficiency of turbidity removal rate using aluminum sulfate as coagulants was in the pH value 7, while the highest efficiency of turbidity removal percentage using iron chloride as coagulants was in pH value 8.5.

Hulumtimi i efikasitetit të reaktorit të mbyllur ciklik dhe atij me llum aktiv në zvogëlimin e azotit dhe fosforit gjatë trajtimit të ujërave të zeza

Research of efficiency of sequencing batch reactor and activated sludge tank in reduction of phosphorus and nitrogen

MENSUR KELMENDI

Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë
Mitrovicë, KOSOVA
mensur.kelmendi@umib.net

MEHUSH ALIU

Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë
Mitrovicë, KOSOVA
mehush.aliu@umib.net

ENDRIT KELMENDI

Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë
Mitrovicë, KOSOVA
endrit.kelmendi@umib.net

Fjalë çelës: reaktori, ciklik, llum aktiv, ndotja, ujëra

Keywords: reactor, cyclic, reactive sludge, pollution, water

Përmbledhja:

Për dallim nga vendet e zhvilluara, te ne trajtimi i ujërave të zeza në mungesë të impianteve është njëri prej problemeve më serioze me të cilat po vazhdon të ballafaqohet shoqëria jonë. Mirëpo, kësaj radhe hulumtimi ynë ka të bëjë me përcaktimin e shkallës së reduktimit të azotit dhe fosforit pas trajtimit të ujërave të zeza në impiantin që funksionon me reaktor të mbyllur ciklik dhe atë me llum aktiv e që ndodhet në fshatin Maxhunaj të Vushtrisë. Duke ditur se azoti dhe fosfori janë dy nga treguesit më të rëndësishëm që merren për bazë në praktikën e vlerësimit të ujërave të ndotura, na ka motivuar që të hulumtojmë shkallën e pranisë së tyre edhe pas trajtimit impiatik, për të kontrolluar shkallën e eutrofikimit të ujërave sipërfaqësorë. Në rastin kur përbërësit që përmbajnë nitrate dhe fosfate lirohen të pa trajtuara në ujërat sipërfaqësorë, ato krijojnë probleme serioze në rrjedhjet ujore. Fosfatet dhe nitratet janë lëndë ushqyese (nutrient) kryesorë të nevojshëm për mikroorganizmat e gjallë dhe proceset e tyre fiziologjike, mirëpo nëse përqendrimi i tyre është përtej vlerave të lejuara, ato konsiderohen ndotës. Për reduktimin e azotit total, gjatë hulumtimit tonë, në të dy reaktorët është aplikuar metoda biologjike që bazohet në dy procese: procesin e nitrifikimit biologjik, përkatësisht transformimin aerobik të $\text{NH}_4\text{-N}$ në nitrite ($\text{NO}_2\text{-N}$) dhe pastaj në nitrate ($\text{NO}_3\text{-N}$), duke i përdorur kompresorët e ajrimit për të shtuar oksigjen dhe mundësuar zhvillimin e baktereve nitrifikuese dhe procesin e denitrifikimit, përkatësisht reduktimin anoksik të $\text{NO}_3\text{-N}$ në N_2 , duke shfrytëzuar bakteret fakultative që zhvillohen gjatë këtij procesi. Ndërsa, në rastin e reduktimit të fosforit total, në reaktorin me llum aktiv është aplikuar metoda biologjike, kurse në reaktorin e mbyllur ciklik, është zbatuar metoda kimike, ku si koagulant gjatë procesit të trajtimit është përdorur klorur hekuri (FeCl_3). Gjatë trajtimit biologjik, fosfori përfshihet në biomasën qelizore e cila më pas largohet nga procesi, si rezultat i shkarkimit të llumit. Për të arritur një nivel të ulët të përbërësve të tretur të fosforit, kuptohet gjatë trajtimit kimik, jonet metalike duhet të jenë të pranishëm në tepicë në krahasim me përqendrimin e jonit të fosforit. Duhet pasur parasysh kushtet klimatike ose edhe përmbajtjen e sasisë së fosforit në hyrje me çka rezultoi që dozimi i klorur hekurit në reaktorin e mbyllur ciklik është ndryshuar në sasi më të lartë ose të ulët, varësisht nga ndryshimet të

faktorëve të përmendur. Gjatë punës hulumtuese e eksperimentale, janë përcaktuar parametrat e azotit total dhe fosforit total, duke aplikuar metodat klasike dhe bashkëkohore të analizës kimike. Rezultatet e fituara të përqendrimit të ndotësve, në sistemin për trajtimin e ujërave të ndotura në reaktorin e mbyllur ciklik (SBR) dhe reaktorin me llum aktiv (AST) janë krahasuar me vlerat referente (vlerat maksimale të lejuara-VML) të Udhëzimit Administrativ 30/2014, duke u bazuar në shtojcën II dhe tabelën 1,2,3 dhe 4 të kësaj shtojce për shkarkimin e ujërave të zeza, e që është në përputhje të plotë me Direktivat e Bashkimit Evropian. Gjatë hulumtimit tonë, rezultatet e fituara dëshmojnë për tejkalim të vlerave referente të fosforit total në reaktorin me llum aktiv, ku për trajtim të ujërave të zeza është aplikuar vetëm metoda biologjike. Një rezultat i tillë na jep të kuptojmë se edhe për kundër trajtimit me impiante të ujërave të zeza, prapë se prapë, prania e nutrientve, edhe pse me një koncentrim shumë më të ulët, është e pranishme në ujërat e trajtuara. Mirëpo, përkundër kësaj, një nga prioritetet më të rëndësishme të institucioneve tona kompetente duhet të jetë ngritja e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura urbane dhe industriale, sepse kjo është zgjidhja e vetme për ruajtjen e ujërave sipërfaqësorë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Abstract:

Unlike developed countries, in our country wastewater treatment in the absence of plants is one of the most serious problems that our society continues to face. However, this time our research is related to determining the degree of reduction of nitrogen and phosphorus after wastewater treatment in the plant that operates with a sequencing batch reactor and that with activated sludge located in the village of Maxhunaj in Vushtrri. Knowing that nitrogen and phosphorus are two of the most important indicators taken into account in the practice of wastewater assessment, has motivated us to investigate the degree of their presence even after impiatal treatment, to control the degree of eutrophication of water superficial. In the event that compounds containing nitrates and phosphates are released untreated into surface waters, they create serious problems in water runoff. Phosphates and nitrates are the main nutrients necessary for living microorganisms and their physiological processes, but if their concentration is beyond the permitted values, they are considered pollutants. For the reduction of total nitrogen, during our research, in both reactors, a biological method was applied based on two processes: the process of biological nitrification, respectively the aerobic transformation of $\text{NH}_4 - \text{N}$ into nitrite ($\text{NO}_2 - \text{N}$) and then into nitrate ($\text{NO}_3 - \text{N}$), using aeration compressors to add oxygen and enable the development of nitrifying bacteria and the denitrification process, namely the anoxic reduction of $\text{NO}_3 - \text{N}$ to N_2 , utilizing the optional bacteria that develop during this process. Whereas, in the case of reduction of total phosphorus, biological method was applied in the reactor with active sludge, while in the sequencing batch reactor, chemical method was applied, where iron chloride (FeCl_3) was used as a coagulant during the treatment process. During biological treatment, phosphorus is included in cellular biomass which is then removed from the process as a result of sludge discharge. To achieve a low level of dissolved phosphorus components, it is understood during chemical treatment, metal ions must be present in excess relative to the concentration of phosphorus ion. The climatic conditions or even the content of the amount of phosphorus in the input should be taken into account which resulted in the dosing of ferric chloride in the closed cyclic reactor being changed to a higher or lower amount, depending on the changes of the mentioned factors. During the research and experimental work, the parameters of total nitrogen and total phosphorus were determined, applying classical and modern methods of chemical analysis. The obtained results of pollutant concentration in the wastewater treatment system in the sequencing batch reactor (SBR) and activated sludge tank (AST) are compared with the reference values (maximum allowed values-VML) of Administrative Instruction 30 / 2014, based on Annex II and Tables 1, 2, 3 and 4 of this Annex on wastewater discharge, which is in full compliance with the Directives of the European Union. During our research, the results obtained indicate that the reference

values of total phosphorus in the reactive sludge reactor were exceeded, where only biological methods were applied for wastewater treatment. Such a result gives us to understand that even against the treatment with wastewater plants, still, the presence of nutrients, although with a much lower concentration, is present in the treated water. However, despite this, one of the most important priorities of our competent institutions should be the establishment of urban and industrial wastewater treatment plants, because this is the only solution for surface water conservation and environmental protection.

Rëndësia e zbatimit të konventës së Kryebashkiakëve për Bashkinë e Tiranës

The importance of the implementation of the Covenant of Mayors in the Municipality of Tirana

AIDA SPAHIU
Universiteti Politeknik i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
aida_spahiu@yahoo.com

LORETA NAKUÇI
Instituti "Harry Fultz"
Tiranë, ALBANIA
loreta.nakuci@gmail.com

LINDITA DHAMO
Universiteti Politeknik i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
lindita.dhamo@gmail.com

Fjalë çelës: konsumi energjisë, reduktimi CO₂, efienca, ndriçimi rrugor,
Keywords: energy consumption, reduction CO₂, efficiency, street lighting

Përmbledhja:

Pakti i Kryetarëve të Bashkive për klimën dhe energjinë është lëvizja kryesore vullnetare evropiane, e cila përfshin autoritetet vendore në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të qëndrueshme të energjisë dhe klimës. Pakti i Kryetarëve të Bashkive është një nismë e bazuar në Bashkimin Evropian, e cila filloi në vitin 2008 dhe Kryetari i Bashkisë së qytetit të Tiranës e ka nënshkruar atë në 2013. Pakti i Kryebashkiakëve është një përgjigje e qyteteve ndaj sfidave të ndryshimit të klimës globale, e orientuar drejtpërdrejt drejt përfshirjes aktive dhe pjesëmarrjes së vazhdueshme të administratave të qyteteve dhe vetë qytetarëve në luftën kundër ndryshimit të klimës. Kryetari i Bashkisë së Tiranës duke nënshkruar Paktin e kryetarëve të bashkive angazhohen për zhvillimin e Planit të Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme (PVEQ), të përgatitur në vitin 2015. Plani i Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme (PVEQ) është dokumenti kryesor, i cili në bazë të të dhënave të mbledhura mbi situatën, identifikon dhe siguron udhëzime të sakta dhe të qarta për zbatimin e projekteve dhe masave të eficiencës së energjisë dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në nivel qyteti. Plani i Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme zbaton masa të shumta të eficiencës të energjisë, si rezultat i zbatimit të të cilave do të arrihet në uljen e emetimeve të CO₂ në territoret e Tiranës me më shumë se 20% deri në vitin 2020 dhe të paktën 40% deri në vitin 2030. Zhvillimi dhe zbatimi i PVEQ në qytetin e Tiranës ka si qëllime kryesore: 1. reduktimin e konsumit të energjisë në sektorët e ndërtesave publike dhe private, transportin dhe ndriçimin publik, ujin dhe përpunimin e ujërave të zeza e kompanive publike përmes zbatimit të masave të eficiencës së energjisë, diversifikimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, menaxhimi i konsumit të energjisë etj.; 2. Reduktimi i emetimeve të CO₂; 3. Mundësimi i transformimit të zonave urbane në zona ekologjikisht të qëndrueshme. Punimi synon të bëjë një analizë të detajuar në lidhje me reduktimin e konsumit të energjisë dhe emetimit të gazrave serë nga zbatimi i masave të vendosura në PVEQ dhe që po zbatohen nga qeveria vendore e bashkisë së Tiranës, deri në vitin 2020. Ky është studimi i parë që ka në fokus rëndësinë e zbatimit të masave të eficiencës së energjisë nga administrata lokale e bashkisë së Tiranës, me qëllim zvogëlimin e konsumit të energjisë dhe emetimin të gazrave serë. Deri tani nuk ka pasur asnjë studim monitorues në lidhje me zbatimin e masave të identifikuara

të eficiencës së energjisë, që po aplikohen nga pushteti vendor i bashkisë së Tiranës. Analiza në punim është fokusuar në katër masa të përdorimit eficient të energjisë: 1. zëvendësimi i motorëve elektrikë me rendiment të ulët me ato me rendiment të lartë dhe kompensim të fuqisë reaktive në sektorin e ujësjellës kanalizimeve; 2. Rinovimi i ndërtesave publike dhe private, 3. Zëvendësimi i llambave të ndriçimit rru- gor me ato LED dhe rinovimi i ndriçimi publik ekzistues sipas parimit të eficiencës së energjisë, 4. Procesi i auditimit të konsumit të energjisë në sektorët publik të bashkisë së Tiranës. Studimi është përqendruar në këto katër masa të eficiencës së energjisë, duke pasur parasysh kontributin e lartë, që ato kanë në reduktimin e konsumit të energjisë elektrike, reduktimin e CO₂ dhe menaxhimin e mirë të konsumit të energjisë, bazuar në objektivat e vendosur nga Strategjia Kombëtare e Energjisë për ekonominë dhe shoqërinë shqiptare, në mënyrë që të arrihet një nivel i kursimit të energjisë kundrejt konsumit të përgjithshëm me 15% në 2030 dhe reduktimi i emetimeve të gazeve serë kundrejt totalit prej 11.5% në 2030. Mbështetur në analizën e bërë dhe rezultatet e marra punimi jep rekomandimet e duhura për zbatimin efektiv të këtyre masave të eficiencës së energjisë nga pushteti vendor i qytetit të Tiranës. Rezultatet e studimit do të japin një pasqyrë më të mirë të konsumit të energjisë dhe reduktimit të CO₂ nga zbatimi i masave të eficiencës të energjisë të vendosura në Planin e Veprimit të Energjisë së Qëndrueshme, nga qeveria vendore e qytetit të Tiranës për të arritur objektivat e vëna.

Abstract:

The Covenant of Mayors for Climate and Energy is the mainstream European voluntary movement involving local authorities in the development and implementation of sustainable energy and climate policies. The Covenant of Mayors is an European Union based initiative, which started in 2008 and Mayor of Tirana city has signed it in 2013. The Covenant of Mayors is a response of cities to the challenges of the global climate change, directly oriented towards active involvement and continuous participation of city administrations and the citizens themselves in the struggle against climate change. Mayor of Tirana Municipality by signing the Covenant of mayors commit to the development of the Sustainable Energy Action Plan (SEAP), prepared in 2015. Sustainable Energy Action Plan (SEAP) is the main document, which on the basis of collected data on the current situation, identifies and provides precise and clear guidelines for the implementation of projects and measures of energy efficiency and use of renewable sources of energy at the city level. The Sustainable Energy Action Plan apply numerous measures of energy efficiency, which will in the end lead to the reduction of CO₂ emissions in Tirana territories by more than 20% by 2020 and at least 40% up to 2030. The development and implementation of SEAP in Tirana city has the main goals: 1. Reduction of energy consumption in the sectors of public and private buildings, public transport and lighting, water and irrigation public companies through the implementation of energy efficiency measures, diversification of renewable sources of energy, management of consumption etc. 2. Reduction of the CO₂ emissions. 3. Enabling the transformation of urban areas into ecologically sustainable areas. The paper aims to do the detailed analysis about the reduction of energy consumption and green gases emission from the implementation of measures put in SEAP and are implementing by local government of Tirana municipality up to 2020. This is the first study that has in focus the importance of implementation of SEAP measures from local government of Tirana municipality in order to reduce energy consumption and green gases emission. There is not any monitoring study about the implementation of identified measures of energy efficiency that are applying from local government of Tirana municipality. The analysis is focused on four energy efficiency measures: 1. replacing the low efficiency electric motors with high efficiency one and reactive power compensation in water sector, 2. Renovation of public and private buildings, 3. Replacing of old lighting street with LED and reconstruction of existing public lighting according to energy efficiency principle, 4. Auditing process of energy consumption on public sectors. The study is focused on these four energy efficiency measures knowing the high contribution that they have in

reduction of energy consumption, reduction of CO₂ emission and good management of energy consumption, based on targets put from National Strategy of Energy for Albanian economy and society in order to reach a level of energy savings versus total consumption by 15% in 2030 and reduction of green gases emissions versus total 11.5% in 2030. Based on analysis and taken results will be given the proper recommendations about effective implementation of these measures from local government of Tirana city. The results of study will give a better view of energy consumption and CO₂ reduction from implementation of energy efficiency measures put on Sustainable Energy Action Plan, from local government of Tirana city in order to achieve the targets.

Ndikimi i lopatave në trupin e furrave rrotulluese, në uzinën e ferronikelit në Drenas

Impact of shovels on the body of rotary kiln, in the ferronikel plant in Drenas

ZARIFE BAJRAKTARI-GASHI

UIBM

Mitrovicë, KOSOVA

z_gashi98@yahoo.com

Fjalë çelës: Xeheror, hekur nikel, furra rrotulluese, fergesa, etj

Keywords: Ore, iron nickel, rotary kiln, calcine etc

Përmbledhja:

Në këtë punim do paraqesim projektin që është realizuar në uzinën e ferronikelit të ri në Drenas, gjatë viteve 2019-2020. Xeheroret e hekur-nikelit janë xeherorë të varfra me përqindje të nikel, prandaj për përfitimin e nikelit nga xeheroret okside që uzina e ferronikelit i disponon nevojiten burime të mëdha të energjisë. Problemet e procesit të fërgimit të furrave rrotulluese janë faktorët te cilët kanë ndikuar në projektin e vendosjes së lopatave brenda furrave rrotulluese, dhe ndryshimit të materialeve zjarrduruese brenda furrave rrotulluese. Lagështia e madhe e xeherorit të hekur-nikelit, është njëri ndër faktorët të cilët ndikon në vështirësitë e fërgimit të ngarkesës së hekur-nikelit në furra rrotulluese, ku asnjë zone e furrave rrotulluese nuk mundë ta realizon pjesën e punës për të cilën është projektuar. Për një realizim me të mirë të përgatitjes së fërgesës në furra rrotullues, projekti i ndryshimeve në trupin e furrave rrotulluese ka filluar në qershor të vitit 2019, në të dy furrat rrotulluese. Lopatat e vendosura janë të ndryshme për të tri zonat e furrave rrotulluese, në zonën e parë janë vendosur tri forma duke fillua me formën me të shkurtër në hyrje të ngarkesës harkore me e shkurtër, në mënyrë që shpërndarja e ngarkesë të hynë në zonën e para nxehtë duke u shpërndarë nga të pjesët e lopatave të vendosura në zonën e parë, në mënyrë që edhe përzierja gjatë rrotullimeve të furrave rrotulluese të jetë me e mirë. Në zonën e dytë forma e lopatave të vendosura është me e shkurtër në mënyrë që nxehtësia që realizohet në këtë zonë të arrin të depërton në tërë hapësirën e ngarkesës. Në zonën e fërgimit forma e lopatave është konike. Në trupin e furrave rrotulluese është bërë ndryshimi i materialit zjarrdurues, ku deri në qershor të vitit 2019 materiali zjarrdurues ishte shamot, nga qershori është larguar materiali zjarrdurues shamot dhe është vendosur termobeton i ankeruar. Me vendosjen e lopatave brenda furrave rrotulluese është arritur një përmirësim i procesit në furra rrotulluese. Mesatarja e shkallës së parareduktimit nga 46.97% që ishte në vitin 2018 është rritur në 51.14 % në vitin 2019 dhe 53.9% në vitin 2020. Si faktorë i rëndësishëm i procesit të fërgimit brenda furrave rrotulluese është temperatura e fërgesës, ku sa me e lartë që është temperatura e fërgesës aq me cilësore arrihet përbërja e fërgesës si një mundësi e zvogëlimit të shpenzimeve të energjisë elektrike në furra elektrike. Nga vendosja e lopatave është rritur mesatarja e temperaturës së fërgesës nga 738 [U+2103] në vitin 2018, në 751 [U+2103] në vitin 2019 dhe 760 [U+2103] në vitin 2020. Nga rezultatet e projektin të vendosjes së lopatave brenda furrave rrotulluese kemi një përmirësim të procesit të furrave rrotulluese, duke bërë edhe mundësi të projekteve tjera që uzina e ferronikelit do i projekton me mundësi të përmirësimit të proceseve metalurgjike dhe përfitimit të legurës së Fe-Ni me cilësi të lartë dhe humbjet e nikelit të jenë sa me minimale. Ndikimi i lopatave në procesin e furrave rrotulluese do të këtë ndikim edhe me të lartë, nëse

xeherorit i hekur-nikelit do të i nënshtrohet tharjes se xeherorit dhe përpunimi i xeherorit të hekur-nikelit do realizohet me sukses, ku zvogëlimi i lagështisë është faktor i rëndësishme i procesit në furra rrotulluese.

Abstract:

In this paper, we will present the project that has been realized in the new ferronickel plant in Drenas, during the years 2019-2020. Ferro-nickel ores are poor in nickel percent ores, so large amounts of energy are needed to obtain nickel from the oxide ores available at the ferronickel plant. The problems of the fermentation process of the rotary kilns are the factors that have influenced the project of placing the shovels inside the rotary kilns and the change of the refractory materials inside the rotary kilns. The high humidity of iron-nickel ore is one of the factors that affect the difficulties of frying the load of iron-nickel in rotary kilns, where no area of the rotary kiln can perform the part of the work for which it is designed. For a better realization of frying preparation in rotary kilns, the project of changes in the body of rotary kilns started in June 2019, in both rotary kilns. The placed shovels are different for the three areas of the rotary kilns, in the first area three forms are placed starting with the shortest form at the entrance of the shortest arc load so that the load distribution enters the pre-heat zone being distributed by all the parts of the shovels placed in the first zone so that the mixing during the rotations of the rotary kilns is even better. In the second zone, the shape of the shovels placed is shorter so that the heat generated in this area manages to penetrate the entire load space. In the fermentation zone, the shape of the shovels is conical. In the body of the rotary kilns, the refractory material was changed, where until June 2019 the refractory material was chamotte, from June the chamotte fireproof material was removed, and anchored thermo concrete was placed. By placing the shovels inside the rotary kilns an improvement of the process in the rotary kilns was achieved. The average pre-reduction rate from 46.97% that was in 2018 has increased to 51.14% in 2019 and 53.9% in 2020. An important factor of the frying process inside the rotary kilns is the frying temperature, where the higher the frying temperature, the better the composition of the frying pan is achieved as an opportunity to reduce electricity consumption in electric kilns. From the placement of the shovels, the average frying temperature has increased from 738 [U+2103]. In 2018, to 751 [U+2103] in 2019 and 760 [U+2103] in 2020. From the results of the project of placing the shovels inside the rotary kilns, we have an improvement of the process of the rotary kilns, making possibilities of other projects that the ferronickel plant will design with the possibility of improving the metallurgical processes and obtaining the Fe-Ni alloy with high quality and nickel losses to be as minimal as possible. The impact of shovels on the process of rotary kilns will have an even higher impact if the iron-nickel ore will be subjected to ore drying and the processing of iron-nickel ore will be carried out successfully, where the reduction of moisture is a factor of important process in rotary kilns.

Arkitektura dhe dimensionin digjital në rikrijimin e marrëdhënieve shoqërore dhe hapësinore

Architecture and the Digital Dimension: Recreating Social and Spatial Relations

DASARA PULA
Universiteti Polis
Prishtinë, KOSOVA
puladasara@gmail.com

Fjalë çelës: Arkitektura, Teknologjia digjitale, Marrëdhëniet shoqërore, Trashëgimia kulturore

Keywords: Architecture, Digital technology, Social relations, Cultural heritage

Përmbledhja:

Kuptimi i një fenomeni arkitektonik është strukturalisht i lidhur me instancat politike, shoqërore, ekonomike, kulturore, shkencore apo teknologjike. Arkitektura është përfaqësues i kushteve (reale, apo në raste të caktuara imagjinare) të krijuara nga këto instance. Nga vitet e 60-ta e deri më sot, teoricienë të arkitekturës si Manfredo Tafuri, e trajtuan arkitekturën si të lidhur, madje edhe të ndikuar, nga të gjitha ndryshimet në politikë, në ekonominë globale dhe prodhimin e përgjithshëm kulturor. Në përkufizimin e Post modernizmit, Fredrick Jameson argumenton se arkitektura, ideologjia, psikanaliza, kultura digjitale, teknologjia, etj., janë të ndërlidhura me njëra tjetrën. Kështu, ato krijojnë një fushë forcash të praktikave, veprimeve dhe ngjarjeve të ndryshme, të cilat ndonëse nuk janë gjithmonë kundërshtuese mes vete, kanë ndikim në njëra tjetrën. Në veprën e tij *The Origins of Modern Town Planning* (1967), L. Benevolo prezantoi tezën sipas të cilës reforma e përgjithshme shoqërore duhet të ndodhë njëkohësisht me reformën arkitektonike dhe urbane. Sot, procesi i përsheptuar i digjitalizimit adreson nevojën për një “reformim” të kushteve të shoqërisë dhe të ekzistencës së saj materiale të përfaqësuar përmes qytetit dhe arkitekturës së tij. Në këtë kontekst, ky punim e trajton arkitekturën si metaforë të një gjuhe që mundëson komunikimin midis hapësirës urbane dhe formave bashkëkohore të zhvillimit shoqëror, duke theksuar funksionin e teknologjive digjitale në qëndrueshmërinë e formës urb-arkitektonike dhe trashëgimisë kulturore. Teoria e arkitekturës, nisur nga vitet 1960 me shfaqjen e kulturës post moderne, ka sjellë vazhdimisht në diskutim marrëdhënien e dimensionit shoqëror dhe teknologjik dhe/apo digjital. Strukturat arkitektonike dhe urbane, reale apo utopike, kanë shërbyer për të interpretuar se si arkitektura përfaqëson shoqërinë, duke përdorur strategjitë e saj tekno-artistike dhe tekno-estetike për të marr pjesë në organizimin e jetës njerëzore individuale dhe kolektive. Qëllimi i këtij punimi është krijimi i një kornize teorike për diskutimin e mënyrave konkrete në të cilat arkitektura mund të përdorë instrumentet digjitale për të krijuar skenarë të mundshme për zhvillimin e ardhshëm të qytetit. Si rast studimi përdoret qyteti i Prishtinës, në veçanti trashëgimia (post) moderne e tij. Në këtë mënyrë, ky punim kontribuon në zgjerimin e diskursit mbi post modernizmin në kontekstin e shteteve post-socialiste në Evropën Juglindore, meqenëse ky diskurs shpesh limitohet në kontekstin e kulturave perëndimore. Dihet se instrumentet digjitale (p.sh. kompjuterët që përdorin programet e modelimit 3D dhe sistemet e hartëzimit të bazuara në inteligjencën artificiale) kanë një ndikim të dukshëm në kuptimin e thellë të marrëdhënieve strukturore dhe hapësinore. Megjithatë, qëllimi i këtij punimi është që të adresohen dy pyetje: 1) Nëse digjitalizimi në praktikën arkitektonike mund të stimulojë qëndrueshmërinë e formave

urbane dhe tipave të ndërtimit, si pjesë e trashëgimisë kulturore; 2) Cili është ndikimi i kulturës digjitale - gjithnjë në zhvillim - në funksionin e arkitekturës si përfaqësim i kushteve politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore. Për t'ju përgjigjur këtyre pyetjeve, do të përdoret "hartëzimi" si një model për të studiuar hapësirën ku njerëzit mund të përcaktojnë pozicionin e tyre apo totalitetin urban në të cilin ndodhen. Procesi i hartëzimit konsiderohet si interpretim i marrëdhënieve imagjinare të arkitektëve (rrjedhimisht njerëzve) me kushtet e tyre reale të ekzistencës. Ky punim i takon fushës së teorisë dhe kritikës së arkitekturës. Dizajni metodologjik bazohet në një kombinim metodash siç janë analizat e teksteve dhe diskurseve, dhe analizat morfologjike e tipologjike. Gjetjet nga ky hulumtim do të përdoren në rastin e studimit, që është qyteti i Prishtinës prej viteve të 70-ta e tutje. Qysh në fillim, për qëllime krahasuese do të përdoren shembuj të ndryshëm nga historia e arkitekturës, në mënyrë që studimi të mos kufizohet në një rast të vetëm. Duke pasur parasysh pamundësinë e studimit të arkitekturës në epokën e digjitalizimit, në rastin e Prishtinës (dhe kudo tjetër), në mënyrë lineare gjatë gjithë periudhës që nga vitet e 70-ta, ky punim do të identifikojë ndërtesa dhe lokacione të caktuara që do të përdoren si shembuj studimi.

Abstract:

Our understanding of an architectural phenomenon is structurally connected with political, social, economic, cultural, scientific or technological instances. Architecture - the building and the city - is a representation of the (real or, on occasion imaginary) conditions created from these instances. From the sixties and onwards, architectural theorists such as Manfredo Tafuri, positioned architecture as related and even impacted by all the changes in politics, world economy and general cultural production. Fredrick Jameson - while defining Postmodernism - argues that architecture, ideology, psychoanalysis, digital culture, technology, etc., are connected with each other. Thus, they create a force-field of different practices, actions and events, that if not always competitive with one another, are interrelated and impact each other. In *The Origins of Modern Town Planning* (1967), L. Benevolo introduced his thesis, by which an overall social reform should take place simultaneously with an urban and architectural reform. Today, the rapid digitalization process addresses the need for a "reformation" of the conditions of the society and its material existence represented through the city and its architecture. In this context, this work deals with the idea that architecture is a metaphor for a language that facilitates communication between the urban space and contemporary forms of social development, emphasizing the function of digital technologies in the sustainability of the urb-architectural form and cultural heritage. The theory of architecture, starting from the 1960s with the emergence of postmodern culture, has constantly brought into discussion the relationship between the social and technological and/or digital dimension. Real and utopian, urban and architectural structures, served to interpret how architecture could represent the society, using its techno-aesthetic and techno-artistic strategies to participate in the organization of individual and collective human life. The aim of this work is to set a theoretical framework for discussing the concrete ways in which architecture can utilize digital tools to create possible scenarios for the future development of the city, using as a case-study the city of Prishtina and its (post-)modern heritage in particular. In so doing, this work extends the discourse on postmodernism in the context of post-socialist states, in South-Eastern Europe, as this discourse is often limited to the contexts of western cultures. Digital tools (e.g. computers using 3D modelling programs or mapping systems based on artificial intelligence) are known to have a distinct impact in creating a deep understanding of the structural and spatial relationships. Yet, the objective of this work is to question: 1) If digitalization in architectural practice can stimulate the sustainability of inherited urban forms and building types; 2) How the ever-evolving digital culture impacts architecture's function as a representation of political, social, economic, and cultural conditions. To answer these questions, we will use "mapping" as a model to study the space in which people are able to map their own positions or the

urban totality in which they find themselves. The mapping process is a representation of both people's and architects' imaginary relationship to their real conditions of existence. This work belongs to the field of theory and critique on architecture. The methodological design is based on a mix of methods, such as text and discourse analysis, and morphological and typological analysis. The findings from the research will be utilized in the case study, the city of Prishtina from the 1970s and onwards. To avoid the narrow base of case-study research from its inception, in the course of its development, different examples from the history of architecture will be used for comparative purposes. Considering the impossibility to study architecture in the digitalization era in Prishtina - or anywhere else - in a linear fashion through the entire period from the 1970s, this work identifies specific buildings and sites to be used as study samples.

Mbi rëndësinë dhe llogaritjen e treguesit të ri, EsCJ, për vlerësimin mjedisor të mbulesës së banesave

On the importance and calculation of the new indicator, EeLC, for environmental assessment of the dwelling roofs

SHPRESA CASLLI

Fakulteti Inxhinierise Mekanike, Universiteti
Politeknik i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
shcaslli@fim.edu.al

DERVISH ELEZI

Fakulteti Inxhinierise Mekanike, Universiteti
Politeknik i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
derviel@yahoo.com

ELFRIDA SHEHU

Fakulteti Inxhinierise Ndertimit, Universiteti
Politeknik i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
elfridaal@yahoo.com

Fjalë çelës: çati ekologjike, materiale termoizolues, eko projektim, EsCJ,
Keywords: ecological roof, thermo insulating materials, eco design, EeLC,

Përmbledhja:

Punimi ofron një set materialesh termoizoluese për çatitë. Çatitë e krahasuara janë tre tipe: me tarracë betoni, me çati druri dhe me çati betoni. Fillimisht krahasohen çatitë e patermoizoluara dhe të termoizoluara, brenda tipit. Për këtë llogariten përkatësisht humbjet termike kur çatitë janë të patermoizoluara dhe më pas kur në to montohen edhe panelet termoizoluese. Rezultatet e përlllogaritjeve tona i aplikojmë në Programin kompjuterik përzgjedhës, CES EduPack - Eco Selector dhe vlerësojmë treguesin mjedisor përkatës nëpërmjet Metodës së Projektimit EKO: EsCJ (MJ/m² vit), Energji e shpenzuar gjatë gjithë ciklit të jetës të banesës tradicionale me çati / tarracë, çati druri dhe çati betoni. Më pas zgjidhjet e ofruara krahasohen jo vetëm ndërmjet tyre, për të treguar se cila nga çatitë ekologjike ka koston më të ulët mjedisore (humbjet më të pakta në funksion të materialit termoizolues të përdorur), por edhe për të llogaritur EsCJ e banesës për secilën tip çatie dhe klasifikimin përkatës në etiketën mjedisore.

Hyrje Në vendin tonë, shtëpitë e banimit, të cilat njihen me emërtimin 'tradicionale me çati' dhe ndërtesat disakatëshe me apartamente me tarracë, të para viteve '90, kryesisht janë të patermoizoluara. Por, shumë shpejt banorët e këtyre banesave do të interesohen që t'i kthejnë ato në ekologjike. Qëllimi i këtij punimi është që t'i ofrojë projektuesve (konstruktorëve, arkitektëve, etj) të dhënat karakterizuese të materialeve termoizoluese për çatitë ekologjike, bazuar në një këndvështrim të ri, atë të treguesit mjedisor, EsCJ. Gjithashtu synojmë ndërgjegjësimin e projektuesve të banesave që ta përfshijnë këtë tregues të ri si kriter për kategorizimin mjedisor të banesave. Nëpërmjet këtij treguesi, krahas energjisë së shpenzuar për ngrohje-ftohje, ata do të bëjnë klasifikimin e banesës në njërin nga kategoritë e etiketës mjedisore, me synimin që t'i afrohen nivelit më ekologjik, A. Punimi merr në konsideratë një set me tre tipe panelesh termoizoluese, IZOTEGOLA, XPS DOW ROOFMATE SL-A: 3, 4 & 6cm dhe EPS: 5cm që u përdorën në secilën nga çatitë ekologjike, duke iu nënshtruar vlerësimit mjedisor.

Procedura e llogaritjes së treguesit mjedisor Banesa dykatëshe është po ajo që kemi marrë në studimin tonë të mëparshëm. Kjo banesë tradicionale (e përlllogaritur në kategorinë D të etiketës mjedisore), tashmë është termoizoluar nga jashtë me panele termoizoluese BETOPAN, po ashtu edhe me dritare

dopio xham e dyer, duke kaluar në nivelin C të etiketës mjedisore [.]. Le të shikojmë se në cilin nivel do të kalojmë në rast se zgjedhim një çati të përshtatshme me humbje energjetike sa më të pakta.

Hapat në procedurën e llogaritjeve të treguesit mjedisor:

1. Bëhen llogaritjet e humbjeve termike kur terraca/çatia është e patermoizoluar; Përcaktohet 'Energjia e shpenzuar gjatë gjithë ciklit të jetës' [.]; 2. Realizohet termoizolimi me ndihmën e paneleve / shtresave termoizoluese sipas llojit të çatisë dhe më pas do të përlllogariten humbjet energjetike, me metodat klasike inxhinierike për secilën; 3. Të dhënat do të futen në projektin Eko Audit të CES Edu-Pack 2012 dhe nga rezultatet e gjeneruara: 'Energji e shpenzuar në çdo fazë të jetës' ose 'Gjurmë e karbonit e lëshuar në atmosferë', do të bëjmë krahasimet ndërmjet mbulesave/çatave të patermoizoluara dhe atyre të termoizoluara, për të gjetur çatinë me treguesit mjedisorë më të mirë. Rezultatet Banesa dy-katesh me terracë betoni, e patermoizoluar ka këtë tregues mjedisor: $E_{cJpa} \text{ izolim} = \text{Energji total} / \text{sipërfaqe} \times \text{vite} = 7.4 \times 10^6 / 480 \times 50 = 308 \text{ MJ/m}^2 \text{ vite}$ ose $84.24 \text{ kWh/m}^2 \text{ vite}$ - Niveli D

Abstract:

This article offers a set of thermic insulation materials for roofs. The roofs compared are three types: concrete terrace, wooden roof and concrete roof. Initially, the without and with insulated roofs that were compared within the type for every insulating panels mounted. That is why thermal losses are calculated respectively when roofs are without insulated and then when insulated panels are assembled in them. The indicator assessed through Eco Design Method that applied in Selection Computerized Software, CES Edu Pack - Eco Selector databases: Expanded Energy all over the Life Cycle for traditional dwellings, EeLC (MJ /m².year) with roof/terrace, wooden roof and concrete roof. Subsequently, the solutions offered are compared not only between them, to show which of the thermic insulated roofs has the lowest environmental cost (the least losses depending on the insulated material used), but also to calculate the EeLC of the dwelling for each roof type and finding the corresponding classification on the environmental label for buildings.

Introduction In our country, residential dwellings, which are known as 'traditional roofed dwellings' and buildings with concrete terraces, built before the 1990, are mostly uninsulated. Soon the inhabitants of these dwellings will be interested in turning them into ecological. The purpose of this work is to provide designers (structural engineers, architects, etc.) not only the characterizing data of insulating materials for ecological roofs, seeing it on a new perspective, that of the environmental indicator, EeLC. We also aim for awareness of dwelling designers to include this new indicator as a criterion for environmental categorization of dwellings. Through this indicator, in addition to calculation of expended energy on heating and cooling, they will make the classification of the dwelling in one of the categories of environmental label, with the aim of getting as close as possible to the first ecological level, A. The article considers a set of three types of insulated panels, ISOTEGOLA, XPS DOW ROOFMATE SL-A: 3, 4 & 6cm and EPS: 5cm.

Procedure for calculating of environmental indicator The two floor-building dwelling is what we considered in our previous study [.]. This traditional dwelling (estimated in category D of environmental label), has already been insulated from outside walls with BETOPAN insulating panels, as well as double glass windows and door, passing at C level of the environmental label [.]. Let us see what level we go to if we choose a suitable roof with as low energy loss as possible.

Steps in the procedure of environmental indicator calculations:

1. Calculations of thermal losses are made when the terrace/roof is without insulation. The expended Energy throughout the life cycle is determined [.]; 2. Thermic insulation is carried out with the help of panels / insulated layers according to the roof type and then the energy losses will be calculated, with classical engineering methods for each; 3. The data will be entered into the Eco Audit project of CES Edu Pack's 2012 and from the results generated: 'Energy expended all over the life' or 'Carbon footprint released into the atmosphere', we will make comparisons between uninsulated covers/roofs and insulated ones, to find the roof with the best environmental indicators.

Results Before of thermic insulation of our dwelling with concrete terrace, this indicator will be:
EeLCwithout insulation = Total energy/surface x year = $7.4 \times 10^6 / 480 \times 50 = 308 \text{ MJ/m}^2 \text{ year}$ or
 $84.24 \text{ kWh/m}^2 \text{ year}$ - Level D (

Organizimi dhe funksionimi i sigurisë ushqimore në Kosovë

Organization and functioning of food safety in Kosovo

VALDET GJINOVCI
Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë
Mitrovicë, KOSOVA
valdet.gjinovci@umib.net

ISMET MULLIQI
Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë
Mitrovicë, KOSOVA
ismet.mulliqi@umib.net

FESTIM REXHEPI
Agjensia e ushqimit dhe veterinarisë
Prishtinë, KOSOVA
festim.rexhepi@rks-gov.net

Fjalë çelës: Kosova, siguria ushqimore, kontrollat zyrtare, shëndeti publik.

Keywords: Kosovo, food safety, official controls, public health.

Përmbledhja:

Organizimi i sistemit të sigurisë ushqimore në Republikën e Kosovës mbulon kontrollin prej prodhimit primar, pjesës së përpunimit, prodhimit të produkteve finale, fazat e shpërndarjes në pikat shitëse me pakicë, ku përmes kontrolleve zyrtare dhe mekanizmave të mbikëqyrjes nga autoriteti kompetent garantohej sistemi i kontrollit të sigurisë ushqimore në të gjitha produktet me origjinë bimore dhe shtazore me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik. Në kuadër të marrëveshjes së stabilizimit asociativ (MSA) në përputhje me kërkesat e acquis të BE -së, Kapitulli 12 Siguria e ushqimit, politikat fitosanitare dhe veterinarë është bërë harmonizimi i legjislacionit kombëtar në përputhje me politikat dhe kërkesat e Komisionit Evropian. Për më tepër është aprovuar ligji për ushqimin Nr. 03/L-016 si dhe rregulloret e pakos higjienike për organizimin e kontrolleve zyrtare dhe detyrimet e operatorëve të biznesit me ushqim, si Rregullorja nr.10/2011 për kontrollet zyrtare të ndërmarrja për të siguruar verifikimin e përputhshmërisë me ligjin për ushqimin dhe ushqimin për kafshë dhe rregullat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, Rregullorja nr.11/2011 për higjienën e prodhimeve ushqimore, Rregullorja nr.12/2011 për përcaktimin e rregullave specifike të higjienës së ushqimit me prejardhje shtazore dhe Rregullorja nr.13/2011 për caktimin e rregullave specifike për organizimin e kontrolleve zyrtare të ushqimit me prejardhje shtazore të dedikuara për konsum nga njerëzit, rregullore këto të harmonizuara nga Komisioni Evropian (Rreg nr. 852, 853, 854 dhe 882). Ligji i ushqimit është bazë për themelimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, autoritet kompetent i cili është themeluar në harmoni me politikat dhe kërkesat e komisionit evropian e cila siguron nivel të lartë të sigurisë së ushqimit për njerëz dhe kafshë. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë është përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit si në nivelin qendror ashtu edhe atë regjional/lokal duke zbatuar strategjinë e integruar për sigurinë e ushqimit "nga ferma në tryezë" përmes së cilës arrihet kontrolli i efikasitetit të gjithë sistemit të sigurisë ushqimore si dhe ngritje besimit e të gjitha palëve të interesit në politikën e sigurisë ushqimore, nga fermerët tek konsumatorët. Trajtimi i sëmundjeve ushqimore akute dhe sëmundjeve zoonotike të cilat barten nga kafshët tek njeriu, në bazë të paraqitjes së tyre autoriteti kompetent bën vlerësimin e rrezikut dhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete me qëllim parandalimin e përhapjes së tyre dhe mbrojtjen e shëndetit publik. Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe Ministria e Shëndetësisë (MSH) në bashkëpunim me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, janë përgjegjës për hartimin e legjislacionit

dhe politikave në lidhje me sigurinë e ushqimit, shëndetin kafshëve, shëndetin e bimëve dhe shëndetin publik veterinar. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, si agjenci ekzekutive është përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit që mbulon të gjithë zinxhirin ushqimor "nga ferma në tryezë", përfshirë importin/eksportin dhe transitin e ushqimit të kafshëve me prejardhje shtazore dhe jo shtazore, ushqimit për kafshë shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve dhe shëndetin e bimëve. Për më tepër, Ligji i Ushqimit është bazë dhe rregullon sistemin e kontrollit zyrtar, duke përcaktuar kompetencat e autoriteteve përgjegjëse për kryerjen e kontrolleve zyrtare. Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve që lidhen me sigurinë ushqimore bëhet në nivel qendror dhe regjional/lokal, ku përgatitja e planeve dhe kontrolleve zyrtare realizohet nga Agjencia e ushqimit dhe Veterinarisë. Artikulli fokusohet në organizimin dhe pikat e kontrollit të sistemit të sigurisë ushqimore në Republikën e Kosovës.

Abstract:

The organization of the food safety system in the Republic of Kosovo covers the control from the primary production, the processing part, the production of the final products, the distribution phases in the retail outlets, where through official controls and supervisory mechanisms by the competent authority of the control system is guaranteed food safety in all products of plant and animal origin in order to protect public health. In the framework of the Stabilization and Association Agreement (SAA) in accordance with the requirements of the EU acquis under Chapter 12 Food safety, phytosanitary and veterinary policies, the national legislation has been harmonized in accordance with the policies and requirements of the European Commission. Furthermore, the law on food no. 03 / L-016 as well as the regulations of the hygienic package for the organization of official controls and the obligations of food business operators, as Regulation no. 10/2011 on official controls performed to ensure the verification of compliance with feed and food law, animal health and animal welfare rules, Regulation no.11 / 2011 on hygiene of food stuffs, Regulation no.12 / 2011 of laying down specific rules on hygiene of food of animal origin and Regulation no.13 / 2011 laying down specific rules for the organization of official controls on products of animal origin intended for human consumption, regulations harmonized by the European Commission (Reg. no. 852, 853, 854 and 882). The food law is the basis for the establishment of the Food and Veterinary Agency, the competent authority which was established in accordance with the policies and requirements of the European Commission which ensures a high level of food safety for humans and animals. The Food and Veterinary Agency is responsible for the implementation of legislation at both central and regional / local level by implementing the integrated strategy for food safety "from farm to fork" through which the control of the efficiency of the entire food safety system is achieved as and builds the trust of all stakeholders in food safety policy, from farmers to consumers. Treatment of acute foodborne diseases and zoonotic diseases which are transmitted from animals to humans, based on their presentation, the competent authority makes a risk assessment and takes concrete actions in order to prevent their spread and protect public health. The Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development (MAFRD) and the Ministry of Health (MoH) in cooperation with the Food and Veterinary Agency are responsible for drafting legislation and policies related to food safety, animal health, plant health and veterinary public health. The Food and Veterinary Agency, as the executive agency, is responsible for enforcing legislation covering the entire food chain "from farm to fork", including the import / export and transit of food with animal and non-animal origin, animal health and welfare and plant health. Furthermore, the Food Law is the basis and regulates the system of official control, defining the competencies of the authorities responsible for conducting official controls. The implementation of laws and regulations related to food safety is done at the central and regional / local level, where the preparation of official plans and controls is carried out by the Food and Veterinary Agency. The article focuses on the organization and control points of the food safety system in the Republic of Kosovo.

Rreziku i tërmeteve ne disa nga pikat më të rëndësishme bregdetare në Shqipëri. Përcaktimi i rrezikut më anë të simulimeve me programet kompjuterike

Earthquake risk in some of the most important coastal points in Albania. Risk determination through simulations with computer programs

ADISA DABERDINI

Universiteti i Elbasanit Aleksander Xhuvani

Tiranë, ALBANIA

adisa.daberdini@gmail.com

NOVRUS METAJ

Universiteti Politeknik i Tiranës

Tiranë, ALBANIA

novimetaj@gmail.com

Fjalë çelës: Termetet, cunamet, simulatore, zona bregdetare, rreziku cunameve.

Keywords: Earthquake, tsunamis, simulators, coastal area, tsunami hazard.

Përmbledhja:

Në këtë studim është paraqitur një nga temat më të rëndësishme dhe më të studiuara në vitet e fundit e cila është dhe shumë e rëndësishme për zonën bregdetare të Shqipërisë. Studimet për tërmetet dhe efektet e tyre në natyrë janë të një rëndësie të konsiderueshme sidomos në vendin tonë pasi kemi një zone me sizmicitet të lartë. Neve në këtë studim i kemi dhënë rëndësinë e duhur si në diskutime ashtu dhe në përdorim të gjerë të zbulimit të rrezikut të këtij fenomeni. Shqipëria është një vend me sizmicitet të lartë dhe që gjithmonë ka qenë i rrezikuar nga tërmetet dhe ka pasur dhe dëme të shumta. Rëndësia e këtij fenomeni është nëse këto do të shkaktonin dëme njerëzore dhe materiale dhe sidomos rrezikun e një cunami në zonat bregdetare. Për këtë arsye në këtë studim kemi paraqitur disa simulime të bëra me të dhënat e marra nga tërmetet dhe të përpunuara në simulator të ndryshëm. Kryesisht si program studimi për simulimet kemi marrë simulatorin e tërmeteve Mironë, por një pjesë e simulimeve janë bërë me simulator online të cilët përdorin direkt të dhënat e marra nga google maps. Simulatoret online në aspektin e të dhënave të hartave janë më të përditësuar pasi kanë të dhënat direkte të lidhura me satelit dhe të dhënat e zonave të marra në studim. Kurse simuloret e përdorur si programe janë më praktike në të dhënat që do të japim në hyrje të programit si të dhënat e hartës, të dhënat e thellësive, struktura e hartës, tërmetet që do të simulohen. Në simuloret online kemi marr të dhëna të përmblytjeve të mundshme direkte dhe të zonave të rrezikuara dhe sa mund të jetë shkalla e cunamit. Simulimet që janë bërë me programet e simulimit si Mironë kanë paraqitur nivele të ndryshme rreziku nëpërmjet kodit të ngjyrave që përdoren nga programi. Fillimisht në program kemi vendosur të dhënat e hartës dhe të thellësive të bregdetit. Studimi ka paraqitur hapësirën e rrezikshmërisë që mund të cenohet nga cunamet në rast se kemi ngjarje të ndryshme të tërmeteve. Kryesisht në studim janë marr tërmete më magnitude të cilat janë të mundura që të ndodhin ose kanë ndodhur si ngjarje në të kaluarën. Në territorin e bregdetit tonë të një rëndësie të madhe janë tërmetet më magnitude 5-7. Pasi këto janë tërmete të mundshme dhe ngjarje të mundshme deri në ditët e sotme dhe mund të shkaktojnë dëme të shumta. Si përfundim nga ky studim kemi nxjerrë zonat e rrezikuara dhe tërmetet më të rëndësishme që mund të ndodhin në zonën bregdetare. Gjithashtu kemi mundësinë që të bëjmë një krahasim të rrezikut të cunamit të paraqitur në simulator të ndryshëm. Këto të dhëna që kemi vendosur në simulator janë përpunuar në bazë të disa modeleve të përpunimit të cunamit të cilat janë të integruara në program dhe

që na japim informacione të rëndësishme. Ngremë dhe çështjen e cunamit të shkaktuar nga tërmetet si një çështje të një rëndësie të madhe edhe për zonat bregdetare të Shqipërisë dhe të vendeve fqinje.

Abstract:

In this study is presented one of the most important and most studied topics in recent years which is also very important for the coastal area of Albania. The territory of Albania is the one which is taken in consideration for all the data and all the simulations that are developed. Studies on earthquakes and their effects in nature are of considerable importance especially in our country as we have an area with high seismicity and with very big effect in the last years. In this study, we have given due importance to both the discussion and the widespread use of risk detection of this phenomenon. Albania is a country with high seismicity and that has always been endangered by earthquakes and there has been a lot of damage. The importance of this phenomenon is whether these would cause human and material damage and especially the risk of a tsunami in coastal areas. For this reason in this study we have presented some simulations made with data obtained from earthquakes and processed in different simulators. We mainly took the Mirone earthquake simulator as a study program for the simulations, but some of the simulations were done with online simulators which directly use the data obtained from google maps. Online simulators in terms of map data are more up-to-date as they have direct satellite-related data and data from the study areas. Whereas the simulators used as programs are more practical in the data that we will give in the introduction of the program such as map data, depth data, map structure, earthquakes that will be simulated. In the online simulators we have obtained data on possible direct floods and endangered areas and what the magnitude of the tsunami may be. Simulations done with simulation programs like Mirone have presented different levels of risk through the color code used by the program. Initially in the program we set the map data and the depths of the coast. The study has presented the range of danger that can be affected by tsunamis in case we have different earthquake events. Magnitude earthquakes that are likely to occur or have occurred as events in the past have been mainly studied. In the territory of our coast of great importance are earthquakes with magnitudes 5-7. Because these are possible earthquakes and possible events to this day and can cause a lot of damage. As a conclusion from this study we have identified the most endangered areas and earthquakes that can occur in the coastal area. We also have the opportunity to make a comparison of the tsunami risk presented in different simulator. These data that we have placed in the simulator are processed based on some tsunami processing models which are integrated in the program and which give us important information. We also raised the issue of tsunamis caused by earthquakes as an issue of great importance for coastal areas of Albania and other countries near us that we share the same Adriatic and Ionian seas.

Fusha makrosizmike rajonale për tërmetin e gjirit të Lalzit, 2018 (m 5.1)

Regional macrosismic field for Lalzi bay earthquake, 2018 (m 5.1)

NOVRUS METAJ
Universiteti Politeknik i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
novimetaj@gmail.com

ADISA DABERDINI
Universiteti i Elbasanit Aleksander Xhuvani
Tiranë, ALBANIA
adisa.daberdini@gmail.com

RRAPO ORMENI
IGJEUM, Universiteti Politeknik i Tiranës
Tiranë, ALBANIA
rrapo55@yahoo.com

Fjalë çelës: Termete, sizmike, rrezik, Matlab, pyetësor.

Keywords: Earthquake, seismic, hazard, Matlab, questionnaire.

Përmbledhja:

Një metodë e përmirësuar e studimit makrosizmik, bazuar në bashkëpunimin vullnetar nëpërmjet internetit, po zhvillohet në Departamentin e Sizmologjisë, Instituti i Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) që nga Tetori i 2016. Pyetësori makrosizmik i drejtohet një personi të vetëm jo-specialist; efektet e raportuara analizohen nga ana statistikore që të ekstrapolojnë intensitetin EMS-98 e referuar ndaj atij vëzhguesi. Vlerësimi makrosizmik i Tërmetit 4 Korrik 2018 Ms=5.1 (Richter) u realizua përmes një sondazhi online në internet. Të dhënat u mblodhën nëpërmjet një pyetësori makrosizmik online, i gjetur në sitin e web <http://www.geo.edu.al>, i menaxhuar nga IGJEUM. Këto të dhëna janë kombinuar edhe me të dhënat janë marr nga faqja (web emsc-csem.org) Qendra e Europiane Mesdhetare Sizmologjike. Një analize statistikore u aplikua në të dhënat e mbledhura për të gjetur shpërndarjen hapësinore të intensitetit të këtyre tërmeteve. Hartat e intensitetit makrosizmik për këto tërmete janë përpiluar dhe më vonë janë përditësuar vazhdimisht informacione të tjera. Qëllimi i këtij pyetësori është të vlerësojë efektet sizmike siç ndihet nga vrojtuesit. Efektet e raportuara në pyetësorët që vijnë nga qytetet dhe komunat në zona të ndryshme janë analizuar me vëmendje. Ky dokument jep një mënyrë të shpejtë për vlerësimin e intensitetit, të funksionit të shuarjes për intensitetin e këtij tërmeti. Në shqyrtim kemi marrë të dhënat për tërmetin e ndodhur në gjirin e Lalzit në 4 Korrik 2018 me magnitudë 5.1. [11] Tërmeti është ndier në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe në vendet fqinje. Në distanca të ndryshme janë ndier intensitete të ndryshme. Qëllimi i këtij studimi është nxjerrja e grafikëve dhe formula e nxjerrjes së shuarjes së intensitetit me largësinë. Nga analiza e këtyre rezultateve janë ndërtuar grafikët përkatës shuarjes së intensitetit dhe janë paraqitur dhe në hartë izosejstet që paraqesin kufijtë për çdo intensitet. Me anë të këtij studimi neve kemi nxjerr edhe formula ligjin polynomial të mesatarizuar të shuarjes së këtij tërmeti në territorin e përhapjes së tij. Në ndihmë të studimit janë përdorur programe të ndryshme si: ArcGis për ndërtimin e hartave sizmologjike, Matlab dhe Excel për grafikët etj. Çdo tërmet që bie, i kapur deri më sot nga aparaturat sizmologjike është një fener i ndezur në thellësi të tokës, që jep informacion dhe njohuri. Pra nga tërmeti ne mësojmë shumë gjëra për truallin, mësojmë më mirë se ç'është toka, ç'proces ndodhin brenda saj, dhe si është e

ndërtuar. Këto informacione dhe dukuri me qindra km thellë nuk merren as me shpime me sonda, por vetëm nga tërmeti. [17] Me vendosjen e aparaturave sizmike shkenca i jep njeriut një mjet të fuqishëm për ta zbuluar nëntokën. Një trup i ngurtë kur bie, mbi të aplikohet një forcë, deformohet. Në një trup elastik deformimi përhapet në të gjithë trupin në formën e valëve. Kur ndodh një deformim ose një zhvendosje e menjëhershme e masës shkëmbore në brendësi të tokës, toka reagon si një trup elastik. [17] Valët elastike në këtë rast përhapen në të gjithë drejtimet e tokës në sipërfaqe të saj duke lëkundur objektet që ndodhen në sipërfaqet e saja dhe që ndjehen nga njerëzit. Ky është tërmeti. Vendi ku ndodh zhvendosja shkëmbore quhet vatër e tërmetit. Nga vatra e tërmetit gjenerohen një ose disa lloje valësh. Ato ndahen në tre grupe kryesore dhe quhen valë sizmike: valë gjatësore, valë tërthore dhe valët sipërfaqësore. Tërmetet në vetvete i ndajmë në tre kategori tërmetet tektonike, tërmetet vullkanikë dhe tërmetet karstikë. Tërmetet tektonikë përbëjnë gjithë tërmetet në tokë rreth 99% (Borman P, 2001).

Abstract:

An improved method of macrosyncological research, based on volunteer internet collaboration, is being developed by the Department of Seismology, the Geoscience, Energy, Water and Environment Institute (IGJEUM) since October 2016. The macrosyncological questionnaire is addressed to a single non-specialist; the reported effects are statistically analyzed to extrapolate the EMS-98 intensity referred to that observer. The macrosyncological evaluation of Termus 4 July 2018 $M_s = 5.1$ (Richter) was accomplished through an online survey on the Internet. The data was collected through a macrosyncological questionnaire online, found on the web site <http://www.geo.edu.al>, managed by IGJEUM. These data are combined with the data obtained from the site (web.emsc-csem.org) European Mediterranean Seismological Center. A statistical analysis was applied to the data collected to find the spatial distribution of the intensity of these earthquakes. Macrosystemic intensity maps for these areas have been compiled and later, other information is constantly updated. The purpose of this questionnaire is to assess the seismic effects as felt by observers. Effects reported in questionnaires coming from cities and municipalities in different areas have been carefully analyzed. This decoder provides a quick way to estimate the intensity of the extinction function for the intensity of this earthquake. In the review, we obtained the data for the term located in Lalzi Bay on 4 July 2018 with magnitude 5.1. The roof has been felt throughout the territory of Albania and neighboring countries. Different distances have been felt at different intensity. The purpose of this study is to extract graphs and extend the extensibility formula. From the analysis of these results, the corresponding extinction graphs have been constructed and are presented in the map of the isosystems that represent boundaries for each intensity. Through this study we have also extracted the formula for the average polynomial law of extinction of this earthquake in its territory of propagation. Various programs such as ArcGis for the construction of seismic maps, Matlab and Exel for graphs etc. are used for the study. Every earthquake that falls, captured to date by seismological apparatus is a beacon lit deep in the earth, which provides information and knowledge. So from the earthquake we learn a lot about the land, we learn better what the earth is, what processes take place inside it, and how it is built. This information and phenomena hundreds of km deep are not even dealt with by drilling probes, but only by earthquakes. [17] With the installation of seismic apparatus, science has given man a powerful tool for discovering the underground. A rigid body when falling, a force is applied to it, deforms. In an elastic body the deformation spreads throughout the body in the form of waves. When a deformation or an immediate displacement of the rock mass inland occurs, the earth reacts like an elastic body. [17] The elastic waves in this case propagate in all directions of the earth at its surface by vibrating the objects that are on its surfaces and that are felt by humans. This is the earthquake. The place where the rock displacement occurs is called the epicenter of the earthquake. One or more types of waves are generated from the epicenter. They are divided into three main groups and are called seismic waves: longitudinal waves, transverse waves and surface waves. Earthquakes

themselves are divided into three categories: tectonic earthquakes, volcanic earthquakes and karstic earthquakes. Tectonic earthquakes make up about 99% of all earthquakes on earth (Borman P, 2001).

Korniza e qëndrueshmërisë Flogen dhe roli primar i shkencës dhe teknologjisë

Flogen sustainability framework and the primary role of science and technology

MUSA RIZAJ

Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë

Mitrovicë, KOSOVA

mrizaj@gmail.com

JUSTINA PULA

ASHAK

Prishtinë, KOSOVA

justinapula@hotmail.com

FLORIAN KONGOLI

Flogen Technologies inc., Canada/USA

Montreal, Canada, CANADA

fkongoli@flogen.com

Fjalë çelës: zhvillimi qëndrueshëm, industria, teknologjia, Flogeni

Keywords: Sustainable development, industry, technology, Flogen

Përmbledhja:

Zhvillimi i qëndrueshëm si koncept bazohet në ekuilibrin midis rritjes ekonomike, mirëqenies sociale dhe një mjedisi të sigurt. Për të arritur këto qëllime, shumë aktivitete janë zhvilluar në nivele vendore dhe ndërkombëtare për të koordinuar aktivitetet midis faktorëve të zhvillimit të qëndrueshëm: rritja ekonomike përmes zhvillimit teknik dhe teknologjik, mirëqenia sociale dhe mbrojtja e mjedisit, dhe aktorët e shkencës dhe teknologjisë; institucionet qeverisëse. Një segment i kësaj çështje është përzgjedhja e teknologjive të qëndrueshme, materialeve të reja dhe përdorimi efikas i burimeve të energjisë. Proceset teknologjike kanë si objektivi përfitimin e materialeve nga mineralet për të plotësuar nevojat e përditshme të jetesës që rezultojnë në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale, por gjithashtu kanë ndikimin më të madh në cilësinë e mjedisit të jetesës. Aplikimi i teknologjive të qëndrueshme në industri shoqërohet me vështirësi të natyrave të ndryshme, të tilla si: çmimi i lartë, njohja e materialeve dhe proceseve, kornizë cilësore. Përkundrazi, ne rrezikojmë që lëndët e para për këto procese të përdoren pa perspektivën e kriterëve të qëndrueshmërisë. Përmbushja e këtyre objektivave kërkon mbështetje institucionale, investime shtesë në linjat teknologjike si dhe rregullime efikase ligjore.

Ky punim do të rishikojë kornizën e qëndrueshmërisë së Flogenit, të zhvilluar dhe publikuar 6 vjet më parë, që sqaroi konfuzionin që ekzistonte në përkufizimin e qëndrueshmërisë duke bërë një dallim të qartë midis kriterëve, aktorëve dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Pjesa e parë e artikullit parashtron konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm me tre kriteret e tij kryesorë: mbrojtjen e mjedisit, rritjen ekonomike dhe përparimin shoqëror. Është treguar se çdo veprimtari njerëzore që plotëson në të njëjtën kohë kriteret e mbrojtjes së mjedisit dhe rritjes ekonomike është e zbatueshme, por ende jo e qëndrueshme. Nëse përmbush qëllimet e mbrojtjes së mjedisit dhe përparimit shoqëror, aktiviteti është i durueshëm, por ende jo i qëndrueshëm. Dhe nëse përmbush kriteret e përparimit shoqëror dhe rritjen ekonomike, aktiviteti është i drejtë, por jo i qëndrueshëm. Për të qenë i qëndrueshëm, aktiviteti njerëzor duhet të përmbushë njëkohësisht tre kriteret. Pjesa e dytë e artikullit shpjegoi konfuzionin që ekzistonte në literaturë në përkufizimin e qëndrueshmërisë ku kriteret, aktorët dhe objektivat ishin përzier në mënyrë të palogjikshme pa ndonjë dallim. Pjesa e tretë do të paraqesë kornizën e qëndrueshmërisë së Flogenit që sqaroi të gjithë konfuzionin duke bërë një dallim të qartë midis kriterëve, aktorëve dhe ob-

jektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Pjesa e katërt e artikullit do të përshkruajë fusha të ndryshme ku korniza e qëndrueshmërisë së Flogenit dhe paraqitja e tij e re grafike janë përdorur tashmë nga Flogeni, për: (a) zhvillimin e modelit të tij qendror të modifikuar për shkencën dhe inxhinierinë e materialeve duke shtuar dimensionin e ri të mundësisë së riciklimit dhe ripërdorimit të tyre. (b) analizimin e riciklimit kundrejt deponimit të mbetjeve si dy opsione të mundshme që do të përdoren sipas avantazheve dhe disavantazheve të tyre. (c) kualifikimin e ndryshimit midis lineares dhe ciklit të mbyllur në të gjitha fazat e trajtimit të burimeve. (d) analizimin e automatizimit në raport me punën manuale dhe arritja në përfundimin se automatizimi është një aktivitet i qëndrueshëm në kushte të caktuara. Kjo kornizë unike e qëndrueshmërisë së Flogenit paraqitet me 3 shtyllat e tij të (1) shkencës dhe teknologjisë, (2) qeverisjes dhe menaxhimit dhe (3) arsimit dhe shoqërisë civile. Do të prezantohen shumë aplikime të kësaj kornize në fushën e minierave dhe burimeve minerale dhe proceset e eksplorimit dhe transformimit të tyre. Për më tepër, zhvillimet pozitive, si dhe problemet dhe mundësitë në këtë fushë do të analizohen në kontekstin e kësaj kornize unike, si dhe do të theksohet roli parësor i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm i shkencës dhe teknologjisë.

Abstract:

Sustainable development as a concept is based on the balance between economic growth, social welfare and a secure environment. To achieve these goals, many activities are developed at local and international levels to coordinate activities between sustainable development factors: economic growth through technical and technological development, social welfare and environmental protection, and science and technology actors; governing institutions. One segment of this issue is the selection of sustainable technologies, new materials and the efficient use of energy resources. The technological processes have as objective the benefit of materials from minerals to meet the daily living needs that result in economic development and social welfare but also have the greatest impact on the quality of the living environment. The application of sustainable technologies in industry is accompanied by difficulties of various natures, such as: high price, knowledge of materials and processes, quality framework. On the contrary, we risk that the raw materials for these processes will be used without the perspective of sustainability criteria. Meeting these objectives requires institutional support, additional investments in technological lines as well as efficient legal regulations. This paper will review the flogen sustainability framework, developed and published 6 years ago, that clarified the confusion that existed in the definition of sustainability by making a clear distinction between criteria, actors and objectives of sustainable development. The first part of the article lays out the concept of sustainable development with its three main criteria: environment protection, economic growth and social advancement. It is shown that any human activity that fulfils at the same time environmental protection and economic growth criteria is viable but not yet sustainable. If it fulfills the environmental protection and social advancement goals the activity is bearable but not yet sustainable. And if it fulfills social advancement and economic growth criteria the activity is equitable but not yet sustainable. In order to be sustainable, the human activity needs to fulfill simultaneously the three criteria. The second part of the article explained the confusion that existed in the literature in the definition of the sustainability where criteria, actors and objectives were illogically mixed without any distinction. The third part will lay out the flogen sustainability framework that clarified all the confusion by making a clear distinction between criteria, actors and objectives of sustainable development. The fourth part of the article will describe various filed where the flogen sustainability framework and its new graphic representation have already been used by flogen to (a) develop his own modified central paradigm of materials science and engineering by adding the new dimension of recyclability and reuse (b) analyze the recycling versus waste landfilling as two possible options to be used according to their own advantages and disadvantages. (c) qualify the difference between linearity and circularity in all resource treatments (d) analyze automation in

relation to manual work and conclude that automation is a sustainable activity under certain conditions. This unique flogen sustainability framework is presented with its 3 pillars of (1) science & technology, (2) governance & management and (3) education & civil society. Many applications of this framework in the field of mines and mineral resources and their exploration processes and transformation will be shown. Furthermore, the positive developments as well as problems and opportunities in this field will be analyzed in the context of this unique framework and the important and irreplaceable primary role of science and technology is highlighted.

Vlerësimi i zonës së sigurisë së rrezatimit RF, metodat dhe instrumentet matëse

RF radiation safety zone assessment, methods and measuring instruments

BESNIK DOBI
Instituti i Rrezatimeve
Tiranë, ALBANIA

besnikdobi1@gmail.com

SONILA DOBI
BMW Group
München, GERMANY

dobi.sonila@gmail.com

ERMAL DOBI

Ferrero

Alba, ITALY

ermal.dobi@gmail.com

Fjalë çelës: Matje, 5G, zone sigurie, instrumentet

Keywords: Measurement, 5G, safety zone, instruments

Përmbledhja:

Teknologjia e gjeneratës së pestë (5G), e njohur si Radio e Re (New Radio, NR), përfaqëson një hap përpara në teknologjinë pa tel në krahasim me gjeneratat e mëparshme. Për më tepër, teknologjia 5G është konceptuar për të mbuluar skenarë të shumëfishtë përdorimi, nga brezi i zgjeruar celular deri te komunikimet ultra të besueshme me vonesë të ulët (Ultra-Reliable Low-Latency Communications, URLLC). Nga pikëpamja teknike, kjo kërkoi shfrytëzimin e modeleve të reja, si: përdorimin e valëve milimetrike, pjesëve të gjerësisë së brezit dhe zbatimin e teknikave më të sofistikuar të prezantuara në 4G, të tilla si duplexi me ndarje në kohë (Time Division Duplex, TDD) dhe Shumë-Përdorues Shumë Hyrje Shumë Dalje (Multi-User Multiple Input Multiple Output, MU-MIMO). NR shfrytëzon shkallën e lartë të fleksibilitetit në nivelin e kodit, kohës, frekuencës dhe hapësirës, për të optimizuar përdorimin e burimeve në kohe dhe hapësire të ofruara nga kanali i komunikimit. Përparësitë e 5G janë diskutuar mjaft, dhe nuk ka dyshim për domosdoshmërinë e vendosjes së sistemeve të komunikimit pa tel më të shpejtë dhe më të besueshëm. Nga një tjetër këndvështrim, zbatimi i kësaj teknologjie të re po shkakton shqetësim në rritje mbi ndikimin e mundshëm në shëndet dhe siguri që vjen nga ekspozimi ndaj fushës elektromagnetike të rrezatuar nga sistemet 5G. Kjo bën të domosdoshëm zhvillimin e teknikave dhe protokolleve të sakta të matjes EMF. Teknikat e matjes të përdorura për të vlerësuar pajtueshmërinë me kufijtë e ekspozimit të fushës elektromagnetike (EMF) janë objekt i rregulloreve ndërkombëtare. Standardet trajtojnë vlerësimin e fuqisë së fushës së Radio-Frekuencës (RF), densitetit të fuqisë dhe Niveleve Specifike të Absorbimit (Specific Absorption Rate, SAR) në afërsi të Stacionit Bazë Radio-komunikues (Radiocommunications Base Station, RBS). Parimi bazë i vlerësimit është matja e fuqisë së marrë nga një burim radio frekuence konstante, zakonisht një sinjal pilot, tek i cili aplikohet një faktor i duhur ekstrapolimi. Teknika e ekstrapolimit ka një rëndësi të madhe praktike. Në të vërtetë, kufijtë e ekspozimit të popullsisë i referohen vlerave mesatare të matura gjatë një periudhe kohore. Për të zvogëluar kostot e matjeve, është e mundur të ndiqet një procedurë e ndryshme që kërkon shumëzimin e fuqisë maksimale të çastit me një faktor të përshtatshëm shkallëzimi. Për të zbatuar një procedurë të tillë, janë krijuar teknika efektive të ekstrapolimit, të afta për të vlerësuar në mënyrë të shpejtë fuqinë

maksimale, nga matjet e kryera në një periudhë të shkurtër kohore. Këto teknika janë me rëndësi të madhe. Në këtë punim, është paraqitur një procedurë ekstrapolimi, e realizuar me instrumentin Narda SRM-3006 Selective Radiation Meter, për një vlerësim të saktë të fuqisë maksimale të çastit, të një stacioni 3G dhe 4G. Ky instrument ofron dy mënyra të ndryshme të matjes së sinjaleve të stacionit bazë 4G LTE (Long Term Evolution, LTE), duke përdorur teknikat e ekstrapolimit në ngarkesën maksimale operacionale: matje spektrale dhe matje selective të kodit. Të dy metodat bazohen në filtrimin e përbërësve të sinjalit 4G LTE që emetohen me një fuqi dalëse të përcaktuar dhe konstante (p.sh. e pavarur nga ngarkesa aktuale e trafikut). Të dy metodat ndryshojnë në faktin që: matja spektrale kryhet në fushën e frekuencës ku sinjalet që do të kapen ndahen në mënyrë spektrale nga sinjali i përgjithshëm, ndërsa metoda selektive e kodit nxjerr sinjalet që duhen matur nga sinjali i koduar. Të dyja procedurat përshkruhen dhe më pas krahasohen. Në punim janë theksuar ndryshimet e teknologjive 4G dhe 5G si edhe mundësia e aplikimit të teknikës së ekstrapolimit për matjet në teknologjinë 5G.

Abstract:

The fifth generation (5G) technology, known as New Radio (NR), represents a step forward in wireless technology compared to the previous generations. Moreover, 5G technology has been conceived to cover multiple usage scenarios, from enhanced mobile broadband to Ultra-Reliable Low-Latency Communications (URLLC). From a technical point of view, this required the exploitation of new models, like the use of millimeter waves, parts of the signal bandwidth, and a more sophisticated implementation of techniques introduced in 4G, such as Time Division Duplex (TDD) and Multi-User Multiple Input Multiple Output (MU-MIMO) techniques. NR takes advantage of high degrees of flexibility at the code, time, frequency and space domain level to optimize the use of temporal and spatial resources given by the communication channel.

While the advantages of 5G are well discussed, and there is no doubt about the necessity of deployment of faster and more reliable wireless communication systems, on the other hand, the implementation of this new technology is causing increasing concern over the possible impact on health and safety arising from exposure to the electromagnetic field radiated by 5G systems—making imperative the development of accurate EMF measurement techniques and protocols.

Measurement techniques used to assess the compliance with electromagnetic field (EMF) exposure limits are the object of international regulation. Standards address the evaluation of radio frequency (RF) field strength, power density, and Specific Absorption Rate (SAR) levels in the vicinity of the Radiocommunications Base Station (RBS). The basic principle of the assessment is to measure the power received from a constant radio frequency source, typically a pilot signal, and to apply a proper extrapolation factor. The extrapolation technique is of great practical relevance. Indeed, exposure limits of the population refer to measured quantities averaged over a period of time. In order to reduce the costs of measurements, it is possible to follow a different procedure that requires to multiply the instant maximum power by a proper scaling factor. In order to apply such a procedure, the development of effective extrapolation techniques, able to estimate the instant maximum power from measurements carried out in a short period of time, is of paramount importance.

In this paper is presented an extrapolation procedure with Narda SRM-3006 Selective Radiation Meter, for an accurate estimation of the instant maximum power received from a 3G and 4G source. The SRM-3006 basically provides two different ways of measuring 4G LTE (Long Term Evolution) base station signals followed by extrapolation to the maximum operational load of the installation: spectral measurement and code selective measurement. Both methods are based on filtering out the components of the 4G LTE signal that are emitted with a defined and constant output power (i.e. independent of the actual traffic load). The two methods differ in that: the spectral measurement is performed in the frequency domain with the signals to be captured being separated spectrally from the overall signal, whereas the code selective method extracts the signals to be measured from the coded signal. Both

procedures are described here and then compared. In this presentation the differences between the 4G and 5G technologies are highlighted as well as the possibility of applying the extrapolation technique for measurements in 5G technology.

Abstracts

Conference of Social and Political Sciences section


The Sixteenth International Annual Meeting of Alb-Science Institute
Shkup, 01 - 03 October 2021

Të gjitha përmbledhjet e këtij dokumenti janë regjistruar në sistemin **ALPA**® nga vetë autorët e tyre. Rrjedhimisht, ndonjë gabim i mundshëm drejtshkrimor apo tjetër në përmbledhje dhe informacionin përkatës është i autorit apo autores përkatëse.

Të drejten për kopjimin dhe shumëfishimin e përmbledhjeve në këtë dokument e ruan ekskluzivisht Instituti Alb-Shkenca (IASH): www.alb-shkenca.org

Gjeneruar më 10 Tetor 2021.

Ky dokument është gjeneruar në mënyrë automatike nga sistemi **ALPA**®.



ALPA - *Albanian Papers*
mali Information Technologies
<http://alpa.mali-it.eu>

Ndikimi i besimeve fetare në sistemin e vlerave të shoqërisë shqiptare

The influence of religious beliefs in the value system of the Albanian society

ADA KOCANI

Qendra studentore 'Vizioni i Ri'

Tiranë, ALBANIA

adakocani@gmail.com

Fjalë çelës: Ndikim fetar, profil vetafirmimit, profil tradicional, implikime

Keywords: Religious influence, materialistic profile, traditional profile, implications.

Përmbledhja:

Referimi i paraqitur për t'u mbajtur në Takimin e XVI të Alb-Shkencës, sjell të dhëna dhe interpretime që sqarojnë problemin e ndikimit aktual të mundshëm të fesë te shqiptarët. Ai e kërkoi përgjigjen ndaj pyetjes të dhënë në titull, lidhur me mundësinë e ndikimit të pasjes besim fetar tek individët në shoqërin aktuale shqiptare. Kjo pyetje është bërë në një nga paraqitjet e emisionit Opinon në muajin Maj të këtij viti (në TV Klan) me një panel opinionistësh. U supozua se drejtimi ku mund të ushtrohej ky ndikim ishte kryesisht në sistemin vleror të tyre. Me që vlerat në përgjithësi klasifikohen në dy drejtime, si në dimensionin materialist vs post-materialist, ashtu edhe në atë tradicional vs racional-shekullar, u supozua se më e pritshme ishte që, në se kishte një ndikim të tillë, ai me gjasë mund të konstatohej kryesisht në profilin vleror tradicional të dimensionit të vlerave tradicionale vs rationale-shekullare. Kjo, me që ky profil vleror lidhej më shumë me vlerat shpirtërore (ky bëjnë pjesë edhe besimet fetare) dhe, nisur edhe nga fakti që studimet e shumta empirike mbi sistemin vleror të dimensionit materialist vs postmaterialist, bazat me të dhëna të cilëve u përdorën në kuadrin e këtij studimi të tipit kryesisht sasior, tregonin një predominim të vlerave materialiste kundrejt atyre shpirtërore në shoqërinë shqiptare në tranzicion. Prandaj, parashikimi për sistemin vleror materialist vs postmaterialist, me që ai e 'konturonte' shoqërinë aktuale shqiptare kryesisht në kahen e vlerave materialiste, ishte që në profilin vleror materialist të mosndikonte pasja e besimit fetar të individëve të kësaj shoqërie. Për këtë, në kuadrin e qasjes racionaliste kritike, u ndërtua një skemë metodologjike që lejoi të identifikoheshin ky ndikim i mundshëm si një problem kërkimor, të veçohej një aspekt i tij për hulumtim me anën e një pyetje kërkimore, të skicohej një përgjigje ndaj pyetjes kërkimore në trajtë supozimi bazë dhe të testoheshin ajo empirikisht në mënyrë jo të drejtpërdrejtë duke testuar implikime-parashikim të dedukuara prej saj. Implikimet, si gjykime të tipit kushtor lejonin të testoheshin drejtpërdrejtë empirikisht parashikimet për një shoqërim statistikor të mundshëm domethënës midis indikatorëve të pasjes besim fetar tek individët e shoqërisë aktuale shqiptare, me indikatorët e sistemeve vlerore në të dy dimensionet. Pra, ato bënë të mundur që të kontrolloheshin empirikisht shoqërimet statistikore të indikatorëve të pasjes besim fetar si me indikatorët e ndryshëm të vlerave materialiste vs postmaterialiste, ashtu edhe me indikatorët e vlerave tradicionale vs rationale-shekullare. Për këtë gjë u shfrytëzuan bazat e të dhënave të anketimeve të tre viteve të fundit që u hetuan sistemet vlerore (2016, 2018 dhe 2019). Rezultoi se, ashtu siç pritej, testet empirike konfirmonin parashikimin teorik të pasjes ndikim të besimit fetar në profilin vleror që jepnin implikimet vetëm për kahjen tradicionale në dimensionin tradicional vs racional-shekullar dhe atë të mospasjes ndikim të besimit fetar për kahjen materialiste në profilin vleror materialist vs

postmaterialist. Gjithashtu, ato lejuan dhe të matej shkalla e ndikimit të faktorit fetar në profilin vleror tradicional. Për të përfocuar gjetjet, u ndoq edhe një linjë kontrolli empirik të supozimit bazë vetëm për respondentët që pasjen e besimit fetar e kishin në nivelin e praktikimit të tij. Dhe, ashtu siç pritej, testi empirik dëshmoi një ndikim më të madh të pasjes së besimit fetar në profilin e tyre vleror tradicional.

Abstract:

This paper is intended to be held on the XVI-th Meeting of Alb-Science and it expose data and interpretations concerning the clarification of the problem related with possible influence of religious beliefs to the Albanians today. His aim was to give an answer to the question on the title concerning how much influence religion to the Albanian individuals. Such a question was posed in one of Opinion emission presentations during this month May in TV Klan, with an opinionists' panel. It was supposed as the direction where maybe exerted this influence mainly the value system of society. Because of fact of the classification of values into two directions, the materialistic vs post-materialistic one's, as well as the traditional vs rational secular one's, it was supposed as more probable that if there is such an influence it will be noticed more mainly into traditional vs rational secular value direction. This is because of the more closed relation of this direction with spiritual values (where are included the religious beliefs) and the other hand, of the fact that the studies on values systems (which data bases was used in this case) has shown a predomination of materialistic value towards the post-materialistic one's in the Albanian society on transition. So, the prediction for the case of the materialistic vs post-materialistic value system was that the materialistic value profile to not be influenced by the presence of religious beliefs into individuals. On the opposite, was predicted such an influence for the case of traditional value profile in the traditional vs rational secular value system. To test empirically such predictions by following the critical rational methodological approach, it was composed a schema with the supposition of mentioned influence as an identification of research problem, by asking a research question was selected one of its aspects and by its answering with a basic supposition and by deduction of predict-implications from this supposition it was possible to do its empirical testing. With such predict-implications it was possible to directly test empirically the prediction of a possible significative statistical associations between the indicators of individuals' religious beliefs with the indicators of traditional value profile, in the traditional vs rational secular direction, and absence of such statistical associations in case of materialistic value profile as well. For this purpose, was used the data bases of value surveys carried out during three last years (2016, 2018 and 2019). It resulted, as it was expected, that there is influence on the traditional value profile in the case of traditional vs rational-secular value direction and not influence on the materialistic value profile in the case of materialistic vs post-materialistic value direction. Also, it was possible to measure the level of this religious influence on the traditional value direction. In the aim of strengthen findings was conducted a special line of empirical control for the basic supposition only for the respondent having the religious beliefs at the level of practicing them. And, as it was expected, empirical testing testimony a more influence of having religious beliefs on traditional value profile.

Efikasiteti i kornizës së kurrikulës në promovimin e vlerave sociale në arsimin para universitar në Republikën e Kosovës

The efficiency of curriculum framework on promotion of social values on the pre-university education in the Republic of Kosovo

MUHABERE MALIQI

Universiteti i Prishtinës

Prishtinë, KOSOVA

muhabere.r.maliqi@gmail.com

Fjalë çelës: korniza e kurrikulës, vlerat shoqërore, arsimiparauniversitar, SEM.

Keywords: curriculum framework, social values, pre university education, SEM.

Përmbledhja:

ABSTRAKT Trendet në rritje të pranishme në procesin e ndryshimeve socio-ekonomike dhe teknologjike kanë sjellë në një situatë ku mund të përballemi me disa probleme me vlerat shoqërore në shumicën e shoqërive tona. Shumica e këtyre problemeve shoqërore janë të lidhura ngushtë me vlerat. Andaj, nuk ka dyshim se të mësuarit për vlerat është e rëndësishme edhe për mekanizmin e kontrollit shoqëror dhe si një pjesë jetike e integritetit shoqëror, edukimi për vlerat është një zgjidhje për trajtimin e çdo problemi ekzistues ose potencial në aspektin shoqëror. Në rastin e Kosovës, shoqëria kosovare ka kaluar një fazë të tranzicionit të thellë si në aspektin politik, ekonomik dhe atë social. Prandaj, hulumtimi mbi vlerat shoqërore dhe promovimi i tyre në arsimin parauniversitar do të sigurojë një bazë të mirë për reformat dhe rekomandimet për politikëbërësit, si dhe politikat në lidhje me edukimin qytetar dhe zbatimin e kurrikulës për kompetencën e qytetarisë. Nga autorët e ndryshëm është theksuar rëndësia e arsimit respektivisht shkollës si institucion e cili ka ndikim në krijimin dhe mbajtjen e kohezionit social përmes transmetimit dhe pranimit të vlerave të përbashkëta. Vlerat shoqërore janë besime morale dhe parime që pranohen nga shumica, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia dhe stabiliteti i një shoqërie. Arsimi jo vetëm që ofron një platformë për sukses, por edhe njohuri të sjelljes shoqërore, forcës, karakterit dhe vetëvlerësimit. Edukimi mbi vlerat nënkupton thjeshtë dallimin mes së drejtës dhe së gabuarës. Vlerat janë ato që pranohen nga grupi, komuniteti ose shoqëria dhe të gjitha aspektet janë të rëndësishme dhe ndër lidhen me njëra-tjetrën. Prandaj, duke marrë parasysh rëndësinë e arsimit për vlerat shoqërore, qëllimi kryesor i këtij punimi është të analizojë promovimin e vlerave shoqërore përmes kornizës së kurrikulës për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës. Vlerësimet mbi rëndësinë e edukimit për vlerat në shoqëri janë të përfshira në Kornizën Kurrikulare të Kosovës dhe promovimi dhe kultivimi i vlerave janë vendosur si një fushë e veçantë brenda kurrikulës. Për më tepër, përveç analizimit të librave shkollorë dhe planeve mësimore në promovimin e vlerave shoqërore, do të konsiderohet gjithashtu ndikimi i kompetencave sipas kurrikulës në arritjen e qëllimit të promovimit të vlerave shoqërore në arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës. Në këtë drejtim, analiza përfshin një pyetësor të destinuar për të gjithë mësuesit e përfshirë në fushën e edukimit qytetar në mënyrë që të sygjerojë konkluzione dhe rekomandime në lidhje me promovimin e vlerave shoqërore dhe kompetencat e edukimit qytetar. Për të arritur qëllimin kryesor të këtij hulumtimi, është përdorur metoda e ekuacioneve strukturore ose e njohur ndryshe si SEM, me ç'rast variabla e varur ka një variabël latente (e pavëzhguar), ndërsa si variabla të pavarur kemi variabla shpjegues në bazë të të cilave ne do të jemi në gjendje të japim sygjerime në lidhje me variablën e varur. Kështu, analiza do të përpiqet të

përcaktojë nëse vlerat shoqërore të promovuara përmes kurrikulës paraqiten qartë përmes teksteve dhe programeve mësimore, variabli i varur do të jetë një variabël latent (i pa vëzhguar), ndërsa si variabla të pavarur ose shpjegues përcaktohen: tekstet shkollore të edukimit qytetar, barazia gjinore, toleranca fetare, multikulturalizmi, të drejtat e njeriut dhe demokracia, të cilat përfshihen në librat shkollorë.

Abstract:

ABSTRACT The increasing trends present in the process of socio-economic and technological changes have brought us to a situation where we can face several problems with social values in most of our societies. Most of these social problems are closely associated to the values. Therefore, there is no doubt that learning about values is also important for the mechanism of social control and as a vital part of social integrity, values education is a solution to address any existing or potential social problem. In addition, Kosovo society has undergone a phase of deep transition in all aspects of political, economic and social aspects. In the case of Kosovo, Kosovo society has undergone through a phase of deep transition both politically, economically and socially. Therefore, research on social values and their promotion in pre-university education will provide a good basis for reforms and recommendations for policy makers, as well as policies related to civic education and the implementation of the curriculum for civic competence. Various authors have emphasized the importance of education, respectively the school as an institution which has an impact on creating and maintaining social cohesion through the transmission and acceptance of common values. Social values are moral beliefs and principles that are accepted by the majority, in order to ensure the continuity and stability of a society. Education not only provides a platform for success, but also knowledge of social behavior, strength, character, and self-esteem. Education on values simply means distinguishing between right and wrong. Values are those accepted by the group, community or society and all aspects are important and interrelated. Therefore, taking into consideration the relevance of the social value education, the main objective of this paper is to analyze the promotion of social values through the curriculum framework for pre-university education in the Republic of Kosovo. Assessments on the importance of values education in society are included in the Kosovo Curriculum Framework and the promotion and cultivation of values are set as a separate area within the curriculum. Furthermore, in addition to the analysis of textbooks and teaching plans in the promotion of social values, the impact of curricular competencies in achieving the goal of promoting social values in pre-university education in the Republic of Kosovo will also be considered. In this regard, the analysis include a questionnaire intended for all the teachers included in the area of civic education in order to suggest conclusions and recommendations regarding the promotion of social values and competence of civic education. In order to accomplish the main goal of this research, the method of structural equations or otherwise known as SEM was used, in which case the dependent variable has a latent variable (unobserved), while as independent variables we have explanatory variables based on which we will be able to give suggestions about the dependent variable. Thus, the analysis will try to determine whether the social values promoted through the curriculum are clearly presented through textbooks and curricula, the dependent variable will be a latent (unobserved) variable, while as independent or explanatory variables are defined: civic education textbooks, gender equality, religious tolerance, multiculturalism, human rights and democracy, which are included in textbooks.

Lista e autorëve - Author list

- Ada Kocani, 184
Adisa Daberdini, 172, 175
Aida Spahiu, 160
Aleksander Peqini, 103, 141
Alfons Harizaj, 83
Ali Caka, 71, 89
Alketa Qosja (Hoxha), 124
Arbër Hyseni, 152
Ardian Maci, 105
Arjana Ylli, 115
Arli Minga, 83
Arta Basha - Jakupi, 87
Aziz Behrami, 120
Besnik Dobi, 181
Besnik Faskaj, 127
Blenard Xhaferaj, 146
Blerim Rexha, 78, 81
Blerina Harizaj, 54
Blerta Derhemi, 66
Bleta Berisha, 68
Burim Hoxhaxhiku, 149
Dasara Pula, 165
Dervish Elezi, 168
Edlira Birko, 41
Edmond Buharaja, 24
Edmond Demollari, 141
Edmond Muço, 13
Egzon Fetahu, 133
Elfrida Shehu, 168
Eliona Lici, 50
Elmira Mucopataj, 34
Elona Gjellaj, 64
Emil Lafe, 74
Endrit Kelmendi, 157
Enkelejda Koka, 96
Eris Rusi, 38
Ermal Dobi, 181
Ervin Pupe, 94
Etleva Jojiç, 103, 141
Fatos Rexhepi, 120
Fatos Ylli, 118
Festim Rexhepi, 170
Fisnik Morina, 112
Florian Kongoli, 178
Florije Tahiri, 109
Fotion Mitrushi, 118
Gentian Zyberi, 92
Gresa Kuleta, 87
Hekuran Hasanaj, 47
Igli Bisha, 85
Irfan Voca, 133
Isak Shabani, 78
Isli Addiu, 96
Ismail Kamberi, 62
Ismet Mulliqi, 170
Izet Ibrahimimi, 136, 144
Justina Pula, 178
Kadri Sylejmani, 81
Klevis Dajlani, 105
Kristaq Jorgo, 36
Kristjana Sulejmani, 103
Laura Binxhia, 115
Laura Binxhija Qeska, 129
Lindita Dhamo, 160
Liri Miho, 105
Lirim Sulko, 29
Loreta Loli, 52
Loreta Nakuçi, 160
Lotar Kurti, 118
Luljeta Dano, 45
Mehush Aliu, 154, 157
Mensur Kelmendi, 154, 157
Milaim Sadiku, 149, 152
Miranda Harizaj, 83, 85
Muhabere Maliqi, 15, 186
Muharrem Zabeli, 144
Musa Rizaj, 136, 178
Mustafa Ibrahimimi, 58
Ndoc Vata, 141
Neli Naço, 26
Novrus Metaj, 172, 175
Nurten Beligradi-Deva, 136, 144
Olsid Mema, 141
Pietro Belba, 138
Ramadan Dervishi, 78, 81
Renata Kau, 99
Riza Braholli, 43

Rrapo Ormeni, 175
Rudina Alimerko, 32
Rudina Pirushi, 124
Sadija Kadriu, 149, 152
Sevdail Demiri, 60
Shpresa Casli, 168
Sofjana Veliu, 99
Sokol Saraci, 17
Sonila Dobi, 181
Teuta Dhima, 22
Ujmir Uka, 133
Valbona Alliu, 124
Valdet Gjinovci, 170
Vehbi Neziri, 78, 81, 89
Vilma Tomço, 83
Vjollca Belegu-Caka, 20
Vlora Navakazi, 87
Yllka Mehana, 149
Zarife Bajraktari-Gashi, 162
Zeqirja Neziri, 56
Zile Kryeziu, 11

ISBN-13: 978-6084980001